



ADEM BEHA

MES
**STABILITETIT
&
DEMOKRATIZIMIT**

ZGJEDHJET, PARTITË POLITIKE DHE
DEMOKRACIA BRENDAPARTIAKE
NË KOSOVË

PRISHTINË
2017

FRIEDRICH
EBERT
STIFTUNG

CPC
Center for Political Change

ADEM BEHA

MES STABILITETIT DHE DEMOKRATIZIMIT

Zgjedhjet, partitë politike dhe demokracia brendapartiake në Kosovë

CPC & FES

Prishtinë, 2017



Recensentë:

Prof. Asoc. Dr. Bekim Baliqi
Prof. Ass. Dr. Anton Vukpalaj
Dr. Gezim Visoka

Titulli: Zgjedhjet, partitë politike dhe demokracia brendapartiake

Autor: Adem Beha

Përkthyes nga shqipja në anglisht: Flori Agalliu

Lektor i botimit në shqip: Gazmend Bërlajolli

Koordinator: Besa Luzha

Redaktor: Arben Hajrullahu

Botues: Qendra për Kurajë Politike dhe Departamenti i Shkencës Politike,
Universiteti i Prishtinës (Kosovë)

Mbështetur nga: Friedrich Ebert Stiftung

Shtypi dhe dizajni: Milky Way Creative

Tirazhi: 500

Botuar në Prishtinë, 2017

© Të drejtat e ribotimit i takojnë autorit dhe botuesit

ISBN 978-9951-8857-3-7

Pikëpamjet e shprehura në këtë libër nuk pasqyrojnë
domosdo ato të Friedrich Ebert Stiftung.

PËRMBAJTJA

Hyrje	7
Konsiderata teorike: partitë politike, demokracia brendapartiake dhe sistemi zgjedhor	13
Zgjedhjet si 'blerje' e stabilitetit – status-quo-izmi si strategji e UNMIK-ut	31
Rikonfigurimi i pushtetit në Kosovë dhe përtej – zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2004	61
Roli i partive politike në shtetndërtimin e Kosovës	79
“Keqkuptimi i Demokracisë” në Kosovën e pavarur - manipulimi i zgjedhjeve dhe “Dello-Kracia”	107
Simulacra e zgjedhjeve 2014 – premtimet, krizat dhe kauzat	143
Zhvillimi ekonomik, korrupsioni dhe zhgënjimi nga EULEX-i	167
Demokracia brendapartiake	191
Përfundime	269
Bibliografia	283

HYRJE

Gjatë viteve 90-të të shekullit të kaluar, me shfaqjen e partive të para politike nën kushtet e patronizimit të Serbisë mbi Kosovën, në skenën politike kosovare u vendos një *pluralizëm i simuluar*. Deri më 1996, ndërsa Jugosllavia po shpërbëhej dhe sistemi komunist po rrënohej, në Kosovë qenë shfaqur dhe organizuar 15 parti të ndryshme politike.¹ Kjo ndarje e madhe e grupimeve politike i leverdiste politikës së Milošević-it për faktin se nëpërmjet ndarjeve të tilla ndërshtepëtare, Beogradi shpresonte ta kontrollonte më mirë situatën politike në Kosovë. Me gjithë këto ndarje, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) mbeti grupacioni më i madh politik në Kosovë në mesin e subjekteve politike të tjera si Partia Parlamentare e Kosovës, Parlamenti i të Rinjve të Kosovës, Partia Demokristiane, Partia Fshatare e Kosovës etj.

Shkelzen Maliqi argumentonte se pluralizmi gjatë periudhës së sundimit të Jugosllavisë së Milošević-it mbi Kosovën ishte thjesht fasadë, kurse subjektet politike nuk ishin parti politike të njëmendta.² Megjithëse u krijua ky lloj pluralizmi, Oliver Schmitt vëren se “[...] mes viteve 1992-1995, LDK sundoi në shoqërinë kosovare pothuajse e pasfiduar”³ duke e lënë në hije shumicën e partive të tjera.

¹ International Crisis Group, ‘Unifying the Kosovar Factions: The Way Forward’ (ICG Balkan Report no 58, Brussels – Tirana, 12 March 1999), f. 3.

² Shih Shkelzen Maliqi, *Kosovo: Separate Worlds* (Dugagjini PH, MM, Prishtina 1998), f. 16.

³ Oliver Jens Schmitt, *Kosova: Histori e Shkurtër e Një Treve Qendrore Ballkanike* (KOHA, Prishtinë, nëntor 2012), f. 250.

Pas hyrjes së NATO-s më 1999, e cila u pasua nga vendosja e administratës së UNMIK-ut dhe largimi i forcave dhe i pushtetit serb nga Kosova, skena politike kosovare u tensionua mes LDK-së dhe forcave politike që e kishin organizuar luftën e armatosur. Ky polarizim i shtirur politik krijoi mjegullën e parë të mungesës së llogaridhënies politike të dy forcave politike më të mëdha në vend. Nga njëra anë LDK-ja, pas organizimit të referendumit për shpalljen e pavarësisë së Kosovës më 1991 (që nuk pati efekte ndërkombëtare) pati ndërtuar një qeveri në ekzil të udhëhequr nga Kryeministri Bujar Bukoshi. Ky e kishte iniciuar të ashtuquajturin ‘Fondi tre%’, nëpërmjet të cilit diaspora shqiptare kontribuonte për organizimin e jetës paralele në Kosovë, respektivisht për financimin e arsimit dhe të shëndetësisë, si dy shtyllat kryesore për mirëmbajtjen e rezistencës civile dhe të kohezionit demografik shqiptar në Kosovë. Nga ana tjetër, një tjetër fond, i njohur si ‘Vendlindja thërret’, që krijuar nga përfaqësuesit e UÇK-së në diasporë, të cilët më vonë do të bëhen figura qendrore të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK). Edhe këtë fond e mbështeste diaspora në përkrahje të luftës së UÇK-së. Asnjëra nga partitë, respektivisht asnjëri nga drejtuesit e këtyre dy fondeve nuk kanë raportuar se ç’shuma qenë shpenzuar saktësisht nga këto burime dhe as ku e si.

Së fundi u hodh pakëz dritë – mes viteve 2006 e 2011 nga ‘Fondi tre%’ ka pasur tërheqje të një shume prej mbi gjysmë milioni eurosh. Sipas hulumtimit të portalit Insajderi del se Fondi i Republikës së Kosovës ishte regjistruar si OJQ dhe zotëronte llogari bankare në Gjermani, Itali, Shqipëri dhe Belgjikë. Në fund të vitit 2000, zoti Isa Mustafa, ish-Ministër i Financave në qeverinë e Republikës së Kosovës që udhëhiqej nga Bukoshi, tashmë kryetar i LDK-së dhe kryeministër i Kosovës, pati deklaruar se në fond kishin

mbetur edhe afro 50 milion marka gjermane.⁴ Fare pak dritë u hodh edhe mbi fondin ‘Vendlindja thërret’, të menaxhuar nga tashmë drejtues të PDK-së. Të dyja partitë kryesore, LDK dhe PDK, e kanë shmangur debatin publik rreth përgjegjësiwe përkatëse për menaxhimin e jetës paralele institucionale në Kosovë dhe për organizimin e luftës për çlirimin e Kosovës.

Me përfundimin e luftës, UNMIK vendosi infrastrukturën juridike për operimin e pluralizmit politik në Kosovë. Lidhja Demokratike e Kosovës vazhdoi ta mbante epërsinë politike edhe në Kosovën e pasluftës. Megjithatë, edhe partitë e sapo-themelura, të cilave lidërshipi u vinte nga UÇK-ja, e sidomos PDK dhe AAK, kishin marrë numër të konsiderueshëm votash në zgjedhjet e pasluftës.

Njëri ndër keqkuptimet kryesore të administrimit ndërkombëtar të UNMIK-ut mbi Kosovën, sipas King dhe Mason, ishte fakti se në sytë e UNMIK-ut partitë politike kosovare trajtoheshin si parti perëndimore, ose “një grup me mendje qytetare të mbledhura rreth përkushtimit të përbashkët ndaj parimeve të caktuara ideologjike. Në të vërtetë, ato ishin rrjete patronazhi të udhëhequra nga një personalitet...”⁵ Me fjalë të tjera, partitë politike gjatë kësaj periudhe, sikurse edhe sot, nuk udhëhiqeshin prej parimeve ideologjike, por prej logjikës klienteliste dhe patrimoniale.

UNMIK-ut nuk i interesonte shumë organizimi i brendshëm i subjekteve partiake në Kosovë. Këtij misioni i interesonte të dinte ‘kush është kush’ nëpër rajonet kryesore të Kosovës dhe të ndiqte strategjinë e bashkëpunimit vetëm me liderët partiakë. Përmes tyre, në njërën anë, e legjitimonte ushtrimin e pushtetit në sytë e

⁴ Vehbi Kajtazi, ‘Transaksionet e dyshimta nga fondi i 3 %-shit – tërheqje parash deri në vitin 2012’, Insajderi, 19 shkurt 2016. Qasur në <http://www.insajderi.com/hulumtime/transaksionet-e-dyshimta-nga-fondi-i-3-shit-terheqje-parash-deri-ne-vitin-2012/> (2 qershor 2016).

⁵ Iain King dhe Whit Mason, *Paqe me çdo kusht: Si dështoi bota në Kosovë* (KOHA: Prishtinë), f. 249.

kosovarëve dhe, në anën tjetër, kontrollonte shumicën e territorit të Kosovës, respektivisht mirëmbante paqen në rajonet kryesore të Kosovës, të kontrolluara nga këta liderë. Zgjedhjet e organizuara para pavarësisë së Kosovës shiheshin në ‘sytë’ e UNMIK-ut si instrument stabiliteti dhe blerje kohe në mungesë të një strategjie dalëse nga Kosova dhe jo si pjesë e procesit të demokratizimit të shoqërisë. Kjo paradigmë me ‘zgjedhjet si instrument stabiliteti’ u ndoq deri në shkurt të vitit 2008, kur Kosova shpalli pavarësinë. Duke qenë se as demokratizimi i përgjithshëm i shoqërisë dhe as demokracia brendapartiake nuk ishin prioritetet e UNMIK-ut, liderët partiakë fituan fuqi politike mbipartiake.

Në të parat zgjedhje lokale dhe ato të përgjithshme të organizuara në Kosovë, gara politike u zhvillua me një ashpërsi retorike. Partitë politike, sidomos LDK dhe PDK, etiketonin njëra-tjetrën me kategori politike pothuajse schmittiane ‘mik-armik’.⁶ Përfaqësuesit e PDK-së i etiketonin disa prej figurave kyçe të LDK-së si tradhtarë, për faktin se, sipas tyre, LDK-ja nuk e kishte përkrahur luftën çlirimtare të UÇK-së. Në një ambient politik ku partitë e trajtonin njëra-tjetrën si ‘armike’, problemi i demokratizimit brendapartiak nuk ishte fare temë prioritare. Demokratizimi i brendshëm partiak, autonomia e degëve dhe e nëndegëve, pluraliteti i mendimeve dhe i qasjeve kundrejt politikës partiake, përzgjedhja meritokratike e kandidatëve të partive politike, nuk ishin pjesë e agjendës politike të partive politike. Meqë demokracia e instaluar në Kosovë ishte ‘demokraci konsociative’, asnjëra prej partive, duke

⁶ Për Schmitt, politikja është një prurje e grupimeve të reja që identifikohen me dikotominë miq-armiq. Schmitt vëren se për të qenë armik politik nuk do të thotë të jesh doemos moralisht i lig ose estetikisht i shëmtuar, ekonomikisht i fuqishëm e kështu me radhë. Armik është ai që është ‘ekzistencialisht i ndryshëm dhe i huaj dhe me të cilin, në raste ekstreme, konfliktet janë të mundshme. Shih Carl Schmitt, *The Concept of the Political* (University of Chicago Press, Expanded edition, 2007). Për një përdorim të këtij koncepti në teoritë politike bashkëkohore, shih Chantal Mouffe, *On the Political* (Routledge; New Ed edition, 2005); Chantal Mouffe, *The Return of the Political* (Verso Books; Revised edition, 2005); Chantal Mouffe, *Agonistics: Thinking the World Politically* (Verso, 2013).

përfshirë këtu edhe LDK-në, nuk kishte mundësi që ta udhëhiqte qeverinë e vetme. Kështu, me anë të koalicioneve të mëdha, në një formë a tjetër, gradualisht ‘u zbut’ dhe ‘u la pas dore’ repertori i cilësimeve si ‘armik’, ‘tradhtar’, ‘i shitur’ etj.

Shtatëmbëdhjetë vjet pas luftës, polarizimi politik i krijuar pas vitit 1999 pothuajse është shkrire. Tani mund të flitet për vendosjen e një *pluralizmi të moderuar*, për faktin se shumica e partive të mëdha në Kosovë, përjashtuar këtu Vetëvendosjen e themeluar së voni, kanë bashkëqeverisur me njëra-tjetrën. Bashkëqeverisja nëpërmjet koalicioneve të mëdha, pa asnjë opozitarizëm politik, ku secila parti bëhej hisedare në ndërtimin e institucioneve qendrore në përpjesëtim me numrin e votave proporcionale, ka bërë që LDK, PDK dhe AAK të mos e ndiejnë presionin e modernizimit, të reformimit a të demokratizimit brendapartiak. Prandaj partitë politike në Kosovë gëzojnë një nam të keq dhe perceptohen si organizata të korruptuara dhe të pabesueshme.⁷ Deri më sot ato nuk ia kanë dalë ta demokratizojnë mirëfilli as vetveten dhe as Kosovën.

Ky studim është i ndarë në tetë kapituj. Kapitulli 1 ofron një kornizë teorike dhe definon konceptin e partisë politike, të demokracisë brendapartiake dhe të sistemit e të rregullave zgjedhore. Kapitulli 2 analizon zgjedhjet e para lokale dhe ato të përgjithshme të organizuara në Kosovën e pasluftës dhe heton se si zgjedhjet ishin parë si instrument për mirëmbajtjen e stabilitetit dhe të *status quo*-së. Kapitulli 3 analizon zgjedhjet e vitit 2004 dhe rikonfigurimin e pushtetit në Kosovë e në rajon, nën dritën e hapjes së negociatave për statusin politik të Kosovës. Kapitulli 4 analizon rolin e partive politike në procesin e shtetndërtimit, mungesën e profilizimit ideologjik partiak, rënien dhe ngritjen e tyre elektorale. Kapitulli 5 analizon zgjedhjet e përgjithshme më 2010, manipulimet zgjedhore, dhe skicon opsionet e ofruara për reformën zgjedhore.

⁷ Transparency International, ‘Shining a light on Political Parties Financing. Albania, Croatia, Kosovo, FYR Macedonia, Serbia’, 2011.

Kapitulli 6 analizon zgjedhjet e vitit 2014, premtimet zgjedhore, bllokadën institucionale në Kosovë dhe kauzat politike të partive politike opozitare. Kapitulli 7 jep një pasqyrë të përgjithshme se si paradigma e stabilitetit me të cilën kishte operuar UNMIK në Kosovë që nga viti 1999 e vonoi procesin e konsolidimit demokratik. Në këtë kapitull fokusi bie jo mbi kauzat e partive politike opozitare, por mbi problemet e përditshme të qytetarëve, duke përfshirë mungesën e zhvillimit ekonomik, korrupsionin endemik në Kosovë dhe zhgënjimet e qytetarëve në raport me misionin e ri të sundimit të ligjit në Kosovë, EULEX-in, të vendosur pas pavarësisë. Kapitulli 8 analizon demokracinë brendapartiake. Në pjesën përmbyllëse paraqiten konkluzionet e këtij studimi.

MES STABILITETIT
DHE DEMOKRATIZIMIT

KAPITULLI I

KAPITULLI 1:

PARTITË POLITIKE, DEMOKRACIA BRENDA PARTIAKE
DHE SISTEMI ZGJEDHOR

KAPITULLI 1: PARTITË POLITIKE, DEMOKRACIA BRENDAPARTIAKE DHE SISTEMI ZGJEDHOR

1.1 Partitë politike

Sipas Kodit për Praktikë të Mirë të Komisionit të Venecias (Këshilli i Evropës) në Fushën e Partive Politike, këto përkufizohen si asocione jofitimprurëse të personave që marrin pushtetin nga përfaqësuesit e tyre të zgjedhur dhe e ushtrojnë atë për të mirën e përgjithshme. Ky Kod thekson se partitë politike luajnë dy role thelbësore në demokracinë përfaqësuese: një rol shoqëror, duke kontribuar në socializimin politik të qytetarëve dhe artikullimin e pluralizmit ideologjik të tyre, dhe një rol institucional, duke kontrolluar qeverinë dhe duke prezantuar politika dhe kandidatë alternativë.⁸ Roli i partive politike në demokracitë moderne është aq i madh sa studiues të partive politike konkludojnë se pa praninë e tyre nuk do të kishte fare demokraci në formën që njohim sot.

Partitë politike e lidhin shoqërinë me politikën nëpërmjet programeve zgjedhore dhe politikave partiake që synojnë agregimin dhe përfaqësimin e interesave të qytetarëve në institucionet shtetërore. Për ta realizuar këtë funksion, partitë politike ndërtojnë struktura gjithëpërfshirëse ku qytetarët kanë mundësi t'i kanalizojnë interesat dhe nevojat e veta, qoftë si anëtarë të partive politike, qoftë

⁸ Council of Europe, 'Code of Good Practice in the Field of Political Parties', European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), Study No. 414/2006.

Shih [http://www.venice.coe.int/ëebforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2009\)002-e](http://www.venice.coe.int/ëebforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2009)002-e), f. 14 (14 maj 2015).

duke zgjedhur përfaqësues që i konkretizojnë këta interesa dhe këto nevoja.

Rrjedhimisht, duke mobilizuar anëtarë, partitë politike synojnë ta shtrijnë strukturën e tyre sa më shumë në shoqëri, në mënyrë që kjo të përkthehet në më shumë përkrahje, vota dhe autonomi vendimmarrëse. Procesi i zgjedhjes së strukturave të brendshme partiake nga kryetari i një nëndege, dege, e deri te kryetari i partisë, njihet si proces i selektokracisë partiake. Nëse procesi i përfshirjes së votueseve dhe anëtarëve të partive politike në vendimmarrje, në inicimin e ideve, në politika programore dhe partiake, si dhe në përzgjedhjen e strukturave partiake, prej atyre lokale e deri te organi më i lartë i partisë (Kongresi ose Këshilli) është gjithëpërfshirës, atëherë partitë supozohet se kanë më shumë demokraci të brendshme, në krahasim me partitë e tjera që janë përjashtuese, centralizuese dhe lideriste.

Megjithatë, ky diferencim nuk është kaq bardh e zi. Sot, në teorinë e studimeve të partive politike njihet edhe koncepti i ‘presidencializimit të politikës’⁹ që nënkupton se partitë politike në botën moderne po bëhen më centraliste dhe po e identifikojnë vetveten me presidentin. Prirja në ngritje e centralizimit të partive politike moderne, e njohur ndryshe si ‘presidencializim i politikës’, shkaktohet nga një mori faktorësh, duke përfshirë këtu nevojën që kanë partitë politike për të qenë efektive në konkurrencën partiake në sistemin demokratik. Përdorimi i medieve sociale, organizimi i fushatave tejet moderne e të fokusuara, hartimi i programeve nga një grup i ngushtë ekspertësh, dëshmojnë faktin se sot fuqia politike brenda partive politike është e përqendruar tek kryetari i partisë dhe një grup i afërt me të, e se pjesa dërrmuese e strukturës partiake është e përjashtuar nga vendimmarrja. Në studimet teorike partiake

⁹ Thomas Poguntke, Paul Webb (ed.) *The Presidentialization of Politics: A Study in Comparative Politics* (Oxford University Press, Oxford, 2005); Gideon Rahat, Tamir Sheafer, ‘The personalization(s) of politics: Israel, 1949– 2003. *Political Communication* 24 (1), 2007, 65–80.

nga Pateman f.v. ky fenomen është identifikuar si pseudopjesëmarrje:¹⁰ qytetarët marrin pjesë në partitë politike, por nuk kanë ndikim në vendimmarrje.

Konsideratat teorike për tipologjitë e partive politike, ideologjinë partiake dhe funksionin e partive politike në demokraci janë të panumërta.¹¹ Gunther dhe Diamond e kanë zhvilluar një tipologji të partive politike duke i ndarë ato në pesë kategori: partitë elitiste, masive, elektoraliste, etnike dhe partitë lëvizje. Charles S. Mack në mënyrë të përmblodhur i tipizon partitë politike në gjashtë kategori: parti elitiste ose të kuadrove; parti masive, parti që kapin gjithçka ('catch-all parties'); parti kartel, parti biznes, parti në shërbim. Autorë të tjerë, si Katz dhe Mair, kur flasin për partinë politike e nënkategorizojnë atë në tri fytyra: partia politike në terren (partia në bazë); partia politike në zyrë qendrore (partia në qendër); dhe partia politike në zyrë publike (partia në shtet/institucione).

Megjithatë, për qëllime praktike të këtij studimi, do t'i shqyrtojmë vetëm partitë elektoraliste që kapin gjithçka (partitë elektoraliste 'catch-all'), si dhe partitë kundër sistemit. Përkufizimet e këtyre partive janë të përdorshme për të ndërtuar një tipologji për partitë politike në Kosovë. Qysh më 1966, studiuesi i partive politike Otto Kirchheimer, u njoh për emërtimin e partive që kapin gjithçka. Këto parti njihen si organizata të centralizuara dhe karakterizohen me deideologjizim të jetës partiake. Me ngritjen e statusit të klasës

¹⁰ Carole Pateman, *Participation and Democratic Theory* (Cambridge: Cambridge University Press, 1970).

¹¹ Rreth tipologjisë së partive politike shih Richard Gunther & Larry Diamond, 'Species of Political Parties: A New Typology', *Party Politics*, Vol.9, No.2. Rreth tipologjive të tjera, shih Giovanni Sartori, *Parties and Party Systems: A Framework for Analysis* (Cambridge University Press, 1976); Grigorii V. Golosov, 'Party system classification: A methodological inquiry', *Party Politics* 2011, 17:539; Colin Leys, 'Models, theories, and the theory of political parties', *Political Studies*, Vol. 7, Issue 2, 1959; Maurice Duverger, *Political Parties: A Behavioural Analysis* (Rand McNally, 1964); Sigmund Neumann, "Towards a Comparative Study of Political Parties", në Sigmund Neumann (ed.) *Modern Political Parties* (Chicago: University of Chicago Press, 1956).

punëtore dhe zhvillimin e industrializimit dhe modernizimit perëndimor, partitë e masave, nënvizon Charles S. Mack, “u bënë viktimë e suksesit të tyre; shteti i mirëqenies që ato e kishin ndërtuar i solli interesat e punëtorëve dhe të klasës së mesme drejt një bashkimi gjithnjë e më të madh”. Mack argumenton se kësisoj u shfaqën partitë që kapin gjithçka, duke i shlyer vijat e forta ideologjike, dhe filluan ta zgjerorin bazën elektorale me qëllimin përfundimtar synimin e pushtetit. Partitë e tilla sot gjenden kudo në Amerikën Veriore, Evropë, Kanada etj., dhe janë të pajisura me staf profesional, aftësi për të kërkuar fonde dhe shkathhtësi të mira komunikimi.¹² Gunther dhe Diamond i shohin partitë që kapin gjithçka si parti tolerante, pa një ideologji të qartë, por që orientohen krejtësisht nga elektorati nëpërmjet lidhësit qendror të partisë, me qëllim të maksimizimit të votave.¹³ Partitë kundër sistemit dallohen nga partitë ‘catch-all’, pos të tjerash edhe për nga distanca ideologjike jo vetëm me partitë e tjera, por edhe me sistemin në përgjithësi. Në vitin 1976, Sartori i përkufizonte partitë kundër sistemit si opozitë e parimeve, duke vënë në pah se këto parti nuk kanë për qëllim ta ndryshojnë vetëm qeverisjen, por ‘vetë sistemin e qeverisjes’.¹⁴

¹² Charles S. Mack, *When Political Parties Die: A Cross-National Analysis of Disalignment and Realignment* (Praeger, 2010).

¹³ Richard Gunther & Larry Diamond, ‘Species of Political Parties: A New Typology’, *Party Politics*, Vol.9, No.2.

¹⁴ Giovanni Sartori, ‘European Political Parties: The Case of Polarized Pluralism’, në Joseph La Palombara dhe Myron Weiner (ed.) *Political Parties and Political Development* (Princeton University Press), ff. 137-176; Për një rivlerësim të partive kundër sistemit, shih Giovanni Capoccia, ‘Anty-system parties’, *Journal of Theoretical Politics* (2002); 14, 9, ff. 9-35.

1.2 Demokracia brendapartiake

Meqenëse në fokus të këtij studimi nuk janë vetëm partitë politike *per se*, do të mjaftohem duke i vënë në diskutim dy pikëpamjet që lidhin partitë politike me demokracinë dhe me demokracinë brendapartiake. Qysh më 1942, studiuesi i partive politike Schattschneider argumentonte se “partitë politike e kanë krijuar demokracinë moderne dhe demokracia është e papërfytyrueshme pa partitë politike”.¹⁵ Një tjetër studiues, Giovanni Sartori, argumenton se roli kryesor i partive politike është ndërlidhja e qytetarëve me qeverinë.¹⁶ Sartori e definon partinë politike si një “grupim politik që merr pjesë në zgjedhje dhe nëpërmjet tyre është në gjendje t’i vendosë kandidatët e vet në zyrë publike”. Sidoqoftë, G. Sartori, R. Micheals, M. Duverger, si studiues me nam të partive politike, nuk i kushtuan vëmendjen e duhur demokracisë brendapartiake, duke e parë këtë të fundit shpeshherë edhe si pengesë që partitë politike të jenë efektive dhe të afta për të garuar në një treg të ashpër politik. Duke ndjekur argumentin e Sartorit, William P. Cross dhe Richard S. Katz argumentojnë se partitë politike, para së gjithash, janë ekipe politikanësh më shumë sesa asociacione qytetarësh dhe se “esenca e demokracisë është më shumë zgjedhja e lirë mes partive sesa pjesëmarrja e drejtpërdrejtë brenda partive”.¹⁷ Një perspektivë të tillë pesimiste ndaj demokracisë së brendshme partiake e jep edhe Schattschneider, duke argumentuar se “demokracia nuk mund të gjendet në vetë partitë, por mes partive”.¹⁸

¹⁵ Elmer Eric Schattschneider, *Party Government* (New York: Rinehart and Company, 1942) f. 1

¹⁶ Giovanni Sartori, *Parties and Party Systems: A Framework for Analysis* (Colchester, ECPR 2005), f. 11.

¹⁷ William P. Cross & Richard S. Katz, ‘The Challenges of Intra-Party Democracy’, në William P. Cross & Richard S. Katz (ed.), *The Challenges of Intra-Party Democracy* (Oxford University Press, 2013), f. 5.

¹⁸ Elmer Eric Schattschneider, *Party Government* (New York: Rinehart and Company, 1942), f.60.

Një studiues tashmë klasik i partive politike, Robert Michels, pohon se demokracia të çon detyrimisht në oligarki dhe mohon çdo mundësi për demokraci të brendshme partiake. Michels i sheh partitë si organizata politike që luftojnë ndërmjet vete politikisht dhe prandaj përkrah qasjen centralizuese brenda partive politike, për shkak se, sipas tij, partitë politike të centralizuara janë në gjendje të ofrojnë zgjidhje më të shpejta. Kjo nënkupton se vendimet më të rëndësishme brenda partive politike merren vetëm nga një dorë njerëzish dhe, para së gjithash, nga pjesa urbane e organizatës, respektivisht e partisë politike. Michels pohon se partitë politike janë organizata, dhe sa herë përdoret termi ‘organizatë’ nënkuptohet se fjala është për oligarki, një ligj ky që Michels e njeh si ‘ligj i hekurt i oligarkisë’.¹⁹ Një studiues jo më pak i rëndësishëm, M. Duverger, argumenton ngjashëm me Michels:

Parimet demokratike kërkojnë që lidhshipi të zgjidhet në të gjitha nivelet, të ripërtërihet shpesh, të jetë kolektivist në karakter dhe i dobët në autoritet. E organizuar në një mënyrë të tillë, një parti nuk është mirë e armatosur për betejat politike.²⁰

Me fjalë të tjera, argumenti i efikasitetit që ofron Duverger thotë se partitë e organizuara në mënyrë demokratike nuk janë efikase në betejat politike me partitë konkurruese. Këtu, para së gjithash, nënkuptohet se partitë politike konkurrojnë për të fituar sa më shumë vota në tregun politik. Argumenti i Duverger rreth efikasitetit të partive politike në fakt i trajton votuesit ashtu siç kompanitë private dhe bizneset i trajtojnë konsumatorët. Partitë politike nuk janë të interesuara vetëm për anëtarët e tyre partiakë, siç nuk janë të

¹⁹ Robert Michels, *Political Parties: A Sociological Study of the Oligarchical Tendencies of Modern Democracy* (Kitchener, Ontario: Batoche Books, 2001), f.224.

²⁰ Maurice Duverger, *Political Parties: Their Organization and Activity in the Modern State*. (London: Methuen, 1954), f. 134.

interesuara bizneset private vetëm për punonjësit e tyre. Të dy palët duan një klientelë sa më të madhe, që të jenë më rentabile dhe më efikase.²¹

Përmbledhtazi, kundërshtarët e demokracisë së brendshme partiake ofrojnë dy lloj argumentesh kur e kritikojnë demokracinë e brendshme partiake: i pari është argumenti i efikasitetit, kurse i dyti është argumenti i trajtimit të pabarabartë të interesave të qytetarëve. Argumenti i parë propozon se demokracia brendapartiake kërcënon efikasitetin e partisë, garën politike, autonominë për vendimmarrje, dhe çon në humbjen eventuale të zgjedhjeve. Argumenti i dytë mëton se partitë janë përgjegjëse jo vetëm për anëtarët, por për të gjithë qytetarët dhe votuesit e tyre.²²

Jan Teorell, tek ‘Një mbrojtje deliberative e demokracisë brendapartiake’, duke marrë për bazë argumentet e Ware dhe Habermas, ofron një qasje deliberative kundrejt argumenteve të mësipërme. Teorell argumenton se, në kuptimin ekonomik, nuk ka garë të përkryer ndërmjet partive politike. Preferencat e elektoratit shpeshherë luhaten dhe nëse partia politike nuk reflekton dhe nuk jep përgjigje për këto luhata, mund të pësojë humbje dhe parti të reja mund të krijohen. Zgjidhja që propozohet është demokracia e brendshme partiake, me anë të të cilës liderët mbahen përgjegjës përpara anëtarësisë dhe elektoratit në përgjithësi. Kështu, sipas Teorell, partitë politike duhet ta ofrojnë atë hapësirë deliberative demokratike për të gjithë njerëzit, për faktin se as mediat dhe as interneti nuk mund ta realizojnë në plotni këtë funksion. Së këndejmi, Teorell e sheh demokracinë e brendshme partiake si një mekanizëm shtesë të zgjedhjeve të përgjithshme, respektivisht vendosjen e procedurave deliberative ku këmbehen argumentet pro dhe kundër ndërmjet liderëve dhe anëtarëve dhe ku evitohen

²¹ Jan Teorell, ‘A Deliberative Defence of Intra-Party Democracy’, *Party Politics* (1999) 5, 363-382, f. 364.

²² Po aty, f. 365.

ekstremizmat brendapartiakë. Teorell këtu i referohet Habermasit, i cili argumentonte se “partitë politike do të duhej të merrnin pjesë në formimin e vullnetit dhe të opinionit nga perspektiva e vetë publikut më shumë sesa të patronizonin sferën publike për qëllime të mbajtjes së pushtetit”.²³

Susan Scarrow tek ‘Partitë Politike dhe Demokracia në Perspektivën Teorike dhe Praktike’, vëren një rënie të aktivizimit politik dhe ngritje të forcave antidemokratike, si rezultat i shpërbërjes së partive politike nga qytetarët dhe paaftësisë së tyre për t’i përfaqësuar dhe për t’u ofruar zgjidhje qytetarëve. Ajo e definon demokracinë e brendshme si më poshtë:

Demokracia e brendshme partiake’ është një term shumë i gjerë që përshkruan një gamë të gjerë metodash për përfshirjen e anëtarëve në deliberimin dhe vendimmarrjen brendapartiake. Disa që avokojnë për demokracinë e brendshme argumentojnë, në një nivel pragmatik, se partitë që përdorin procedura të brendshme demokratike kanë gjasë të zgjedhin liderë më të aftë dhe më tërheqës, të kenë më shumë politika përgjegjëse dhe, rrjedhimisht, të gëzojnë sukses më të madh elektoral.²⁴

Scarrow argumenton se partitë politike ‘duhet të praktikojnë atë që predikojnë’, me fjalë të tjera: demokracinë. Por, ajo vëren se skeptikët e shohin demokratizimin si ‘kalë Troje’ që vetëm sa e fuqizon lidërshtipin nacional partiak. Ajo i shkoqit tri dimensione të organizimit partiak për ta matur demokracinë brendapartiake. Këto dimensione janë: gjithëpërfshirja (inkluziviteti), centralizimi (qendërzimi i vendimmarrjes) dhe institucionalizimi. Nga këto tri

²³ Po aty, f. 374.

²⁴ Susan Scarrow, ‘Political Parties and Democracy in Theoretical and Practical Perspective: Implementing Intra-Party Democracy’, (National Democratic Institute for International Affairs, 2005), f. 3.

dimensione, Scarrow analizon tre indikatorë të zbatimit të demokracisë brendapartiake. Këta indikatorë janë përzgjedhja e kandidatëve të partisë, përzgjedhja e liderëve të partisë dhe definimi i pozicioneve rreth politikave. Fillimisht, sipas fjalëve të Scarrow, konceptet primare definojnë si në vijim:

Gjithëpërfshirja na tregon se sa i gjerë është qarku i vendimmarrësve në parti [...] Në partitë më inkluzive, të gjithë anëtarëve të partisë, ose madje të gjithë mbështetësve, u jepet mundësia për të vendosur mbi çështjet e rëndësishme, si zgjedhja e liderit partiak ose përzgjedhja e kandidatëve të partisë [...] **Centralizimi** përshkruan shkallën deri ku vendimet merren nga një grup i vetëm ose trup vendimmarrës [...] Nocioni i **institucionalizimit** partiak mund të mbulojë një gamë të gjerë tiparesh, përfshirë autonominë e partisë nga aktorë të tjerë, shkallën e zhvillimit të brendshëm organizativ dhe shkallën deri ku mbështetësit e identifikojnë veten e tyre me partinë dhe e shohin atë si një aktor të rëndësishëm. Në një kuptim më të ngushtë organizativ, dy tipare që e definojnë nivelin e institucionalizimit partiak janë shkalla deri ku procedurat e vendimmarrjes së brendshme janë të formalizuara, si dhe shkalla deri ku partia ka koordinuar strukturat përgjatë konstituentëve të synuar.²⁵

²⁵ Susan Scarrow, 'Political Parties and Democracy in Theoretical and Practical Perspective: Implementing Intra-Party Democracy', (National Democratic Institute for International Affairs, 2005), f. 6.

1.3 Rregullat zgjedhore dhe sistemi zgjedhor

Sistemet zgjedhore janë produkte të rrethanave të ndryshme politike të shoqërive të ndryshme. Këtu përfshihen historitë dhe kultura politike e vendeve të ndryshme, preferencat e elitave politike për një ose një tjetër sistem zgjedhor, struktura e shoqërive, ndarjet sociale dhe kompozicioni heterogjen apo homogjen i tyre.²⁶ Ka aq shumë studime për sistemet zgjedhore edhe efektet e tyre përfaqësuese, saqë një trajtim përmbledhës i një materiali të tillë do të ishte gati i pamundshëm. Mjafton të themi se mund të jenë botuar mbi dhjetëra mijëra studime mbi format dhe efektet e përfaqësimit dhe të sistemit zgjedhor. Sipas një listimi të njërit prej studiuesve më me nam të partive politike, Richard S. Katz, vetëm në vitin 1989 kishte mbi 1500 studime në këtë fushë, kurse tre vjet më vonë ky numër ishte rritur në 2500. Studimet për rregullat dhe sistemet zgjedhore u intensifikuan shumë sidomos pas Luftës së Dytë Botërore, e veçmas pas asaj që Samuel Huntingon e quan ‘Valë e Tretë e Demokratizimit’. Transicioni nga autoritarizimi drejt hapjeve dhe demokratizimit të sistemeve të ndryshme politike e shoqërore, shoqërohej para së gjithash me debatin e riorganizimit politik, me fjalë të tjera, me debatin për rregullat zgjedhore dhe sistemin zgjedhor, i cili më pastaj do të përcaktonte përmbajtjen dhe funksionimin e sistemit politik. Sa për t’i përmendur vetëm disa studiues eminentë: Micheal Gallagher, Arendt Lijphart, Donald

²⁶ Gianfranco Baldini dhe Adriano Pappalardo, *Elections, Electoral Systems and Volatile Voters* (Palgrave Macmillan, 2009), f. 4. Po ashtu, Andrew Reeve dhe Alan Ware argumentojnë se kundërshtimet rreth sistemeve zgjedhore ishin në qendër të debatit politik kah fundi i viteve ‘50-të. “Sigurisht, deri në fund të viteve 1950, shumë shkencëtarë politikë (dhe politikanë gjithashtu) besonin që mund të korni rezultate të dëshiruara politike thjesht duke ndërtuar një kornizë të caktuar institucionale (qeveria britanike më 1950 duket se besonte që mund të krijonte demokraci liberale në ish-kolonitë e saj afrikane duke i vendosur institucionet e veta parlamentare atje; kjo përpjekje dështoi me të madhe”. Andrew Reeve dhe Alan Ware, *Electoral Systems: A comparative and theoretical introduction* (Routledge, 2011), f. 8.

Horwitz, Giovanni Sartori, Mathew Shugart, Rein Tagapera, në mesin e shumë të tjerëve, kanë dhënë kontribut domethënës në studimin e rregullave dhe të sistemeve zgjedhore.²⁷

Sipas studiuesve të sistemeve zgjedhore, rregullat zgjedhore dallojnë prej sistemit zgjedhor. Për Gary W. Cox, sistemi zgjedhor duhet të kuptohet si një “grup i ligjeve dhe i rregullave partiake që e rregullojnë garën zgjedhore mes dhe brenda partive”. Për më tej, sipas tij “[...] këto ligje dhe rregulla rregullojnë se si partitë i bëjnë nominimet e tyre, si votojnë qytetarët dhe se si numërohen këto vota; si do të jetë struktura e distrikteve të sistemit; dhe si votat e numëruara përkthehen në ulëse”.²⁸ Kështu sipas Cox, praktikat e shteteve për rregullimin e aspekteve të mësipërme janë të ndryshme: në disa shtete shumë prej aspekteve të lartpërmendura rregullohen me anë të rregulloreve partiake, kurse disa të tjera nëpërmjet ligjeve të shteteve respektive. Sistemi zgjedhor më shumë ka të bëjë me metodën për përkthimin e votave të kandidatëve/listave në ulëse të alokuara për kandidatë dhe lista partiake respektive. Kjo njihet ndryshe edhe si ‘formula elektorale’.

Studiues të tjerë e kanë ngushtuar edhe më tej përkufizimin për sistemin zgjedhor. Sipas Gianfranco Baldini dhe Adriano Pappalardo “sistemi zgjedhor mund të përkufizohet si një grumbull i ligjeve që rregullon transformimin e preferencave në vota dhe të votave në ulëse. Ky përkufizim nënvizon bashkekzistencën e dy elementeve në kursin e përfaqësimit politik: mundësitë që fletëvotimi u jep zgjedhësve për të shprehur zgjedhjet dhe pasojat e këtyre zgjedhjeve në kuptimin e ndarjes së zyrave për të cilat ka votuar elektorati”.²⁹ Edhe studiues të tjerë me nam si Michael

²⁷ David M. Farrell, *Comparing Electoral Systems* (Macmillan Press Ltd, 1998), f. 2.

²⁸ Gary W. Cox, *Making Votes Count: Strategic Coordination in the World's Electoral Systems* (Cambridge University Press, 1997), f. 38.

²⁹ Gianfranco Baldini dhe Adriano Pappalardo, *Elections, Electoral Systems and Volatile Voters* (Palgrave Macmillan, 2009), f. 17.

Gallagher dhe Paul Mitchel e përkufizojnë sistemin zgjedhor si “një numër rregullash që strukturon se si votat hidhen në zgjedhje për një asamble përfaqësuese dhe se si këto vota pastaj konvertohen në ulëse në atë asamble. Duke marrë për bazë këtë numër të votave, një sistem zgjedhor përcakton përbërjen e parlamentit”.³⁰ Sipas tyre, sistemi zgjedhor, si përkufizim, është më i ngushtë, në krahasim me rregullat zgjedhore, ku përfshihen e drejta e votës, paanshmëria e administrimit të zgjedhjeve, transparenca e numërimit të votave etj.

Giovaneni Sartori, njëri prej studiuesve më eminentë në fushën e demokracisë dhe të sistemeve zgjedhore, ka argumentuar se sistemi zgjedhor është “instrumenti manipulativ më specifik i politikës”.³¹ Pasojat e sistemit zgjedhor janë gjithmonë politike. Funksionimi dhe karakteri i një sistemi politik varen kryekëput prej sistemit zgjedhor. Vendosja e rregullave të lojës politike nëpërmjet sistemit zgjedhor ndikon drejtpërdrejt në formimin e institucioneve qeverisëse, në karakterin unitar ose federal të tyre, numrin e partive politike, madhësinë e distrikteve zgjedhore, garën elektorale dhe koalicionet politike, përjashtimin ose përfshirjen e grupeve të caktuara, kompozicionin e qeverisë, si dhe modelin e demokracisë që një vend vendos të ndjekë – konsensuale apo mazhoritare. Siç pohojnë Andrew Reeve dhe Alan Ware, përzgjedhja e një sistemi zgjedhor është aq e rëndësishme sa, fjala vjen, një parti ose kandidat që do të mund të zgjidhej në një sistem proporcional, do të mund të dilte parti ose kandidat humbës në një sistem mazhoritar. Siç argumentojnë këta studiues, “ndryshimi i rregullave zgjedhore mund të ndryshojë ‘formën’ e politikës zgjedhore”.³² Duke marrë për bazë

³⁰ Micheal Gallagher dhe Paul Mitchel, ‘Introduction to Electoral Systems’, në Micheal Gallagher dhe Paul Mitchel, *The Politics of Electoral Systems* (Oxford University Press, 2005), f. 4.

³¹ Giovaneni Sartori, ‘Political development and political engineering’, f. 261-98 në J. D. Montgomery & A.O. Hirschman (eds.), *Public Policy*, Vol. 17. (Cambridge, MA: Harvard University Press, 1968).

³² Andrew Reeve dhe Alan Ware, *Electoral Systems: A comparative and theoretical introduction* (Routledge, 2011), f. 8. Reeve dhe Ware, këtë konstatim e

efektet e mëdha që kanë sistemet zgjedhore, argumenton Sarah Birch, aktorët politikë në vendet postkomuniste e kanë hetuar se përmbajtja dhe forma e një sistemi zgjedhor mund të përcaktojë edhe fatin e tyre politik dhe këta aktorë kanë qenë shumë të interesuar t'i manipulojnë institucionet zgjedhore për qëllime vetjake. Birch ka studiuar reformat elektorale në 20 shtete të Evropës Qendrore dhe Lindore për të ardhur në përfundimin se shumica e këtyre sistemeve karakterizohen me tipare të përbashkëta. Së pari, është lëvizja nga sistemi mazhoritar i një distrikti të vetëm drejt rritjes graduale të barrierave për t'u futur në institucione, nëpërmjet pragut zgjedhor, mesatarja e të cilit në 20 shtetet e analizuara është 4.25, në krahasim me 1.23 në shumicën e sistemeve proporcionale në Evropën Perëndimore. Së dyti, më të popullarizuarat në këto shtete janë sistemet e përziera zgjedhore. Së treti, në shumicën e shteteve postkomuniste, sistemi zgjedhor është i trupëzuar në vetë Kushtetutën e shtetit, si në Poloni, Çeki, Gjeorgji, Slloveni, Hungari etj.³³

Sistemet zgjedhore të caktuara prodhojnë efekte të caktuara politike. Për rrjedhojë, një qeveri mund të jetë më stabile e më efektive ose më jostabile e më joefektive varësisht prej tipit të sistemit zgjedhor. Sidoqoftë, qenësor për çdo sistem zgjedhor është koncepti i përfaqësimit. Nëpërmjet sistemeve zgjedhore përfaqësohen grupe dhe interesa të ndryshëm dhe shpeshherë

ilustrojnë me reduktimin e ndikimit të partisë komuniste në Francë mes Republikës së Katërt dhe të Pestë (1946-58). Sipas tyre, 'gjatë Republikës së Katërt (1946-58), komunistët zakonisht tërhiqnin rreth një çerekun e votave totale dhe i përkthenin këto në numër të deputetevë në Parlamentin Francez. Prania e një grupi të tillë të madh që e kundërshtonin regjimin ishte shkaktar i rëndësishëm i krizës qeverisëse me të cilën ballafaqohej regjimi. Me rregullat e reja të adoptuara nga Republika e Pestë, për komunistët ishte bërë më e vështirë t'i përkthenin votat e tyre në ulëse parlamentare. Ky nënpërfaqësim i komunistëve ishte njëri prej faktorëve kontributdhënës për një stabilitet më të madh të regjimit'.

³³ Sarah Birch, *Electoral Systems and Political Transformation in Post-Communist Europe* (Palgrave Macmillan, 2003), f. 31-40.

antagonistë në institucionet publike.³⁴ Machover bën një dallim mes dy kuptimeve të ndryshme të nocionit ‘përfaqësim’ dhe derivateve të tij. Këtë dallim e bën duke pyetur kush apo çfarë janë ‘përfaqësuesit’ dhe kë apo çfarë supozohet se e përfaqësojnë?³⁵ Sipas Gianfranco Baldini dhe Adriano Pappalardo, teoritë e përfaqësimit bëjnë dallimin mes përbërjes të qeverisë dhe vendimeve të saj. Ndërsa sistemet proporcionale zgjedhore vënë theksin tek përbërja e qeverisë, ato mazhoritare e vënë tek efikasiteti i qeverisë që i ka fituar zgjedhjet për të marrë vendime efektive. Ata që avokojnë për sistemet proporcionale mendojnë se ky sistem garanton përfaqësim më të mirë. Këtu qeveria dhe parlamenti kuptohen si mikrokozmos ose pasqyra të shoqërisë. Me fjalë të tjera, të gjitha ndarjet sociale të pranishme në një shoqëri – duke përfshirë këtu klasat, religjionet, etnitë, gjuhët e ndryshme – duhet të pasqyrohen/përfaqësohen në këto institucione.³⁶ Ky është konceptimi ‘mikrokozmiq’ i përfaqësimit, ku parlamenti dhe qeveria përfaqësojnë shoqërinë në miniaturë. David M. Farrell bën dallim mes këtij koncepti ‘mikrokozmiq’ të përfaqësimit, dhe një koncepti tjetër që quhet ‘agjenti kryesor’ (principal agent) i përfaqësimit. Sipas konceptit të dytë, kompozicioni social, demokratik, gjeografik, a etnik i parlamentit është më pak i rëndësishëm. E rëndësishme, sipas këtij koncepti, është që njerëzit e zgjedhur për të udhëhequr me institucionet respektive në qeveri dhe parlament të marrin vendime që mbrojnë interesat e qytetarëve.³⁷

Studiuesit e sistemeve zgjedhore, varësisht prej

³⁴ Pietro Grilli di Cortona, Cecilia Manazi, Aline Pennisi, Federica Ricca, Bruno Simeone, *Evaluation and Optimization of Electoral Systems* (SIAM Monographs, 1998), f. 5.

³⁵ Mosh'e Machover, 'The Underlying Assumptions of Electoral Systems', në Dan S. Felsenthal dhe Mosh'e Machover (ed.), *Electoral Systems: Paradoxes, Assumptions, and Procedures* (Springer, 2012), f. 5.

³⁶ Gianfranco Baldini dhe Adriano Pappalardo, *Elections, Electoral Systems and Volatile Voters* (Palgrave Macmillan, 2009), f. 18-19.

³⁷ David M. Farrell, *Comparing Electoral Systems* (Macmillan Press Ltd, 1998), f. 7.

karakteristikave të tyre, kanë tipologjizuar disa sisteme zgjedhore. Disa autorë i ndajnë sistemet zgjedhore në proporcionale dhe joproporcionale, kurse këta pastaj i nëndajnë në disa nëntipa tjera.³⁸ Disa të tjerë i ndajnë sistemet zgjedhore në tre tipa: sistem zgjedhor mazhoritar, proporcional dhe të përzier. Sistemi zgjedhor mazhoritar mbizotëron pothuajse në të gjitha shtetet evropiane në fillim të shek. XX, kurse sot shumica e shteteve evropiane aplikojnë një formë ose një tjetër të sistemit zgjedhor proporcional. Siç ka argumentuar Stein Rokkan, e drejta universale e votës kishte prodhuar dy efekte të menjëhershme: në njërën anë, klasat punëtore kërkonin përfaqësim në parlament, kurse në tjetrën, partitë e vjetra kërkonin përfaqësim proporcional për t'i mbrojtur pozitat e tyre në sistemin politik.³⁹ Belgjika ishte e para që e aplikoi sistemin zgjedhor proporcional më 1899, e pasuar nga Holanda (1906), Suedia (1907), dhe sot shumica e vendeve evropiane. Ndërkohë, numri i vendeve që përdorin sistemi mazhoritar është pakrahasimisht më i vogël, për t'i përmendur këtu vetëm disa demokraci të avancuara të tilla si Mbretëria e Bashkuar, ShBA-ja, Kanadaja, Australia e Franca.⁴⁰

Sistemi zgjedhor mazhoritar është më i thjeshtë në krahasim me sistemin zgjedhor proporcional. Sistemi mazhoritar ndryshe njihet edhe si sistem pluraliteti, ku territori ndahet në disa zona/distrikte elektorale dhe në secilin distrikt fituesi i zgjedhjeve i merr të gjitha votat, pa marrë parasysh se sa vota ka marrë kundërshtari. Ky sistem promovon një garë politike ku ka humbës dhe fitues të qartë të zgjedhjeve. Studiuesit e sistemeve zgjedhore i

³⁸ David M. Farrell, fjala vjen, i ndan sistemet zgjedhore në pesë tipa. Shih *Comparing Electoral Systems* (Macmillan Press Ltd, 1998), f. 4; Richard W. Doudriette dhe Andrew Ellis, në studimin e tyre, sistemet mazhoritare i ndajnë në 4 nëntipe, kurse sistemet proporcionale në dy nëntipa. Shih 'A Global Snapshot', në Larry Diamond dhe Marc f. Plattner (ed.), *Electoral Systems and Democracy* (The Johns Hopkins University Press: Baltimore, 2006).

³⁹ Stein Rokkan, *Citizens, Elections, and Parties: Approaches to the Comparative Study of the Process of Development* (Oslo: Universitetsforlaget, 1970), f. 157.

⁴⁰ Gianfranco Baldini dhe Adriano Pappalardo, *Elections, Electoral Systems and Volatile Voters* (Palgrave Macmillan, 2009), f. 20-39.

kanë listuar anët e mira dhe të këqija të këtij sistemi. Përkrahësit e këtij sistemi argumentojnë se ky: a) është sistem i thjeshtë, ku ka një votë të drejtpërdrejtë për fituesin dhe ku ky duhet të japë llogari karshi votuesve; b) favorizon një lidhje të drejtpërdrejtë mes deputetëve të parlamentit dhe votuesve. Sipas kritikëve, ky sistem është i padrejtë dhe jopërfaqësues. Këtu theksi vihet tek mospërfaqësimi i grave dhe i pakicave. Në sistemet mazhoritare, përqindja e qytetarëve që dalin në votime është e ulët në krahasim me sistemet proporcionale. Dhe e fundit, por jo më pak e rëndësishme, është kritika se brenda këtij sistemi mund të ndahen zonat ose distriktet zgjedhore në atë mënyrë që mund të japë rezultat të caktuar zgjedhor, i njohur si ‘gerrymandering’.

Sistemi zgjedhor proporcional është më i ndërlikuar, varësisht prej shkallës së proporcionalitetit ose formulave proporcionale (si p.sh. d’Hont, Sainte-Laguë). Formula e përgjithshme e këtij sistemi është se numri i votave përkthehet në numrin e ulëseve për listat ose kandidatët e partive politike, dhe këto parti përfaqësohen në institucione, varësisht prej fuqisë së tyre elektorale, nëse e kalojnë pragun zgjedhor. Ndërkohë, sistemet zgjedhore të përziera i ndajnë karakteristikat e dy sistemeve të lartpërmendura.

Debati i fundit mbi sistemet zgjedhore ka të bëjë me ndikimin e tyre në formën e demokracisë. Studiuesit dhe shtetndërtuesit ndërkombëtarë në shoqëritë e dala prej luftës kanë dilema se çfarë sistemi zgjedhor është më i përshtatshmi për këto shoqëri. Janë dy autorë, në mesin e të shumtëve, emrat e të cilëve lidhen me këtë debat: Arendt Lijphart dhe Donald Horwitz. Derisa sistemet zgjedhore proporcionale janë pazgjidhshëm të lidhura me demokracitë konsensuale, sistemet zgjedhore mazhoritare janë të lidhura me demokracitë mazhoritare. Lijphart mendon se sistemi zgjedhor proporcional është më i përshtatshëm për shoqëritë që kanë diversitet etnik, regjional, religjioz, etj., për shkak se, nëpërmjet këtij lloji sistemi, këto grupe dhe ndarje shoqërore kanë mundësi të

përfaqësohen në institucione. Kjo quhet demokraci konsensuale dhe konsociative, multipartiake, në të cilën qeveritë ndërtohen me anë të koalicioneve të gjera dhe grupet e ndryshme etno-kulturore gëzojnë autonomi të theksuar. Nëse ka diçka që nuk u përshtatet këtyre shoqërive, argumenton Lijphart, ky është sistemi zgjedhor mazhoritar, për faktin se funksionin sipas rregullave të lojës përjashtuese, ka një fitues dhe humbës të qartë të zgjedhjeve. Horwitz, në anën tjetër, argumenton se sistemet zgjedhore mazhoritare janë më të përshtatshme në shoqëritë e dala nga lufta, për faktin se në to presidenti luan rol unifikues në shoqëri dhe qëndron si figurë unifikuese mbi palët, sistemi pamundëson parti njëetnike dhe politikanët duhet të bëjnë apel për vota edhe te grupet e tjera etnike.⁴¹

⁴¹ Për më shumë, shih Donald Horowitz, 'Democracy in divided societies', *Journal of Democracy* (1993) 4 (4), 18–38; Arend Lijphart, 'Consociational Democracy', *World Politics*, Volume 21, Issue 2, January 1969, ff.. 207-225; Arend Lijphart, 'Constitutional design for divided societies', *Journal of Democracy* (2004), Volume 15, Number 2, April 2004, ff. 96-109.

MES STABILITETIT
DHE DEMOKRATIZIMIT

KAPITULLI II

KAPITULLI 2:

ZGJEDHJET SI 'BLERJE' E STABILITETIT – STATUS-QUO-IZMI
SI STRATEGJI E UNMIK-UT

KAPITULLI 2: ZGJEDHJET SI ‘BLERJE’ E STABILITETIT – STATUS-QUO-IZMI SI STRATEGJI E UNMIK-ut

Paqendërtuesit duhet të vazhdojnë me zgjedhje vetëm atëherë kur ka dëshmi se ‘partitë e moderuara’ [...] kanë mbështetje të mjaftueshme popullore [...] për të dominuar mbi ‘partitë e jomoderuara’ në zgjedhje.⁴²

Pas përfundimit të luftës në Kosovë, ndonëse u vendosën një administratë civile dhe një ushtarake (UNMIK-u dhe KFOR-i) që synonin ta ndërtonin një shoqëri paqësore shumetnike, baza ligjore e këtij administrimi ndërkombëtar nuk i jepte përgjigje pyetjes se cili do të ishte statusi përfundimtar politik i Kosovës. Mungesa e një strategjie dalëse dhe paqartësia e statusit politik të Kosovës kishin rritur frustrimin në mesin e qytetarëve të Kosovës dhe kishin ushqyer politika etnike përjashtuese, të cilat, siç u pa në ngjarjet e dhunshme të marsit 2004, pothuajse e përmbysën gjithë arsyetimin e intervenimit ndërkombëtar për ta ndërtuar një shoqëri kosovare paqësore dhe shumetnike.

Duke qenë UNMIK-u një mision ndërkombëtar me administratë komplekse, ku i gjithë pushteti trupëzohej në Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP), qeverisja e tij në Kosovë u shoqërua me tri dilema. E para ishte dilema e legjitimitetit të brendshëm. PSSP-ja ushtronte gjithë pushtetin

⁴² Roland Paris, *At War's End: Building Peace after Civil Conflict* (Cambridge University Press, 2004), f. 189-190.

ekzekutiv në Kosovë. Në mënyrë që ky pushtet të mos dukej si administrim i drejtpërdrejtë i një shoqërie postkonfliktuale nga një administratë postkoloniale, UNMIK-u ndërtoi mekanizma kuazi-qeveritarë, përmes së cilëve synonte të merrte miratimin e liderëve politikë të Kosovës – qofshin këta shqiptarë ose serbë – për politikat e veta në Kosovë. Megjithatë, UNMIK-u ishte i vetëdijshëm se përfaqësuesit politikë të UÇK-së gëzonin mbështetje solide në Kosovë dhe insistonte që kjo mbështetje të ulej dhe kështu të krijoheshin mundësitë që forcat e moderuara politike t'i fitonin zgjedhjet e para që do të organizoheshin në Kosovën e pasluftës. E dyta ishte dilema e sigurisë. PSSP-ja dhe UNMIK-u kishin dilema se ç'loj zgjedhjesh duhet të mbaheshin në Kosovë dhe kur. Një qeveri e udhëhequr nga krerët e UÇK-së, sipas perceptimit të UNMIK-ut, do të mund të ndikonte në shpërnguljen edhe të atyre serbëve që kishin mbetur në Kosovë. Një frikë tjetër ishte se një qeveri e tillë do ta shpallte Kosovën shtet të pavarur dhe sovran, pa konsultim me UNMIK-un. Dilema e tretë ishte ajo e strategjisë dalëse. Meqë UNMIK-u nuk kishte një strategji dalëse nga Kosova, transferimi i kompetencave qeverisëse nga UNMIK-u tek institucionet e përkohshme po zvarritej vazhdimisht. Kjo qasje rrezikonte jo vetëm praninë e këtij misioni në Kosovë, por edhe marrëdhëniet ndëretnike.

Për ta adresuar dilemën e parë, pra, për t'u dukur legjitim në sytë e kosovarëve, UNMIK-u ndërtoi mekanizmat e parë konsultativë që përfshinin përfaqësues të partive politike dhe të shoqërisë civile. Duke qenë se Qeveria e Përkohshme e Hashim Thaçit kishte emëruar shumicën e ministrave në kabinetin qeveritar dhe shumicën e kryetarëve të komunave (27 kryetarë nga gjithsej 29 komuna), si dhe i kishte vendosur njerëzit e vet në bordet e ndërmarrjeve shoqërore, PSSP-ja i asokohshëm i UNMIK-ut, z. Bernard Kouchner, ndodhej para një fakti të kryer të ekzistimit të këtyre institucioneve. Kundërshtimi i drejtpërdrejtë i tyre mund t'i

rriste tensionet politike me përfaqësuesit e UÇK-së, të cilët, sipas perspektivës së UNMIK-ut, do ta kërcënonin stabilitetin e vendit.⁴³ Për ta evituar këtë skenar, Kouchner filloi t'i kooptonte përfaqësuesit e këtyre institucioneve tashmë të instaluara *de facto* në Kosovë nëpërmjet mekanizmave konsultativë.⁴⁴

Njëri prej këtyre mekanizmave ishte Këshilli Transitor i Kosovës, i cili kishte tri qëllime: së pari, ta rriste bashkëpunimin mes UNMIK-ut, partive politike shqiptare dhe partive politike serbe; së dyti, të hapte një mundësi dialogu mes lidërshpit shqiptar dhe atij serb dhe ta rriste mirëbesimin ndërmjet tyre; së treti, synohej që me anë të këtij mekanizmi të testoheshin politikat e UNMIK-ut për Kosovën dhe të identifikoheshin bashkëpunëtorët dhe kundërshtarët potencialë.

Me qëllim që ta adresonte dilemën e dytë të sigurisë, në shkurt 2000 UNMIK-u kishte filluar t'i zëvendësonte strukturat paralele shqiptare të krijuara pas luftës nga Qeveria e Përkohshme e Hashim Thaçit dhe nga LDK-ja, siç ishin institucioni i Kuvendit ose ai i 'Presidentit të Kosovës' i udhëhequr nga Ibrahim Rugova që nga zgjedhjet e vitit 1998. Në janar 2000, UNMIK-u nxori Rregulloren 2000/1 mbi 'Strukturën e përbashkët administrative të Kosovës' në të cilën kërkohej shprehimisht që: "Strukturat e tashme të Kosovës, qofshin ato ekzekutive, ligjvënëse ose gjyqësore, (siç janë 'Qeveria e Përkohshme e Kosovës', 'Presidenca e Republikës së Kosovës'), në masën e mundshme dhe në pajtim me këtë rregullore, do të

⁴³ Sipas King dhe Mason, "në emër të 'stabilitetit', misioni tradhtoi shumë nga njerëzit e çiltër dhe idealistë të Kosovës, në favor të gangsterëve". Iain King, Mason, *Paqe me çdo kusht: Si dështoi bota në Kosovë* (KOHA, Prishtinë, prill 2007), f. 77.

⁴⁴ Nicolas Lemay-Hébert, 'Coerced transitions in Timor- Leste and Kosovo: managing competing objectives of institution-building and local empowerment', *Democratization* (2012), 19:3, f. 470; Tonny Brems Knudsen dhe Carsten Bagge Lausten (ed.) *Kosovo between War and Peace: Nationalism, Peacebuilding and International Trusteeship* (London and New York, Routledge, 2006). Po ashtu, shih Report of the Secretary-General on the United Nations Interim Administration Mission in Kosovo [S/1999/1250] of 23 December 1999.

transformohen dhe do të integrohen në mënyrë progresive në Strukturën e Përbashkët të Përkohshme Administrative, e cila do ta fillojë punën nga data 31 janar 2000, kur edhe strukturat e tjera të Kosovës të natyrës ekzekutive, ligjvënëse ose gjyqësore do të pushojnë së ekzistuari”.⁴⁵ Sipas të njëjtës rregullore, edhe komunat e Kosovës do të përfshihen brenda të njëjtës strukturë.

Për ta adresuar dilemën e tretë të strategjisë dalëse dhe fillimin e transferimit të kompetencave tek institucionet e Kosovë, UNMIK-u planifikonte që fillimisht ta themelonte një tip të institucioneve të përkohshme nëpërmjet zgjedhjeve të lira, fer dhe demokratike. Dilema e tretë, pra paqartësia politike për Kosovën, ishte më e madhja e UNMIK-ut. Nën dritën e kësaj dileme shihej edhe mbajtja e zgjedhjeve. OSBE-ja, si njëra prej katër shtyllave të UNMIK-ut, qëllimisht e kishte shtyrë datën e mbajtjes së zgjedhjeve. Kjo ndodhi për dy arsye: së pari, sepse organizimi i menjëhershëm i zgjedhjeve mendohej se mund të përmbyste vetë qëllimin për të cilin kishte zbarkuar misioni i UNMIK-ut në Kosovë – që kishte të bënte me krijimin e një shoqërie shumetnike, paqësore dhe me parandalimin e ripërsëritjes së konfliktit; së dyti, për shkak të antagonizmave dhe tensioneve ndërpartiake dhe ndëretnike në Kosovë. Duke qenë se Hashim Thaçi, që tashmë kishte themeluar PDK-në si parti politike, ishte një lojtar politik faktik që kishte shtrirë ndikimin në një pjesë të konsiderueshme të shoqërisë kosovare, qëllimi i OSBE-së ishte që ta shtynte sa më shumë datën e organizimit të zgjedhjeve. Sipas kalkulimeve të OSBE-së, nëse zgjedhjet do të mbaheshin menjëherë, ish-përfaqësuesit politikë të UÇK-së, që kishin themeluar PDK-në, kishin shumë gjasa që t'i fitonin ato dhe ta merrnin pushtetin në Kosovë.

⁴⁵ Shih, Roger f. M. Lorenz, 'The Rule of Law in Kosovo: Problems and Prospects', *Criminal Law Forum* (2000) 11: 127–142, f. 131. Po ashtu, UNMIK/Rreg/2000/01 'Mbi Strukturën e Përbashkët të Përkohshme Administrative të Kosovës', 14 janar 2000.

Në fakt, në Kosovë ekzistonte një tension i pesëfishtë politik: së pari, mes LDK-së (që konsiderohej më e moderuar) dhe PDK-së (që konsiderohej më radikale); së dyti, mes UNMIK-ut dhe PDK-së; së treti, mes PDK-së dhe pakicës serbe në Kosovë; së katërti, mes vetë pakicës serbe në veri të Kosovës, që ndiqte drejtpërdrejt udhëzimet e Serbisë për veprimet në Kosovë, dhe së pesti, ndërmjet vetë pakicës serbe të shpërndarë nëpër enklava në pjesën jugore të Kosovës, që ndiqte një qasje më bashkëpunuese dhe më të moderuar kundrejt bashkëpunimit me UNMIK.⁴⁶

Duke i marrë në konsideratë këto tensione, shtetndërtuesit ndërkombëtarë të Kosovës ishin skeptikë për mbajtjen e menjëhershme të zgjedhjeve. Ndryshe nga Marrëveshja e Dejtonit, e cila parashihte që zgjedhjet në Bosnjë të mbaheshin prej 6 deri në 9 muaj pas nënshkrimit të marrëveshjes së paqes, Marrëveshja e Rambujesë parashihte mbajtjen e zgjedhjeve në Kosovë 9 muaj pas nënshkrimit të saj.⁴⁷ Duke marrë mësim nga zgjedhjet e organizuara

⁴⁶Jens Narten, 'Post-Conflict Peacebuilding and Local Ownership: Dynamics of External-Local Interaction in Kosovo under United Nations Administration', *Journal of Intervention and Statebuilding* (2008), 2:3, 369-390, f. 376.

⁴⁷ Sipas Marrëveshjes së Rambujesë, neni II. Roli I OSBE-së: "Në harmoni me Nenin IV të Kapitullit 5, zgjedhjet e para duhet të mbahen brenda 9 muajve pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje". Po ashtu, sipas nenit IV: Procesi i implementimit: "Brenda 9 muajve pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje, do të mbahen zgjedhjet në përputhje dhe sipas procedurës së përkruar në Kapitullin III të kësaj Marrëveshjeje për autoritetet e themeluara këtu, në përputhje me listën e votuesve të përgatitur sipas standardeve ndërkombëtare nga Komisioni Qendror Zgjedhor. OSBE-ja do t'i mbikëqyrë këto zgjedhje, që të sigurohet se janë të lira dhe të drejta". Në anën tjetër, duhet theksuar se, për dallim nga Marrëveshja e Rambujesë, Rezoluta 1244 e KS mbetet e heshtur rreth kohës kur do të duhej të organizoheshin zgjedhjet. Pika 11c parashihte "Organizimi dhe mbikëqyrja e zhvillimit të institucioneve të përkohshme për demokratizim dhe vetëqeverisje autonome, duke gjetur zgjidhjen politike, duke përfshirë këtu edhe mbajtjen e zgjedhjeve", kurse pika 11f parashihte "Në fazën e fundit, mbikëqyrja e bartjes së autoritetit nga institucionet e përkohshme të Kosovës në institucionet e krijuara me zgjedhje politike". Sipas raportit të Grupit Ndërkombëtar të Krizave 'Starting from Scratch in Kosovo', sugjerimet e para të bashkësisë ndërkombëtare para marjes së mandatit të Bernard Kouchner-it si PSSP i UNMIK-ut, ishin që zgjedhjet duhet të mbaheshin pas dy vjetëve. Shih International Crisis Group,

në Bosnjë, zgjedhjet e para në Kosovë u mbajtën 16 muaj pas vendosjes së administratës ndërkombëtare në Kosovë, pra vetëm në vjeshtën e vitit 2000. Bashkësia Ndërkombëtare në rastin e Bosnjës kishte kuptuar se zgjedhjet nuk janë gjithmonë zgjidhja më e mirë, për faktin se pikërisht partitë politike që e kishin mobilizuar luftën ishin ato që i fituan zgjedhjet pas saj. Pra, politika këtu ishte njëfarë vazhdimi i luftës në ‘arenën elektorale’.

2.1 Institucionet demokratike, zgjedhjet dhe stabiliteti

Më 1997, në një artikull që problematizonte demokracinë joliberalë, Fareed Zakaria e niste argumentimin me një çështje që kishte shtruar diplomati amerikan Richard Holbrook në vigjilje të mbajtjes së zgjedhjeve në Bosnjë në shtator 1996. Holbrook shtronte një dilemë legjitime me të cilën përballen pothuajse të gjitha vendet në transicion që nga Azia, Amerika Latine, Afrika e deri tek Evropa Juglindore. Dilema është kjo: çka nëse në Bosnjë mbahen zgjedhje të lira dhe fer, por fituesit e tyre janë racistë, fashistë ose separatistë që publikisht e kundërshtojnë marrëveshjen e paqes. Sot e kësaj dite, kjo mbetet dilema e demokracisë liberale. Sipas këtij parashtrimi, zgjedhjet (madje edhe kur vlerësohen të lira dhe fer), janë kriter i pamjaftueshëm që një vend të konsiderohet demokraci liberale. Për Zakarian, ajo që në përfundim quhet demokraci liberale nuk karakterizohet vetëm me zgjedhje të lira dhe fer, por para së gjithash me ndarjen e pushteteve dhe me mbrojtjen e lirive themelore të fjalës, të tubimit, të besimit dhe të pronës.⁴⁸

‘Starting from Scratch in Kosovo’, (Balkans Report No 83, 13 December 1999), f. 9.

⁴⁸ Fareed Zakaria, ‘The rise of illiberal democracy’, *Foreign Affairs*; Nov/Dec 1997; 76, 6; f. 22; Për një trajtim të stërholluar të demokracive joliberales, shih librin e Fareed Zakaria, *The Future of Freedom, Illiberal Democracy at Home and Abroad* (W. W. Norton & Company, 2007).

Ajo që sot quhet demokraci joliberalë ka të bëjë me një përkufizim minimalist të demokracisë. Sipas këtij përkufizimi, demokracia reduktohet në organizim të zgjedhjeve të lira dhe fer. Madje, në disa vende për të cilat përdoret ky përkufizim, zgjedhjet nuk janë as plotësisht të lira dhe as plotësisht fer. Në anën tjetër, ajo që e karakterizon demokracinë liberale është liberalizmi konstitucional, që nuk e redukton demokracinë vetëm në një metodë për zgjedhjen e qeverisë, por e sheh demokracinë si përmbajtje që realizohet nëpërmjet qëllimeve të qeverisë. Ajo që quhet liberalizëm konstitucional, thotë Zakaria, është e rrënjëzuar në traditën dhe historinë perëndimore dhe “kërkon të mbrojë autonominë dhe dinjitetin e individit kundrejt shtrëngimeve –cilido qoftë burimi i tyre – shteti, kisha, ose shoqëria”.⁴⁹ Demokracia liberale perëndimore dhe liberalizmi konstitucional bazohen në dy ide të thjeshta, njëra e ngritur mbi civilizimin grek (liritë individuale), tjetra mbi atë romak (sundimi i ligjit). Duke u bazuar në traditën kantiane të republikanizmit (që ka të bëjë me ndarjen dhe balancimin e pushteteve, sundimin e ligjit, mbrojtjen e të drejtave individuale etj), Michael W. Doyle, një studiues me nam në fushën e paqëndërimit, argumentoi kundër mazhoritarizimit demokratik dhe shtroi tezën se është liberalizmi konstitucional, dhe jo detyrimisht demokracia, ai që e shpie një vend drejt paqes.⁵⁰ Për ta ilustruar këtë argument, mjafton të marrim një rast hipotetik: supozojmë se shumica e qytetarëve voton një parti politike ose lidërsip të saj që për kauzë politike ka spastrimin etnik, deportimin ose vrasjen e një të grupi të caktuar. Pyetja që shtrohet është kjo: a mund ta quajmë këtë *demokraci liberale*? Duket se një argument i ngjashëm ndiqet edhe

⁴⁹ Fareed Zakaria, ‘The rise of illiberal democracy’, *Foreign Affairs*; Nov/Dec 1997; 76, 6; f. 26.

⁵⁰ Michael W. Doyle, *Ways of War and Peace: Realism, Liberalism and Socialism* (New York: W. W. Norton, 1997). Për një diskutim të ngjashëm, shih Alexandra Gheciu, ‘International Norms, Power and the Politics of International Administration: The Kosovo Case’, *Geopolitics* (2005), 10:1, f. 121-124.

te teza e institucionalizimit para liberalizimit, e prezantuar nga Roland Paris, si një strategji paqëndërtimi e ndjekur nga shtetndërtuesit e jashtëm në shoqëritë e dërrmuara dhe të sapodala nga konflikti.

Mënyra më e mirë për ta kuptuar qasjen e Roland Paris për paqëndërtimin ndërkombëtar, është duke pyetur se me çfarë nuk pajtohet qasja e tij. Paris rimodifikon qasjen wilsoniane. Ai nuk pajtohet me ata që mendojnë se duhen mënjeluar vlerat e liberalizimit në paqëndërtimin ndërkombëtar dhe, në vend se të ndiqen ato vlera, të përkrahen regjime autoritare me prezencë të fortë ushtarake dhe financiare ndërkombëtare. Kjo qasje nuk e promovon as ndarjen si strategji për zgjidhjen e konfliktit, që nënkupton ndarjen fizike mes palëve ndërluftuese dhe as krijimin e shteteve të reja. Roland Paris provon të gjejë një të mesme ndërmjet këtyre dy makroqasjeve ekstreme të zgjidhjeve të konflikteve ndërkombëtare. Sipas tij, paqëndërtuesit duhet t'i transformojnë shtetet dhe shoqëritë e shpartalluara nga konflikti drejt demokracisë liberale. Në mënyrë që ky transicion të mos prodhojë pasoja të paparashikueshme, Paris mendon se paqëndërtuesit duhet të mos nguten me organizmin e zgjedhjeve dhe ndjekjen e politikave të tregut para se t'i vendosin mirëfilli bazat institucionale. Kjo qasje institucionaliste e vë theksin tek institucionet si garantuese të paqes, dhe jo detyrimisht te liberalizimi i menjëhershëm.⁵¹

Duke mësuar nga gabimet e OKB-së në Bosnjë e Hercegovinë, UNMIK-u (respektivisht OSBE-ja) fillimisht ndërtoi një bazë minimaliste institucionale në Kosovë, duke nxjerrë një mori rregulloresh, para se të vinte koha e organizimit të zgjedhjeve. Chesterman vëren se ekzistonte një tension mes popullatës lokale dhe interesave të bashkësisë ndërkombëtare lidhur me kohën kur duhej të mbaheshin zgjedhjet në Kosovë.

⁵¹ Roland Paris, *At War's End: Building Peace after Civil Conflict* (Cambridge University Press, 2004).

Tensioni i parë ka të bëjë me ndikimin që do ta kenë zgjedhjet në zhvillimin e strukturave dhe të personaliteteve politike. Në disa rrethana, si në Bosnjë, zgjedhjet e hershme mund të kenë efektin e shndërrimit të gjeneralëve në politikanë, duke i formalizuar ndarjet etnike në vija politike. Në shtete më pak të zhvilluara, ku mungojnë institucionet burokratike adekuate, mbajtja e zgjedhjeve para krijimit të këtyre institucioneve mund t'i pengojë praktikat afatgjata demokratike dhe stabilitetin [...] Zgjedhjet në Kosovë ishin shtyrë pjesërisht si rezultat i ndikimit që ato kanë pasur në Bosnjë.⁵²

UNMIK-u ishte i vetëdijshëm se çështja e pavarësisë do të ishte tema numër një e partive politike shqiptare në Kosovë gjatë fushatës zgjedhore. Zhvendosja sa më larg e shpalljes së datës së zgjedhjeve bëhej me qëllim që të minimizohej suksesi i forcave politike të dala nga UÇK-ja.⁵³ UNMIK-u nuk dëshironte që gjeneralët e UÇK-së, siç kishte ndodhur me rastin e Bosnjës, të bëheshin politikanë dhe ta udhëhiqnin vendin. Kalkulimi i tyre i gabuar vinte nga fakti se PDK-në e shihnin si parti më radikale, kurse LDK-në si parti më të moderuar. Ndonëse ky klasifikim mund të kishte njëfarë vlere sa i përket sfondit, mënyrës së themelimit dhe qasjeve programatike e retorike të të dyja partive, kur ishte fjala për pavarësinë e Kosovë, të gjitha partitë politike shqiptare në Kosovë ishin të paktën po aq 'nacionaliste' sa edhe vetë PDK-ja. Kërkesa e të gjitha partive politike në Kosovë, duke përfshirë edhe LDK-në e Ibrahim Rugovës, ishte pavarësia e plotë e Kosovës si option kompromisi. Me të

⁵² Simon Chesterman, *You, The People: The United Nations, Transitional Administration, and State-building* (Oxford University Press, 2004), f. 208; Simon Chesterman, 'Ownership in Theory and in Practice: Transfer of Authority in UN Statebuilding Operations', *Journal of Intervention and Statebuilding* (2007), 1:1, ff. 3-26.

⁵³ Oisín Tansey, *Regime-building: Democratization and International Administration* (Oxford University Press, 2009) f. 131; Shih po ashtu Ian R. Mitchell, 'The ambiguities of elections in Kosovo: Democratization versus human rights?', *The International Journal of Human Rights* (2000), 4:3-4, 246-262.

drejtë, Roland Paris kishte vërejtur se koncepti i moderimit politik në Kosovë është një koncept relativ.⁵⁴ Megjithatë, duket se UNMIK-u më shumë u frikësohej mjeteve që do të mund të përdorehin për realizimin e kësaj kërkesë politike të shqiptarëve të Kosovës, atyre të supozuara paqësore të LDK-së, ose jopaqësore të PDK-së.

Para organizimit të zgjedhjeve, UNMIK-u ndërtoi një bazë minimaliste institucionale. Përmes rregullores së veçantë 2000/16⁵⁵ për regjistrimin dhe veprimin e partive politike në Kosovës (datë 21 mars 2000), rregullores 2000/21 për themelimin e Komisionit Qendror Zgjedhor (të lëshuar më 18 prill 2000), dhe rregullores 2000/39 mbi Zgjedhjet Komunale në Kosovë⁵⁶ (të lëshuar më 8 korrik 2000) UNMIK-u kishte ndërtuar infrastrukturën ligjore për mbarëvajtjen e zgjedhjeve. Rregullorja e UNMIK-ut për Zgjedhjet Komunale në Kosovë saktëson se “zgjedhjet për kuvendet komunale do të zhvillohen sipas sistemit të përfaqësimit proporcional të bazuar në listat e kandidatëve të partive politike, iniciativave qytetare dhe koalicioneve dhe kandidatëve të pavarur” dhe se “çdo listë e kandidatëve duhet të përfshijë së paku 30% kandidate gra brenda 15 kandidatëve të parë”.⁵⁷ Nga maji deri në

⁵⁴ Roland Paris, *At War's End: Building Peace after Civil Conflict* (Cambridge University Press, 2004), f. 216.

⁵⁵ UNMIK/Reg/2000/16 ‘Për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike në Kosovë’, 21 mars 2000.

⁵⁶ UNMIK/Reg/2000/39 ‘Mbi Zgjedhjet Komunale në Kosovë’, 8 korrik 2000.

⁵⁷ UNMIK/Reg/2000/39 ‘Mbi Zgjedhjet Komunale në Kosovë’, 8 korrik 2000, neni 4. Simon Chesterman ka argumentuar se në zgjedhjet e para të përgjithshme në Kosovë, ishin përfaqësuar rreth 28% të grave në Kuvend. Ky përfaqësim, sipas tij, ishte më shumë se dyfishi i përfaqësimit të grave në Kongresin ose Senatin e ShBA-së, dhe një përfaqësim i tillë shkonte përtej standardeve të korrektësisë politike. Chesterman tematizon kuotën e përfaqësimit të grave për të argumentuar natyrën imponuse të rregullave zgjedhore, të kushtetutës dhe konstitucionalizmit në vendet postkonfliktuale. Chesterman thotë se “përfaqësimi më i lartë i grave mund të reflektojë më mirë dëshirën dhe aspiratat e grave në një territor si Kosova. Por është gjithashtu e qartë që vendime tilla janë marrë jo thjesht nga pikëpamja e të qenit responsiv ndaj pritshmërive lokale”. Shih Simon Chesterman, ‘Imposed Constitutions, Imposed Constitutionalism, and Ownership’, *Connecticut Law Review* (2004), Vol 37, f. 951.

korrik, për dy muaj radhazi, kishte pasur diskutime për sistemin zgjedhor mes përfaqësuesve të OSBE-së dhe partive politike kosovare. Në korrik 2000, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, i drejtuar nga UNMIK-u, kishte imponuar njëanshëm sistemin zgjedhor të përfaqësimit proporcional. Preferencat e LDK-së dhe të PDK-së për sistemin zgjedhor ishin të ndryshme. Qëndrimi i PDK-së ishte që Kosova të aplikonte një sistem zgjedhor të pastër mazhoritar, duke kalkuluar se në një sistem të tillë do t'i fitonte zgjedhjet dhe do të kishte më shumë ndikim, kurse LDK-ja propozonte një sistem të përzier zgjedhor (me tipare edhe të sistemit mazhoritar edhe të atij proporcional). Kalkulimet e PDK-së dhe të LDK-së bëheshin mbi baza të ndryshme. PDK-ja e propozonte sistemin mazhoritar duke besuar se do ta konkretizonte mbështetjen që kishte në mesin e qytetarëve si forcë politike e dalë nga lufta e UÇK-së, dhe besonte se kështu do ta fitonte shumicën në Kosovë si forca kryesore politike. Në anën tjetër, LDK-ja frikësohej për humbjen e ndikimit politik në terren dhe shpresonte se një propozim i tillë do ta nxirrte LDK-në më mirë në skenën politike.

UNMIK-u kishte imponuar sistemin zgjedhor proporcional me lista të mbyllura. Katër janë arsyet kryesore se pse u vendos ky sistem zgjedhor në Kosovë: së pari, ishte instrument për mbrojtjen dhe përfaqësimin e pakicave dhe të grave në Kosovë; së dyti, u jepte mundësi partive të vogla të përfaqësoheshin në institucione; së treti, kostoja financiare e këtij sistemi ishte me vogël dhe menaxhimi i tij më i lehtë; së katërti, me këtë sistem zgjedhor supozohej se pjesëmarrja e qytetarëve në zgjedhje do të ishte më e lartë, dhe se kjo do t'i legjitimonte edhe institucionet e përkohshme vetëqeverisëse të Kosovës, por edhe vetë praninë e UNMIK-ut. Përtej këtyre arsyeve, ky sistem zgjedhor e pamundësonte çdo parti politike që si e vetme ta formonte qeverinë e vendit. Në përputhje me idenë e Arendt Lijphart për demokracinë konsociative, pas zgjedhjeve, partitë politike do të detyroheshin të uleshin, të

ndërtimin koalicione paszgjedhore dhe të bashkëpunonin mes vete, deshën a nuk deshën. Me fjalë të tjera, sistemi zgjedhor proporcional ishte njëra prej metodave (çelësave) që përdori UNMIK-u për ta inxhinieruar përfaqësimin politik, kulturën politike dhe ndërtimin e institucioneve.

Organizimi i zgjedhjeve të para ishte ndoshta aktiviteti më i rëndësishëm politik i UNMIK-ut pas zbarkimit të tij në Kosovë. Shkollarët Juan J. Linz dhe Alfred Stepan⁵⁸ argumentojnë se në shoqëritë postkonfliktuale zgjedhjet e përgjithshme duhet t'u paraprijnë atyre lokale. Kjo nuk ndodhi në rastin e Kosovës. Mbajtja e zgjedhjeve të përgjithshme në Kosovë nuk ishte në rendin e ditës së UNMIK-ut. Në këndvështrimin e UNMIK-ut, siç heton Andrew Taylor, organizimi i zgjedhjeve lokale para atyre të përgjithshme shihej me pesë avantazhe: së pari, këto zgjedhje do të shërbenin si 'projekt pilot' për t'i testuar procedurat, infrastrukturën dhe institucionet që i menaxhonin zgjedhjet; së dyti, për ta kundërbalancuar legjitimitetin politik të strukturave politike të dala nga UÇK-ja; së treti, pjesëmarrja e serbëve do të ndikonte në ndryshimin e perspektivës së tyre për Kosovën e pas vitit 1999; së katërti, qeveritë lokale do të funksionalizoheshin dhe do të fillonin të jepnin shërbime; dhe, së pesti, zgjedhjet lokale do t'i mundësonin UNMIK-ut që ta vlerësonte konfiguracionin e pushtetit pas konfliktit në Kosovë.⁵⁹

Zgjedhjet e para lokale u mbajtën pikërisht duke e pasur në konsideratë paqartësinë politike rreth statusit të Kosovës. Për ta zbritur nivelin e kërkesave politike në Kosovë, 16 muaj pas zbarkimit, në tetor 2000, UNMIK-u i kishte organizuar zgjedhjet

⁵⁸ Juan J. Linz and Alfred Stepan, 'Political Identities and Electoral Sequences: Spain, the Soviet Union and Yugoslavia', *Daedalus*, 121, Spring 1992, pp. 123–139.

⁵⁹ Andrew Taylor, 'This election was never going to be perfect: The Kosovo Municipal election of October 2000 as post-conflict election', *Civil Wars* (2002), Vol. 5 Issue 3, f. 71.

lokale. Ndonëse platformat zgjedhore të partive politike do të duhej të merreshin me zhvillimin ekonomik dhe demokracinë lokale, në platformën e të gjitha partive politike shqiptare në zgjedhjet komunale qëndronte politika e jashtme, respektivisht kërkesa për pavarësinë e Kosovës. Përkundër pesimizmit të projektuar ndërkombëtar se zgjedhjet do t'i fitonte PDK-ja, zgjedhjet lokale të tetorit të vitit 2000 i fitoi LDK-ja. 58% e trupit elektoral e votoi LDK-në, 27% PDK-në, dhe 7.7% AAK-në. Shkalla e daljes në votime ishte shumë e lartë: 79% e qytetarëve morën pjesë në votime në zgjedhjet e para lokale. Ndonëse për të garuar në zgjedhje ishin regjistruar 49 parti politike në Komisionin Qendror Zgjedhor, gara reale politike u zhvillua mes LDK-së, PDK-së dhe AAK-së. Kjo do të ishte shkalla më e lartë e pjesëmarrjes së qytetarëve në zgjedhje dhe numri më i madh i partive politike të regjistruara për garë në krahasim me të gjitha zgjedhjet që do të organizoheshin më vonë në Kosovë. Edhe pas zgjedhjeve lokale, UNMIK-u mbajti gjithë pushtetin diskrecional në përputhje me rregulloren 2000/45 mbi Vetëqeverisjen e Komunave në Kosovë.

Në zgjedhjet e para lokale të organizuara në Kosovë, serbët e bojkotuan plotësisht pjesëmarrjen në zgjedhje, duke e rënduar edhe më shumë, madje për herë të dytë, legjitimitetin e UNMIK-ut, pas shpërnguljes së një pjese të madhe të tyre në Serbi dhe në pjesën veriore të Kosovës. Me fjalë të tjera, në perspektivën e UNMIK-ut, zgjedhjet shiheshin më shumë si një instrument stabiliteti që t'i bënte bashkësitë e ndryshme etnike ta bashkushtronin pushtetin në Kosovë, sesa si një instrument i legjitimitetit demokratik. Simon Chesterman në 'Zgjedhjet janë ajo që bëjmë' argumentonte se UNMIK i projektonte zgjedhjet si aktivitet që do t'i mbante shqiptarët, por dhe serbët e Kosovës të angazhuar në jetën politike, duke e marrë parasysh faktin se pavarësia e Kosovës nuk shtrohej në

tavolinën e diskutimit. ‘Zgjedhjet do të na i blejnë tre vjet stabilitet’, kishte deklaruar njëri prej zyrtarëve të lartë të OSBE-së.⁶⁰

2.2 Sistem zgjedhor ‘për demokraci shumetnike’

Para mbajtjes së zgjedhjeve të përgjithshme, UNMIK-u, përkatësisht OSBE-ja si njëra prej shtyllave kryesore të tij, dizajnoi sistemin zgjedhor në Kosovë. Korniza Kushtetuese tashmë përcaktonte se 20 prej 120 vendeve në Kuvendin e Kosovës do t’u takonin komuniteteve. Duke qenë Kosova shoqëri postkonfliktuale dhe e ndarë në baza etnike, sistemi zgjedhor synonte të ndërtonte – nëse shprehemi me terminologjinë e Arendt Lijphart – një demokraci multietnike⁶¹, në të cilën pushteti ekzekutiv do të bashkushtrohej nga përfaqësuesit e grupeve të ndryshme etnike. Kjo njihet ndryshe edhe si ‘power-sharing’ ose konsociacionalizëm.⁶²

Studiuesit pajtohen se ndarjet etnike e kërcënojnë stabilitetin dhe demokracinë, por qasjet që ata propozojnë për t’i adresuar këto ndarje etnike institucionalisht dhe për ta stabilizuar demokracinë në vendet me ndarje të thella etnike, janë të ndryshme. Dy janë qasjet teorike se si mund të inxhinierohet një shoqëri e dalë nga lufta dhe e copëzuar mbi baza etnike: qasja centripetaliste dhe ajo centrifugaliste. Sipas qasjes centripetaliste, të argumentuar nga Donald Horwitz (1993), rregullat e sistemit zgjedhor duhet të dizajnohen në atë mënyrë që krijojnë incentiva për politikanët, të cilët detyrohen të kërkojnë vota edhe jashtë grupit të vet etnik.⁶³

⁶⁰ Simon Chesterman, ‘Elections Are What We Do’, *The World Today*, Vol. 57, No. 11 (Nov., 2001), f. 20.

⁶¹ Arend Lijphart, ‘Multiethnic Democracy’ në Seymour Martin Lipset, *The Encyclopedia of Democracy* (Washington, 1985), f. 864.

⁶² Ky koncept është përdorur nga Arendt Lijphart më 1969. Më 1994, Lijphart e modifikon këtë duke e quajtur demokraci koncesuale.

⁶³ Donald Horowitz, ‘Democracy in divided societies’. *Journal of Democracy* (1993) 4 (4), 18–38.

Studiuesit që e përkrahin këtë qasje, si Timonthy Sisks (1993)⁶⁴, Benjamin Reilly (1995), Pipa Norris (1997)⁶⁵ argumentojnë se faktorët që duhet të merren parasysh gjatë aplikimit të qasjes centripetaliste (integruese) në shoqëritë e dala nga lufta, janë demografia, gjeografia e shtrirjes së pakicave ose bashkësive nacionale, si dhe nëse kjo ose ajo pakicë është e integruar dhe ka një shtet tjetër amë.

Benjamin Reilly, për shembull, duke argumentuar për ndarjet etnike në shoqëritë e dala nga lufta, vë re tri modele: ai i Fixhit, ku baraspesha mes dy grupeve është bipolare; i Bosnjë-Hercegovinës, ku balanca mes grupeve është multipolare; dhe i Ruandës, ku ka një pakicë dominante.⁶⁶ Mirëpo, përbërja demografike dhe shtrirja gjeografike e bashkësive etnike në Kosovë është e ndryshme nga rastet e mësipërme. Duke qenë se shumica e popullsisë së Kosovës me etni shqiptare dhe 10% e përbërë nga bashkësi të tjera etnike, asnjë sistem zgjedhor nuk do të mund ta shpërbënte këtë raport demografik.

Rrjedhimisht, partitë politike shqiptare nuk morën ndonjë incentivë për të kërkuar vota përtej grupit të tyre etnik. Ngjashëm vepruan edhe partitë e bashkësive të tjera etnike, si ato serbe, rome, ashkallije, egjiptiane, turke dhe gorane. Dan Everts, udhëheqës i OSBE-së në Kosovë, përgjegjës për dizajnimin e sistemit zgjedhor në Kosovë, argumentonte se përzgjedhja e sistemit zgjedhor proporcional kishte për qëllim ta parandalonte formimin e një realiteti bipolar politik dhe të siguronte përfaqësimin e partive minoritare.⁶⁷ Ndonëse edhe në zgjedhjet lokale të vitit 2000 edhe ato

⁶⁴ Timonthy Sisk, 'Choosing an electoral system: South Africa seeks new ground rules', *Journal of Democracy*, 1993, 4 (1), 79–91.

⁶⁵ Pippa Norris 'Choosing electoral systems: proportional, majoritarian and mixed systems'. *International Political Science Review*, 1997, 18 (3), 297–312.

⁶⁶ Benjamin Reilly, *Democracy in Divided Societies. Electoral Engineering for Conflict Management*. (Cambridge University Press, Cambridge, 2001), f. 185

⁶⁷ Dan Everts, 'Review of the OSCE Mission in Kosovo's Activities 1999–2001'. Pristine/Prishtinë, 2001, OMiK.

të përgjithshme të vitit 2001, LDK, PDK dhe AAK ishin partitë kryesore që e dominonin skenën politike, rivaliteti mes tyre ishte i lartë. Faktikisht, sidomos para zgjedhjeve ishte krijuar një polaritet mes PDK-së dhe LDK-së. Duke qenë se fërkimet dhe tensionet më të mëdha politike ishin brenda vetë partive politike shqiptare, sistemi zgjedhor synonte t'ia pamundësonte cilësdo parti që të qeveriste e vetme në Kosovë. Me krijimin e koalicioneve të gjera qeverisëse në të gjitha qeveritë e pasluftës, synohej të parandalohet një antagonizëm politik bipolar.

Andrew Taylor argumenton bindshëm arsyet e përzgjedhjes së këtij sistemi zgjedhor në Kosovë. Sipas Taylor “asnjë sistem zgjedhor nuk mund ta ndryshonte faktin demografik të shumicës shqiptare”, prandaj qëllimi i këtij sistemi ishte reflektimi i këtij realiteti demografik në njërën anë dhe përfaqësimi i pakicave joshqiptare, përmes mekanizmave të bashkushtrimit të pushtetit (‘power-sharing’) në anën tjetër.⁶⁸ Qasja centripetaliste, siç është shpjeguar në një studim të Benjamin Relly, promovon një sistem mazhoritar me parti të karakterit multietnik që kërkojnë vota përtej grupeve të tyre etnike, e që duhet të përmbushë dy kriteret. Së pari, në vendet post-konfliktuale, ku promovohet ky sistem, ka një numër skajshmërisht të lartë të grupeve etnike dhe një shpërndarje gjeografike skajshmërisht të lartë të këtyre grupeve. Në rastin e Kosovës, numri dhe madhësia e grupeve etnike ishin të vegjël dhe kishte një koncentrim gjeografik të pakicës më të madhe serbe në pjesën veriore të Kosovës. Në zgjedhjet lokale të vitit 2000, UNMIK-u e testoi sistemin proporcional me lista të hapura dhe nxori disa mësim nga ky sistem.

Me aprovimin e Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë ishte përbrendësuar sistemi zgjedhor

⁶⁸ Andrew Taylor, ‘Electoral systems and the promotion of ‘consociationalism’ in a multi-ethnic society. The Kosovo Assembly elections of November 2001’, *Electoral Studies* 24 (2005) 435-463, f. 441.

proporcional në frymën dhe germën e tij, duke filluar prej preambulës që bënte thirrje për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve e deri tek pjesa përmbajtësore, e cila komuniteteve etnike në Kosovë u garantonte përfaqësim në Kuvend, në Qeveri dhe në të gjitha institucionet e tjera. Andrew Taylor argumenton se qëllimi i Kornizës Kushtetuese ishte “vendosja e një sistemi partiak në Kosovë që do ta mbante një balancë mes krijimit të koalicioneve të menaxhueshme, qeverisë efektive dhe qeverisjes multietnike”.⁶⁹

Janë tri aspekte themelore të sistemit zgjedhor proporcional në Kosovë që morën një vëmendje të konsiderueshme në analizën e Taylor. Këto janë: madhësia e distriktit, struktura e fletëvotimit dhe rregullat për ndarjen e vendeve në Kuvend. UNMIK-u adoptoi një zonë të vetme zgjedhore në Kosovë. Ky aspekt i sistemit zgjedhor ka mbetur i pandryshuar në të gjitha zgjedhjet e organizuara në Kosovë deri më 2014, ndonëse partitë politike dhe shoqëria civile herë pas here ofronin opsione të ndryshme për më shumë distrikte zgjedhore. Ndonëse ky sistem u kritikua për faktin se po e gërryente legjitimitetin e sistemit politik dhe nuk po krijonte lidhjen komunikuese mes përfaqësuesve të zgjedhur në Kuvend dhe votuesve në rajone gjeografike të ndryshme në Kosovë, qëllimi i përzgjedhjes së këtij sistemi të proporcionalitetit ishte inxhinierimi i një sistemi të qeverisjes multipartiake, ku asnjëra parti nuk do të mund të udhëhiqte e vetme me institucionet qendrore të Kosovës. Po ashtu, me anë të një zone të vetme zgjedhore ku do të zgjidheshin të 120 deputetët, ofrohej mundësia që partitë politike të grupeve etnike të kishin një përfaqësim të garantuar në sistemin e saponduar politik. Për dallim nga zgjedhjet e para lokale, në zgjedhjet e përgjithshme listat u mbyllën, përveç të tjerash edhe për faktin se në zgjedhjet lokale të vitit 2000 ishte evidentuar një përfaqësim i

⁶⁹ Andrew Taylor, ‘Electoral systems and the promotion of ‘consociationalism’ in a multi-ethnic society. The Kosovo Assembly elections of November 2001’, *Electoral Studies* 24 (2005) 435-463, f. 456.

munguar i grave në institucione. Në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2001, çdo i treti kandidat në listat zgjedhore të partive politike ishte grua, me çka garantohej përfaqësimi i grave në institucione. Ky rregullim ligjor i përfaqësimit të grave në Kuvend mbeti i pandryshuar edhe në zgjedhjet e vitit 2004, 2007, 2010 dhe 2014, me dallim të listave që u rihapën në zgjedhjet e vitit 2010. Mbyllja e listave në zgjedhjet e vitit 2001 u kritikua për faktin se një sistem i tillë u mundësonte kryetarëve të partive politike kontroll më të madh brendapartiak në përzgjedhjen e të preferuarve të tyre nëpër lista zgjedhore. Duke qenë se qytetarët dhe anëtarët e partive politike nuk do të kishin ndonjë ndikim në ndërtimin e këtyre listave, mendohej se kësioj do të gërryhej besueshmëria në partitë politike dhe do të dekurajohej pjesëmarrja e qytetarëve në zgjedhje. Argumenti i UNMIK-ut për mbylljen e listave dhe ofrimin e vetëm një zone zgjedhore bazohej në sa vijon: Kosova ishte territor i vogël dhe përmes këtij sistemi mundësohej një proporcionalitet më i lartë. ‘Sainte-Laguë’ ishte përzgjedhur si metodë e përkthimit të votave në ulëse të Kuvendit.⁷⁰

Ndonëse ky sistem mbipërfaqësoi komunitetin serb në Kosovë, siç do të shohim nga rezultatet e zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2001, kjo prapëseprapë nuk ia pakësoi të drejtat popullsisë shumicë në Kosovë. Ndonëse një sistem i tillë i përfaqësimit është kritikuar nga studiues që promovojnë centripetalizimin, sipas të cilëve një sistem i tillë zgjedhor institucionalizon politikën etnike në shoqëritë e dala nga lufta, Andrew Taylor argumentonte se në aspektin praktik kjo kritikë është e pakuptimtë. Taylor pohon se “një shoqëri e ndarë mbi baza etnike dhe kulturore do të mbetet e ndarë mbi baza etnike dhe kulturore pavarësisht se çfarë sistemi zgjedhor

⁷⁰ Andrew Taylor, ‘Electoral systems and the promotion of ‘consociationalism’ in a multi-ethnic society. The Kosovo Assembly elections of November 2001’, *Electoral Studies* 24 (2005) 435-463, f. 449-453.

aprovohet dhe përpjekja për t'i përmbysur këto ndarje nga mekanizmat mazhoritarë është tejet e rrezikshme”.⁷¹

Sistemi zgjedhor në Kosovë mori në konsideratë, në një shkallë të lartë, pothuajse të gjithë faktorët kontekstualë në Kosovë. Një pjesë e madhe e serbëve të shpërngulur nga pjesë të tjera në pjesën veriore të Kosovës, kontestonin si legjitimitetin ashtu edhe legalitetin e UNMIK-ut. Ky kontestim ishte konkretizuar me bojkotimin e zgjedhjeve lokale. Në anën tjetër, kërkesat e Serbisë karshi serbëve kosovarë për mospjesëmarrje në institucionet e Kosovës ishin të qarta. Ndonëse tashmë ishte ndalur lufta dhe ishte instaluar një paqe negative, tensionet ndëretnike ende ishin të gjalla dhe serbët ndiheshin të frikësuar nga një hakmarrje e mundshme e shqiptarëve, të cilët demografikisht dhe politikisht ishin shumicë në Kosovë. Nën këto rrethana, apeli për parti multietnike dhe sistemi mazhoritar faktikisht do t'i përjashtonin krejtësisht serbët nga institucionet e Kosovës, me çka do të delegjitimohej edhe administrata e UNMIK-ut, e instaluar për të ndërtuar një demokraci multietnike. Incentiva për përfaqësimin e serbëve përmes vendeve të rezervuara, përmes Kornizës Kushtetuese, sidomos pas ndryshimeve demokratike në Serbi me rënien e Milošević-it nga pushteti, ishte njëri prej opsioneve të pakta në ‘tavolinën e zgjidhjeve’.

Sistemi politik dhe ai zgjedhor në Kosovë i përmbajnë pothuajse të gjithë ata mekanizma konsultativë dhe vendimmarrës të pushtetndarjes për të cilat Arendt Lijphart flet gjatë e shtruar. Këta mekanizma kanë qenë pjesë e Kornizës Kushtetuese dhe, pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, në përputhje me Planin e Ahtisaari-t, do të përbrendësoheshin në Kushtetutën e Kosovës, si mekanizma ligjorë për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve në Kosovën e pavarur. Komunitetet pakicë do të kenë të garantuar përfaqësimin në nivel lokal dhe qendror, në nivel parlamentar dhe qeveritar, në nivel të gjyqësisë dhe të administratës publike. U

⁷¹ Po aty, f. 461.

krijuan edhe mekanizma konsultativë në nivel të institucionit të Presidentit të Kosovës, si Këshilli Konsultativ për Komunitete; mekanizma vendimmarrës, si Komisioni Parlamentar për të Drejta dhe Interesa të Komuniteteve dhe Kthim, në Kuvendin e Kosovës; si dhe mekanizma koordinues, si Zyra për Çështje të Komuniteteve pranë Zyrës së Kryeministrit.⁷²

2.3 ‘Zgjedhjet historike’

Organizata ndërkombëtare i kanë cilësuar zgjedhjet e para të përgjithshme në Kosovë si ‘zgjedhje historike’.⁷³ UNMIK-u i shihte zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2001 si një mundësi tjetër për ta legjitimuar dyfish vetveten. Në njërën anë, duke negociuar për pjesëmarrjen e serbëve në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2001 dhe, në anën tjetër, duke krijuar mundësinë për themelimin e institucioneve të përkohshme vetëqeverisëse në Kosovë dhe transferimin gradual të kompetencave nga UNMIK-u te këto institucione. Meqë serbët i kishin bojkotuar zgjedhjet lokale të vitit 2000, me rënien e regjimit të Milošević-it ishte hapur mundësia për të bashkëpunuar me Serbinë, në mënyrë që ajo të mos apelonte tek serbët kosovarë për një bojkot të ri të zgjedhjeve që do të organizoheshin më 2001. Serbët kishin mospajtime të thella rreth pjesëmarrjes në këto zgjedhje. Ata që ishin zhvendosur në pjesën veriore të Kosovës u treguan më rigidë, për faktin se tashmë kishin krijuar *de facto* disa ‘institucione paralele’ dhe gëzonin përkrahjen e

⁷² Shih për këtë, Adem Beha, ‘Minority Rights: An Opportunity for Adjustment of Ethnic Relations in Kosovo?’, *Journal on Ethnopolitics and Minority Issues in Europe*; Vol 13, No 4, 2014, 85-110; Gëzim Visoka and Adem Beha, ‘Minority Consultative Bodies in Kosovo: A Quest for Effective Emancipation or Elusive Participation?’, *Journal on Ethnopolitics and Minority Issues in Europe*, Vol 10, No 1, 2011, 1-30.

⁷³ Grupi Ndërkombëtar i Krizave, ‘Kosova: Zgjedhje Historike’ (Prishtinë, 21 nëntor 2001).

drejtpërdrejtë të Serbisë. Serbët e Graçanicës ishin më pragmatikë rreth pjesëmarrjes në zgjedhje.⁷⁴

Pjesëmarrja e serbëve në zgjedhjet e përgjithshme u bë e mundshme pas një marrëveshjeje të nënshkruar më 5 nëntor 2001 mes PSSP-së së UNMIK, Hans Haekkerup-it, dhe Kryetarit të Qendrës të Bashkërendimit me Kosovën të RFJ-së, Nebojša Čović. Nëpërmjet kësaj marrëveshjeje, Serbia parashtronte tri kërkesa për UNMIK-un: a) institucionet që do të dilnin nga zgjedhjet, e veçmas Kuvendi, të mos ndërmerrnin ndonjë hap drejt shpalljes së pavarësisë së Kosovës, b) UNMIK-u të angazhohej për përmirësimin e sigurisë së serbëve dhe kthimin e refugjatëve serbë, dhe c) disa njësi të Ushtrisë Jugosllave të ktheheshin në Kosovë. Në fakt, natyra e kërkesave të Serbisë ndryshonte vazhdimisht, për faktin se partnerët e koalicionit që e kishte rrëzuar Slobodan Milošević-in nga pushteti, Partia Demokratike e Serbisë (DSS)⁷⁵ e udhëhequr nga Vojislav Koštunica dhe Partia Demokratike e Zoran Djindjić-it, nuk kishin një pozicion të përbashkët për Kosovën. Në mënyrë që këto parti t'i iknin përgjegjësisë politike rreth Kosovës, Beogradi, pas listimit të disa kërkesave që duhet të përmbusheshin nga UNMIK-u për serbët e Kosovës, u pajtua rreth pjesëmarrjes së serbëve në zgjedhjet në Kosovë.⁷⁶

⁷⁴ Jens Stilhoff Sørensen, 'International Statebuilding in Kosovo', në David Chandler dhe Timothy D. Sisks (ed.) Routledge Handbook of International Statebuilding (Routledge, 2013), f. 275.

⁷⁵ Sipas Grupi Ndërkombëtar i Krizave, "Mungesa e dëshirës të Koshtunicës dhe e partisë së tij, Partia Demokratike e Serbisë (DSS), për të miratuar pjesëmarrjen e serbëve mund të shpjegohet me faktorë të ndryshëm, përfshi lidhjen e vazhdueshme me projektin "Serbia e madhe". Së dyti, ishte frika se krijimi i institucioneve të reja rrezikonte zgjimin e strukturave paralele serbe në ato pjesë të Kosovës ende nën kontrollin serb, në veri të lumit Ibër ku DSS është e fortë. Së treti, udhëheqësit e DSS-së kanë pasur frikë se po ofendojnë thelbin e partisë, përbërjen nacionaliste, në të mirë të partive të tjera në skenën politike serbe". Shih arsyetimet e plota në Grupi Ndërkombëtar i Krizave, 'Kosova: Zgjedhje Historike (Prishtinë, 21 nëntor 2001), f. 7.

⁷⁶ Përpos faktit se Haekkerup kishte nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me Nebojša Čović-in, ai kishte deklaruar se Kosova ishte pjesë e Republikës Federale

Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë e 15 majit 2001 përshkruan “institucionet, të cilat do të lihen në duar të liderëve kosovarë dhe të nëpunësve publikë pas zgjedhjeve, më 17 nëntor 2001”.⁷⁷ Në zgjedhjet e përgjithshme të nëntorit 2001 garuan 26 parti politike dhe shkalla e daljes së qytetarëve në votime ishte 64%, pra 14% më e ulët në krahasim me zgjedhjet lokale të para një viti. Siç është vërejtur nga Grupi Ndërkombëtar i Krizave:

Dështimi i fushatës për të ngjallur të njëjtin entuziazëm si në zgjedhjet komunale ndoshta reflekton pjesërisht vështirësinë për t'i dalluar partitë nga njëra-tjetra në çështjet thelbësore. Ndërsa të tri partitë premtojnë përkushtim ndaj një qeverisjeje të mirë e demokratike, ndaj respektimit të ligjit, ekonomisë së tregut, etj., duke qenë se asnjëra prej tyre nuk ka përvojë qeverisëse, është e pamundshme të vlerësohen premtimet e tyre. Në lidhje me çështjen kryesore, statusin përfundimtar të Kosovës, të tria janë të përkushtuara për pavarësi. Në një masë të madhe, parapëlqimet e votuesve bazohen në traditat ose faktorët rajonalë, si dhe në personalitetin e udhëheqësve të partive.⁷⁸

LDK-ja doli fituese e zgjedhjeve me 45.7% të totalit të votave. Krahasuar me zgjedhjet lokale të vitit 2000 kur LDK-ja kishte marrë 58% të votave të trupit elektoral, kjo shënoi një rënie të votës së përgjithshme ndaj LDK-së. PDK-ja u rendit partia e dytë fituese me 25.7% të votave, kurse AAK-ja e treta me 7.8% të votës së

të Jugosllavisë. Sjellja jodiplomatike, si ajo e ndaljes së mikrofonit të kryetarit të PDK-së, gjatë inagurimit të Kuvendit të Kosovës, po ashtu e kishin shndërruar atë në figurë antipatike. Shih për këtë James Ker-Lindsay, 'From autonomy to independence: the evolution of international thinking on Kosovo, 1998-2005', *Journal of Balkans and Near Eastern Studies*, 2009, 11:2, f. 149.

⁷⁷ UNMIK Rreg/2001/9, 'Constitutional Framework for Provisional Self-Government in Kosovo', 15 maj 2001. Qasur në http://www.assembly-kosova.org/common/docs/FrameorkPocket_ENG_Dec2002.pdf (4 prill 2015)

⁷⁸ Grupi Ndërkombëtar i Krizave, 'Kosova: Zgjedhje Historike' (Prishtinë, 21 nëntor 2001), f. 3.

përgjithshme. Serbët morën pjesë në zgjedhje nëpërmjet një koalicioni të madh të disa partive politike (Koalicioni 'Povratak'). Ky koalicion kishte arritur të fitonte 11.3% të votave të përgjithshme. Duke qenë se me Kornizën Kushtetuese 10 ulëse ishin të garantuara paraprakisht për pakicën serbe, këtyre vendeve iu shtuan edhe 12 ulëse të tjera nga rezultatet zgjedhore, duke e rritur përfaqësimin e serbëve në Kosovë me 22 ulëse në Kuvendin e Kosovës.⁷⁹

Me shpalljen e rezultateve zgjedhore ishte hapur mundësia për krijimin e institucioneve të përkohshme, ashtu siç parashihej me Kornizën Kushtetuese. LDK dhe PDK kishin mospajtime të thella rreth ndarjes së pozitive udhëheqëse dhe të dyja negocionin për pozitën e presidentit dhe të kryeministrit. Duke ndjekur një qasje parteraliste për ta zhbllokuar këtë situatë, lidërshipi i Hans Haekkerup-it⁸⁰ kishte dështuar t'i jepte zgjidhje kësaj vonese të formimit të institucioneve. Pas nënshkrimit të marrëveshjes mes Haekkerup-it dhe Čović-it, për të cilën nuk ishte konsultuar lidërshipi politik në Kosovë, Haekkerup humbi kredibilitetin e tij tek partitë politike shqiptare, dhe dalëngadalë nisi të shihej si pengesë për realizimin e aspiratave të shqiptarëve për pavarësinë e Kosovës. Me gjithë faktin se vendi kishte mbajtur zgjedhje në nëntor 2001, Kosova do të presë deri në shkurt 2002 për formimin e institucioneve të përkohshme. Pas dorëheqjes së Haekkerup-it dhe

⁷⁹ Oisín Tansey, 'Democratization Without a State: Democratic Regime-building in Kosovo, Democratization'. 14:1 (2007), f. 139; Jens Narten, 'Post-Conflict Peacebuilding and Local Ownership: Dynamics of External-Local Interaction in Kosovo under United Nations Administration', *Journal of Intervention and Statebuilding* (2008), 2:3, 369-390, f. 379; Iain King, Mason, *Paqe me çdo kusht: Si dështoi bota në Kosovë* (KOHA, Prishtinë, prill 2007), f. 134.

⁸⁰ Rreth rolit të lidërshit të UNMIK, Yeshi Choedon duke e analizuar lidërshpin e PSSP-ve të UNMIK-ut, i vlerëson Kouchner-in, Steiner-in dhe Jessen Petersen-in për aktivizimin e tyre në Kosovë, me përjashtim të PSSP-ve të tjerë. Sipas Choedon "faktori personalitet dhe mungesa e përkushtimit kanë kontribuar në mungesën e bashkërendimit brenda UNMIK-ut". Shih Yeshi Choedon, 'The United Nations Peacebuilding in Kosovo: The Issue of Coordination', *International Studies* 47 (1), 2010, f. 52.

zëvendësimit të tij në janar 2002 nga PSSP-ja i ri i UNMIK-ut, Michael Steiner, u hap rruga për formimin e institucioneve dhe ndarjen e pozitave qeverisëse mes PDK-së dhe LDK-së, falë lidërshiptit energjik të Steiner-it. Duke qenë se përfaqësuesit dhe ambasadorët e Quint-it dhe të UNMIK-ut mbanin ‘çelësat e pushtetit’ dhe ishin të interesuar për një lidërshipt të moderuar politik, ata kishin ndërhyrë dhe kishin dhënë udhëzime të qarta se kush mund ta drejtonte qeverisjen e Kosovës.⁸¹ Lideri i PDK-së, si Drejtor Politik i UÇK-së dhe Kryeministër i ‘Qeverisë së Përkohshme’, sipas perceptimit të UNMIK-ut, nuk do të mund t’i kontribuonte ndërtimit të një shoqërie demokratike, tolerante dhe multietnike, për faktin se nga serbët shihej si ‘njeri i UÇK-së’. Po ashtu, as LDK-ja, partia më e madhe fituese e zgjedhjeve, nuk do të mund ta pranonte lehtë një marrëveshje me Thaçin si kryeministër, duke pasur parasysh kritikën e këtij të fundit ndaj LDK-së dhe liderit të saj. Në anën tjetër, bashkësia ndërkombëtare e mbante përgjegjësin Thaçin, siç thuhej në raportin e Grupi Ndërkombëtar i Krizave, për “kaosin, korrupsionin dhe kriminalitetin e periudhës menjëherë pas luftës”.⁸² Në një formë a tjetër, në fazën e parë të transicionit demokratik në Kosovë, imazhi i Hashim Thaçit ishte dëmtuar. Siç konstaton Oisín Tansey, “pas një periudhe të negociatave direkte me liderët politikë, dhe në kontekstin e presionit të ShBA-së që Thaçi të mos jetë kryeministër, Steiner propozoi një kandidat kompromisi për këtë pozitë, politikanin e PDK-së, Bajram Rexhepin. Sugjerimi u pranua, PDK pranoi ta mbështeste presidentin, dhe u arrit një marrëveshje pas një sesiioni të negociatave të gjata në rezidencën private të PSSP-së që përfundoi në orët e hershme të 28 shkurtit

⁸¹ Oisín Tansey, *Regime-building: Democratization and International Administration*. (Oxford University Press, 2009), f. 121.

⁸² Grupi Ndërkombëtar i Krizave, ‘Kosova: Zgjedhje Historike (Prishtinë, 21 nëntor 2001), f. 5.

2002”.⁸³ Në anën tjetër, King dhe Mason argumentojnë se njëri prej emrave të tjerë të diskutuar për pozitën e kryeministrit të propozuar nga PDK-ja ishte Fatmir Limaj, por ky emër ishte refuzuar nga Steiner, meqë Limaj pritej të akuzohej nga Tribunali i Hagës për krime lufte. Në fakt, një vit pas lidhjes së koalicionit të madh dhe ndërtimit të qeverisë, në shkurt 2003, Tribunali i Hagës ngriti aktakuzë ndaj Fatmir Limajt, si politikani i dytë më me ndikim në PDK, dhe tre kolegëve të tjerë të tij të luftës.⁸⁴

Sipas marrëveshjes së shkurtit 2002, LDK, PDK dhe AAK ndërtuan një koalicion të madh⁸⁵, ku PDK-ja mori pozitën e Kryeministrit, LDK atë të Presidentit të Kosovës, kurse AAK dhe Koalicioni Povratak u bënë hisedarë në qeveri. Qëllimi i një koalicioni të tillë të madh ishte ndërtuar në përputhje me parimet e ‘demokracisë konsensuale’. Me anë të këtij koalicioni synohej të ulej polariteti politik mes LDK-së dhe PDK-së dhe të ndërtohej një konsensus i gjerë për të qeverisur në Kosovën e pasluftës. Në anën tjetër, duke qenë se shumica e këtyre partive ishin ndërtuar mbi baza etnike, ku lojaliteti fitohej dhe mbahej nga aleancat familjare dhe klanore në rajonet ku këto parti kishin bazën e vet elektorale, UNMIK-u synonte që, duke i përfshirë të gjitha partitë në pushtet, ta rriste kontrollin mbi territorin e Kosovës, ta zgjeronte bazën e vet të legjitimitetit të brendshëm dhe, rrjedhimisht, ta mirëmbante *status quo*-në. Me fjalë të tjera, “nevoja për të pasur një qeveri të

⁸³ Oisín Tansey, ‘Democratization without a State: Democratic Regime-building in Kosovo’, *Democratization*, 2007, 14:1, f. 139, f. 140.

⁸⁴ Në ditën e ngritjes së aktakuzës së Tribunalit të Hagës ndaj Limajt, ky kishte qenë duke skijuar në Slloveni me liderin me PDK-së, Hashim Thaçi dhe i ishte dorëzuar policisë së Sllovenisë. Iain King, Mason, *Paqe me çdo kusht: Si dështoi bota në Kosovë* (KOHA, Prishtinë, prill 2007), f. 152.

⁸⁵ Gjatë procesit të negociatave për ndarjen e posteve dhe formimin e institucioneve, LDK-ja i kishte premtuar PDK-së 5 prej 10 ministrive që do të kishte Qeveria e Kosovës. Prej këtyre 10 ministrive, 3 ishin caktuar për pakicat, që realisht, sipas këtij propozimi, LDK-ja do të udhëhiqte me vetëm 2 ministri. Sidoqoftë, duke kushtëzuar realizimin e kësaj marrëveshjeje, LDK-ja nuk e pranonte Thaçin për kryeministër.

efektshme u vu pas nevojës për stabilitet”.⁸⁶ Mungesa e qartësimit të statusit politik të Kosovës ende i rrezikonte marrëdhëniet ndëretnike brenda vetë Kosovës si dhe stabilitetin rajonal. Në anën tjetër, edhe pse UNMIK-u kishte paralajmëruar se Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse në Kosovë (IVPQ-të) të dala nga zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2001 nuk kishin mandat të shpallnin pavarësinë e Kosovës, AAK-ja kishte iniciuar një mocion për shpalljen e njëanshme të pavarësisë së Kosovës.

Megjithatë, këtij koalicioni të madh i mungonte kohezioni dhe një lidhshmëri e fuqishme që do t'i bashkërendonte veprimet brendaqeveritare. Kryeministri Bajram Rexhepi nuk ishte kryetar i PDK-së dhe për çdo veprim të tij i duhej të konsultohet me Hashim Thaçin. Deputetëve të LDK-së, PDK-së, AAK-së dhe të Koalicionit Povratak, të përfaqësuar në Kuvendin e Kosovës, po ashtu u mungonte përvoja. Kësisoj, UNMIK-u ende e mbante rolin e protagonistit në të gjitha iniciativat e ndërmarra në Kosovë. Pas formimit të institucioneve, menjëherë filluan përplasjet mes UNMIK-ut dhe IPVQ-ve dhe kjo përplasje u ndikua nga tri ngjarje të rëndësishme.

Në prill 2002, UNMIK-u nënshkroi Marrëveshjen Kufitare mes Jugosllavisë dhe Maqedonisë në emër të Kosovës. Kjo marrëveshje që nënshkruar para formimit të Unionit Serbi-Mali i Zi, në nëntor 2002, e ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian.⁸⁷ Sipas kësaj marrëveshjeje, Kosova humbte një pjesë të territorit dhe ky i kalonte Maqedonisë. Kuvendi i Kosovës, më 23 maj 2002 e kundërshtoi këtë marrëveshje me një rezolutë të veçantë të quajtur

⁸⁶ Grupi Ndërkombëtar i Krizave, 'Dy në Tango: Agjendë për PSSP në Kosovë' (ICG, Raporti i Evropës Nr.148, 3 shtator 2003), f. 5.

⁸⁷ Për transicionin e Malit të Zi drejt pavarësisë, shih librin e edituar nga Florian Bieber (ed.), *Montenegro in Transition: Problems of Identity and Statehood* (Nomos Verlagsgesellschaft, Baden-Baden, 2003). Shih punimin e Srđa Pavlović, 'Who are Montenegrins? Statehood, identity and civil society', ff. 83-1-7 dhe punimin e Florian Bieber, 'Montenegrin politics since the disintegration of Yugoslavia', ff. 7-11.

‘Integriteti Territorial i Kosovës’. PSSP-ja, Michael Steiner, e shpalli rezolutën të pavlefshme. Unioni Serbi-Mali i Zi e kishte përfshirë Kosovën në preambulën e vet⁸⁸ dhe Kuvendi i Kosovës, për të dytën herë, me 7 nëntor 2002, nxori një rezolutë, me të cilën dënonte këtë veprim të Serbisë. Edhe kjo rezolutë u shpall e pavlefshme. Duke qenë se gjatë kësaj kohe kishin filluar hetimet për disa pjesëtarë të UÇK-së nga UNMIK-u, dhe meqenëse politikat e UNMIK-ut, në sytë e partive politike, po mirëmbanin sovranitetin e Jugosllavisë mbi Kosovën, Kuvendi i Kosovës, më 15 maj 2003 nxori rezolutën e tretë për ‘Luftën Çlirimtare të Popullit të Kosovës për Liri dhe Pavarësi’. Edhe kjo rezolutë u shpall e pavlefshme dhe u konsiderua përçarëse për marrëdhëniet ndëretnike. Rezoluta e tretë për ‘Luftën Çlirimtare të Popullit të Kosovës për Liri dhe Pavarësi’ pati pasoja të pasynuara, duke ulur tonalitetin e konfliktit të mëparshëm mes LDK-së dhe PDK-së, për faktin se rezoluta mirënjohu luftën e armatosur të UÇK-së dhe rezistencën paqësore të LDK-së.⁸⁹

Tre muaj para se Kosova t’i organizonte zgjedhjet e para të përgjithshme, më 11 shtator 2001, Al-Kaida sulmoi kullat binjake në New York. Kjo ngjarje e zhvendosi vëmendjen e ShBA-së nga Kosova drejt Lindjes së Mesme, fillimisht në Afganistan dhe pastaj në Irak e përtej.⁹⁰ Edhe pas zgjedhjeve të para të përgjithshme,

⁸⁸ Shih, State Union of Serbia and Montenegro, ‘Constitutional Charter of the State Union Serbia and Montenegro’, 2002. Qasur në http://www.worldstatesmen.org/SerbMont_Const_2003.pdf (5 korrik 2015).

⁸⁹ Grupi Ndërkombëtar i Krizave, ‘Dy në Tango: Agjendë për PSSP në Kosovë’ (ICG, Raporti i Evropës Nr. 148, 3 shtator 2003), f. 5.

⁹⁰ Për politikën e jashtme të ShBA-së pas 11 Shtatorit, shih Simon Chesterman, ‘Just war or Just Peace After September 11: Axes of Evil and War Against Terror in Iraq and Beyond’, *International Law* (2004-2005) Vo.37, ff. 281-301; Dirk Nabers, ‘Filling the Void of Meaning: Identity Construction in U.S. Foreign Policy After September 11, 2001’, *Foreign Policy Analysis*, Vol. 5, Issue 2, ff.191-214; Christopher Hill, ‘Renationalizing or Regrouping? EU Foreign Policy Since 11 September 2001’, *Journal of Common Market Studies*, Vol.41, Issue 1, ff. 143-163; Stephen M. Walt, ‘Beyond bin Laden: Reshaping U.S. Foreign Policy’, *International Security* (2001/2), Vol.26, No. 3, ff. 56-78; James M.

UNMIK-u ende nuk kishte një strategji dalëse nga Kosova.

Më 15 nëntor 2001, nëpërmjet një debati të hapur, Këshilli i Sigurimit bëri një vlerësim të misioneve të veta paqeruajtëse në zonat e konfliktit. Sipas këtij raporti, ‘dalja’ ose ndryshimi i mandatit të operacioneve paqëndrueshë, varej nga tri rrethana: përfundimi i suksesshëm i mandatit, dështimi ose suksesi i pjesshëm. “Qëllimi i operacioneve paqësore”, theksonte raporti, “është arritja e paqes së qëndrueshme”. Raporti konstaton se paqja bëhet e qëndrueshme atëherë kur konfliktet shoqërore zgjidhen me mjete paqësore nëpërmjet ushtrimit të sovranitetit shtetëror dhe qeverisjes demokratike. Në mënyrë që të arrihej kjo, palët ndërluftuese duhet ta zhvendosin konfliktin e tyre nga terreni drejt një kornize institucionale. “Për ta arritur një transicion të tillë, mandati i misionit duhet të përfshijë elemente të tilla si ndërtimi i institucioneve, promovimi i qeverisjes së mirë dhe sundimi i ligjit, duke i ndihmuar palët që të zhvillojnë institucione me bazë të gjerë legjitime”.⁹¹ Sipas raportit, paqëndërtimi i suksesshëm dhe gjithëpërfshirës varet nga përmbushja e tri objektivave: a) konsolidimi i sigurisë së brendshme dhe të jashtme; b) fuqizimi i institucioneve politike dhe qeverisja e mirë; c) promovimi i rehabilitimit dhe transformimit ekonomik dhe social.

Raporti ‘No exit without a strategy’, në lidhje me rastin e Kosovës, theksonte se “dalja e UNMIK-ut është e lidhur me përcaktimin e statusit final të territorit”, dhe në përputhje me këtë mandat “operacioni ka filluar të kthejë një autonomi dhe vetëqeverisje të shtuar, por duke mënjeluar çdo veprim që do të paragjykonte rezultatin mbi statusin final”. Ndonëse në raport ishte

McCormick, *The Domestic Sources of American Foreign Policy: Insights and Evidence* (Rowman & Littlefield Publishers, Inc. 2012); Joseph S. Nye, ‘U.S. Power and Strategy After Iraq’, *Foreign Affairs* (2003).

⁹¹ United Nations Security Council, ‘No exit without strategy: Security Council decision-making and the closure or transition of United Nations peacekeeping operations’, S/2001/394, 20 prill 2001, f. 2.

evidentuar se “[kishte] një tension të pamënjatueshëm mes aspiratave të popullit në Kosovë dhe mandatit të dhënë nga Këshilli i Sigurimit, duket se nuk ka alternativë tjetër [...] derisa të arrihet një marrëveshje për statusin final në një kohë tjetër”.⁹²

⁹² Po aty, ff. 7-8.



KAPITULLI III

KAPITULLI 3:

RIKONFIGURIMI I PUSHTETIT NË KOSOVË DHE
PËRTEJ - ZGJEDHJET E PËRGJITHSHME TË VITIT 2004

KAPITULLI 3: RIKONFIGURIMI I PUSHTETIT NË KOSOVË DHE PËRTEJ - ZGJEDHJET E PËRGJITHSHME TË VITIT 2004

Që nga viti 1999, sovraniteti empirik i Kosovës është kufizuar nga katër faktorë: a) Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit, b) institucionet paralele serbe, c) paaftësia e qeverisë së Kosovës për të ushtruar kontroll mbi territorin e Kosovës, dhe d) mungesa e kapaciteteve për të zbatuar politika publike.⁹³ Duke i analizuar këta faktorë, Dominik Zaum nënvizon se sovraniteti empirik i Kosovës ishte i lidhur me mungesën e qartësisë politike për statusin e Kosovës. Meqë statusi politik i Kosovës mbeti i padefinuar, UNMIK-u shpiku të ashtuquajturat ‘standarde para statusit’ si instrument për të blerë kohë. UNMIK-u kishte parashtruar para Kosovës përmbushjen e 8 standardeve: 1) funksionimi i institucioneve demokratike; 2) sundimi i ligjit; 3) liria e lëvizjes; 4) kthimi i qëndrueshëm dhe të drejtat e komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre; 5) ekonomia; 6) të drejtat pronësore; 7) dialogu Beograd-Prishtinë; 8) Trupat Mbrojtëse të Kosovës.⁹⁴ Çdo progres

⁹³ Dominik Zaum, *Sovereignty Paradox: Norms and the Politics of International Statebuilding* (Oxford, New York: Oxford University Press, 2007), f.141.

⁹⁴ Shih Joseph Marko, ‘Independence without standards? Kosovo’s Interethnic Relations Since 1999’, *European Yearbook of Minority Issues Online* (2007), Vol. 5, Issue 1, ff. 219-241.

drejt statusit përfundimtar kushtëzohej me përmbushjen e ‘standardeve para statusit’/‘standardeve të civilizimit’. Sidoqoftë, Zaum vëren se transferimi i autoritetit politik nga UNMIK-u tek institucionet lokale nuk varej nga përmbushja e standardeve ose paaftësia e Kosovës për t’i përmbushur ato, por para së gjithash nga paaftësia e teknokratëve të UNMIK-ut për të bashkëpunuar me institucionet lokale në Kosovë.

Qëllimi i këtyre standardeve ishte ndërtimi i një sovraniteti me faza në Kosovë. Faza e parë nënkuptonte se sovraniteti do të ushtrohej në mënyrë të përbashkët (shared sovereignty) mes UNMIK-ut dhe institucioneve të përkohshme, kurse në fazën e dytë ky pushtet do të dorëzohej në mënyrë graduale tek institucionet vendore (phased sovereignty).⁹⁵ Siç argumenton Knoll, politika e standardeve para statusit ishte kornizuar nën ndikimin e idesë së ‘sovranitetit të merituar’ (earned sovereignty). Ideja e këtyre standardeve ishte vendosja e disa indikatorëve të qeverisjes së mirë – një politikë kjo e kushtëzimit – përmes të cilës do të matej progresi i Kosovës gjatë periudhës së transicionit. Ndonëse ky set indikatorësh ishte caktuar për një periudhë kalimtare, në mënyrë që të mundësohej hapja e negociatave për përcaktimin e statusit përfundimtar të Kosovës, Knoll vërente se deri më 2003, standardet para statusit më shumë konsideroheshin si mjete për menaxhimin e stabilitetit të brendshëm të Kosovës sesa si politikë e adoptuar dhe e përbrendësuar nga institucionet e përkohshme të saj.

Po ashtu, shih UNMIK ‘Standards for Kosovo’, Pristina, 10 dhjetor 2003. Qasur në <http://www.securitycouncilreport.org/atf/cf/%7B65BFCF9B-6D27-4E9C-8CD3-CF6E4FF96FF9%7D/Kos%20Standards.pdf> (26 korrik 2016).

⁹⁵ Sipas Hooper dhe Williams, ‘Kosova përfaqëson shembullin më gjithëpërfshirës të përdorimit të sovranitetit me faza për ta menaxhuar transferimin e autoritetit sovran dhe funksionet. Në përputhje me Rezolutën 1244, OKB ka miratuar Kornizën e Përkohshme Kushtetuese e cila do të sgurohet që UNMIK-u dhe entitetet e Kosovës të ushtrojnë shumicën e funksioneve që në mënyrë tipike asociohen me një shtet të pavarur, duke përfshirë këtu marrëdhëniet me jashtë’. Shih James R. Hooper dhe Paul R. Williams, ‘Earned Sovereignty: The Political Dimension’, *Denv. J. Int’l. & Pol’y*, Vol 31, ff. 365-367.

Përbushja e objektivit të tretë të UNMIK-ut, që kishte të bënte me transferimin e kompetencave të plota nga UNMIK-u tek institucionet e Kosovës, ishte bllokuar pikërisht nga UNMIK-u për shkak të statusit të pazgjidhur.⁹⁶ Kësisoj, dy paradigma kishin shoqëruar administrimin ndërkombëtar në Kosovë: në njërën anë, UNMIK-u e lidhte progresin në Kosovë me normat e ashtuquajtura standarde të civilizimit (standardet para statusit), kurse kosovarët me normën e vetëvendosjes.⁹⁷ Nicolas Lemay-Hebert vëren se në rastin e administrimit ndërkombëtar të Kosovës përplaseshin dy objektiva antagonistë. Sipas tij: “fokusi fillestar në ndërtimin e institucioneve në Kosovë dhe në Timorin Lindor, si dhe centralizimi i autoritetit në duart e zyrtarëve ndërkombëtarë, i çuan këta zyrtarë në marginalizimin e imperativëve të fuqizimit (empowerment) dhe të përjashtimit të popullatës lokale nga korniza e qeverisjes, duke krijuar probleme të reja në terren dhe duke ushqyer një valë të re kundërshtimi popullor ndaj administratës ndërkombëtare”.⁹⁸ Sipas tij, politika e ‘standardeve para statusit’ e kishte frustruar lidershipin politik vendor, i cili i shihte këto si ‘standarde për parandalimin e statusit’.

Edhe pse ‘standardet para statusit’ konsideroheshin standarde të qeverisjes së mirë⁹⁹, kjo politikë dhe qasje paternalizuese i trajtonte institucionet e përkohshme të Kosovës si ‘nxënës’ që duhej të maturoheshin para se të hapej statusi final i Kosovës. Vonesat në

⁹⁶ Jens Narten, ‘Post-Conflict Peacebuilding and Local Ownership: Dynamics of External-Local Interaction in Kosovo under United Nations Administration’, *Journal of Intervention and Statebuilding* (2008), 2:3, 369-390, f. 379.

⁹⁷ Dominik Zaum, *Sovereignty Paradox: Norms and the Politics of International Statebuilding* (Oxford, New York: Oxford University Press, 2007), f.152.

⁹⁸ Nicolas Lemay-Hébert, ‘Coerced transitions in Timor-Leste and Kosovo: managing competing objectives of institution-building and local empowerment’, *Democratization*, (2012), 19:3, f. 467.

⁹⁹ Carsten Stahn, *The Law and Practice of International Territorial Administration: Versailles to Iraq and Beyond*, (Cambridge: Cambridge University Press, 2008), f. 313; Osin Tansey, *Regime-building: Democratization and International Administration*. (Oxford University Press, 2009), f. 139.

transferimin e kompetencave nga UNMIK-u tek institucionet e Kosovës – të cilave u kërkohej t'i përmbushnin standardet për të cilat nuk kishin kompetenca të plota – prodhoi pasoja të paparashikuara. Diskursi provokativ i Qeverisë së Serbisë ndaj popullatës shqiptare të Kosovës, sipas të cilit e ardhmja e Kosovës do të ishte brenda Serbisë, si dhe ndërhyrja e saj në territorin e Kosovës me instrumentalizimin e strukturave paralele në enklavat serbe, veçanërisht në pjesën veriore të Kosovës, ndikuan drejtpërdrejt në humbjen e durimit të lidërshiptit politik shqiptar dhe të popullatës shqiptare. Vonesat për shqyrtimin e statusit të Kosovës kishin filluar të gërryenin edhe marrëdhëniet dhe mirëbesimin më elementar mes shqiptarëve dhe serbëve.

Për sa kohë frika shqiptare dhe shpresa serbe për rifutjen e Kosovës në Jugosllavi mbeten pa përgjigje, përpjekjet për krijimin e marrëdhënieve normale dhe konstruktive midis dy bashkësive, si brenda Kosovës ashtu edhe mes Kosovës e Serbisë, ka shumë mundësi të jenë të pafrytshme.¹⁰⁰

Më 17 dhe 18 mars të vitit 2004, pas një incidenti në Mitrovicë, ku supozohej se disa fëmijë shqiptarë qenë ndjekur nga qentë e disa serbëve të moshës madhore dhe kishin përfunduar të mbytur në lumin Ibër, situata doli jashtë kontrollit në gjithë Kosovën. Kjo ngjarje u shfrytëzua si shkas për të shfryrë gjithë mllefin dhe frustrimin katërvjeçar të popullatës lokale me situatën politike të mbetur pezull, si dhe me mungesën e perspektivës ekonomike dhe ndërhyrjet e vazhdueshme të Serbisë në Kosovë. Gjatë këtyre ditëve në Kosovë shpërthyen 33 protesta me afro 51.000 pjesëmarrës, mbetën të vrarë 19 persona, kurse 954 të tjerë u lënduan.¹⁰¹ Pas

¹⁰⁰ International Crisis Group 'Udhëzime Për Kosovën (I) Shqyrtimi i Statusit Përfundimtar' (Raporti 125 i ICG-së për Ballkanin, 1 mars 2002, Prishtinë/Bruksel, 1 mars 2002), f. 5.

¹⁰¹ OSCE Mission in Kosovo, Department of Human Rights and Rule of Law,

këtyre ngjarjeve të dhunshme të marsit, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së emëroi të Ngarkuarin Special, Kai Eide, që ta vlerësonte situatën e përgjithshme në Kosovë.

Kai Eide vlerësoi se *status quo*-ja ishte e paqëndrueshme dhe se bashkësia ndërkombëtare duhej të ndërmernte masa për ta iniciuar dialogun për përcaktimin e statusit përfundimtar të Kosovës. Megjithatë, brenga e tij dhe e partnerëve ndërkombëtarë të Kosovës ishte menaxhimi i brendshëm i Kosovës për mirëmbajtjen e stabilitetit. Mesazhi ndërkombëtar ishte i qartë: një dhunë tjetër e përmasave të marsit 2004 do ta pengonte hapjen e negociatave. Në anën tjetër, vetë ngjarjet e marsit e përshpejtuan adresimin e statusit të pazgjidhur politik të Kosovës. Si rrjedhojë e këtyre ngjarjeve, administrata e UNMIK-ut gjatë kohës së Harri Holker-it ishte afër kolapsit.¹⁰² Holker dha dorëheqje dhe u pasua nga Søren Jessen-Petersen. Duke qenë i vetëdijshëm se Tribunali Ndërkombëtar për Ish-Jugosllavinë po e hetonte Kryetarin e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinajn, për krime lufte, çështja e parë që shtrohej para Jessen-Petersen-it, por edhe përfaqësive diplomatike të akredituara në Kosovë, ishte menaxhimi i stabilitetit në Kosovë në rast të ngritjes së një aktakuze nga Tribunali i Hagës. ‘Koha e duhur’ për hapjen e negociatave për statusin e Kosovës do të varej edhe prej dinamikave politike brenda Kosovës, që do t’i prodhonin zgjedhjet e radhës.

Më 23 tetor 2004, Kosova i organizoi zgjedhjet e dyta të përgjithshme. Ndonëse qysh më 2003 kishte nisur një debat publik për reformimin e sistemit zgjedhor, duke marrë për bazë mungesën e llogaridhënës së deputetëve karshi votuesve, mungesën e lidhjes së

‘Human rights challenges following the March riots, 2004’, f. 4; Shih, po ashtu, Elizabeth Pond ‘Kosovo and Serbia after the French *non*’, *The Washington Quarterly* (2005), 28:4, ff. 19-36.

¹⁰² Jens Stilhoff Sørensen, ‘International Statebuilding in Kosovo’, në David Chandler dhe Timothy D. Sisks (ed.) *Routledge Handbook of International Statebuilding* (Routledge, 2013), f. 276.

deputetëve me zona të veçanta gjeografike dhe mbipërfaqësimin e pakicave në këto zgjedhje, nuk kishte pasur kurrfarë ndryshimi në sistemin zgjedhor. Gjatë kësaj kohe ishte argumentuar se “sistemi zgjedhor me lista të mbyllura vetëm sa e ka forcuar strukturën hierarkike dhe hermetike të partive, duke u ndihmuar ta forcojnë pushtetin liderëve të dalë në skenë në kohën e luftës dhe duke ngulfatur potencialin për evolucion”.¹⁰³ Diku te 1.4 milionë qytetarë të Kosovës me të drejtë vote kishin dalë për të votuar, pra afër 13% më pak se në zgjedhjet e para të përgjithshme. Freedom House i kishte vlerësuar këto zgjedhje si të lira dhe fer.¹⁰⁴ Duke qenë se më 2003 UNMIK-u e kishte transferuar pjesën dërmuese të kompetencave të Kreut 5 të Kornizës Kushtetuese, institucionet që dolën nga këto zgjedhje kishin më shumë kompetenca dhe gëzonin më shumë autonomi.¹⁰⁵

Në këto zgjedhje u certifikuan 33 subjekte politike. Edhe në zgjedhjet e vitit 2004, LDK printe me 313.437 vota dhe 47 ulëse në Kuvend, në krahasim me 199.112 vota ose 30 ulëse të PDK-së, 579.311 vota ose 9 ulëse të AAK-së, dhe 43.017 vota, ose 7 ulëse të ORA-s.¹⁰⁶ Pas shpalljes së këtyre rezultateve, LDK-ja, nën udhëheqjen e Ibrahim Rugovës, ndërtoi një koalicion me AAK-në,

¹⁰³ Grupi Ndërkombëtar i Krizave, ‘Kosova pas Haradinajt’, (Raport për Evropë i Grupit të Krizave, numër 163, 26 maj 2005), f. 13.

¹⁰⁴ Alexander J. Motyl, Amanda Schnetzer, *Nations in Transit 2004: Democratization in East Central Europe and Eurasia* (New York, Washington D.C, 2004), f. 523.

¹⁰⁵ Në Kreun 5 të Kornizës Kushtetuese ishin listuar përgjegjësitë e institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes në Kosovë, përfshirë këtu, mes tjerash, përgjegjësitë rreth politikave monetare dhe financiare, vetëqeverisje lokale, arsim, kulturë, shëndetësi etj.

¹⁰⁶ OSCE, ‘Kosovo Assembly Elections 2004 – CRS Results’, Pristina, 3 nëntor 2004. Qasur në <http://www.osce.org/kosovo/25332?download=true> (27 qershor 2016); NDI, ‘Kosovo 2004 Central Assembly Elections’. Qasur në https://www.ndi.org/files/1761_ksv_assembly_102604.pdf (27 qershor 2016); Bjørg Hope Galtung, ‘Kosovo: Assembly Elections October 2004’, Nordem Report 02/2005. Qasur në <http://www.jus.uio.no/smr/english/about/programmes/nordem/publications/2005/0205.pdf> (27 qershor 2016).

nën udhëheqjen e Ramush Haradinajt, duke e lënë jashtë koalicionit qeverisës partinë e dytë më të madhe, PDK-në. Meqenëse po afrohej koha e përcaktimit të statusit përfundimtar të Kosovës, asnjëra nga partitë dhe as lidërsipit i tyre nuk kishin marrë ndonjë iniciativë për të ndërtuar marrëdhënie me vendet fqinje të Kosovës. Për herë të parë kjo iniciativë u ndërmor gjatë fushatës zgjedhore të vitit 2004, kur Veton Surroi vizitoi Maqedoninë, Malin e Zi, Kroacinë, Slloveninë dhe Shqipërinë. Ky ishte një hap i rëndësishëm për të treguar aftësinë e lidërsipit kosovar për të ndërtuar marrëdhënie fqinjësore të mira.

Janë tri karakteristika që e shoqëruan procesin zgjedhor dhe paszgjedhor në zgjedhjet e vitit 2004. Karakteristika e parë ishte futja e disa iniciativave të reja qytetare dhe e kandidatëve të pavarur¹⁰⁷, bojkotimi i këtyre zgjedhjeve nga serbët, si dhe mbetja e PDK-së në opozitë. Kështu, në këto zgjedhje, kishin garuar lista e qytetarëve ORA e Veton Surroit dhe Alternativa Demokratike e Kosovës e Edita Tahirit. Të dy, Surroi dhe Tahiri, kishin një përvojë të vlefshme politike, duke qenë pjesëmarrës në proceset politike të viteve 90-të në Kosovë. ORA arriti të fitonte 6.23% të votave të përgjithshme, respektivisht 7 deputetë në Kuvendin e Kosovës. Karakteristika e dytë ishte pjesëmarrja e ulët e serbëve, ndryshe nga zgjedhjet e vitit 2001, meqë duke marrë si shkas ngjarjet e marsit 2004, partitë serbe dhe qytetarët serbë të Kosovës¹⁰⁸, me përjashtim

¹⁰⁷ Si kandidatë të pavarur në zgjedhjet e vitit 2004 kishin marrë pjesë: Behlul Beqaj, Fuad Ramiqi, Ramë Dreshaj, Riza Lluka. Megjithatë, që të gjithë këta kandidatë nuk kishin arritur që të fitojnë vota për të hyrë në Kuvend.

¹⁰⁸ Siç ka argumentuar Grupi Ndërkombëtar i Krizave, 'Duke pasur parasysh mosgatishmërinë e politikanëve shqiptarë që të merren me këto shqetësime dhe dështimin e UNMIK-ut që të ofrojë një ambient të sigurt, ky komunitet mbahet për atë që beson të jetë dega e fundit: Beogradi. Bojkotimi i zgjedhjeve të tetorit 2004 i ka marginalizuar serbët e Kosovës që kërkonin legjitimitet elektoral. Liderët ekstremistë jashtë institucioneve që ishin në krye të kërkesave për bojkot pohojnë se ata përfaqësojnë komunitetin'. Shih Grupi Ndërkombëtar i Krizave, 'Kosova: Drejt Statusit Final' (Raporti i Grupit të Krizave për Evropë N°161, 24 janar 2005), f. 15

të listës serbe të quajtur ‘Lista Kosova dhe Metohija’, e cila udhëhiqej nga Slaviša Petković, i bojkotuan zgjedhjet. Duke qenë se serbët e përjashtuan veten nga institucionet e Kosovës me bojkot, institucionet që dolën nga zgjedhjet ballafaqoheshin me probleme të mëdha në zbatimin e standardeve para statusit. Tani Beogradi ishte imponuar si një aktor edhe më i fuqishëm në tavolinën e negociatave për përcaktimin e statusit të Kosovës. Karakteristika e tretë e këtyre zgjedhjeve ishte mbetja jashtë koalicionit e PDK-së, si parti e dytë me më së shumti vota. PDK-ja ndodhej në eklips: “bojkoti i serbëve, këmbëngulja e LDK-së dhe e AAK-së që të formojnë koalicion, si dhe refuzimi i UNMIK-ut që ta marrë nën mbrojtje nga pasojat e disfatës elektorale, të gjitha bashkë bënë që PDK-ja të mbetet jashtë zyrës së kryeministrit, në të cilën besonte se kishte të drejtë të veçantë, pa marrë parasysh se çfarë do të ishte rezultati i zgjedhjeve”.¹⁰⁹ Për herë të parë, Kosova po ballafaqohej me një opozitarizëm parlamentar të fuqishëm.

Për dallim nga kryeministri i mëparshëm i PDK-së, Bajram Rexhepi, që nuk ishte kryetar partie dhe që nuk kishte mundësi të ushtronte ndikimin e plotë mbi Qeverinë e Kosovës, lidershpi i kryeministrit të ri dhe, njëkohësisht i kryetarit të AAK-së, ishte shumë më energjik në periudhën e shkurtër të qeverisjes së tij. Duke qenë se krerët e shteteve evropiane ishin njoftuar paraprakisht për një ngritje potenciale të një aktakuze për krime lufte ndaj Haradinajt, Kryeministri i Kosovës dhe IPVQ-të ishin izoluar nga bashkësia ndërkombëtare.¹¹⁰ Me gjithë këtë, marrëdhëniet mes kryeministrit Haradinaj dhe PSSP-së së ri të UNMIK-ut, Søren Jessen-Petersen zhvilloheshin në mënyrë korrekte. Petersen ndiqte një politikë shumë më realiste se paraardhësi i tij, duke deklaruar, me t’u

¹⁰⁹ Grupi Ndërkombëtar i Krizave, ‘Kosova pas Haradinajt’, (Raport për Evropë i Grupit të Krizave, numër 163, 26 maj 2005), f. 17.

¹¹⁰ Grupi Ndërkombëtar i Krizave, Kosova: Drejt Statusit Final’ (Raport për Evropë i Grupit të Krizave Nr. 161, 24 janar 2005), f. 4.

vendosur në Prishtinë, se stabiliteti i Ballkanit është i lidhur pazgjidhshëm me zgjidhjen e statusit të Kosovës.

Duke qenë se tashmë ‘standardet para statusit’ ishin operacionalizuar në 109 veprime, kryeministri Haradinaj, në periudhën e shkurtër të qeverisjes së vet kishte kontribuar jashtëzakonisht shumë për zbatimin e këtyre standardeve. Elisabeth Pond ofron përshkrimin vijues për figurën e Ramush Haradinajt:

Pas luftës, ai e mësoi vetë gjuhën angleze, mori pjesë në seminarët gjithëditore të BE-së për të cilat asnjë politikan nuk ishte i interesuar, dhe kompensoi deficitet e veta arsimore, duke studiuar Drejtësinë në Universitetin e Prishtinës. Ishte një lider partiak që po përpiqej ta modernizonte partinë [...] nëpërmjet pjesëmarrjes nga poshtë. Si kryeministër, e kuptoi rëndësinë e decentralizimit, duke e zbatuar atë me entuziazëm, dhe mori ‘pronësi’ lokale të paprecedent për këtë dhe për politika të tjera.¹¹¹

Në mars 2005, Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavi ngriti aktakuzë për krime lufte ndaj kryeministrit Ramush Haradinaj. Vëzhguesit e vëmendshëm ndërkombëtarë kishin frikë se kjo aktakuzë mund ta destabilizonte Kosovën dhe rajonin me një përsëritje potenciale të dhunës së një viti më parë. Megjithatë, ndonëse një ndrojtje e tillë ishte legjitime, Haradinaj kishte treguar gjithë maturinë e duhur në momentin e dorëheqjes dhe vetëdorëzimit në Tribunalin e Hagës. Duke qenë se Serbia ende po strehonte dy prej njerëzve më të kërkuar për krime lufte, liderët serbë të Bosnjës, Radovan Karadžić dhe Ratko Mladić, vetëdorëzimi i Ramush Haradinajt në Tribunalin e Hagës tregonte se shqiptarët kishin

¹¹¹ Elisabeth Pond, ‘Kosovo and Serbia after the French *non*’, *The Washington Quarterly*, 28:4, 19-36, f. 31.

“zhvilluar një lidrshp të përgjegjshëm politik”.¹¹² PSSP i UNMIK-ut, Søren Jessen-Petersen ¹¹³, e kishte cilësuar Haradinajn bashkëpunëtor dhe mik të afërt, duke deklaruar se “Kosova sot është më afër se kurrë që t’i realizojë aspiratat e saj për zgjidhjen e statusit të ardhshëm”. Ai ishte shprehur para gazetarëve edhe se, nëse Tribunali i Hagës e kërkon, UNMIK-u do të japë garancinë e nevojshme që Haradinaj të lirohet dhe të mbrohet në liri”.¹¹⁴ Organizatat e shoqërisë civile lëshuan një deklaratë të përbashkët se kryeministri Haradinaj i nevojitej Kosovës, me sloganin ‘Our Prime has a job to do here’.

Më 28 dhjetor 2003 Serbia organizoi zgjedhjet e veta parlamentare, por parlamenti i saj nuk u inaugurua deri më 27 janar 2004. Në mars 2004, Partia Demokratike e Serbisë, e udhëhequr nga Koštunica, kishte formuar një qeveri të pakicës në Serbi, së bashku me partinë Lëvizja për Ringjalljen e Serbëve të Vuk Drašković-it, partinë Serbia e Re të Veljimir Ilić-it dhe grupin teknokrat G17+, të udhëhequr nga Miroljub Labus. Kjo qeveri nuk kishte treguar gatishmërinë e duhur që të bashkëpunonte me Tribunalin e Hagës. Kjo do të ishte rrethanë pozitive në favor të Kosovës, kurdo që do të diskutohej statusi i saj përfundimtar. Në Serbi ishin organizuar edhe zgjedhjet presidenciale. Në to, 53% e votuesve e kishin votuar Boris Tadić-in për President në raundin e dytë të votimeve, kundrejt Tomislav Nikolić-it të Partisë Radikale Serbe. Zgjedhja e Tadić-it shihej me optimizëm për reformimin e brendshëm të Serbisë, por nuk kishte asnjë shpresë se ai do të ofronte një kurs të qartë të bashkëpunimit me Tribunalin e Hagës dhe një ndryshim kursi sa i

¹¹² Fred Cocozelli, ‘Critical junctures and local agency: how Kosovo became independent’, *Southeast European and Black Sea Studies*, (2009) 9:1-1, f. 204.

¹¹³ Momentalisht, Petersen është profesor i Marrëdhënieve Ndërkombëtare në Johns Hopkins School of Advanced International Studies.

¹¹⁴ Grupi Ndërkombëtar i Krizave, ‘Kosova pas Haradinajt’, (Raport për Evropë i Grupit të Krizave, numër 163, 26 maj 2005), f. 3.

përket të ardhmes së Kosovës.¹¹⁵ Përkundrazi, Serbia filloi draftimin e një plani për ndarjen e Kosovës.

Më 29 prill 2004, Aleksandar Simić dhe Slobodan Samardžić, dy këshilltarët e tashmë ish-Kryeministrit të Serbisë, Vojislav Koštunica, hartuan një plan për Kosovën. Titulli i tij ishte ‘Plani për zgjidhjen politike të gjendjes në Kosovë e Metohi të Serbisë’. Pra, siç mund të lexohet, në këtë plan nuk përmendej askund fjala *status*. Ai parashihte “autonomi territoriale për pesë distrikte ku jetojnë serbët dhe ku ndodhen monumentet religjioze, të konsoliduara që të formojnë një ‘Rajon’”,¹¹⁶ krejt kjo e ndërtuar mbi premisën se trazirat e marsit e kishin treguar pamundësinë e integritit me shqiptarët. Sfera e pushtetit të deleguar – duke përfshirë edhe policinë dhe gjyqësinë – do të krijonte një sistem pothuajse tërësisht të ndarë të qeverisjes dhe do të reduktonte ‘dorën’ e çfarëdo qeverie qendrore të Kosovës mbi ‘rajone’ deri në minimum.

Përkundër këtij dhe propozimeve të tjera që do të vinin më pas, qoftë për kantonizimin, qoftë për ndarjen e Kosovës, Kosova nuk do të mund të kthehej më asnjëherë nën Serbi. Tani, Serbia dhe Mali i Zi ishin pajtuar të negocionin Marrëveshjen për Stabilizim dhe Asociim, pa përfshirjen e Kosovës në këtë marrëveshje. Në këtë frymë, në nëntor 2005, Komisioni Evropian në raportin për progresin e vendeve të Ballkanit Perëndimor drejt Bashkimit Evropian, lëshoi tri dokumente, duke e trajtuar edhe juridikisht Kosovën ndaras nga Serbia dhe Mali i Zi. Ngjashëm kishte ndodhur edhe kur, në dhjetor 2005, Serbia dhe Mali i Zi patën nënshkruar Dokumentin për Partneritetin Evropian.¹¹⁷ Ofrimi i perspektivës

¹¹⁵ Fred Coccozelli, ‘Critical junctures and local agency: how Kosovo became independent’, *Southeast European and Black Sea Studies*, (2009) 9:1-1, ff. 191-2008; International Crisis Group, ‘Serbia’s Changing Political Landscape’ (ICG Europe Briefing, 22 July 2004).

¹¹⁶ Grupi Ndërkombëtar i Krizave, ‘Kosova: Drejt Statusit Final’ (Raport për Evropë i Grupit të Krizave Nr. 161, 24 janar 2005), f. 18.

¹¹⁷ Grupi Ndërkombëtar i Krizave, ‘Kosova: Sfida e transicionit’ (Raport për Evropë i Grupit të Krizave Nr. 170, 17 shkurt 2006), f. 4.

evropiane për Serbinë dhe Partneriteti për Paqe mendohej se do të mund të tregtoheshin me bashkëpunimin e Serbisë gjatë procesit të ardhshëm negociues, kur do të vendosej çështja e statusit politik të Kosovës.¹¹⁸

3.1 Negociatat e Vjenës dhe zgjedhjet e vitit 2007

Anketa e Raportit për Paralajmërim të Hershëm [Early Warning Report] e UNDP-së për vitin 2005, i kishte pyetur qytetarët e Kosovës se cila do të ishte zgjidhja më e mirë për statusin përfundimtar të Kosovës. Sipas këtij raporti, 90.2% kishin shprehur opinionin se pavarësia e Kosovës në kufijtë ekzistues është zgjidhja më e mirë për ta.¹¹⁹ Përkrahja për UNMIK-un, e cila shprehej me një shkallë kënaqëshmërie prej 64% të kosovarëve me këtë organizëm në vitin 2002, kishte pësuar një rënie drastike më 2004, kur e njëjta shkallë kënaqëshmërie shënonte vetëm 21%. Kësisoj, legjitimiteti i UNMIK-ut në sytë e kosovarëve ishte gërryer në mënyrë të pakthyeshme dhe, si pasojë e këtij deficiti të legjitimitetit, administrata e UNMIK-ut prej miqësore qe shndërruar në armiqësore. Vetë akronimi i UNMIK-ut, në shqiptimin e tij anglisht *anmik*, nënkuptonte fjalën e dialektit vendas të shqipes për armikun.¹²⁰

Me këtë disponim negativ të kosovarëve për UNMIK-un, Grupi i Kontaktit ishte i vetëdijshëm se “Kosova nuk mund të kthehet nën sundimin e Beogradit pa një kryengritje të re të

¹¹⁸ Bernhard Knoll, ‘Fuzzy Statehood: An International Legal Perspective on Kosovo’s Declaration of Independence’, *Review of Central and East European Law* 34 (2009) 361-402, f. 369.

¹¹⁹ UNDP, Early Warning Reports, Kosovo, October-December 2005, f. 8. Qasur në http://www.kosovo.undp.org/repository/docs/ewr12_eng.pdf (23 mars 2013).

¹²⁰ Simon Chesterman, ‘Kosovo in Limbo: State-building and “Substantial Autonomy”’, (International Peace Academy, gusht 2001).

armatosur të shumicës 90 për qind shqiptare të krahinës”.¹²¹ Rekomandimi i Kai Eide-së se *status quo*-ja është e paqëndrueshme prodhoi një fazë dhe dinamikë të re politike për Kosovën – nisjen e negociatave për statusin përfundimtar të Kosovës. Megjithatë, duke marrë për bazë faktin se ngjarjet e marsit 2004 e kishin vendosur Kosovën në një pozicion të pavolitshtëm në raport me mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të pakicave, negociatat u zhvilluan në Vjenë, nën udhëheqjen e ish-kryeministrit finlandez dhe më vonë, fituesit të Çmimit Nobel për Paqe, Martti Ahtisaari. Negociatat u përqendruan më shumë në përmbajtjen e statusit (si do të mbroheshin pakicat në Kosovë, si do të organizohej jeta e tyre vetëqeverisëse nëpër komuna, si do të garantohej përfaqësimi i tyre në nivel lokal dhe nacional) sesa vetëm në formën e këtij statusi.

Negociatat e Vjenës, nëse shikohen nga prizmi i teorisë së lojërave¹²², dukeshin si një lojë me shumë zero. Serbia dhe Kosova kishin qëndrime diametralisht të kundërta. Ndryshimi i qëndrimeve të tyre ishte po i aq i pamundshëm sa shndërrimi i katrorëve në rrathë. Siç ka argumentuar Mark Weller, negociatat e Vjenës ishin kushtëzuar nga një numër faktorësh strukturorë.¹²³ Serbia kishte përdorur në mënyrë të vazhdueshme argumentin e integritetit dhe të unitetit territorial të shteteve, që ishte bazamenti i sistemit klasik ndërkombëtar. Pranimi i shtetësisë së Kosovës do të nënkuptonte pranimin e parimit të vetëvendosjes dhe të secesionit jashtë kontekstit të ngushtë kolonial. Faktori i dytë strukturor ishte parimi i

¹²¹ Grupi Ndërkombëtar i Krizave, ‘Kosova: Drejt Statusit Final’ (Raport për Evropë i Grupit të Krizave Nr. 161, 24 janar 2005), f. 3.

¹²² Për më shumë mbi teorinë e lojës, shih Karl Wolfgang Deutsch, *The Analysis of International Relations* (Prentice Hall College, 1988); Robert D. Putnam ‘Diplomacy and domestic politics: the logic of two-level games’, *International Organization*/ Volume 42/ Issue 03/ Summer 1988, ff. 427-460; Jame Morrow, *Game theory for political scientists*, (Princeton University Press, 1994); Ken Binmore, *Game Theory: A Very Short Introduction* (Oxford University Press, 2007).

¹²³ Mark Weller, ‘The Vienna negotiations on the final status for Kosovo’, *International Affairs* 84: 4 (2008) ff. 659–681.

‘pajtimet të shtetit’. Sipas këtij argumenti, shteteve nuk mund t’u imponohen obligime ndërkombëtare pa vullnetin e tyre, sidomos jo nga ato që kanë të bëjnë me integritetin territorial. Megjithatë, siç vëren Weller, këto ‘parime të forta’ të integritetit dhe të unitetit territorial të shteteve dhe pajtimi i shteteve për çfarëdo ndryshimi eventual të kufijve, janë rivlerësuar dhe fokusi kishte filluar të vihej edhe tek të drejtat e popullit dhe të popullatës. Brenda këtij konteksti ishte adresuar edhe rasti i Kosovës, popullata e të cilës kishte vuajtur nga shkeljet masive të të drejtave të njeriut, të cilat Weller i kishte përmbledhur në disa studime të tij.¹²⁴ Po ashtu, deportimi i gjysmës së popullatës shqiptare të Kosovës nga forcat ushtarë dhe paraushtarake serbe, administrimi ndërkombëtar i tejzgjatur, frika nga përsëritja e dhunës si ajo e marsit 2004, mungesa e vizionit për statusin e Kosovës dhe aspirata e shumicës së popullatës shqiptare për pavarësi të plotë, ishin disa prej elementeve që u morën në konsideratë për ta gjetur formulën për zgjidhjen e statusit të Kosovës.

Në tetor 2005, Këshilli i Sigurimit e autorizoi ish-Presidentin finlandez, Marti Ahtisaari, si të Ngarkuar Special, që t’i udhëhiqte negociatat për statusin e Kosovës. Siç shkruante Grupi Ndërkombëtar i Krizave: “Edhe pse nuk thuhej në mënyrë eksplicite, qëllimi kryesor i Vjenës ishte gjetja e një zgjidhjeje të qëndrueshme për të ardhmen e serbëve të Kosovës në një Kosovë të pavarur”.¹²⁵ Pas 17 raundeve të bisedimeve përgjatë 14 muajve, potenciali i

¹²⁴ Marc Weller, *The Crisis in Kosovo, 1989–1999* (Cambridge: Documents and Analysis Publishing, 1999), f. 120–183; Marc Weller, *The Kosovo Conflict* (Cambridge: Documents and Analysis Publishing, 2001), ff. 160–319; Marc Weller, *Peace Lost: The Failure of Conflict Prevention in Kosovo* (Martinus Nijhoff, 2008).

¹²⁵ Grupi Ndërkombëtar i Krizave, ‘Statusi i Kosovës: shtyrja sjell rreziqe’, (Raport për Europë i Grupit të Krizave Nr. 177, 10 nëntor 2006), f. 4; I njëjti argument ishte prezantuar edhe nga Shkelzen Maliqi në intervistën e realizuar nga Shkelzen Gashi, ‘Kosovës i mungon fuqia imponuese për vetëvendosje’, f. 29. Shih këtë intervistë tek Shkelzen Gashi, ‘Statusi pa Pardon’ (PrintingPress, Prishtinë, 2006).

negociatave të mëtutjeshme ishte shterur.¹²⁶ Pas kësaj faze, Marti Ahtisaari ndoqi një qasje inovative, duke kombinuar strategjinë e ndërmjetësimit (‘mediation’), me atë të arbitrit, një qasje kjo që James Ker-Lindsay e quante meditrim (‘meditation’). Sipas kësaj qasje të meditimit – që dallohet nga ndërmjetësimi, ku ndërmjetësuesi luan një rol aktiv në proces, duke propozuar ide dhe zgjidhje që do të mund të shqyrtoheshin pafundësisht nga palët – ndërmjetësuesit shkojnë një hap tutje dhe propozojnë një plan të finalizuar.¹²⁷ Më 26 mars 2007, Marti Ahtisaari e shpali planin e vet.¹²⁸ Ai shoqërohej me një rekomandim të ndarë, ku propozohej pavarësi e mbikëqyrur për Kosovën, por ky rekomandim fillimisht nuk u paraqit publikisht.

Pas ngjarjeve të dhunshme të marsit 2004, në raportet për vitin 2004 dhe 2005 ku Kai Eide vlerësonte situatën në Kosovë, artikulohej qartë se *status quo*-ja në Kosovë nuk mund të menaxhohej më tutje. Për të lëvizur drejt shpalljes së pavarësisë, duhej të merreshin në konsideratë, rekomandonte Eide, edhe faktorët e brendshëm edhe ata rajonalë. Me fjalë të tjera, dinamikat e brendshme politike në Serbi, Kosovë dhe rajon do të ishin indikatorët kryesorë për të ecur në këtë drejtim.

¹²⁶ Denisa Kostovicova, ‘Legitimacy and International Administration: The Ahtisaari Settlement for Kosovo from a Human Security Perspective’, *International Peacekeeping* (2008), Vol. 15, No. 5, 631-647, f. 635.

¹²⁷ James Ker-Lindsay, ‘The Emergence of ‘Meditation’ in International Peacemaking’, *Ethnopolitics: Formerly Global Review of Ethnopolitics* (2009), 8:2, 223-233, f. 231.

¹²⁸ Duke e shpjeguar se shtyrja në përcaktimin e statusit do të mund t’i rriste pasiguritë dhe frikën në mesin e shqiptarëve, Pettifer argumenton se ‘Raporti i Ahtisaari-t ishte menduar për të shuar këto frika dhe për të siguruar një kornizë për një zgjidhje politike. Ai tenton ta bëjë këtë me sigurimin e ‘sovrانيتit’ totemik për shqiptarët, duke ruajtur tabunë e pavarësisë së plotë me sovranitet të plotë dhe të ulës në Kombet e Bashkuara për shtetin e ri. Por, si në botën e diskursit akademik antropologjik, siç ka treguar Levi Strauss, struktura e tabusë është e lidhur me frikën, në këtë rast me frikën e një Kosove vërtet të pavarur’. Për një analizë të shkëlqyer të Planit të Ahtisaari-t, shih James Pettifer, ‘The Ahtisaari Report – Totem & Taboo’, (Conflict Studies Research Centre, Balkan Series 07/08, shkurt 2007), f. 7.

Gjatë viteve 2007 dhe 2008 edhe Serbia edhe Kosova organizuan zgjedhje. Në zgjedhjet e 17 nëntorit 2007, për herë të parë PDK-ja (në koalicion me disa parti të vogla), e udhëhequr nga Hashim Thaçi, doli parti fituese me 196.207 vota ose 34.3% të totalit të votave, e pasuar nga LDK-ja me 129.410 vota ose 22,6% të votave, e treta vinte AKR, me 70.165 vota ose 9.6% të të totalit të votave, e katërta LDD-PShDK me 57.992 vota ose 10% të totalit të votave, e pesta AAK me 54.611 vota ose 9.6% të totalit të votave, e gjashta ORA me 23.722 ose 4.1% të totalit të votave, dhe e shtata PD me 9.890 ose 1.7% të totalit të votave. Edhe pse Nexhat Daci ishte ndarë nga LDK-ja duke formuar partinë LDD, duke marrë kështu një pjesë të votave të LDK-së, kjo e fundit mbeti përsëri në pushtet dhe ndërtoi një koalicion me PDK-në. Ky koalicion gjeti përkrahjen edhe nga përfaqësitë diplomatike në Kosovë. Mbështetja ndërkombëtare kundrejt këtij koalicioni arsyetohej me faktin se PDK dhe LDK ishin dy partitë më të mëdha politike në vend, që do të gjeneronin stabilitet politik brenda Kosovës dhe do ta ndanin përgjegjësinë politike në raport me negociatat që po zhvilloheshin në Vjenë. Meqë tashmë ishte shpalosur Plani i Ahtisaarit, ekzistonte frika e faktorit ndërkombëtar se qeveria e re, e udhëhequr nga kryeministri i ri dhe kryetari i PDK-së, Hashim Thaçi, do ta shpallte menjëherë pavarësinë e Kosovës. Gjatë kësaj periudhe, Lëvizja Vetëvendosje kishte intensifikuar aksionet kundër procesit të decentralizimit, me sloganin: ‘Jo negociata, vetëvendosje!’.

Megjithatë, çdo vonesë eventuale e shpalljes së pavarësisë së Kosovës rrezikonte paqen në Kosovë dhe rajon. Tim Judah parashtronte këtë dilemë: nëse në një pikë të caktuar kohe Thaçi do ta luante ‘kartën e Kurtit’, rezultati do të ishte i paparashikueshëm dhe potencialisht një valë e re e dhunës antiserbe, e ngjashme me trazirat e marsit 2004, do të mund të shpërthente në Kosovë.¹²⁹

¹²⁹ Tim Judah, ‘Kosovo’s Moment of Truth’, *Survival*, Vol. 47, No. 4 Winter 2005–06, ff. 73–84, f. 82.

Në Serbi mbajtja e zgjedhjeve presidenciale ishte planifikuar për datën 20 janar 2008. Në këtë garë zgjedhore, për pozitën e Presidentit të shtetit garonin Boris Tadić nga Partia Demokratike (DS) dhe Tomislav Nikolić nga Partia Radikale Serbe. Ndërsa i pari konsiderohej lider proevropian dhe mbështetej nga forcat perëndimore, i dyti konsiderohej lider nacionalist. Tadić-i fitoi në raundin e dytë me 51%. Kuvendi i Kosovës shpalli pavarësinë më 17 shkurt, vetëm një ditë pasi Tadić-i ishte inauguruar në këtë pozitë për herë të dytë.¹³⁰

¹³⁰ Fred Cocozelli, 'Critical junctures and local agency: how Kosovo became independent', *Southeast European and Black Sea Studies*, (2009) 9:1-2; 191-208, f. 191.

IV

MES STABILITETIT
DHE DEMOKRATIZIMIT

KAPITULLI IV

KAPITULLI 4:

RIKONFIGURIMI I PUSHTETIT NË KOSOVË DHE
PËRTEJ - ZGJEDHJET E PËRGJITHSHME TË VITIT 2004

KAPITULLI 4: ROLI I PARTIVE POLITIKE NË SHTETNDËRTIMIN E KOSOVËS

Gjatë viteve '80 dhe '90 të shekullit XX ekzistonin tri qasje kundërshtuese për zgjidhjen e problemit të Kosovës. E para mund të cilësohet si qasje *militariste*.¹³¹ Lëvizja Popullore e Kosovës, e themeluar më 1982, prej nga më vonë do të organizohej UÇK-ja, ndoqi një qëndrim historicist, sipas të cilit statusi politik diskriminues i Kosovës nën administratën e Serbisë duhej të adresohet me mjete ushtarake. E dyta mund të tipizohet si qasje *reformiste*. Prijatë e kësaj qasjeje ishte partia 'Bashkimi Demokrat Jugosllav' (UJD-i) e themeluar nga Ante Marković. Pas abrogimit të autonomisë së Kosovës dhe fuqizimit të autoritarizmit të Slobodan Milošević-it, ende kishte shpresa se Jugosllavia mund të

¹³¹ Henry H. Perrit e bën një kategorizim tjetër të vlefshëm. Perrit e ndan në tri kategori rezistencën dhe organizimin politik në Kosovë: 'institucionalistët e rrugës paqësore', 'planifikuesit në ekzil', dhe 'mbrojtësit në shtëpi'. Shih, për më shumë, Henry H. Perrit, *Ushtria Çlirimtare e Kosovës: Rrëfimi prej brenda për një kryengritje*, (KOHA, Prishtinë, shtator 2008), f. 16. Stephanie Schwandner-Sievers, në analizën e saj për trashigëminë e ilegales në Kosovë, argumenton se 'memoria e aktivizimit militant të paraluftës simbolikisht është kodifikuar, formalizuar në mënyrë rituale, dhe është vendsour në skenën e publike në Kosovën e sotme [...] në njërin anë ky proces riprodhon referencat e përbashkëta kulturore të cilat e idealizojnë solidaritetin etno-nacional, unitetin dhe krenarinë, të cilat i kanë shërbyer mobilizimit militant tashmë para vitit 1990'. Shih, Stephanie Schwandner-Sievers, 'The bequest of Illegalja: contested memories and moralities in contemporary Kosovo', *Nationality Papers: The Journal of Nationalism and Ethnicity* (2013), Vol.41, Issue 6, ff. 953-970.

demokratizoj dhe se shqiptarët e Kosovës mund t'i kontribuonin këtij demokratizimi, duke marrë pjesë në zgjedhje dhe duke e votuar këtë parti. Përkrahësit e kësaj qasjeje në Kosovë ishin disa intelektualë alternativë të kohës, por që nuk gëzonin mbështetje popullore, si Shkëlzen Maliqi dhe Veton Surroi. Qasja e tretë mund të tipizohet si qasje *pacifiste* e refuzimit të institucioneve dhe të zgjedhjeve që do të organizoheshin brenda Jugosllavisë. Lidhja Demokratike e Kosovës, e themeluar më 1989, ka ndjekur një qasje sipas të cilës problemi i Kosovës duhet të zgjidhej në mënyrë pragmatike dhe paqësore, njëherë si republikë e pavarur brenda Federatës Socialiste të Jugosllavisë. Por LDK-ja njëkohësisht refuzonte të merrte pjesë në zgjedhjet që organizoheshin në Jugosllavi, duke provuar ta delegjitimonte regjimin e Serbisë në Kosovë. Pra, për zgjidhjen e problemit të Kosovës u fillua me qasjen e tretë dhe u vazhdua me të parën, me fjalë të tjera, nga rezistenca paqësore u kalua tek e armatosura. Qasja e ndërmjetme, ajo reformiste, në procesin e shpërbërjes së Jugosllavisë, edhe ashtu ishte e paragjykuar të refuzohej nga shumica e popullsisë së Kosovës.

Me ndërhyrjen e NATO-s në Kosovë dhe vendosjen e administratës së OKB-së, u regjistruan parti të ndryshme politike që nisën t'i konkurronin LDK-së së drejtuar nga Ibrahim Rugova. Themeluesit e këtyre partive politike njiheshin për kontributin e tyre në UÇK. Këtu është fjala për PDK-në dhe AAK-në. Më vonë, mungesa e qartësisë politike për statusin e Kosovës dhe pushteti i kudondodhur i UNMIK-ut krijoi terrenin për lindjen e një lëvizjeje të re politike – lëvizjen Vetëvendosje.

Tetë vjet pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, ajo që karakterizon shumicën e këtyre partive politike, me përjashtim të VV-së, është mungesa e koherencës ideopolitike, praktikat lideriste dhe jodemokratike, si dhe baza patrimoniale e organizimit. Në seksionet vijuese analizohet profili ideologjik i këtyre partive

politike, krahasohen votat e përgjithshme të tyre, duke i parë rëniet dhe ngritjet e tyre elektorale në të gjitha zgjedhjet e përgjithshme të organizuara deri më 2014. Pas kësaj, skicohet një tipologji se ç'përfaqësojnë këto parti politike dhe hidhet dritë mbi dinamikat politike brenda dhe ndërmjet tyre.

4.1 Shterpësia ideologjike

Debati politik mes partive politike në Kosovë karakterizohet nga një shterpësi ideologjike. Partitë kryesore në Kosovë, me përjashtim të VV-së, nuk dallohen shumë për ndonjë profil të qartë ideologjik. Në fakt, debati politik në Kosovë pothuajse është i deideologjizuar. Ndërsa LDK-ja dhe PDK-ja definojnë në statutet e tyre përkatëse si parti të qendrës së djathtë, statuti i AAK-së dhe ai i VV-së mbeten të heshtur rreth orientimit ideologjik. Ndonëse nuk përmendet shprehimisht në statut, zyrtarët e lartë të AAK-së e definojnë vetveten si parti të qendrës së djathtë¹³², kurse zyrtarët e VV-së e definojnë veten si “një lëvizje që përfaqëson një profil ideologjik që i takon social-demokracisë evropiane”.¹³³ Megjithatë, me përjashtim të VV-së, e cila që nga themelimi nuk ka qeverisur me vendin në nivel nacional, të gjitha partitë politike që kanë qeverisur me Kosovën që nga viti 2000, duke përfshirë këtu PDK, LDK dhe AAK, mund të konsiderohen si parti pragmatike të tipit ‘catch-all’.

Siç është vërejtur në studimin ‘Busolla Ideologjike në Kosovë’, PDK-ja, ndonëse e përkrah procesin e privatizimit të ndërmarrjeve në Kosovë, që është një politikë e djathtë, e ka përkrahur njëkohësisht edhe një administratë të madhe publike, çka është politikë e majtë. Po ashtu hetohet se në PDK nuk ka qartësi

¹³² Intervistë me z. Ali Berisha, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Prishtinë, 7 prill 2016; Intervistë me z. Pal Lekaj, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Prishtinë, 7 prill 2016.

¹³³ Intervistë me z. Glauk Konjufca, Lëvizja Vetëvendosje, Prishtinë, 1 prill 2016.

dhe konsistencë ideologjike brenda strukturës partiake, për faktin se, bie fjala, “sa u përket çështjeve ekonomike, më shumë se gjysma e PDK-së gjendet në të majtë të qendrës dhe më pak se gjysma në të djathtë të qendrës”. Një mungesë e konsistencës brenda anëtarëve të PDK-së vërehet edhe tek vlerat sociale, ku gjysma ka orientim konservator dhe gjysma tjetër orientim liberal.

Edhe LDK-ja, ndonëse përkrah privatizimin – një politikë kjo e djathtë – njëkohësisht përkrah intervenimin e shtetit te shërbimet shëndetësore pa pagesë, një politikë e majtë kjo. Në studimin ‘Busulla Ideologjike në Kosovë’ konstatohet se në strukturën e LDK-së janë prezentë edhe ata që quhen majtistë konservatorë e edhe liberalët e tregut të lirë. VV, si organizata e tretë politike për nga fuqia e votës në Kosovë, me orientim politik majtist, dëshmon një konsistencë më të madhe ideologjike brenda strukturës së saj organizative: a) duke mbajtur pozicion të pandryshuar kundër prezencës së fortë së bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë, b) duke kundërshtuar format dhe modelet e privatizimit të ndërmarrjeve në Kosovë, dhe c) duke promovuar një intervenim më të madh të shtetit në pensione, asistencë sociale, rregullim të tregut, subvencione në bujqësi, etj. Ndërkohë, vlerat ideologjike të AAK-së, sipas studimit në fjalë, frekuentojnë më shumë kah djathtëzmi. Mirëpo, edhe në rastin e AAK-së, sikurse te LDK-ja, ka dy grupime, si për çështjet sociale ashtu edhe për ato ekonomike. Njëri grupim anon më shumë kah të majtët konservatorë dhe tjetri ka qëndrime më liberale.¹³⁴

Rrjedhimisht, me sa u tha më lart, partitë politike në Kosovë nuk i ndjekin në mënyrë konsistente parimet ideologjike. Ato janë “të interesuara më pak për parimet politike dhe më shumë për

¹³⁴ D4D, ‘Busolla ideologjike në Kosovë: Hartë e orientimit të partive politike’, Seria: Partitë Politike, Nr 8, Prishtinë, 2014. Dy studime të mëhershme nga autorë dhe institute të tjera po ashtu vërejnë se partitë politike në Kosovë nuk kanë ndonjë profil të qartë ideologjik. Shih Jeton Zulfaj at al., ‘Political Parties in Kosovo: Profile and Ideology’, Çelnaja, Prishtinë, 2008 dhe Kushtrim Shaipi dhe Agon Maliqi, ‘Party Attitudes Towards the Society: Values, Religion, State and Individuality’, FES, Prishtinë, 2009.

sigurimin ose mbajtjen e pushtetit për liderët e vet dhe për shpërndarjen e të ardhurave tek ata të cilët i udhëheqin dhe punojnë për to. Interesat janë qendrorë, jo ideologjitë”.¹³⁵

4.2 Rënia dhe ngritja e partive politike

Në tabelën e mëposhtme, duke u bazuar në ekstraktet e Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ-së), janë përmbledhur votat e partive politike dhe kemi bërë ndarjen e tyre nëpër vite zgjedhore.

Partitë politike	PDK	LDK	VV	AAK	Koalicionet qeveritare	Pjesëmarrja në votime
Nr. i votave në zgjedhjet 2001	202622 vota 26 ulëse në Kuvend 25.70% të totalit të votave	359851 vota 47 ulëse në Kuvend 45.65% të totalit të votave	/	61668 vota 8 ulëse në Kuvend 7.83% të totalit të votave	LDK + PDK + AAK + pakicat	64.30%
Nr i votave në zgjedhjet 2004	199112 vota 30 ulëse në Kuvend 28.85% të totalit të votave	313437 vota 47 ulëse në Kuvend 45.42% të totalit	/	579311 vota 9 ulëse në Kuvend 8.39% të totalit të votave	LDK + AAK + pakicat	53.57%

¹³⁵ David Jackson, ‘Clientelism: The alternative dimension to Kosovo’s governance’ (Kosovo Local Government Institute, Prishtinë, shkurt 2014), f. 18.

		të votave				
Nr i votave në zgjedhjet 2007	196207 vota 37 ulëse në Kuvend 34.3% të totalit të votave	129410 vota 25 ulëse në Kuvend 22.6% të totalit të votave	/	54611 vota 10 ulëse në Kuvend 9.6% të totalit të votave	PDK + LDK + pakicat	40.10%
Nr i votave në zgjedhjet 2010	224339 vota 34 ulëse në Kuvend 32.22% të totalit të votave	172552 vota 27 ulëse në Kuvend 24.69 % të totalit të votave	88652 vota 14 ulëse në Kuvend 12.69 % të totalit të votave	77130 vota 12 ulëse në Kuvend 11.04 % të totalit të votave	PDK +AKR + pakicat	45.30%
Nr i votave në zgjedhjet 2014	222181 vota 35 ulëse në Kuvend 30.38% të totalit të votave	184594 vota 33 ulëse në Kuvend 25.24% të totalit të votave	99398 vota 17 ulëse në Kuvend 13.95% të totalit të votave	69793 vota 8 ulëse në Kuvend 9.54% të totalit të votave	PDK + LDK + pakicat	42.63 %

Rezultatet e partive politike në të gjitha zgjedhjet e përgjithshme . Tabelë e
kompiluar nga autori. Të dhënat e ekstrahuara nga Komisioni Qendror i
Zgjedhjeve.

Mes viteve 2001-2014, në përgjithësi, votimi për PDK-në është rritur për 9.65%, për LDK-në vota është zvogëluar për 48.7%, ndërsa për AAK-në ka pasur rritje për 13.17% të votës së përgjithshme. Ndërsa VV, në periudhën 2010-2014, ka shënuar rritje të votave të mbledhura prej 12.12%.

Në zgjedhjet e para të përgjithshme të vitit 2001, PDK ka marrë 202.622 vota, kurse në zgjedhjet e përgjithshme të parakohshme të vitit 2014, ka marrë 222.181 vota. PDK-ja është rritur për vetëm 19.556 vota. Në zgjedhjet e para të përgjithshme të vitit 2001, LDK ka fituar 359.851 vota, kurse në zgjedhjet e përgjithshme të parakohshme të vitit 2014, LDK ka fituar 184.594 vota. LDK ka humbur dhe është tkurrur për 175.257 vota, ose më shumë se gjysmën e totalit të votave të fituara në zgjedhjet e para. Në zgjedhjet e para të përgjithshme të vitit 2001, AAK ka fituar 61.668 vota, kurse në zgjedhjet e përgjithshme të parakohshme të vitit 2014, ka fituar 69.793 vota. AAK-ja është rritur për vetëm 8.125 vota. VV për herë të parë mori pjesë në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2010, dhe në to fitoi 88.652 vota. Në zgjedhjet e përgjithshme të parakohshme më 2014, VV mori 99.398 vota. Pra, për vetëm katër vjet, VV, edhe pse subjekt politik opozitar, u rrit për 10.746 vota.

Bazuar në këto të dhëna, PDK-ja, ndonëse që nga viti 2007 e tutje udhëheq me Qeverinë e Kosovës, nuk ka shënuar ndonjë progres të madh në rritjen e votës elektorale; LDK-ja, duke qenë hisedare në shumicën e koalicioneve qeveritare pas luftës, nga viti 2001 deri në 2014 ka shënuar humbjen më të madhe të votave në mesin e të gjitha partive politike; AAK-ja, për dallim nga viti 2010 kur mori 77.130 vota, pra numrin më të madh të votave në nivel qendror në të gjitha zgjedhjet në Kosovë, vazhdoi të stagnonte në rritjen e votës elektorale, kurse VV-ja është subjekti politik që ka shënuar progresin më të madh të rritjes së numrit të votave në krahasim me partitë e tjera politike.

4.3 Drejt një tipologjie partiake

PDK, LDK dhe AAK janë parti politike të tipit ‘catch-all’, ose parti që tentojnë të kapin gjithçka. Këto parti njihen si organizata të centralizuara dhe nuk karakterizohen me ndonjë ideologji të qartë politike. Studiuesit e partive politike i konsiderojnë partitë ‘catch-all’ si parti tolerante, pa një ideologji të qartë, që orientohen krejtësisht nga elektorati përmes lidërshiptit qendror të partisë, me qëllim të maksimizimit të votave. Në anën tjetër, VV është parti ‘relativisht antisistem’. Për studiuesit e partive politike, ky tip organizimi ideopolitik partiak dallohet, pos të tjerash, nga partitë ‘catch-all’ nga një distancë ideologjike jo vetëm me partitë e tjera, por edhe me sistemin në përgjithësi. Trajektorja e zhvillimit të VV-së kalon nga një lëvizje shoqërore ‘absolutisht kundër sistemit’ drejt një subjekti politik ‘relativisht kundër sistemit’. PDK, LDK dhe AAK karakterizohen për një lidërship dominant dhe mungesë inkluziviteti të anëtarësisë në proceset vendimmarrëse partiake, si dhe mungesë autonomie të degëve. Në anën tjetër, VV ka një lidërship jodominant dhe karakterizohet me një inkluzivitet më të lartë të anëtarësisë në proceset vendimmarrëse.

Studimet empirike të studiuesve të partive politike ofrojnë evidenca se partitë elektorale ‘catch-all’ janë më jomiqësore ndaj demokratizimit të brendshëm partiak, kurse partitë kundër sistemit konsiderohen më inkluzive, më të decentralizuara dhe më miqësore ndaj transparencës dhe demokratizimit të brendshëm partiak. VV-në e definojmë si parti relativisht kundër sistemit, për faktin se ajo fillimisht ka pasur qëndrim kundër Planit të Ahtisaarit dhe të gjitha produkteve të tij, duke refuzuar kështu pjesëmarrjen në zgjedhje, për shkak të kufizimeve vendimmarrëse dhe autonomisë së institucioneve të Kosovës. Më vonë, trajektorja e zhvillimit të VV ka pasur një zhvendosje nga një lëvizje absolutisht kundër sistemit në një lëvizje relativisht kundër sistemit, duke u përfshirë në zgjedhje

dhe duke pranuar formatin institucional mbi të cilin janë organizuar zgjedhjet dhe rrjedhimisht edhe institucionet e Kosovës.

4.3.1 Partia Demokratike e Kosovës – PDK

*Partia Demokratike e Kosovës është parti popullore e themeluar mbi vlerat tradicionale, kombëtare, vlerat e luftës çlirimtare dhe vlerat universale të demokracisë qytetare.*¹³⁶

Partia Demokratike e Kosovës është formuar më 10 tetor 1999. Origjina e PDK-së vjen nga lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, kurse themelimi i kësaj të fundit ishte rezultat i zhgënjimit të kosovarëve nga mostrajtimi i çështjes së Kosovës në Konferencën e Dejtonit nga bashkësia ndërkombëtare.¹³⁷ Kjo konferencë ishte organizuar me qëllim të ndaljes së luftës që po zhvillohej në Bosnjë -Hercegovinë.

Deri më 1995, Kosova nuk po ndiqte një politikë konfrontuese në procesin e shpërbërjes së Jugosllavisë. Shqiptarët e Kosovës e morën mësimin se bashkësia ndërkombëtare nuk do ta shpërblente qasjen e saj paqësore të udhëhequr prej LDK-së së Ibrahim Rugovës për aq kohë sa nuk kishte një luftë të hapur në Kosovë. Dy personalitete me nam në Kosovë, Adem Demaçi dhe Rexhep Qosja, kritikuan ashpër qasjen e butë të LDK-së dhe argumentonin nevojën që Kosova të ndërronte kurs veprimi, duke u organizuar edhe ushtarakisht. Më 1999, pas vendosjes së trupave të NATO-s dhe të UNMIK-ut në Kosovë, disa nga përfaqësuesit politikë të UÇK-së themeluan PDK-në. Deri në organizmin e Kuvendit të Parë

¹³⁶ Statuti i Partisë Demokratike të Kosovës (pa datë), neni 1.

¹³⁷ Shih: Miranda Vickers, *Between Serb and Albanian: A History of Kosovo*, (Columbia University Press, 2001), f. 292.

Zgjedhor, të mbajtur në tetor 2000, partia njihej si Partia e Progresit Demokratik të Kosovës.¹³⁸

Në Kuvendin e Parë Zgjedhor, partia ndërroi emrin dhe sot njihet si Partia Demokratike e Kosovës. Partia Demokratike e Kosovës u krijua nga përfaqësuesit e Drejtorisë Politike të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Hashim Thaçi, si Drejtor i Drejtorisë Politike të UÇK-së, kishte udhëhequr delegacionin e Kosovës në Konferencën e Rambujesë, e cila kishte për qëllim t'i jepte fund luftës në Kosovë. Meqenëse Marrëveshja e Rambujesë nuk u nënshkrua nga Milošević-i, por vetëm nga përfaqësuesit e bashkësisë ndërkombëtare dhe delegacioni i Kosovës, mbetej e hapur mundësia e fundit që NATO-ja ta bombardonte Serbinë. Pas përfundimit të luftës, Hashim Thaçi drejtoi një Qeveri të Përkohshme në Kosovë deri në organizmin e zgjedhjeve të para. Legjitimiteti i kësaj Qeverie ishte kontestuar edhe përbrenda Kosovës, kryesisht nga LDK-ja. PDK-ja i humbi të gjitha zgjedhjet në nivel vendi deri më 2006 dhe u rendit forca e dytë më e madhe politike në vend që nga paslufta.

Në të gjitha Kuvendet Zgjedhore të organizuara deri më 2010 nga PDK-ja, Hashim Thaçi u zgjodh kryetar i pakontestuar pa asnjë kundërkandidat. Në aspektin ideor, sipas statutit aktual, PDK vetëdefinohet si parti e qendrës së djathtë. Në fillimet e saj, PDK-ja ka pasur një orientim ideologjik relativisht majtist, duke kultivuar kontakte edhe me Partinë Laburiste të Mbretërisë së Bashkuar. Edhe më herët, një pjesë e drejtuesve të PDK-së ishin pjesëmarrës dhe organizatorë të lëvizjeve ilegale në Kosovë, si Organizata Marksiste-Leniniste, Lëvizja për Çlirimin e Kosovës, Lëvizja Popullore e Kosovës, etj. Lëvizja Popullore e Kosovës dhe Lëvizja për Çlirimin e Kosovës, të themeluara me emra të tillë pas vitit 1992, ndiqnin një

¹³⁸ Për një diskutim të lindjes së UÇK-së dhe një profil të personaliteteve që më vonë do të bëhen pjesë e PDK-së, shih Henry H. Perrit, *Ushtria Çlirimtare e Kosovës: Rrëfimi prej brenda për një kryengritje*, (KOHA, Prishtinë, shtator 2008); Kosovo Stability Initiative, 'A Power Prime: A Handbook to Politics, People, and Parties in Kosovo', dhjetor 2011, f. 35-43.

gasje të fortë, duke përkrahur idenë e organizimit të luftës në Kosovë, ndonëse u mungonin armët dhe financimi. Lëvizja Popullore e Kosovës, e cila ushtronte pjesën më të madhe të aktivitetit të saj në diasporë, kishte themeluar UÇK-në, e cila tre vjet pas themelimit, më 1997, pati paraqitjen e saj të parë publike. Në diasporë ishte themeluar fondi ‘Vendlindja Thërret’, nëpërmjet të cilit diaspora shqiptare e kanalizonte kontributin financiar për ta ndihmuar luftën e UÇK-së. Në mars 1998, Hashim Thaçi ishte emëruar drejtor për informim në UÇK. Meqë lufta në Kosovë ishte bërë e pashmangshme për shkak të prezencës dhe brutalitetit të madh të forcave ushtarake serbe në Kosovë, masakrave masive të shoqëruara me djegien e fshatrave dhe shpërnguljen e qytetarëve të Kosovës nga shtëpitë, bashkësia ndërkombëtare kishte filluar ta legjitimonte UÇK-në.

Si rezultat i dështimeve të negociatave ndërkombëtare që do ta detyronin Milošević-in ta ndërpriste luftën në Kosovë, në mars 1999 NATO ndërmori një fushatë ofensive duke i bërë forcat ushtarake dhe policore serbe të tërhiqeshin nga Kosova. Në qershor 1999 u vendos administrata ndërkombëtare në Kosovë. U krijuan disa mekanizma konsultativë mes forcave politike në Kosovë dhe UNMIK-ut deri në organizimin e zgjedhjeve. PDK-ja ende nuk gëzonte një nam të mirë në mesin e qytetarëve urbanë të Kosovës, megjithëse kishte krijuar 32 degë rajonale. Popullariteti jo fort i lartë i PDK-së vinte edhe si rezultat i sjelljeve autoritare të disa prej figurave të këtij subjekti, por edhe si rezultat i sjelljeve jocivile të disa ish-ushtarëve të UÇK-së menjëherë pas luftës.

Për dallim nga vendet e tjera, si Sllovenia, Kroacia e Bosnjë-Hercegovina, ku njerëzit e lidhur me luftën kishin arritur t’i fitonin zgjedhjet, në Kosovë ndodhi e kundërta. LDK-ja do të fitonte numrin më të madh të votave, si në nivelin e komunave, ashtu edhe në atë qendror. Meqenëse tensioni politik PDK-LDK ishte i polarizuar, bashkësia ndërkombëtare kishte përkrahur formimin e

një koalicioni të gjerë LDK-PDK-AAK, në mënyrë që të parandalonte formimin e një realiteti politik bipolar në Kosovë.

Sipas një studimi të Grupit Ndërkombëtar të Krizave, pas luftës në Kosovë, Thaçi kishte vendosur kontroll pothuajse të plotë mbi komunat dhe ndërmarrjet shoqërore.

Për pasojë, PDK-ja dhe Thaçi u panë si përgjegjës për kaosin, korrupsionin dhe kriminalitetin e periudhës menjëherë pas lufte [...] Prej atëherë kjo parti është përpjekur ta përmirësojë imazhin e saj dhe të rizbulojë veten si një parti e përgjegjshme të cilës mund t'i besohet pushteti politik. Me këtë synim u zgjodh si kandidatë për president Flora Brovina, veprimtare e të drejtave të njeriut, ish-burgosur politike në Serbi, pediatre, poete dhe presidente e Lidhjes së Grave Shqiptare të Kosovës.¹³⁹

Pas vdekjes së Rugovës, që u pasua edhe me ndarjen e LDK-së, PDK-ja arriti që në zgjedhjet e vitit 2007 të dilte parti fituese. Tetë vjet pas themelimit, PDK-ja kishte filluar të hapej ndaj njerëzve të rinj për ta riaranzhuar imazhin publik dhe kishte përfshirë në radhët e saj disa akademikë dhe aktivistë të shoqërisë civile. PDK-ja bëri koalicion me LDK-në, lideri i të cilës, Fatmir Sejdiu, mori një pozitë më pak ekzekutive, atë të Presidentit të Kosovës. Hashim Thaçi mori pozitën e Kryeministrit të Kosovës dhe pas një viti, në shkurt 2008, u bë protagonist i kryesor politik në vend, duke lexuar Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës. Edhe në zgjedhjet e vitit 2010, PDK-ja arriti që t'i fitonte zgjedhjet e përgjithshme në Kosovë, ndonëse këto zgjedhje u vlerësuan nga aktorë relevantë vendorë dhe ndërkombëtarë si më të këqijat në organizim qysh nga paslufta në Kosovë, për faktin e manipulimit të tyre. Ambasadori i atëhershëm i Ambasadës Amerikane në Kosovë, Christopher Dell, procesin e

¹³⁹ Grupi Ndërkombëtar i Krizave, 'Kosova: Zgjedhje Historike (Prishtinë, 21 nëntor 2001), f. 5.

votimit e pati kualifikuar si ‘vjedhje industriale të votave’. Përkundër kësaj, PDK-ja e Thaçit arriti ta ndërtonte një koalicion me LDK-në dhe disa parti të tjera të vogla, duke ia siguruar Thaçit edhe një mandat në pozitën e kryeministrit.

Zgjedhjet e parakohshme të përgjithshme të vitit 2014 prodhuan një dinamikë të re politike. Si rezultat i kësaj, PDK dhe LDK ndërtuan një koalicion të përbashkët qeverisës. Pozita e kryeministrit të vendit, për herë të parë i takoi LDK-së, kurse pozitën e Kryetarit të Kuvendit të Kosovës e mori PDK-ja. Me mbarimin e mandatit të Atifete Jahjagës, sipas marrëveshjes së koalicionit mes PDK-së dhe LDK-së, ky post do t’i ndahej PDK-së. Në zgjedhjet e vitit 2014, dy nga figurat kyçe në PDK, Fatmir Limaj dhe Jakup Krasniqi, u ndanë nga PDK-ja dhe formuan iniciativën politike Nisma për Kosovën. Këta të fundit e kanë kritikuar PDK-në për qasjen autoritariste të lidershipit të saj. Ndarja erdhi si pasojë e një afere përgjimi, që tashmë njihet në opinionin publik si ‘afëra pronto’. PDK-ja sot ballafaqohet me problemin e reformimit të brendshëm, lëndimin e imazhit ndërkombëtar për shkak të të ashtuquajturit ‘Raport i Dick Marty-t’, i cili pretendon se krerët e saj qenë përfshirë në krime lufte dhe krim të organizuar.

4.3.2 Lidhja Demokratike e Kosovës – LDK

LDK-ja është parti politike e qendrës së djathtë, e anëtarëve të lirë dhe të përgjegjshëm, të cilët veprojnë mbi bazë të Statutit, për të arritur objektivat e përcaktuar në Programin e saj politik.¹⁴⁰

Lidhja Demokratike e Kosovës është formuar më 23 dhjetor 1989. Themelimi i saj ishte rezultat i drejtpërdrejtë i abrogimit të

¹⁴⁰ Statuti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (2012), neni 2.

autonomisë së Kosovës nga Milošević-i. Siç shpjegon Mehmet Kraja, fillimisht kishte dilema se si do të quhej kjo iniciativë: klub, shoqatë apo parti politike. Për të pasur mundësi regjistrimi në Sekretariatën Federativ të Jurisprudencës, duhej të gjendej një formulim adekuat. Kraja nuk e kujton se kush vendosi që kjo iniciativë të quhej ‘Lidhje’, për faktin se në të ishin përfshirë edhe intelektualë të tjerë, por kujton se askujt nuk i pëlqente ky emër, për shkak të ndërlidhjes së tij me emrin e Lidhjes Komuniste. Në kujtimet e tij, Jusuf Buxhovi shkruan se emrin e partisë Lidhja Demokratike e Kosovës e kishte skicuar vetë ai dhe për të ky emër ndërlidhej me Lidhjen shqiptare të Prizrenit.¹⁴¹ Sidoqoftë, për Mehmet Krajën, të rëndësishme ishin vënia në emërtim e cilësimit ‘demokratike’ dhe e saktësisht ‘e Kosovës’. Programi i LDK-së ishte i dobët e me fraza të gjata, por siç heton Kraja, në të ishte “fiksuar disi subjektiviteti politik i Kosovës [...] pra, një program i dobët dhe ndoshta mirë që ishte i tillë” për shkak se ndryshe partia s’do të mund të regjistrohej.¹⁴²

Kjo ishte periudha e fillimit të shpërbërjes së Jugosllavisë. Me ngritjen e Milošević-it në pushtet, autonomia e Kosovës, e garantuar me Kushtetutën e vitit 1974, u abrogua dhe në Kosovë u shpall gjendja e jashtëzakonshme dhe u instalua një regjim policor e ushtarak me elemente apartheidi. 215 intelektualë nënshkruan një apel të quajtur ‘Apeli 215’ në të cilin kundërshtojnë heqjen e autonomisë së Kosovës. Ky apel u injorua nga Kuvendi i Republikës së Serbisë.¹⁴³ Si pasojë e abrogimit të autonomisë së Kosovës, tre gazetarë të rubrikës së kulturës ‘Rilindja’, Mehmet Kraja, Ibrahim Berisha dhe Xhemajl Mustafa, kishin diskutuar fillimisht nevojën

¹⁴¹ Jusuf Buxhovi, *Kthesa Historike: Vitet e Gjermanisë dhe epoka e LDK-së* (Faik Konica, Prishtinë, 2008), f. 184.

¹⁴² Mehmet Kraja, *Vitet e humbura*, (Shoqata Botuese e Lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipërisë, Tiranë, 1995), f. 167.

¹⁴³ Shih Zekeria Cana, *Apeli i 215 intelektualëve shqiptarë*, (Rilindja, Prishtinë, 2001), f. 111-144; po ashtu, Jusuf Buxhovi, *Kthesa Historike: Vitet e Gjermanisë dhe epoka e LDK-së* (Faik Konica, Prishtinë, 2008), f. 154-164.

për themelimin e një subjekti politik që do t'i artikulonte kërkesat politike të shqiptarëve të Kosovës. Kjo ide më vonë ishte ndarë edhe me Jusuf Buxhovin, Ali Aliun, Zenel Kelmendin dhe Bujar Bukoshin.

Në Kosovë, pushteti mbahej nga Partia Komuniste e Kosovës, e cila vepronte nën udhëzimet e Partisë Komuniste të Jugosllavisë së Milošević-it. Minatorët në Trepçë kishin vendosur të hynin në grevë dhe ta kërkonin dorëheqjen e kreut të Lidhjes Komuniste në Kosovë. As kjo kërkesë nuk u dëgjua. Gazetarët e të përditshmes Rilindja, të pakënaqur me pozitën politike të Kosovës dhe injorimin e kërkesave të intelektualëve e të minatorëve, lëshuan një letër publike ku i shprehën këto pakënaqësi dhe dhanë dorëheqje nga Lidhja Komuniste. Ideja për themelimin e një fronti rezistues kishte filluar të kristalizohej.

Milazim Krasniqi që caktuar të bisedonte me Ibrahim Rugovën, me kërkesë që t'i printe kësaj iniciative. Rugova kishte refuzuar të bëhej udhëheqës i kësaj nisme, duke qenë i angazhuar edhe si Kryetar i Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës. Sidoqoftë, ai kishte pranuar ta firmoste këtë iniciativë. Në anën tjetër, Jusuf Buxhovi ishte caktuar të diskutonte me Rexhep Qosjen, që ky ta drejtonte LDK-në, por edhe Qosja kishte refuzuar. Ndonëse nuk dihej kush do të bëhej Kryetar i LDK-së, në mbledhjen e Kuvendit Themelues të saj, Kraja e kishte propozuar Rugovën. Propozimi, ndonëse u kundërshtua nga Rugova, u votua në Kuvend. Për një periudhë të shkurtër kohore, të gjithë anëtarët e Partisë Komuniste i dorëzuan librezat dhe u anëtarësuan në LDK. Vetë Ibrahim Rugova kujton se “brenda një muaji LDK-ja mbledhi gati 200.000 anëtarë”.¹⁴⁴ Mehmet Kraja, anëtarësimin masiv në LDK e quan ‘deklarim politik për frontin e refuzimit’. Më 2 korrik 1990, 111

¹⁴⁴ Ibrahim Rugova, *Çështja e Kosovës: Biseda me Marie-Francoise Allain dhe Xavier Galmiche* (Dugagjini, Pejë, 1995), f. 85; Kosovo Stability Initiative, ‘A Power Prime: A Handbook to Politics, People, and Parties in Kosovo’, (Prishtinë, dhjetor 2011), ff. 23-33.

deputetë shpallën Deklaratën Kushtetuese për Pavarësinë e Kosovës, më 7 shtator 1990 e aprovuan një kushtetutë të re për Kosovën, dhe një vit më pas, në shtator 1991, u organizua një referendum për Republikën e Kosovës si shtet sovran dhe i pavarur. Ndonëse këto veprime nuk kishin pasoja të drejtpërdrejta ndërkombëtare dhe Kosova nuk u pranua ndërkombëtarisht si e pavarur, ato ngulitën idenë e kërkesës për subjektivitet të pavarur dhe të lirë politik të Kosovës.

LDK-ja u shndërrua në një lëvizje nacionale dhe politike për t'i rezistuar regjimit të Milošević-it. Në Kosovë u organizuan zgjedhjet e përgjithshme më 1992 dhe më 1998, në formë thuajse klandestine. Jusuf Buxhovi arsyeton logjikën e mbajtjes së këtyre zgjedhjeve brenda Kosovës nën okupim. Sipas tij, kjo ishte bërë me qëllim që të legjitimoheshin institucionet paralele në Kosovë dhe përfaqësuesit e tyre legjitimë, të cilët do të mund ta përfaqësonin Kosovën potencialisht në një konferencë ndërkombëtare, ku do të diskutohej për zgjidhjen e problemit të saj.¹⁴⁵ LDK-ja kishte fituar një shumicë thuajse absolute në këto zgjedhje (574.755 vota ose 76.44% të totalit të votave). Më pas, ajo ndërtoi një rrjet të institucioneve arsimore dhe shëndetësore, të cilat përkraheshin financiarisht nga 'fondi i 3 përqindëshit', i cili mblidhte mjete financiare për t'i përkrahur institucionet paralele në Kosovë. Lideri i LDK-së, Ibrahim Rugova, gëzonte një përkrahje masive popullore. LDK-ja, nëse flasim me termat e partive politike, deri në vitin 1995 ishte një parti predominuese¹⁴⁶ që gëzonte shumicë absolute të besimit të qytetarëve në Kosovë. Pas organizimit të Konferencës së Dejtonit më 1995, kur u vendos që pas luftës në Bosnjë-Hercegovinë, ajo të njihet si shtet i pavarur dhe sovran, qytetarët e

¹⁴⁵ Po ashtu, Jusuf Buxhovi, *Kthesa Historike: Vitet e Gjermanisë dhe epoka e LDK-së* (Faik Konica, Prishtinë, 2008).

¹⁴⁶ Ky term është përdorë nga Giovanni Sartori, në kapitullin 'Kriteri numerik', në librin *Parties and Party Systems: A Framework for Analysis* (Colchester, ECPR 2005).

Kosovës kishin dhënë shenjat e para të zhgënjimit se strategjia paqësore e drejtuar prej LDK-së dhe heqja nga agjenda ndërkombëtare e çështjes së Kosovës, nuk po shpërbleheshin nga bashkësia ndërkombëtare. Henry H. Perrit e përshkruante Rugovën kështu:

Rugova u bë fytyra e politikës së Kosovës, duke dominuar madje edhe pas përfundimit të luftës. Rugovën e duan ata që e panë duke e mbajtur zjarrin e pishtarit ndezur për një kohë të gjatë. Por imazhet e Rugovës janë po ashtu imazhet e një njeriu të largët dhe enigmatik, me shallin e tij të çuditshëm të mëndafshët, duke qëndruar jashtë rrethojës në bazën e Forcave Ajrore në Dayton, kryesisht i injoruar nga Richard Holbrooke dhe Slobodan Milošević-i, të cilët zhvillonin negociata për përfundimin e luftës në Bosnjë, duke mos i kushtuar rëndësi Kosovës.¹⁴⁷

Sipas Guzina, LDK kishte një kërkesë maksimaliste: organizimin e një shteti sovran dhe të pavarur, e cila kërkesë mendohej të realizohej përmes mjeteve minimaliste¹⁴⁸, qasjes paqësore dhe refuzimit të dhunës. Kjo qasje, ndonëse pranohej ndërkombëtarisht, e mirëmbante *status quo*-në politike në Kosovë. Siç shkruan Miranda Vickers, pas Dejtonit, “për shumicën e kosovarëve *status quo*-ja nuk do të mund të mirëmbahej më tutje”.¹⁴⁹ Marrëveshja e Dejtonit zbehu qasjen joviolente të LDK-së, por vetëm përkohësisht, me gjithë faktin se kishte zëra që LDK-ja do të

¹⁴⁷ Henry H. Perrit, *Ushtria Çlirimtare e Kosovës: Rrëfimi prej brenda për një kryengritje*, (KOHA, Prishtinë, shtator 2008), f. 27.

¹⁴⁸ Shih: Dejan Guzina, Kosovo or Kosova – Could it Be Both? The Case of Interlocking Serbian and Albanian Nationalism, në Florian Bieber dhe Zidas Daskalovski (ed.), *Understanding the War in Kosovo*, (Franc Cass, London, 2003), f. 39.

¹⁴⁹ Miranda Vickers, *Between Serb and Albanian: A History of Kosovo*, (Columbia University Press, 2001), f. 290.

mund të zhdukej si organizim politik. Siç ka vërejtur Grupi Ndërkombëtar i Krizave në një studim:

Shumica mendonin se partia dhe udhëheqësi i saj do të zhdukeshin politikisht pas fushatës së bombardimeve të NATO-s më 1999. Gjatë bombardimeve, Rugova u filmua në një takim me ish-presidentin jugosllav Slobodan Milošević dhe u akuzua nga disa si tepër paqësor. Pas bombardimeve, UÇK-ja veproi me shpejtësi për të plotësuar boshllëkun e lënë nga ikja e forcave serbe, ndërsa Rugova edhe për disa javë qëndroi jashtë vendit. Megjithatë, vetëm një pakicë e shqiptarëve të Kosovës morën pjesë aktive në UÇK. Besnikëria ndaj LDK-së dhe Rugovës u rikthye përballë zmbropsjes ndaj arrogancës së UÇK-së të shfaqur në dëshirën për të kontrolluar ekonominë dhe politikën në kaosin para krijimit të UNMIK-ut. Pozicioni mbizotërues i LDK-së në zgjedhjet e tetorit 2000 e risolli atë si forcën mbizotëruese politike të Kosovës.¹⁵⁰

LDK-ja, ndonëse ende nuk ishte riorganizuar si një parti moderne politike, edhe pas vitit 1999 kishte arritur t'i fitonte të gjitha zgjedhjet nacionale dhe lokale deri në vitin 2007. Pas vdekjes së Rugovës, LDK-ja mbajti një kuvend zgjedhor dhe Fatmir Sejdiu u zgjodh Kryetari i saj i ri. Kuvendi u zhvillua në një frymë të tensionuar për faktin se përkrahësit delegatë të dy kandidatëve, Fatmir Sejdiu dhe Nexhat Daci, nuk kishin arritur të menaxhonin mbarëvajtjen e Kuvendit. Në këtë kuvend pati edhe një incident fizik të përplasjes mes këtyre dy fraksioneve. Si pasojë e kësaj, Nexhat Daci lëshoi LDK-në dhe themeloi partinë e tij, Lidhjen Demokratike të Dardanisë, me çka një pjesë e LDK-së u nda. Në zgjedhjet e brendshme të vitit 2010 në LDK, Isa Mustafa i konkurroi ish-

¹⁵⁰ Grupi Ndërkombëtar i Krizave, 'Kosova: Zgjedhje Historike (Prishtinë, 21 nëntor 2001), f. 4.

kryetarit të LDK-së Fatmir Sejdiut. Mustafa u zgjodh Kryetar i ri. Në mars 2012, LDK-ja aprovoi statutin e ri, duke i dhënë një frymë më moderne strukturës dhe organizimit partiak. Megjithatë, ajo gjendet në një fazë krejtësisht fillestare të reformimit të saj të brendshëm. Në maj 2015, LDK organizoi zgjedhjet e brendshme. Deri më tani, LDK-ja ka organizuar tetë Kuvende Zgjedhore, dhe ka zgjedhur tre kryetarë. Në zgjedhjet e fundit në nivel vendi, LDK doli si partia e dytë më e madhe në Kosovë. Ajo sot është në koalicion me PDK-në, dhe lideri i LDK-së, për të parën herë pas vitit 1999, është edhe Kryeministër i Kosovës. Tendencat ideologjike të LDK-së anojnë më shumë kah djathtizmi konservator. Ajo është e anëtarësuar në familjen e partive popullore evropiane. LDK-ja ballafaqohet sot me problemin e ngritjes së kapaciteteve, të reformimit të brendshëm dhe shndërrimit nga një lëvizje-parti në një parti moderne politike.

4.3.3 Lëvizja Vetëvendosje!

Lëvizja VETËVENDOSJE! është lëvizje politike që e synon faktorizimin e popullit në vendimmarrjen politike nëpërmjet organizimit dhe mobilizimit të tij. Lëvizja VETËVENDOSJE! angazhohet për ndryshime rrënjësore shoqërore dhe politike, duke u mbështetur në parimin e barazisë, të demokracisë, të lirisë politike dhe të drejtësisë sociale të çdo qytetari. Lëvizja VETËVENDOSJE! synon një Kosovë sovranë, pra një Kosovë që ka kontroll në burimet natyrore të saj dhe që e gëzon të drejtën për të pasur një forcë ushtarake të pavarur të veten, si dhe të drejtë për bashkimin me Shqipërinë.¹⁵¹

¹⁵¹ Statuti i Lëvizjes Vetëvendosje, neni 1.

Fillimisht e njohur si KAN (Rrjeti i Aksionit për Kosovën), e themeluar më 1997 nga Alice W. James dhe një grup aktivistësh të tjerë ndërkombëtarë, ky rrjet kishte për qëllim promovimin e vlerave universale, si liria, barazia dhe drejtësia. KAN kishte përkrahur Unionin e Pavarur të Studentëve të Universitetit të Prishtinës, në protestat e tyre paqësore për kthimin e objekteve universitare, pas largimit të stafit dhe studentëve shqiptarë nga këto objekte nga forcat serbe. Më pas, kishte ndërmarrë fushatën avokuese për lirimin e pengjeve të luftës, e njohur ndryshe si fushata APAL (Albanian Prisoner Advocacy List). Më 12 qershor 2005 KAN ishte shndërruar në Lëvizjen Vetëvendosje, pas aksionit të ndërmarrë pranë selisë së UNMIK-ut, ku ishte shpalosur parulla ‘Jo negociata, vetëvendosje!’.¹⁵²

Formimi i VV-së erdhi si pasojë e administrimit ndërkombëtar dhe paqartësisë politike mbi statusin e Kosovës. Kjo administratë e OKB-së ishte vendosur në Kosovë për të administruar paqen dhe për të ndërtuar institucione që do të gëzonin një autonomi relative, deri në zgjidhjen finale të statusit të Kosovës, ndonëse asnjë prej dokumenteve bazë të këtij misioni nuk saktësonte cila do të ishte ajo zgjidhje. Qasja e UNMIK-ut ishte se nuk mund të dilte nga Kosova pa një strategji dalëse. Simon Chesterman kishte kritikuar mungesën e strategjisë dalëse të UNMIK-ut, duke argumentuar se nuk ka strategji pa një dalje (no strategy without an exit).¹⁵³ Më 2003,

¹⁵² Për historikun e Lëvizjes Vetëvendosje shih Lëvizja Vetëvendosje, ‘Historiku i Lëvizjes Vetëvendosje!’. Qasur në http://www.vetevendosje.org/wp-content/uploads/2013/09/Historik_i_Levizjes_VETEVENDOSJE.pdf (15 shkurt 2015); Shih po ashtu Kosovo Stability Initiative, ‘A Power Prime: A Handbook to Politics, People, and Parties in Kosovo’, dhjetor 2011, ff. 51-53.

¹⁵³ Simon Chesterman, *You, The People: The United Nations, Transitional Administration, and State-building* (Oxford University Press, 2004), f. 204.

bashkësia ndërkombëtare kishte kushtëzuar lidershipin politik të institucioneve të Kosovës përmes ‘standardeve para statusit’.¹⁵⁴

Frustrimi në mesin e qytetarëve të Kosovës me këtë politikë të UNMIK-ut kishte filluar të rritej dhe perceptimet e qytetarëve të Kosovës tregonin për rënien e popullaritetit të UNMIK-ut te qytetarët e Kosovës. Si pasojë e një incidenti që ndodhi në Mitrovicë, Kosova u përball me trazirën më të madhe të pasluftës, në mars 2004. Si pasojë, Kai Eide u ngarkua nga Sekretari i OKB-së që ta vlerësonte përmbushjen e standardeve dhe, në vitet 2004 e 2005, përmes raporteve të tij u rekomandua hapja e negociatave për statusin e Kosovës, duke konstatuar se *status quo*-ja nuk do të mund të mirëmbahej edhe më tutje. Martti Ahtisaari, ish-Presidenti i Finlandës, ishte caktuar t’i ndërmjetësonte negociatat për zgjidhjen e statusit të Kosovës. Negociatat u zhvilluan më 2006 dhe 2007.

Slogani i Lëvizjes Vetëvendosje ishte ‘Jo negociata, vetëvendosje!’. Qëndrimi i VV-së¹⁵⁵ ishte se vetëvendosja është e drejtë universale dhe se Kosova duhej ta gëzonte këtë të drejtë për ta vendosur vetë fatin politik. Për VV-në, UNMIK-u ishte një regjim antidemokratik që kushtëzonte zgjidhjen e statusit të Kosovës përmes negociatave dhe kompromiseve. VV-ja paraqiti qëndrimin e saj kundër negociatave në 14 pikat e saj, duke përfshirë këtu pozicionin e pabarabartë të Kosovës në negociata, shpërbërjen e

¹⁵⁴ UNMIK, ‘Standards for Kosovo’, Pristina, 10 dhjetor 2003. Qasur në <http://www.securitycouncilreport.org/atf/cf/%7B65BFCF9B-6D27-4E9C-8CD3-CF6E4FF96FF9%7D/Kos%20Standards.pdf> (26 korrik 2016).

¹⁵⁵ Për një analizë të metodave të ndjekura nga VV-ja, shih Stephanie Schwandner-Sievers, ‘Democratisation through Defiance? The Albanian Civil Organisation ‘Self-Determination’ and International Supervision in Kosovo’, në V. Bojicic-Dzelilovic et al. (eds.), *Civil Society and Transitions in the Western Balkans* (Palgrave Macmillan, 2013); Për qëndrimet e Albin Kurtit, shih intervistën e David Chandler me Albin Kurtin, ‘JISB Interview: Kosova in Dependence: From Stability of Crisis to the Crisis of Stability’, *Journal of Intervention and Statebuilding*, 5: 1, 2011, 89 — 97; Gëzim Visoka, ‘International Governance and Local Resistance in Kosovo: the Thin Line between Ethical, Emancipatory and Exclusionary Politics’, *Irish Studies in International Affairs*, Vol. 22 (2011), 99 f. 125.

strukturave paralele, mungesën e dëmtshpërblimit të Serbisë ndaj Kosovës për vrasjet, dhunimet, dënimet dhe shkatërrimet e pronës në Kosovë, etj.¹⁵⁶ VV-ja organizoi protesta të vazhdueshme kundër negociatave prej vitit 2005 deri më 2007. Në shkurt 2007, në protestën e VV-së të organizuar në Prishtinë kundër negociatave të delegacionit kosovar që po bisedonte me Serbinë, policët e UNMIK-ut që po e menaxhonin rendin e protestës, pas eskalimit të saj, kishin hedhur plumba gome në drejtim të protestuesve dhe me këtë rast kishin vrarë Arben Xheladinin dhe Mon Balajn.

Duke qenë se VV-ja kundërshtonte bazën legale të UNMIK-ut, Rezolutën 1244 dhe Marrëveshjen e Rambujesë, dokumente këto që kishin bërë të mundshëm përfundimin e luftës dhe vendosjen e administratës civile dhe ushtarake në Kosovë, VV-ja ka argumentuar në vazhdimësi¹⁵⁷ se përmes këtyre dokumenteve Kosova nuk mund të bëhej shtet, për faktin se ato garantonin integritetin territorial të Jugosllavisë mbi Kosovën. Kësisoj, VV-ja ishte iniciativa e vetme politike që kundërshtonte dyfish procesin politikëbërës në Kosovë: duke kritikuar, në njërën anë, lidërshtimin politik në Kosovë për fillimin e negociatave për statusin e Kosovës në Vjenë dhe, në anën tjetër, duke kritikuar UNMIK-un si regjim antidemokratik dhe jollogaridhënës kundrejt popullit të Kosovës. Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës dhe zbarkimit të misionit për sundimin e ligjit

¹⁵⁶ Lëvizja Vetëvendosje, 'Jo negociata, sepse'. Qasur në http://www.vetevendosje.org/wp-content/uploads/2013/09/jo_negociata_sepse.pdf (12 shkurt 2015).

¹⁵⁷ Lëvizja Vetëvendosje, 'Manifesti i Vetëvendosje!-s'. Në këtë dokument shkruhej: 'Vetëvendosja është themeli i statusit të qytetarit. Ndërkaq, dokumenti bazik në të cilin gjën mbështetjen e plotë administrimi i Kosovës (Rezoluta 1244), secilin individ e trajton vetëm si banor, status të cilin mund ta gëzojë edhe refugjati. Vetëvendosja nënkupton si e tillë vetëshpalljen e Qytetarit. Për vetëvendosjen nuk ka zëvendësim. Ajo i siguron rrënjët e individit në proceset politiko-shoqërore. Vetëm liria mundëson që nga bashkësi etnike të bëhemi bashkësi politike. Që të jemi vetë përcaktues të identiteteve tona si qytetarë e jo të veçuar e të kategorizuar kolektivisht nga pushteti'. Qasur në <http://www.vetevendosje.org/ep-content/uploads/2013/09/Manifesti-1.pdf> (15 shkurt 2015).

dhe mbikëqyrjen e zbatimit të Planit të Ahtisaari-t në Kosovë, VV-ja nuk e ndryshoi kursin e saj të veprimtimit dhe të kritikës as ndaj këtyre misionëve, duke i konsideruar si surrogate të UNMIK-ut, që e pengojnë pavarësimin e plotë të Kosovës.

Në një intervistë me David Chandler, Albin Kurti argumentonte:

Prezenca ndërkombëtare në Kosovë është dominim ndërkombëtar i bazuar në paradigmën e stabilitetit. Garanton që situata të mbetet stabile. Mbi 5 miliardë euro janë derdhur në Kosovë në më pak se 10 vjet. Stabiliteti është një gjë që kushton. Nevojitet më shumë përpjekje për të garantuar status quo-në sesa për të bërë progres [...] Në Kosovë nuk ka kundërthënie mes stabilitetit dhe krizës. Është kriza ajo që është stabile [...] Qeverisja ndërkombëtare në Kosovë është dyfish jodemokratike. Së pari, në vetvete është jodemokratike; ajo përbëhet nga urdhrat lart-poshtë, pa demokraci të brendshme në vendimmarrje. Së dyti, është jodemokratike për Kosovën; institucionet vendore i nënshtrohen normativisht dhe politikisht ndërkombëtarëve në një mënyrë përfshirëse dhe absolute. Për më shumë, ndërkombëtarët i kanë lejuar institucionet e Kosovës që të merren me atë që Pierre Bourdieu (1999) i quan ‘dora e majtë e shtetit’ (arsimi, kujdesi shëndetësor, kultura) por ndërkombëtarët kanë mbajtur gjithmonë kontroll në ‘dorën e djathtë të shtetit’ (ushtria, policia, sistemi gjyqësor).¹⁵⁸

¹⁵⁸ Albin Kurti, ‘JISB Interview: Kosova in Dependence: From Stability of Crisis to the Crisis of Stability’, *Journal of Intervention and Statebuilding* (2011), 5: 1, ff. 89-97. Në këtë intervistë, Kurti zhvillon edhe më tutje argumentin e tij për stabilitetin. Sipas tij: “Paradigma e stabilitetit e suspendon historinë. Historia vetë Misionin Ndërkombëtar (i cili e konsideron popullatën lokale të papjekur) do ta kishte bërë të papjekur. Si një fëmijë 11 vjeçar. Për më tepër, historia është parë që ka mundësi ta trazojë paqen’.

Për herë të parë, në zgjedhjet nacionale të vitit 2010, VV mori pjesë në zgjedhje dhe u rendit si forca e tretë politike në vend. Lista me emrat e kandidatëve të VV-së që garuan në zgjedhje ishte bërë sipas rendit alfabetik, një metodë kjo e papraktikuar nga partitë e tjera politike. Prej vitit 2010, kur VV-ja u regjistrua si iniciativë qytetare në KQZ, e deri në vitin 2015, VV-ja është udhëhequr nga Albin Kurti. Në shkurt 2015, VV-ja organizoi zgjedhje të brendshme brendapartiake. Visar Imeri, pa asnjë kundërkandidat, u zgjodh kryetar i VV-së. Imeri mori 96,42% të votave të anëtarësisë së VV-së. Moskandidimi i Kurtit në pozitën e kryetarit të VV-së u pa nga zëra kritikë si strategji e brendshme e VV-së për ta rikandiduar Kurtin në zgjedhjet e radhës. VV sot ballafaqohet me qasjen e saj rigoroze kundër hyrjes në koalicione me partitë politike që kanë qeverisur me Kosovën deri më tani. Rekrutimi i ekspertëve të fushave të ndryshme qeverisëse që kanë kapacitete teknike për t'u ballafaquar me qeverisjen e vendit edhe në nivel qendror do të mbetet një sfidë tjetër e VV-së. Një sfidë e tillë është hasur në Komunën e Prishtinës, e cila tashmë drejtohet nga VV-ja që nga zgjedhjet lokale të vitit 2013.

4.3.4 Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës – AAK

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës është formuar më 2 maj 2000. Ramush Haradinaj, themeluesi i AAK-së, nuk kishte marrë pjesë në delegacionin e Kosovës në Konferencën e Rambujesë. Por, si komandant i UÇK-së në rajonin e Dukagjinit, Haradinaj mori pjesë në takime dhe diskutime ndërkombëtare që vendosën rreth transformimit të UÇK-së. Duke qenë se polarizimet politike mes PDK-së dhe LDK-së ishin të mëdha, përfshirja e AAK-së në skenën politike në Kosovë ndikoi në zbutjen e antagonizmave mes të ashtuquajturit 'krah i luftës' dhe 'krahut të paqes'. PDK-ja e

promovonte vetveten si pasuese e vetme dhe e pakontestuar e UÇK-së, ndonëse ky formacion ushtarak për çlirimin e Kosovës nuk kishte karakter partiak.

Në librin e Bardh Hamzajt, *Paqja e Gjeneralit: Dialog me Ramush Haradinajn*, Haradinaj jep detajet se si u krijua AAK-ja. Haradinaj shpjegon se pas luftës, populli i Kosovës ishte mbetur në konfuzion për faktin se partitë politike më shumë merreshin me të kaluarën se kush dhe çfarë ka bërë, sesa me vendosjen e prioriteteve për rindërtimin e Kosovës. Themelimi i AAK-së, sipas tij, nuk është se e ka ndarë politikën e UÇK-së, për faktin se, siç thotë ai, “politika e UÇK-së nuk ka qenë politikë e grupeve, e atyre që e kanë bërë luftën. Por ka qenë politikë e një fryme të luftës. Luftës për Çlirim” dhe UÇK-ja nuk i ka takuar vetëm një grupi, por ka qenë vlerë e popullit shqiptar.¹⁵⁹ Haradinaj ishte i pakënaqur me mënyrën se si po zhvillohej politika e pasluftës.¹⁶⁰

Ramush Haradinaj shpjegon edhe idenë se si u caktua emri i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës. Sipas tij, meqenëse shprehjet si ‘lëvizje’ dhe ‘lidhje’ tashmë ishin të tejkaluara, ai kishte menduar që emrin e Aleancës ta lidhte me historinë e afërt të Kosovës, Aleancën Veri-Atlantike, duke vlerësuar se njerëzit kishin respekt ndaj nocionit ‘aleancë’, që njëkohësisht shihej si shprehje e moderuar. Qëllimi i kësaj Aleance, sipas fjalëve të Haradinajt, ishte ndërtimi i ardhmërisë së Kosovës. Haradinaj kundërshtonte

¹⁵⁹ Bardh Hamzai, *Paqja e Gjeneralit: Dialog me Ramush Haradinaj* (Zëri, Prishtinë, 2001), f. 145.

¹⁶⁰ Po aty, f. 149. Në bisedat me Sokol Dobrunën, epror i UÇK-së në zonën e Dukagjinit, i cili po shërbente në Qeverinë e Përkohshme të Kosovës, të drejtuar nga Hashim Thaçi, Haradinaj kishte shprehur rezervat me punën që po bënte kjo qeveri dhe mungesën e hapësirës për njerëz të rinj. Sipas Haradinajt, në shtator 1999 Hashim Thaçi dhe Xhavit Haliti kishin kërkuar një takim me të, por që ishte bojkotuar nga Haradinaj. Ai shpjegon arsyen e bojkotit me faktin se kishte rezerva ndaj njerëzve të PDK-së, si Xhavit Haliti dhe Kadri Veseli, por pas insistimit të Ethem Çekut, i kishte takuar Thaçin dhe Halitin. Këta të fundit kishin kërkuar mbështetje për PDK-në dhe qëllimi i takimit ishte që “të gjithë njerëzit e Ramushit” të mos kishin vështirësi të inkuadroheshin në PDK.

këmbënguljen e partive politike që të merreshin me të kaluarën se kush, çfarë dhe si ka bërë, për shkak se kjo krijonte antagonizma dhe pengonte të ardhmen e Kosovës. Duke bërë një profil të AAK-së, Grupi Ndërkombëtar i Krizave vlerësonte organizimin dhe lidërshtipin energjik të Ramush Haradinajt, duke e prezantuar AAK-në si parti të qendrës. Sidoqoftë, Grupi Ndërkombëtar i Krizave nënvizonte se:

Ka një lloj dykuptimësie në lidhje me qëndrimin e bashkësisë ndërkombëtare ndaj Haradinajt dhe AAK-së. Tregohet respekt për qasjen profesioniste të partisë dhe organizimin e saj efektiv, e dhe për energjinë e Haradinajt, si dhe vlerësohet qëndrimi i moderuar praktik dhe bashkëpunues i partisë. Në anën tjetër, janë ngritur dyshime mbi lidhjet e tij me persona të dyshuar si kriminelë dhe me elementë ekstremistë. Ashtu si Thaçi dhe PDK-ja, Haradinaj u është përshtatur rrethanave, duke qenë i vetëdijshëm se udhëheqësit e Kosovës duhet të japin prova se dinë ta drejtojnë administratën, të nxisin zbatimin e ligjit, t'i respektojnë pakicat etj. Megjithatë, duke pasur parasysh të kaluarën e tij, ai duhet të provojë se cili është.¹⁶¹

Ndonëse fillimisht u krijua si koalicion i disa partive të vogla si LPK, LKÇK, Partia Parlamentare e Kosovës, UNMIKOMB, etj, më 2004, AAK u nda nga këto parti dhe garoi si parti e vetme në zgjedhjet nacionale të vitit 2004. Gjatë këtyre zgjedhjeve, LDK doli e para, dhe AAK-ja si partia e tretë me 8.3% të totalit të votave lidhi koalicion me LDK-në. Ramush Haradinaj do të marrë timonin e Kryeministrit të Kosovës, kurse Ibrahim Rugova atë të Presidentit të Kosovës. Futja e AAK-së në koalicion me LDK-në nuk u mirëprit nga PDK-ja, e cila konsideronte veten pasuese të UÇK-së. Ky

¹⁶¹ Grupi Ndërkombëtar i Krizave, 'Kosova: Zgjedhje Historike' (Prishtinë, 21 nëntor 2001), f. 5.

qëndrim i PDK-së, pos të tjerash, mund të shpjegohet edhe me faktin se elektorati i AAK-së dhe PDK-së ishin relativisht të njëjtë. Kjo i kontribuoi uljes së polarizimit politik mes atyre që kishin luftuar (UÇK-së, respektivisht më vonë PDK-së) dhe atyre që kishin ndjekur qasjen e negociatave, të dialogut për zgjidhjen e çështjes së Kosovës (LDK-së). 100 ditë pas ushtrimit të pozitës së kryeministrit të Kosovës, Gjykata Ndërkombëtare Penale për ish-Jugosllavi (Tribunali i Hagës), ngriti padi për krime lufte ndaj Ramush Haradinajt. Haradinaj dha dorëheqje dhe më 2005 u paraqit para Tribunalit të Hagës. Nga viti 2005 deri më 2010, Haradinaj u gjykua për krime lufte në Tribunalin e Hagës dhe, në fund, u shpall i pafajshëm. Pas dorëheqjes së Ramush Haradinajt, përkundër pritshmërive publike, koalicioni qeveritar mes LDK-së dhe AAK-së mbijetoi. Bajram Kosumi, njëri nga nënkryetarët e AAK-së, u zgjodh Kryeministër i Kosovës deri më 2006. Pas tij, AAK-ja propozoi një Kryeministër të ri, Agim Çekun. Pas zëvendësimit të Kosumit me Çekun, Kosumi kishte dhënë dorëheqje nga AAK-ja, kurse pas përfundimit të mandatit të tij, Agim Çeku lëshoi AAK-në dhe mori nën udhëheqjen e vet Partinë Social-Demokrate të Kosovës. Në prill 2008, Çeku u anëtarësua në PDK.

Për dallim nga partitë e tjera, një nga pengesat kryesore për konsolidimin e AAK-së ishte mungesa e liderit të saj në Kosovë. Në Kosovë ishte lansuar një slogan për kthimin e tij nga Haga në Kosovë: 'Our Prime has a job to do here'. Nga viti 2005 deri më 2008, partia u udhëhoq nga Ahmet Isufi. Më 2008, Blerim Shala emërohet nënkryetar i AAK-së dhe angazhohet për ta drejtuar AAK-në për dy vjet radhazi, deri më 2010 kur Haradinaj shpallet i pafajshëm nga Gjykata e Hagës. Pas kthimit të Haradinajt në Kosovë, Blerim Shala jep dorëheqje nga AAK-ja dhe emërohet Koordinator Politik për dialogun që po zhvillohej mes Kosovës dhe Serbisë në Bruksel. Një pozitë të përafërt Shala e kishte ushtruar edhe gjatë viteve 2006-2007, kur ishte emëruar nga Kryetari i

Kosovës, Ibrahim Rugova, si Koordinator i Grupeve Punuese për negociatat që do të zhvilloheshin në Vjenë. Për dallim nga partitë e tjera, një pjesë e kuadrove që i ishin bashkuar AAK-së, u larguan prej saj. Kjo e dëmtoi reputacionin e AAK-së, për shkak të ndjekjes së një politike jostabile të menaxhimit të kuadrove.

Në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2014, AAK-ja doli partia e katërt. Ndonëse edhe në këto zgjedhje PDK-ja kishte arritur të dilte partia fituese në Kosovë, asnjëra nga partitë politike opozitare nuk parapëlqente të hynte në koalicion me PDK-në, duke e demonizuar si parti që i bartte të gjitha mëkatet për keqeverisjen e vendit, korrupsionin dhe krimin e organizuar. Ishte krijuar një koalicion i gjerë paszgjedhor mes LDK-së, AAK-së, VV-së dhe Nismës, i quajtur VLAN, që kishte refuzuar bashkëpunimin me PDK-në. Qëndrimi i koalicionit VLAN ishte që lideri i AAK-së të propozohej për Kryeministër. Pas bllokadës institucionale gjashtëmujore, Kuvendi nuk arriti t'i kryente funksionet e tij. Me kërkesë të VLAN-it, Gjykata Kushtetuese kishte lëshuar një vendim me të cilin shpjegonte se sipas ligjeve për organizimin e zgjedhjeve në Kosovë, koncepti i koalicionit paszgjedhor ishte në shpërputhje me parimet kushtetuese dhe ligjet për zgjedhjet në Kosovë. Aleanca sot është parti opozitare. Sfidat e saj kryesore janë shtrirja e saj në tërë territorin e Kosovës, rritja e elektoratit dhe rekrutimi i kuadrove me profil të lartë.

MES STABILITETIT
DHE DEMOKRATIZIMIT

KAPITULLI V

KAPITULLI 5:

KEQKUPTIMI I DEMOKRACISË” NË KOSOVËN E PAVARUR - MANIPULIMI
I ZGJEDHJEVE DHE “DELLO-KRACIA

KAPITULLI 5: “KEQKUPTIMI I DEMOKRACISË” NË KOSOVËN E PAVARUR - MANIPULIMI I ZGJEDHJEVE DHE “DELLO-KRACIA”

Një vit para shpalljes së pavarësisë së Kosovës, Oisín Tansey kishte shkruar një studim me titull ‘Demokratizimi pa shtet: Regjim-ndërtimi demokratik në Kosovë’. Tansey argumentonte se përkundër faktit që Kosova ende nuk ishte njohur si shtet, kjo e fundit kishte ndërtuar një regjim demokratik hibrid, të udhëhequr pjesërisht nga vendorët dhe pjesërisht nga ndërkombëtarët. Duke i analizuar zhvillimet me mbarëvajtjen e zgjedhjeve dhe ndërtimin e institucioneve, Tansey shkruante se Kosova ka bërë hapa të rëndësishëm në ndërtimin e një regjimi demokratik.¹⁶² Artikulli i Tansey-t provonte t’i kundërvijë tezës së Juan Lin-it dhe Alfred Stepanit, sipas të cilëve shteti sovran është parakusht i demokracisë. Linz dhe Stepan argumentojnë se nuk mund të ketë demokraci pa qytetarë, dhe nuk mund të ketë qytetarë pa shtet. Kurse, shteti vetë duhet të pranohet ndërkombëtarisht. Këta dy studiues argumentojnë se kur një pjesë e popullsisë nuk pajtohet me kufijtë e shtetit, dhe nuk e konsideron atë legjitim, kjo paraqet një problem serioz në konsolidimin e demokracisë së atij shteti.¹⁶³

¹⁶² Oisín Tansey, ‘Democratization without a State: Democratic Regime-building in Kosovo’, *Democratization* (2007), 14:1, 129-150.

¹⁶³ Juan J. Linz dhe Alfred Stepan, *Problems of Democratic Transition and Consolidation: Southern Europe, South America and Post-Communist Europe* (Baltimore, MD: The Johns Hopkins University Press, 1996), f. 5-20.

Përpos kontestimit të shtetshmërisë së Kosovës nga pakica serbe në Kosovë, një problem tjetër serioz që e pengon konsolidimin e demokracisë në Kosovë ka të bëjë me kapacitetet e shoqërisë kosovare për të prodhuar elita politike llogaridhënëse që janë të afta për të ndërtuar një shtet funksional. Dy vjet para shpalljes së pavarësisë së Kosovës, një raport i Grupit Ndërkombëtar të Krizave vërente:

Disa dyshojnë nëse Kosova ka elitë politike e shoqërore që mund të krijojë dhe të zhvillojë një shtet funksional. Demokracia e brendshme e brishtë që haset te partitë politike, së bashku me vendimin e UNMIK-ut për sistemin zgjedhor të aplikueshëm, kanë kufizuar përgjegjësinë e politikanëve para votuesve. Sistemi me lista të mbyllura vetëm sa i forcon hierarkitë e partive dhe monopolin mbi të ardhurat qeveritare dhe përfitimet nga këto të ardhura të njerëzve partiakë që veprojnë prapa skenës. Ndoshta rol edhe më të madh në mbajtjen e skenës politike, të ngërthyer në sistemin patron-klient luan dështimi që në gjashtë vjetët e fundit Kosova t'i afrohet një ekonomie moderne, duke bërë kështu që të devalvohen idetë dhe politikat. Viti i fundit i UNMIK-ut duhet të shfrytëzohet që të korrigjohet vendimi i gabuar, i cili favorizonte listat e mbyllura, me qëllim që të krijohet pak më shumë hapësirë demokratike, të pengohet thellimi i kleptokracisë si dhe të inkurajohet përfshirja në sistem e gjakut të ri politik, përfshirë edhe grupet relativisht të marginalizuara, siç janë gratë dhe rinia.¹⁶⁴

Ndonëse procesi i demokratizimit në Kosovë ka filluar gjatë viteve '90-të dhe veçanërisht pas vitit 1999 me mbajtjen dhe organizimin e

¹⁶⁴ Grupi Ndërkombëtar i Krizave, 'Kosova: Sfida e transicionit' (Raport për Evropë i Grupit të Krizave numër 170, 17 shkurt 2006), f. 4.

disa palë zgjedhjeve nën tutelën e UNMIK-ut¹⁶⁵, duke mos qenë Kosova shtet me qytetarë, por një territor i administruar ndërkombëtarisht pa status politik të definuar, asaj i kishte munguar parakushti fillestar për konsolidimin e demokracisë. Pas 17 shkurtit 2008 u hap mundësia potenciale e konsolidimit të demokracisë në Kosovë. Sidoqoftë, menjëherë ishin shfaqur probleme serioze që pengonin këtë konsolidim demokratik. Në njërin anë, serbët e pjesës veriore menjëherë kontestuan shtetin e sapolindur të Kosovës me mjete jodemokratike, duke djegur pikat kufitare në veri të Kosovës, dhe kjo përbënte pengesë reale në konsolidimin e demokracisë në gjithë territorin e Kosovës. Në anën tjetër, Kosova nuk e kishte përfunduar plotësisht procesin e njohjeve ndërkombëtare dhe anëtarësimin në organizatat ndërkombëtare. Duke i lënë mënjane këta dy faktorë, Kosova bëri një prapakthim në aspektin e demokratizimit, kur zgjedhjet e përgjithshme të organizuara më 2010 u manipuluan pandreqshëm.

Që nga organizimi i zgjedhjeve të para pas luftës në Kosovës ishte instaluar një demokraci minimaliste. Joseph Schumpeter e ka definuar demokracinë si metodë ose procedurë përmes të cilës zgjidhen politikanët për zyra publike.¹⁶⁶ Robert D. Putman, në anën tjetër, shkruante se “një qeveri e mirë është, sidoqoftë, më shumë sesa një forum i pikëpamjeve garuese ose një bord për ankese; në fakt [një qeveri e mirë] i bën gjërat. Një qeveri e mirë demokratike jo vetëm i merr në konsideratë kërkesat e qytetarëve të saj (përgjegjëse), por vepron në mënyrë efektive mbi këto kërkesa (efektive).”¹⁶⁷

¹⁶⁵ Fred Cocozzelli, ‘Between Democratisation and Democratic Consolidation: The Long Path to Democracy in Kosovo’, *Perspectives on European Politics and Society* (2013), 14:1, 1-19.

¹⁶⁶ Joseph Schumpeter, *Capitalism, Socialism and Democracy* (New York: Harper & Brothers, 1947), ff. 250-252

¹⁶⁷ Robert D. Putman, *Making Democracy Work: Civic Tradition in Modern Italy* (Princeton University Press, 1993), f. 63.

Sipas Fareed Zakaria-s, demokracia nuk duhet të barazohet vetëm me organizimin e zgjedhjeve, duke i konsideruar këto të fundit si kriter të pamjaftueshëm që një vend të konsiderohet demokraci liberale. Për Zakaria-n, ajo që në perëndim quhet demokraci liberale, nuk karakterizohet vetëm me zgjedhje të lira dhe fer, por edhe me ndarjen e pushteteve, mbrojtjeve e lirive bazike të fjalës, të tubimit, të besimit dhe të pronës.¹⁶⁸

Shumë studiues, gazetarë, analistë politikë e zyrtarë të lartë partiakë ndajnë mendime thuajse të përafërta për nivelin e demokratizimit të shoqërisë kosovare.¹⁶⁹ Kështu, për shembull, politologu Artan Mustafa argumenton se Kosova ka bërë hapa të suksesshëm të demokratizimit, siç janë mbajta e zgjedhjeve, shumësia e partive politike, e grupeve të interesit, paqja e përgjithshme, tregu i gjerë e i gjallë mediatik, forcimi i institucioneve, etj. Megjithatë, Mustafa kërkon më shumë se kaq: “Kosova ka nevojë për liri më domethënëse, përtej brengosjeve të sigurisë publike. Për këtë kërkohet [...] forcim i barazisë materiale ndërmjet klasave dhe gjinive”.¹⁷⁰ Ndërsa sociologu Gëzim Selaci argumenton se njëra prej pengesave në demokratizimin e Kosovës mbetet ndërhyrja e ndërkombëtarëve në proceset politike të brendshme në Kosovë. Siç shprehet Selaci: “Ka njëfarë paradoksi, sepse ne kemi krijuar këtë nivel të demokracisë që e kemi përmes ndërhyrjes ndërkombëtare, por në anën tjetër ka forma të ndërhyrjes ndërkombëtare të cilat po e pengojnë zhvillimin e demokracisë. Pra është krijuar njëfarë raporti i mbikëqyrjes dhe njëfarë lidhje më e madhe ndërmjet faktorëve të jashtëm dhe të brendshëm politikë sesa

¹⁶⁸ Fareed Zakaria, ‘The rise of illiberal democracy’, *Foreign Affairs*; Nov/Dec 1997; 76, 6; f. 22.

¹⁶⁹ Për zhvillimin e intervistave e falënderoj Arben Sylejmanin, gazetar dhe studiues i shkencës politike në Departamentin e Shkencës Politike.

¹⁷⁰ Intervistë me z. Artan Mustafa, politolog dhe gazetar, Prishtinë, 5 prill 2016.

një lidhje ndërmjet aktorëve politikë të brendshëm dhe qytetarëve”.¹⁷¹

Për politologun Bekim Baliqi procesi i demokratizimit në Kosovë nuk duhet të shikohet vetëm në rrafshin procedural. Baliqi mendon se pengesat për demokratizimin e mëtutjeshëm të Kosovës janë mungesa e sundimit të ligjit dhe mungesa e zhvillimit ekonomik. Sipas tij: “Mungesa e sundimit të ligjit i nënshton votuesit ndaj një sistemi klientelist. Kjo e sfidon demokratizimin e mëtutjeshëm të vendit.”¹⁷² Po ashtu, analisti Halil Matoshi argumenton se “demokracia në Kosovë është nominale[...], sepse atë e pengon fryma lideriste apo heriozimi i liderëve, klanet dhe ideologjia nacionaliste!”.¹⁷³

Politologu Agron Demi e ka klasifikuar Kosovën si demokraci joliberales, që e redukton gjithë procesin demokratik në mbajtjen e zgjedhjeve. Sipas tij, në Kosovë mungon një kulturë demokratike e qeverisjes, që nënkupton llogaridhënien, shtetin ligjor, lirinë e shprehjes etj.¹⁷⁴ Kurse për sociologun dhe analistin Dukagjin Gorani “demokracia në Kosovë është demokraci elektorale që nënkupton se demokracia është produkt i një angazhimi gati aritmetik të subjekteve politike. Kush fiton më shumë vota, realisht e merr pushtetin, dhe lufta e partive është reduktuar në interpretimin teknik të përkufizimit të demokracisë. Ai interpretim teknik e shndërron demokracinë kosovare në nivelin e demokracisë elektorale [...] Pra Kosova është një sistem i demokracisë elektorale që prodhon një raport klientelist mes pushtetit dhe qytetarit (votuesit). Njëra ndër pengesat e zhvillimit të demokracisë është eliminimi i mundësisë së

¹⁷¹ Intervistë me z. Gëzim Selaci, sociolog dhe ligjërues në Departamentin e Sociologjinë (Univesiteti i Prishtinës), Prishtinë, 6 prill 2016.

¹⁷² Intervistë me z. Bekim Baliqi, politolog dhe profesor në Departmanetin e Shkencës Politike Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 31 mars 2016.

¹⁷³ Intervistë me z. Halil Matoshi, analist, Prishtinë, 28 mars 2016.

¹⁷⁴ Intervistë me z. Agron Demi, politolog dhe Drejtor Ekzekutiv në institutin GAP, Prishtinë, 5 prill 2016.

deliberacionit ose asaj që Jurgen Habermas e quan demokraci deliberative”.¹⁷⁵

Në anën tjetër, zyrtarët e partive politike mendojnë se Kosova nuk e ka konsoliduar ende demokracinë e saj. Ata e kanë vlerësuar me cilësorë të ndryshëm demokracinë në Kosovë, si ‘demokraci embrionale’,¹⁷⁶ ‘demokraci e pakompletuar’,¹⁷⁷ ‘pjesërisht vend demokratik’,¹⁷⁸ ‘demokraci e brishtë’,¹⁷⁹ ‘jo plotësisht vend demokratik’.¹⁸⁰

Edhe në zgjedhjet e para të organizuara pas pavarësisë së Kosovës, prioriteti themelor i partnerëve ndërkombëtarë mbeti stabiliteti. Kësaj, preferencat e tyre ishin të qarta që qeveria, e cila do të formohej pas këtyre zgjedhjeve, të gëzonte përkrahje domethënëse në Kuvendin e Kosovës, në mënyrë që të menaxhoheshin ‘temat e mëdha’ si: bashkërendimi i përpjekjeve për marrjen e njohjeve të reja ndërkombëtare për Kosovën dhe normalizimi i marrëdhënieve Kosovë-Serbi. PDK-ja, për të dytën herë, ndërtoi një koalicion pas zgjedhor me LDK-në.

Koalicioni paraprak PDK-LDK kishte menaxhuar transicionin politik deri në shpalljen e pavarësisë së Kosovës. Njëri prej shqetësimeve kryesore të kësaj kohe ishte frika se serbët e mbetur do të mund të largoheshin nga Kosova pas shpalljes së pavarësisë, ngjashëm siç kishin bërë në rastin e Sarajevës, ku pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Dejtonit, udhëheqësit ekstremistë serbë u kishin

¹⁷⁵ Intervistë me z. Dukagjin Gorani, sociolog dhe analist (intervista është realizuar në cilësinë e analistit dhe sociologut, para se ai të aderonte në Lëvizjen Vetëvendosje), Prishtinë, 5 prill 2016.

¹⁷⁶ Intervistë me z. Glauk Konjufca, Lëvizja Vetëvendosje, Prishtinë, 1 prill 2016.

¹⁷⁷ Intervistë me Basri Musmurati, Partia Demokratike e Kosovës, Prishtinë, 31 mars 2016.

¹⁷⁸ Intervistë me znj. Ajnishale Halimi, ish-anëtare e Lëvizjes Vetëvendosje, tash anëtare e PDK-së, Prishtinë, 22 maj 2016.

¹⁷⁹ Intervistë me z. Shpejtim Bulliqi, Lidhja Demokratike Kosovës, Prishtinë, 1 prill 2016.

¹⁸⁰ Intervistë me z. Ali Berisha, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Prishtinë, 7 prill 2016.

bërë thirrje serbëve lokalë ta lëshonin Sarajevën, e cila sipas Marrëveshjes së Dejtonit do t'i takonte Federatës Bosniake.¹⁸¹ Një veprim i ngjashëm do të dëmtonte shumë legjitimitetin dhe njohjet e menjëhershme të shtetit të saposhpallur të Kosovës. Sidoqoftë, ky skenar nuk ishte zbatuar në Kosovë. Koalicionit qeverisës mes PDK-së dhe LDK-së, i ra edhe barra e bashkërendimit të lobimit për marrjen e njohjeve të para, si dhe për përgatitjen e mendimit dhe mbrojtjen ligjore të deklaratës së pavarësisë së Kosovës para Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, e cila ishte kontestuar nga Serbia në këtë gjykatë. Kjo e fundit, me 10 shtator 2010 nxori opinionin se deklarata e shpalljes së pavarësisë nuk kishte shkelur të drejtën ndërkombëtare.

Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, një antagonizëm dhe përplasje politike mes PDK-së dhe LDK-së kishin filluar të dilnin në sipërfaqe. Fillet e çarjes së këtij koalicioni ndoshta mund të kërkohej tek e ashtuquajtura afera 'Zanzi Bar'. Kjo aferë e ka marrë emrin e nga një lokal nate me të njëjtin emër në Prishtinë. Ky lokal gjendet afër zyrave qendrore të PDK-së dhe në të, natën e 15 nëntorit 2009, figura të larta të PDK-së e kishin shpallur të përfunduar koalicionin me LDK-në. Ironikisht, të nesërmen, zyrtarë nga PDK-ja e kishin demantuar këtë lajm. Kumbi prej PDK-së për prishjen e koalicionit nga bodrumi i një lokali nate ishte hap krejtësisht i pamenduar dhe jo-institucional për disa arsye. Së pari, sepse Presidenti i Kosovës që vinte nga LDK-ja kishte mandat 5-vjeçar dhe shkarkimi potencial i tij do të mund të bëhej me 2/3 e votave të të gjithë deputetëve, të cilat PDK-ja nuk i posedonte. E dyta, arsyet për shkarkimin e Presidentit të Kosovës do të duhej të ishin kushtetuese, që nënkuptonte dënimin për kryerjen e ndonjë krimi të rëndë, paaftësinë për të ushtruar përgjegjësinë e postit të

¹⁸¹ Grupi Ndërkombëtar i Krizave, 'Udhëzime për Kosovën (I) Shqyrtimi i Statusit Përfundimtar' (Raporti 125 i ICG-së për Ballkanin, 1 mars 2002), f. 6.

Presidentit, ose ndonjë sëmundje të rëndë.¹⁸² Së treti, votëbesimin e Qeverisë mund ta kërkonte Kryeministri Thaçi nga salla e Kuvendit të Kosovës jo më vonë se 5 ditë nga dita e parashtrimit të tij, dhe jo nga bodrumet e lokaleve të natës. Ky incident, në fakt tregonte natyrën e brishtë dhe jostabile të këtij koalicioni.

Nëntë muaj më vonë, koalicioni LDK-PDK u shpërbë, pasi një grup prej 31 deputetësh, të udhëhequr nga Naim Rustemi, ish-deputet i PDK-së dhe më vonë deputet i pavarur, kishin ngritur një çështje që kishte të bënte me pozicionet e Presidentit të shtetit, i cili ushtronte njëkohësisht edhe pozitën e Kryetarit të LDK-së. Koalicioni mes Partisë Demokratike (PDK-së) dhe Lidhjes Demokratike (LDK-së) hyri në rrugë qorre kur Gjykata Kushtetuese e Kosovës konstatoi se Kryetari i LDK-së, njëherësh President i Republikës së Kosovës, kishte bërë shkelje të rëndë kushtetuese duke mbajtur njëkohësisht të dyja postet.¹⁸³ Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese i shtatorit 2010, kërkonte nga Presidenti i vendit të zgjidhte njërën prej këtyre pozitave. Presidenti i Kosovës, Fatmir Sejdiu, dha dorëheqje nga pozita e Presidentit, duke e mbajtur atë të kryetarit të partisë të LDK-së. Kriza do të mund të evitohej lehtë nëse, pas Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, Fatmir Sejdiu do të mbante pozitën e Presidentit të Shtetit, jo duke e ‘ngrirë’ pozitën e Kryetarit të LDK-së, por duke dhënë plotësisht dorëheqje nga kjo pozitë me shkrim dhe duke hapur kështu mundësinë për zgjedhje të brendshme në LDK. Dy muaj më vonë, në Konventën Zgjedhore që organizoi LDK-ja, Fatmir Sejdiu humbi edhe pozitën e dytë – atë të kryetarit të LDK-së, karshi kandidatit tjetër për kryetar, Isa Musfatës.

¹⁸² Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 91 [Shkarkimi i Presidentit].

¹⁸³ Gjykata Kushtetuese e Kosovës, ‘Judgment Case No. KI 47/10 Naim Rustemi and 31 other Deputies of the Assembly of the Republic of Kosovo vs. his Excellency, Fatmir Sejdiu, President of the Republic of Kosovo. Qasur në http://www.gjk-ks.org/repository/docs/ki_47_10_eng_2.pdf (11 janar 2015).

Duke gjetur si shkas mosprivatizimin e Postës dhe Telekomit të Kosovës, që partneri tjetër i koalicionit e kishte vendosur në agjendën e Kuvendit, në tetor 2010, LDK-ja doli nga koalicioni me PDK-në. Kjo realisht nuk ishte arsyeja e vërtetë e zhbërjes së koalicionit. Meqenëse LDK-ja kishte konsumuar 3 vjet mandat në koalicion me PDK-në, LDK-ja taktizoi duke u distancuar nga PDK-ja dhe duke u bërë gati për zgjedhjet e parakohshme. Edhe pse LDK-ja kishte ndjekur një taktikë krejtësisht pragmatike duke u distancuar nga PDK-ja për t'i konkurruar kësaj në zgjedhjet e ardhshme, braktisja e zyrave të Qeverisë nga ministrat e LDK-së, pa e kaluar transicionin dhe pranim-dorëzimin tek ministrat që do të mund të vinin si rezultat i një procesi të ri zgjedhor, në aspektin e stabilitetit institucional dhe obligimeve ndërkombëtare që kishte Kosova, ishte një politikë krejtësisht joinstitucionaliste, krejt ndryshe nga politika që pretendon se promovon LDK-ja.

PDK-ja dëshironte zgjedhje të shpejta dhe të jashtëzakonshme, në mënyrë që ta zvogëlonte mundësinë e organizimit të kundërshtarit kryesor të saj, LDK-së, për zgjedhje. Pas kërkesës së Aleancës Kosova e Re për votën e mosbesimit ndaj qeverisë së PDK-së, Kryetari i Kuvendit të Kosovës shpalli zgjedhjet e reja të jashtëzakonshme. Anketa e opinionit publik 'Pulsi Publik' e nëntorit 2010 tregon se të anketuarit fajësonin gati në mënyrë të barabartë si PDK-në ashtu edhe LDK-në për këtë krizë politike që e shpuri Kosovën në zgjedhje të jashtëzakonshme: 30% e të anketuarve kishin fajësuar PDK-në kurse 28% LDK-në. Të dhënat e anketës tregonin se 50% e qytetarëve, pavarësisht prej vendbanimit ose etnisë, ishin në gjendje t'u bashkoheshin protestave që kanë karakter politik, kurse 72% e qytetarëve nuk ishin të kënaqur me drejtimin ekonomik të Kosovës.¹⁸⁴ Përkundër këtij shqetësimi publik për gjendjen politike dhe ekonomike të Kosovës, protestat masive në Kosovë nuk do të merrnin formë konkrete deri më 2014. Madje edhe

¹⁸⁴ UNDP dhe USAID, 'Pulsi Publik', Raporti 1. Mars 2011, Prishtinë.

kur u organizuan, protestat nuk patën këto kauza, por krejt të tjera, dhe nuk u organizuan nga shoqëria civile a qytetarët, por nga vetë partitë politike opozitare, që në një a formë a tjetër ishin bashkëpërgjegjëse për kulturën e mosllogaridhënies dhe të keqqeverisjes nga viti 2000 e këndej.

Zgjedhjet e vitit 2010 ishin zgjedhjet e para të përgjithshme të organizuara nga institucionet vendore pas pavarësimit të Kosovës. Në to, PDK-ja kishte arritur të fitonte 224.339 vota dhe 34 ulëse, LDK-ja 172.552 vota dhe 27 ulëse, VV-ja 88.652 vota dhe 14 ulëse, AAK-ja kishte marrë votën më të madhe në krahasim me të gjitha zgjedhjet e përgjithshme, respektivisht 77.130 vota dhe 12 ulëse, kurse Koalicioni AKR-PD-PSD-PPI-PPK-PNDSh-PGjK, i udhëhequr nga Aleanca Kosova e Re (AKR) e Behgjet Pacollit, kishte fituar 50.951 vota, 8 ulëse. PDK-ja formoi qeverinë së bashku me koalicionin e partive të vogla të drejtuara nga AKR-ja. Sipas marrëveshjes, Hashim Thaçi mori sërish pozitën e Kryeministrit, AKR-ja atë të Presidentit të Kosovës, kurse pozitë ministore u ndanë sipas fuqive të tyre politike.

ENEMO, një rrjet i organizatave evropiane që monitoroi zgjedhjet, kishte konstatuar se ato ishin shoqëruar me probleme serioze.¹⁸⁵ Christopher Dell, në atë kohë Ambasador i ShBA-së i akredituar në Kosovë, i kishte cilësuar zgjedhjet e vitit 2010 si “të manipuluar në mënyrë industriale”. Përkundër faktit se shoqëria civile u angazhua fuqishëm me 5000 vëzhgues që t’i monitoronte zgjedhjet, partitë politike ishin organizuar edhe më fort që t’i manipulonin dhe ta dëmtonin integritetin e votimit. Shkalla e deformimit dhe e manipulimit të votave ishte aq e lartë sa Komisioni

¹⁸⁵ European Union Election Expert Mission to Kosovo, ‘Final Report’, 25 January 2011, f. 60.

Qendror Zgjedhor u detyrua t'i riorganizonte zgjedhjet në disa komuna.¹⁸⁶

Po ashtu, zgjedhjet u monitoruan edhe nga 'Demokracia në Veprim', një rrjet kosovar i organizatave për monitorimin e zgjedhjeve. Faji për manipulimin e zgjedhjeve u ishte faturuar pikërisht komisionarëve të partive politike, të cilët duhej ta mirëmbanin procesin zgjedhor në vendvotime. Siç vëren një studim i KIPRED-it:

Si pasojë e keqpërdorimeve të shumta, Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) kishte pranuar gjithsej 454 ankesa të cilat ndërlidheshin me parregullsi dhe manipulimin e zgjedhjeve të mbajtura në dhjetor 2010 dhe rivotimit në janar 2011. Disa nga këto ankesa kanë bërë që KQZ pas vendimeve të PZAP-it të vendosë për rizgjedhje në Skenderaj, Drenas dhe Deçan, dhe në dy vendvotime, njëri në Lipjan dhe tjetri në Malishevë.¹⁸⁷

Deformimi i rezultateve zgjedhore, nxitja, frikësimi dhe kërcënimi i qytetarëve nga subjektet politike për të votuar një subjekt politik pa vullnetin e tyre, si dhe kërcënimi dhe frikësimi ndërmjet subjekteve politike është i ndaluar me ligj. Ligji për Zgjedhje të Përgjithshme në Kosovë rregullon Kodin e Mirësjelljes së Subjekteve Politike. Në mesin e veprimeve të ndaluara të subjekteve politike, neni 33 i këtij ligji, pos të tjerash, i ndalon veprimet e subjekteve politike si: “premtimi i ndonjë shpërblimi financiar me qëllim të përfitimit të mbështetjes së votuesve”, “kërcënimi apo tentimi për të kërcënuar subjektet e tjera politike”, “nxitja e cilitdo person për të votuar në

¹⁸⁶ Shih KIPRED, 'Shkaqet dhe shkasat e krizës institucionale në Kosovë', Analizë Politike 2010/6, Prishnë, nëntor 2010; KIPRED, 'Zgjedhjet Parlamentare në Kosovë 2010: Vështrim i përgjithshëm dhe trendet', Prishtinë, prill 2011.

¹⁸⁷ KIPRED, 'Krimet e Zgjedhjeve: Analizë e ndjekjes penale dhe gjykimit të rasteve të krimeve të zgjedhjeve në Kosovë'. Prishtinë, tetor 2011, f. 6.

zgjedhje, i cili nuk ka të drejtë vote”, “nxitja e personit për të votuar më shumë se një herë në të njëjtat zgjedhje ose për të votuar në emër të një personi tjetër”,¹⁸⁸ etj. Përkundër rregullimit të mirësjelljes së veprimeve të subjekteve politike në procesin zgjedhor, në zgjedhjet e vitit 2010 u manipuluan 890 vendvotime.

Sa më shumë që institucionet e Kosovës pavarësoheshin nga OSBE-ja dhe merrnin obligime për t’i menaxhuar vetë zgjedhjet, aq më shumë rritej trendi i manipulimit të zgjedhjeve. Një vit para pavarësisë së Kosovës, OSBE-ja kishte filluar t’i bartte gradualisht kompetencat për organizimin e zgjedhjeve tek institucionet e Kosovës. Në zgjedhjet e përgjithshme dhe ato lokale, të mbajtura njëkohësisht më 2007 – edhe pse u vlerësuan si ‘zgjedhje me standarde ndërkombëtare’ – u raportuan shkelje dhe Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa dorëzoi mbi 100 dosje te Prokurori i Shtetit. Ky i fundit megjithatë nuk i trajtoi këto raste me prioritet, duke e ndjekur një politikë të heshtur të mosndëshkimit.

Adam Przeworski e ka definuar demokracinë si sistem të institucionalizuar të pasigurisë.¹⁸⁹ Sipas këtij përkufizimi, askush

¹⁸⁸ Ligji për Zgjedhje të Përgjithshme, Kreu V, Neni 33: Veprimet e Ndalura të Subjekteve Politike: Pos të tjerash, d) çrregullimi i tubimeve të subjekteve tjera politike ose nxitja e të tjerëve për një veprim të tillë; e) pengimi ose tentimi për pengimin e gazetarëve për të përmbushur detyrat e tyre profesionale; f) premtimi i ndonjë shpërblimi financiar me qëllim të përfitimit të mbështetjes së votuesve; (g) kërcënimi ose tentimi për të kërcënuar subjektet tjera politike, përkrahësit ose kandidatët e tyre; h) nxitja e cilitdo person për të votuar në zgjedhje, i cili nuk ka të drejtë vote; j) nxitja e personit për të votuar më shumë se një herë në të njëjtat zgjedhje ose për të votuar në emër të një personi tjetër; k) abuzimi me të drejtën e ankesës, ose duke bërë ankesa ose paraqitje të rrejshme, të pavlera dhe irrituese në KZAP; l) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës m) për qëllime të promovimit të subjektit politik ose kandidatëve të tij duke përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo lloj materiali që i referohet personit i cili: (i) është në vuajtje të dënimit të shqiptuar nga Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë; ose (ii) ka padi të ngritur nga Tribunali dhe i cili nuk i është përmbajtur urdhrit për t’u paraqitur para Tribunalit.

¹⁸⁹ Adam Przeworski, ‘Democracy as the contingent outcome of conflicts’, në J. Elster & R. Slagstad (eds.), *Constitutionalism and Democracy*, (Cambridge, UK: Cambridge University Press, 1988), f. 59-80.

nuk është i sigurt në fitore. Rezultatet zgjedhore nuk janë të paracaktuara dhe mekanizmat zgjedhorë u japin shanse të gjithëve. Politikanët dhe partitë politike që dëshirojnë ta minimizojnë këtë pasiguri, që është pjesë esenciale e zgjedhjeve demokratike, synojnë të mbërrijnë rezultate pozitive duke manipuluar sistemin zgjedhor. Kjo sjellje e keqe elektorale e shkatërron mekanizmin brenda të cilit funksionon demokracia – votimi i fshehtë, i ndershëm dhe pa presion. Sarah Birch argumenton se politikanët shpeshherë rrezikojnë humbjen e legjitimitetit duke u angazhuar në manipulime zgjedhore, duke qenë të sigurt se manipulimet do të shpërblehen me rezultate të mira. Sjelljet e këqija elektorale përfshijnë një varg aktivitete, duke filluar nga përdorimi i taktikave të pandershme në fushata zgjedhore, pengimi i votimit në ditën e zgjedhjeve (p.sh. duke e hequr një kuti votuese nga një pikë votimi), presioni ndaj votuesve, korrupsioni etj.¹⁹⁰

Ka disa arsye pse u manipuluan në mënyrë masive zgjedhjet e përgjithshme të dhjetorit 2010. Së pari, në këto zgjedhje, gara politike u komplikua me pjesëmarrjen e Lëvizjes Vetëvendosje në zgjedhje. Prezenca e VV-së në garë, si një formacion politik shumë dinamik, rriti pasigurinë e partive të tjera politike, në veçanti të PDK-së dhe të LDK-së. Së dyti, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës kishte ndërtuar një listë të përbashkët zgjedhore me disa figura që kishin dalë nga LDK-ja, të udhëhequr nga Ukë Rugova, djali i ish-Presidentit të Kosovës. Siç do të tregojnë edhe rezultatet, AAK-ja, në këto palë zgjedhje, mori rezultatet më të mira zgjedhore që nga themelimi i saj. Së treti, në LDK, pas dorëheqjes nga pozita e Presidentit të shtetit dhe Kryetarit të LDK-së, Fatmir Sejdiu, LDK-ja, një muaj para zgjedhjeve, mbajti Konventën Zgjedhore, dhe zgjodhi një Kryetari të ri, Isa Mustafën. Ky i fundit kishte adresuar kritika të vazhdueshme ndaj PDK-së dhe Hashim Thaçit, sidomos në

¹⁹⁰ Sarah Birch, 'Electoral Systems and Electoral Misconduct', *Comparative Political Studies*, Vol.40, 2007, f. 5.

aspektin e korrupsionit dhe të krimit të organizuar. PDK-ja i frikësohej një momentumit potencial të ri në LDK-së me Kryetarin e ri. Duke i pasur parasysh këta faktorë të pasigurisë prej humbjes së pushtetit e me këtë edhe të mundësisë së dominimit të sferës publike, PDK-ja, duke qenë në qeverisje, më së shumti interesohej ta zvogëlonte këtë paparashikueshmëri, duke u përfshirë në manipulime masive të votave. Të njëjtën gjë ishin të interesuara ta bënin, edhe pse me intensitet më të ulët, edhe partitë e tjera me përvojë të udhëheqjes, qoftë LDK-ja ose partitë e tjera më të vogla.

5.1 Reforma zgjedhore antikushtetuese në Kosovë

Pas zgjedhjeve të jashtëzakonshme më 2010¹⁹¹ – ndonëse legjitimiteti dhe integriteti i tyre u kontestuan gjerësisht – PDK-ja si fituese e zgjedhjeve ndërtoi një koalicion me AKR-në e Behgjet Pacollit dhe partitë e pakicave. Sipas marrëveshjes, pozita e Kryeministrit iu dha PDK-së, kurse ajo e Presidentit AKR-së. Më 22 shkurt 2011, Kuvendi i Kosovës zgjodhi Behgjet Pacollin në postin e Presidentit të Kosovës. Zgjedhja e Pacollit u kontestua menjëherë. Sabri Hamiti, së bashku me një grup deputetësh, më 1 mars 2011 kontestuan në Gjykatën Kushtetuese procedurën e zgjedhjes së Pacollit dhe vendimin e Kuvendit të Kosovës Nr. 04-V. Gjykata Kushtetuese më 30 mars 2011 gjeti se zgjedhja e Pacollit proceduralisht ishte bërë në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës. Aktgjykimi i saj pohonte se ishin shkelur procedurat gjatë zgjedhjes së Pacollit në pozitën e Presidentit të vendit.¹⁹²

¹⁹¹ Në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2010 ishin certifikuar 55 subjekte politike: 23 shqiptare, 11 serbe, dhe 21 të pakicave të tjera.

¹⁹² Në rastin e zgjedhjes së Pacollit, sipas aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, mungonte kuorumi prej (2/3) të votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit (80

Që të nesërmen pas këtij aktgjykimi, Gjykata Kushtetuese i mori disa kërkesa për sqarime nga tri institucione: Kryetari i Kuvendit, Zyra e Presidentit të Kosovës dhe Qeveria e Kosovës. Pyetjet kërkonin sqarimin nëse vendi duhet të shkonte në zgjedhje të reja ose jo, nëse vendi kishte ushtrues detyre të Presidentit, nëse kishte vakuum institucional, etj. Gjykata Kushtetuese, në sqarimin e saj pohonte se aktgjykimi hynte në fuqi nga data e publikimit me 31 mars 2011, që në terma teknikë nënkuptonte se Behgjet Pacolli kishte qenë President i Kosovës që nga data 22 shkurt. Në lidhje me shpalljen e zgjedhjeve të reja, ajo sqaronte se vendimi i saj nuk e impononte një gjë të tillë dhe se nga data e publikimit të vendimit, Kosova kishte ushtrues të detyrës të Presidentit.¹⁹³

Pas zgjedhjeve thellësisht të manipuluar të vitit 2010, me ndërmjetësimin e ish-ambasadorit amerikan z. Christopher Dell, në prill 2011 tre liderët e partive më të mëdha politike, Hashim Thaçi, Isa Mustafa dhe Behgjet Pacolli, nënshkruan një marrëveshje 5-pikëshe. Në pikën e parë, liderët emëronin znj. Atifete Jahjaga për Presidente të Republikës së Kosovës. Në pikën e dytë, pajtoheshin që të formonin një Komision për Reformën e Zgjedhjeve Presidenciale. Në pikën e tretë, parashihej formimi i një Komisioni

deputetë). Mungesa e kuorumit e pamundësonte procedimin e votimit për President. Në rundin e tretë, Pacolli u zgjodh me 62 vota nga 65 sa ishin të pranishëm në sallë, ndonëse para se të fillonte rundi i parë, në sallë ishin të pranishëm 81 deputetë, 4 prej të cilëve ishin larguar në rundin e dytë dhe 2 të tjerë në raundin e tretë. Neni 86 i Kushtetutës së Kosovës, gjatë procedurës së votimit për President, kërkon kandidimin e të paktën dy kandidatëve. Shih Gjykata Kushtetuese, 'Rasti Nr. Ko 29/11 Parashtues Sabri Hamiti dhe deputetë të tjerë të Kuvendit të Kosovës Nr. 04-V-04 Lidhur me zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës të 22 shkurtit 2011'. Nr. ref: OM 108/11, 30 MARS 2011, Prishtinë. Qasur në http://www.gjk-ks.org/repository/docs/ko_29_11_agj_om_shq.pdf (19 prill 2016).

¹⁹³ Shih Gjykata Kushtetuese, 'Sqarim i Aktgjykimi në Rastin Nr. KO 29/11 Sabri Hamiti dhe deputetë e tjerë: Vlerësimi i kushtetutshmërisë të Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Nr. 04-V-04, të 22 shkurtit 2011, lidhur me zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës', Prishtinë, më 1 prill 2011, Nr. Ref. SQ 111/11. Shih http://www.gjk-ks.org/repository/docs/aktgjykimi_ko_29_11_shq.pdf (Qasur më 19 prill 2016).

për Reformën e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, kurse në pikën e katërt dhe të pestë, parashihej reformimi i Ligjit për Zgjedhje të Përgjithshme dhe organizimi i zgjedhjeve 18 muaj pas ditës kur këto amendamente do të hynin në fuqi.¹⁹⁴ Duke qenë se kjo marrëveshje për nominimin e znj. Atifete Jahjaga ishte menaxhuar nga ish-ambasadori amerikan, Christopher Dell, Lëvizja Vetëvendosje e kritikoi atë, duke theksuar se marrëveshja ishte provë e ‘Dellokracisë’ në Kosovë.¹⁹⁵

Më pas kjo marrëveshje politike u konkretizua në Kuvendin e Kosovës përmes një rezolute të datës 7 prill 2011. Po të njëjtën ditë me miratimin e kësaj saj, Atifete Jahjaga u zgjodh Presidente e Kosovës me 80 vota. Sipas rezolutës, propozohej ndryshimi i legjislacionit të zgjedhjeve, në mënyrë që Presidenti i Kosovës të zgjidhej drejtpërdrejt nga populli. Sipas marrëveshjes së liderëve partiakë, zgjedhjet presidenciale do të organizoheshin jo më vonë se gjashtë muaj nga data në të cilën ndryshimet e nevojshme kushtetuese dhe legjislative do të hynin në fuqi. Në mënyrë që ndryshimet ligjore të fillonin menjëherë, Kuvendi mbështeti themelimin e një komisioni për reforma, i cili do të udhëhiqej nga opozita dhe do ta kryente punën e vet nga 6 deri në 9 muaj prej datës së themelimit. Pika 3 e rezolutës përmban thelbin e saj:

Kuvendi i Republikës së Kosovës mbështet zotimet dhe afatet kohore të përmbajtura në Memorandum që kanë të bëjnë me nevojën për amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe legjislacionit të ndërlidhur, që mes të tjerash do të përkrahin krijimin e më shumë distrikteve zgjedhore në

¹⁹⁴ Shih marrëveshjen e liderëve të partive politike në Kosovë për reformën zgjedhore, D4D, ‘Deforma Zgjedhore: Dy vite pas, reforma në pikën zero’. Seria 5, Zgjedhjet. Prishtinë, shtator 2013, f. 45.

¹⁹⁵ Petrit Collaku, ‘Kosovo Elects New President’, Balkan Insight, 7 prill 2011. Qasur në <http://www.balkaninsight.com/en/article/kosovo-elects-new-president> (12 qershor 2016).

Kosovë.¹⁹⁶

Sipas marrëveshjes politike të liderëve politikë të Kosovës, Jahjaga do të duhej të shërbente në pozitën e Presidentes së vendit për vetëm 9 muaj, derisa të përfundonin reformat kushtetuese dhe zgjedhore. Më 23 mars 2012 dhe, më pas, më 4 maj 2012, Kryetari i Kuvendit i kishte dërguar Gjykatës Kushtetuese amendamentet e propozuara për reformë kushtetuese dhe zgjedhore, për të vlerësuar nëse këto i pakësonin liritë dhe të drejtat e njeriut. Gjykata Kushtetuese në aktgjykimin e saj iu referua marrëveshjes politike të liderëve politikë, sipas të cilës Presidenti i Kosovës do të zgjidhej në mënyrë të drejtpërdrejtë nga populli, pas reformimit të Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme. Në një vendim të gjatë, preciz e të argumentuar mirë prej 67 faqesh, Gjykata Kushtetuese konstatoi se amendamentet e propozuara pakësonin të drejtat dhe liritë e njeriut, veçanërisht neni i ri i propozuar (162.1) “në lidhje me ndërprerjen e parakohshme të mandatit të Presidentit të Republikës së Kosovës”.¹⁹⁷ Me fjalë të tjera, Gjykata Kushtetuese e Kosovës konstatoi se reforma kushtetuese nuk mund ta prekte mandatin e plotë 5-vjeçar të Presidentes Jahjaga.

Në fakt, problematike në gjithë këtë proces ishin premiset mbi të cilat ndërtohej reforma zgjedhore. Manipulimet masive të votave në zgjedhjet e vitit 2010 nuk kishin të bënin fare me formën e zgjedhjes së Presidentit të Kosovës. Koncentrimi në formën e

¹⁹⁶ Kuvendi i Kosovës, ‘Rezolutë në mbështetje të Memorandumit të marrëveshjes ndërmjet Behgjet Pacolli, Isa Mustafa dhe Hashim Thaçi. Nr. 04-R-01, Prishtinë, 7 prill 2011. Qasur në <http://elibraria.org/assets/Rezoluta-Marreveshja.pdf> (10 janar 2014).

¹⁹⁷ Gjykata Kushtetuese ‘Aktgjykim në Rastet K.O.29/12 dhe K.O. 488/12 Amendametet e propozuara kushtetuese, të dorëzuara nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës më 23 mars 2012 dhe 4 maj 2012’. Shih http://www.gjk-ks.org/repository/docs/Aktgjykim%20KO29_48_12_Anex%20A%20&%20B_SH Q.pdf (9 qershor 2015).

¹⁹⁷ Tanjug, ‘EU dissatisfied with electoral reform in Kosovo’, 20 April 2012. Qasur në http://www.b92.net/eng/news/politics.php?yyyy=2012&mm=04&dd=20&nav_id=79861

zgjedhjes së Presidentit, dhe jo në reformën substanciale të Ligjit për Zgjedhje të Përgjithshme, tregon më së miri për mungesën e gatishmërisë së liderëve dhe të partive kryesore në Kosovë për reformimin e sistemit zgjedhor. Puna e Komisionit për reformimin e sistemit zgjedhor ishte pamundësuar pikërisht nga partitë politike që shfaqeshin si bartëse të reformave. Në momentin kur po shkruhet ky studim bëhen gjashtë vjet nga koha kur liderët e partive politike kishin nënshkruar një marrëveshje për fillimin e reformave zgjedhore dhe kushtetuese, por deri më tani, nuk është arritur asnjë rezultat i matshëm. Përfaqësuesi Special i BE-së në Kosovë, Samuel Zbogar, kishte shprehur zhgënjimin me partitë politike në Kosovë për shkak të mungesës së progresit lidhur me reformën zgjedhore. Instituti D4D ka vërejtur se “partitë e mëdha nuk janë të interesuara për të gjetur zgjidhje për manipulimet ‘industriale’ të votës së lirë, sepse tashmë e kanë përpunuar sistemin vetanak për të qenë pjesë e kësaj industrie manipuluese dhe nuk shohin forca të tjera që do ta trazonin këtë situatë”.¹⁹⁸

Një memo e Zyrës së Bashkimit Evropian dhe e shteteve anëtare në Prishtinë dërguar liderëve të partive politike në Kosovë, përmbante hartën e principeve nga duhej lëvizur për ta hartuar reformën zgjedhore, paralelisht me organizimin e zgjedhjeve lokale në Kosovë, që do të mbaheshin në nëntor 2013. Memorandumi i BE-së, drejtuar zyrtarëve të partive politike rreth reformës zgjedhore, përmbante 5 parime ku përfshihej bashkëpunimi me shoqërinë civile dhe hisedarët e tjerë, transparenca dhe thjeshtësia e sistemit zgjedhor, si dhe përfaqësimi i pakicave dhe i grave. Në mënyrë që të realizoheshin këto parime, në memo u skicuan, mes të tjerash, këto rekomandime:

¹⁹⁸ D4D, ‘Deforma Zgjedhore: Dy vite pas, reforma në pikën zero’. Seria 5, Zgjedhjet. Prishtinë, shtator 2013, f. 9.

1. Zvogëlimi në minimum i numrit të votave preferenciale. Është e preferueshme që votuesit të kenë një preferencë të vetme për një kandidat/e. Kjo do të mundësonte që trupat menaxhues të votave të numërojnë me shpejt votat dhe të zvogëlojnë mundësitë e keqpërdorimeve brendapartiake;
2. Pragu zgjedhor nuk duhet të aplikohet tek partitë që përfaqësojnë komunitetet pakicë;
3. Eliminimi i votave me kusht për të gjitha zgjedhjet, për shkak të potencialit se votat me kusht mund të manipulohen;
4. Qartësimi se cilat dokumente janë të pranueshme për të votuar;
5. Zëvendësoj ngjyrën e padukshme me ngjyrën e dukshme;
6. Heq sanksionet kolektive;
7. Bëj procesin e ankesave më transparent, duke i bërë ankesat publike. Zgjas afatin për dorëzimin e ankesave;
8. Vazhdoj praktikën e numërimit të votave në qendrat e votimit dhe në ndonjë vend të centralizuar.¹⁹⁹

Në Kosovë, listat e votuesve vazhdojnë të jenë të papërditësuara. Rregullat zgjedhore nuk janë të precizuara mirë. Vakuumi ligjor ka të bëjë me faktin se Ligji për Zgjedhje të Përgjithshme nuk rregullon në detaje procesin zgjedhor dhe mungojnë udhëzime për implementimin e këtij ligji. Po ashtu, përbërja e KQZ-së vazhdon të jetë problematike. KQZ-ja përbëhet prej 10 anëtarëve, 6 anëtarë nga grupimet kryesore politike shqiptare dhe 4 nga anëtarët e grupimeve të pakicave, të cilat në vazhdimësi kanë votuar sipas preferencave të koalicionit qeveritar, duke mundësuar kështu mbivotimin në KQZ.

¹⁹⁹ Shih Memorandumi i Zyrës së BE-së në Kosovë dërguar liderëve politikë në Kosovë, 'Memo to Party Leaders on Kosovo's Electoral Reform Process from the EUSR/Head of European Union Office and EU Member States represented in Pristina'. Shih <http://elibraria.org/assets/General-Principles-for-Electoral-Reform.pdf> (12 janar 2014).

Drejtorët e shkollave, si menaxherë të qendrave të votimit, vazhdojnë të luajnë një rol vendimtar edhe në ditën e zgjedhjeve. Duke marrë parasysh faktin se një pjesë e madhe e drejtorëve të shkollave janë anëtarë partiakë dhe shpeshherë të rekrutuar në ato pozita nga partitë në pushtet, menaxhimi i këtyre vendvotimeve nga këta drejtorë pamundëson një proces zgjedhor fer dhe neutral. Po ashtu, fotografimi i votës, i cili hedh dyshime mbi korrupsion ose blerje të votave, është një fenomen i përhapur në përmasa shqetësuese në Kosovë, ndonëse fotografimi i votës është i ndaluar me ligj. Votimi për tjetrin, votimi grupor, ku anëtarët e familjes futen së bashku tek kutia e votimit, që ndodh në shumë qendra të votimit dhe veçanërisht në pjesët periferike, është po ashtu në kundërshtim me rregullat e zgjedhjeve.²⁰⁰ Këto dhe probleme të tjera nuk janë adresuar në mënyrë efektive ende nga gjykatat, prokuroritë, dhe as nga partitë politike.

5.2 Pse partitë politike pranojnë ndryshimin e rregullave zgjedhore?

Nëse i qëndrojmë besnikë përkufizimit të sistemit zgjedhor si një mekanizëm përmes së cilit votat e hedhura përkthehen në ulëse në Kuvend, në Kosovë ende nuk është zhvilluar një debat i njëmendtë rreth asaj se çfarë sistemi zgjedhor i përshtatet më së miri rrethanave socio-politike të Kosovës. Sistemi zgjedhor proporcional është imponuar nga UNMIK-u. Pas shpalljes së pavarësisë, në përputhje me Planin e Ahtisaarit, sistemi zgjedhor ishte përbrendësuar fillimisht në këtë plan dhe, më pastaj, në Kushtetutën e Kosovës si

²⁰⁰ Memorandumi i Zyrës së BE-së në Kosovë dërguar liderëve politikë në Kosovë, 'Memo to Party Leaders on Kosovo's Electoral Reform Process from the EUSR/Head of European Union Office and EU Member States represented in Pristina'. Shih <http://elibraria.org/assets/General-Principles-for-Electoral-Reform.pdf> (12 janar 2014).

një instrument për përfaqësimin e pakicave dhe të grave në shoqërinë kosovare. Deri më tani, debati rreth reformës zgjedhore në Kosovë më shumë ka qenë i fokusuar në ndryshimin e rregullave zgjedhore, sesa të vetë sistemin zgjedhor. Pjesë e këtij debati kanë qenë struktura e fletëvotimit, ndarja e Kosovës në zona zgjedhore dhe pragu zgjedhor, por jo edhe formula zgjedhore përmes së cilës votat e hedhura në fletëvotime përkthehen në ulëse në Kuvend.

Debati për reformimin e rregullave zgjedhore ka nisur qysh më 2006 dhe është intensifikuar sidomos pas zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2010, të cilat ishin vlerësuar si zgjedhjet me më së paku integritet pas luftës në Kosovë. Iniciativa për reformimin e rregullave zgjedhore është ndikuar prej faktorëve endogjenë (kritikës së shoqërisë civile në Kosovë), por edhe ekzogjenë (kritikave të vazhdueshme të organizatave ndërkombëtare për parregullsi masive, vjedhje, votim kolektiv, fotografim të votës, etj). Pyetja kyçe është kjo: pse partitë politike vendosin që t'i reformojnë rregullat e lojës zgjedhore, brenda të cilave i fitojnë zgjedhjet? Richard S. Katz liston gjashtë arsye se pse partitë mund të ndryshojnë ose pse lejojnë që të ndryshohen rregullat e një loje zgjedhore. Sipas tij, janë 6 arsye:

1. Fituesit mund të besojnë se fitorja e tyre e vazhdueshme është seriozisht e kërcënuar brenda rregullave ekzistuese;
2. Fituesit nuk e kanë nën kontroll të gjithë situatën dhe atyre mund t'u imponohen reformat;
3. Ka një ndarje të interesave mes anëtarëve të koalicionit fitues;
4. Ata që janë në gjendje të aprovojnë reforma zgjedhore janë tepër optimistë rreth të ardhmes së tyre në sistemin e ri, ose i keqperceptojnë pasojat e mundshme;
5. Partitë mund t'i vlerësojnë më shumë ndryshimet afatgjata në një sistem kompetitiv sesa avantazhet afatshkurtra elektorale;

6. Partitë mund të jenë të gatshme që t'i tregtojnë
avantazhet elektorale për qëllime të tjera.²⁰¹

Arsyet e problematizimit dhe inicimit të reformës zgjedhore pas vitit 2010 mund të jenë të shumëfishta. Mjafton këtu t'i listojmë vetëm disa prej tyre. Meqenëse PDK-ja ishte certifikuar si parti fituese e zgjedhjeve të përgjithshme më 2010, legjitimiteti i fitores së saj ishte gërryer pandreqshëm. Rrjedhimisht, PDK-ja nuk e pati nën kontroll të gjithë situatën dhe, në mënyrë që të mos i kontestohet vazhdimisht ky legjimitet, së bashku me LDK-në dhe AKR-në u pajtuan për inicimin e reformës zgjedhore. PDK-ja ishte e interesuar ta tregtonte reformën zgjedhore me stabilitetin qeverisës pas zgjedhjeve të kontestuara masivisht si nga organizatat lokale ashtu edhe ato ndërkombëtare. Në anën tjetër, në nëntor 2010 LDK-ja kishte zgjedhur një kryetar të ri në Konventën e saj Zgjedhore, Isa Mustafa, i cili gjithë agjendën politike e ndërtonte kundër figurës së ish-Kryeministrit dhe Kryetarit të PDK-së, Hashim Thaçi. Ndonëse LDK-ja nën drejtim e Isa Mustafës ishte rritur për 43.142 vota, ose 24.69% të votave në krahasim me zgjedhjet paraprake të vitit 2007, ajo prapëseprapë nuk doli parti fituese. Duke qenë se kryetari i ri i LDK-së nuk e përmbushi premtimin e tij zgjedhor për ta nxjerrë LDK-në si parti fituese të zgjedhjeve, Mustafa pranoi të merrte pjesë në reformën zgjedhore, në mënyrë që t'i ikte përgjegjësisë politike për humbjen e zgjedhjeve. Në anën tjetër, partneri i koalicionit të PDK-së, AKR-ja, ishte po ashtu e interesuar që të bëhej pjesë e reformës zgjedhore dhe të impononte si propozim idenë e saj që Presidenti i Kosovës të zgjidhej në mënyrë të drejtpërdrejt, një propozim ky që AKR-ja e kishte promovuar që nga themelimi i saj si parti politike.

²⁰¹ Richard S. Katz, 'Why are there so many (or so few) electoral reforms?', në Micheal Gallagher dhe Paul Mitchell (ed.), *The Politics of Electoral Systems* (Cambridge University Press, 2005), f. 63.

5.3 Vendet e rezervuara për pakicat në Kuvendin e Kosovës: dy mandate plus

Puna për reformën zgjedhore ishte zhvendosur nga Komisioni për Reformë Zgjedhore tek takimet informale mes liderëve të partive politike në Kosovë. Në këto takime morën pjesë liderët e PDK-së, të LDK-së, VV-së, AAK-së, SLS-së, KDTP-së dhe ambasadorët e vendeve të fuqishme në Kosovë. Nga 2010 deri më 2014 u zhvilluan disa takime mes liderëve të partive politike, por nuk ishte arritur një konsensus për sistemin zgjedhor dhe përbërësit e këtij sistemi. Partitë politike kanë mospajtime rreth zonave zgjedhore, pragut zgjedhur, përfaqësimit të pakicave, përfaqësimit gjinor, kompetencave dhe përbërjes së KQZ-së, ruajtjes së listave të hapura apo mbylljes së listave të votimit. Megjithatë, tri çështje mbeten si më kontestuese në procesin e reformës zgjedhore: listat e hapura apo të mbyllura; përbërja e KQZ-së; dhe vendet e rezervuara për pakicat. Vazhdimi i vendeve të rezervuara për pakicat në Kuvendin e Kosovës, i cili propozim nuk është kundërshtuar nga PDK-ja dhe partitë e pakicave të tjera, ka hasur në rezistencë të qartë politike nga partitë e tjera opozitare shqiptare.

Në këtë debat, tashmë ish-Kryeministri i Kosovës dhe ish-Kryetari i PDK-së, Hashim Thaçi, kishte propozuar që të ftohej Komisioni i Venecias për të ndihmuar në përfundimin e reformës zgjedhore.²⁰² Partitë opozitare kishin kundërshtuar këtë propozim. Përfaqësuesit nga LDK-ja kishin argumentuar se në Komisionin për Reformë qenë përfshirë edhe ekspertët ndërkombëtarë. Nga anën tjetër, AAK-ja, përmes nënkryetarit të saj, z. Ahmet Isufi, kishte thënë: “Kërkesa e kryeministrit për ta ftuar Komisionin e Venecias që ta përfundojë reformën zgjedhore është pretekst, përmes të cilit ai

²⁰² ‘Reforma zgjedhore në dorën e partive politike, jo të Komisionit të Venedikut’, Telegrafi, 6 janar 2014.

Shih: <http://www.telegrafi.com/lajme/reforma-zgjedhore-ne-doren-e-partive-politike-jo-te-komisionit-te-venedikut-2-39857.html> (15 janar 2014).

mundohet ta arsyetojë kërkesën e komuniteteve pakicë për shtimin e mandateve të rezervuara”.²⁰³ Kjo nënkuptonte që krahas reformimit të sistemit zgjedhor, të ndryshohej edhe Kushtetuta e Kosovës.

Sipas Kushtetutës së Kosovës, rregullat për 20 vendet e garantuara plus mandatet e fituara me vota për përfaqësimin e komuniteteve pakicë në Kuvendin e Kosovës do të vlenin vetëm për dy mandatet e para zgjedhore.²⁰⁴ Në Nenin 64 të Kushtetutës së Kosovës thuhet se “partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetin serb, do të kenë numrin e vendeve në Kuvend të fituar në zgjedhjet e hapura, me minimumin dhjetë (10) vende të garantuara, në rast se numri i vendeve të fituara është më i vogël se dhjetë (10), dhe 10 vende për pakicat e tjera romë, ashkalinj, egjiptianë, goranë, turq dhe boshnjakë”.²⁰⁵ Partitë politike në Kosovë nuk e kundërshtuan nenin 64, por nuk ranë dakord që pakicat të kishin më shumë se 20 vende në Kuvendin e Kosovës. Ata kishin refuzuar vazhdimin e vendeve të rezervuara, ku pakicat do të kishin 20 vende të garantuara dhe varësisht prej numrit të votave të fituara, ta rrisnin numrin e ulëseve në Kuvendin e Kosovës edhe pas dy mandateve të para zgjedhore.

LDK-ja nuk ishte e pajtimit për vazhdimin e vendeve të rezervuara për pakicat në Kuvendin e Kosovës, me arsyetimin se kjo e hapte Planin e Ahtisaarit dhe Kushtetutën e Kosovës. Vjosa Osmani nga LDK-ja kishte argumentuar se nëse pakicat i kanë 20 vende të garantuara dhe fitojnë mbi 10 vende, atëherë pakicat do të mund të konsideroheshin si fuqia e parë ose e dytë politike në Kuvendin e Kosovës dhe një përfaqësim i tillë disproportional do të ishte diskriminim për shumicën shqiptare. Sipas saj, reforma zgjedhore nuk duhet të prekte Kushtetutën e Republikës së Kosovës

²⁰³ Po aty.

²⁰⁴ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 148.

²⁰⁵ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 64 dhe 148.

dhe se çdo ndryshim i Kushtetutës kërkonte shumicën e dyfishtë në Kuvendin e Kosovës. Një ndryshim i tillë nuk mund të bëhej, duke pasur parasysh kundërshtimin e LDK-së për vendet e rezervuara për pakica.²⁰⁶

Përfaqësuesit e partive politike serbe nuk u pajtuan me ndryshimin e statusit të vendeve të rezervuara në Kuvendin e Kosovës (20 vende të garantuara plus mandatet e fituara përmes votës). Përfaqësuesit e shoqërisë civile kundërshtuan propozimin për vazhdimin e vendeve të rezervuara për pakicat, me argumentin se kjo e defunksionalizonte demokracinë në Kosovë.

5.4 Propozimet e shoqërisë civile për reformën zgjedhore

Raporti i Komisionit Evropian 2015 për Kosovën nënvizonte se “Kuvendi i Kosovës mbetet të miratojë reformën zgjedhore e cila është vonuar. Anëtarësimi i Kosovës në Komisionin e Venecias mund të ndihmojë në këtë drejtim. Po ashtu, Kuvendi duhet të nisë një auditim të pavarur të financimit të partive politike dhe të fushatave zgjedhore të partive, ashtu siç është përcaktuar me Ligjin për Financimin e Partive Politike”.²⁰⁷

Deri më tani, Kosova është ballafaquar me probleme të vazhdueshme në zgjedhjen e Presidentit të vendit. Gjykata Kushtetuese, përmes dy aktgjykimeve të saj, kishte konstatuar se Fatmir Sejdiu kishte shkelur Kushtetutën e Kosovës duke mbajtur njëkohësisht pozitën e Kreut të Shtetit dhe atë të Kryetarit të LDK-së, kurse në rastin e zgjedhjes së Behgjet Pacollit, ajo kishte kontestuar procedurat e zgjedhjes së tij.

²⁰⁶ KTV, Interaktiv. Reforma Zgjedhore, 19 dhjetor 2013.

²⁰⁷ Komisioni Evropian, ‘Dokument Pune i Personelit të Komisionit: Raporti për Kosovën 2015’, Bruksel, 10.11, 2015, SWD (2015) 215 final, f. 6.

Përkrahësit e idesë që Presidenti të zgjidhej drejtpërdrejt e arsyetuan propozimin me faktin se një President i zgjedhur kështu përfaqësonte unitetin e popullit dhe zgjedhja e tij/saj e drejtpërdrejt e hiqte institucionin e Presidentit të vendit nga kalkulimet politike të partive. Në një studim të botuar rishtazi, Enver Hasani tematizonte rolin e Presidentit të vendit në raport me Kushtetutën, duke i ndërtuar premisat e tij nga debati akademik mes Carl Schmitt-it dhe Hans Kelsen-it. Sipas Schmitt-it, Kreu të Shtetit (*Führer*), i cili ndodhet në majë të piramidës, është pazgjidhshmërisht i lidhur me unitetin sociologjik dhe politik të popullit, të cilin e përfaqëson. Sipas kësaj doktrine juridike, pushteti trupëzohet dhe unifikohet në institucionin e Kreut të Shtetit dhe nuk mund të ndahet me parlamentin, ku dominojnë interesa partikularë të forcave të ndryshme politike. Hans Kelsen, në anën tjetër, konsideronte se Kreu i Shtetit nuk mund të përfaqësonte unitetin sociologjik dhe politik të popullit, por unitetin konstitucional, ligjor të popullit, dhe ky unitet konstitucional shprehej në Kushtetutë. Pra, në konceptin e Schmitt-it, në majë të piramidës është *Führer-i*, kurse në konceptin e Kelsen-it, në majë të piramidës është Kushtetuta, të cilës i nënshtrohet edhe Presidenti i vendit.²⁰⁸

Nga debati i mësipërm mund të vërejmë se një President i zgjedhur nga Kuvendi i Kosovës nuk e përfaqëson më pak unitetin e popullit. Në momentin e zgjedhjes, pavarësisht prej mënyrës – nga Kuvendi ose drejtpërdrejt – Presidenti i Kosovës përfaqëson unitetin konstitucional të Kosovës. Asnjë President, qoftë edhe ai i zgjedhur në mënyrë të drejtpërdrejtë, nuk mund të pretendojë se përfaqëson ‘unitetin metafizik apo sociologjik’ të popullit të Kosovës.

Analistët e pavarur, një numër i organizatave të shoqërisë civile dhe partitë politike kanë qëndrime të ndryshme nëse Presidenti i Kosovës duhet të zgjidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo.

²⁰⁸ Enver Hasani, ‘Constitutional Protection of the Head of State: The Case of Kosovo’, *ICL Journal* (2013), Vol. 7, ff.128-149.

Analisti Halil Matoshi argumenton se është pro zgjedhjes së Presidentit të Kosovës në mënyrë të drejtpërdrejtë. Sipas tij, nëse do të ndryshonte mënyra e zgjedhjes së Presidentit të Kosovës, “do të kishte mundësi të zgjidhej një President jopartiak, i pranueshëm për shumicën e popullit, i cili do të luante rolin e një autoriteti moral, mbipartiak e mbietnik [dhe] në rast krizash institucionale e politike do ta mbante shoqërinë unike”.²⁰⁹ Politologu Artan Mustafa, në anën tjetër, parashtron dy argumente për dhe kundër zgjedhjes së Presidentit në mënyrë të drejtpërdrejtë: “Zgjedhja e drejtpërdrejtë e Presidentit nga Parlamenti krijon lehtësi në formimin e koalicionëve qeverisëse, pastaj për arsye se Presidenti ka pushtet relativisht simbolik, etj. Por, votimi direkt do të arsyetohej duke marrë për bazë anën praktike të gjendjes në Kosovë, ku reforma në partitë politike është e vështirë. Pa zgjedhje direkte, Prishtina kurrë nuk do ta kishte Shpend Ahmetin kryetar. Kështu që, në kontekst të bllokimit të reformave, vota popullore mund të krijojë hapësira inovacioni”.²¹⁰

Sociologu dhe analisti Dukagjin Gorani argumenton se zgjedhja e Presidentit të Kosovës në mënyrë të drejtpërdrejtë do të implikonte edhe ndryshimin e kompetencave. Duke qenë se Presidenti ushtron një post ceremonial, Gorani ka nënvizuar: “Votimi i drejtpërdrejtë i Presidentit nënkupton që Presidenti ka kompetenca ekzekutive”.²¹¹ Megjithatë, politologu Agron Demi, duke analizuar se zgjedhja e Presidentit është shndërruar në njërën nga pikat e bllokadës politike në vend, propozon që Presidenti i Kosovës të zgjidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë, por pa i ndryshuar kompetencat aktuale të cilat i ushtron Presidenti me Kushtetutën e Kosovës. Demi argumenton: “Duke parë se është bërë e vështirë që të arrihet shumica prej 80 votave në Kuvend e që do të sillnin një

²⁰⁹ Intervistë me z. Halil Matoshin, analist, Prishtinë, 28 mars 2016.

²¹⁰ Intervistë me z. Artan Mustafa, politolog dhe gazetar, Prishtinë, 5 prill 2016.

²¹¹ Intervistë me z. Dukagjin Gorani, sociolog dhe analist (intervista është realizuar në cilësinë e analistit dhe sociologut, para se ai të aderonte në Lëvizjen Vetëvendosje), Prishtinë, 5 prill 2016.

President konsensual, por të vetëdijshëm se ulja e pragut për zgjedhjen e Presidentit do të nënkuptojë zgjedhjen e një Presidenti i cili nuk përfaqëson shumicën, zgjidhja më e mirë do të ishte përmes zgjedhjeve të drejtpërdrejta, por pa i ndryshuar kompetencat aktuale të Presidentit. Kosova duhet ta ruajë sistemin e qeverisjes parlamentare dhe të mos shndërrohet në vend me sistem presidencial”.²¹²

Në anën tjetër, përfaqësuesit e partive politike kanë qëndrime të ndryshme rreth zgjedhjes së Presidentit në mënyrë të drejtpërdrejtë. Ali Berisha dhe Pal Lekaj nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës kanë deklaruar se qëndrimi i AAK-së është që Presidenti të zgjidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë. Sipas Berishës, “qëndrimi i AAK-së që nga fillimi ka qenë që Presidenti të zgjidhet drejtpërdrejt dhe jo të jetë përfaqësues i një kaste politike”.²¹³ Qëndrim identik me të Berishës kishte edhe bashkëpartiake i tij, Pal Lekaj.²¹⁴ Shpejtim Bulliqi dhe Arben Gashi nga Lidhja Demokratike e Kosovës po ashtu kanë nënvizuar se Presidenti duhet të zgjidhet me vota të qytetarëve. Megjithatë, sipas Bulliqit, “paraprakisht duhen reduktuar disa prej kompetencave të Presidentit, në mënyrë që të sqarohen disa nga kompetencat të cilat janë të përziera me kryeministrin”²¹⁵, kurse sipas Gashit, “Presidenti i Kosovës duhet të zgjidhet me vota të qytetarëve. Arsyeja është e thjeshtë: ai njeri duhet të jetë reprezentativ, ta përfaqësojë shumicën e qytetarëve të Kosovës”.²¹⁶ Basri Musmurati nga Partia Demokratike e Kosovës ka deklaruar: “Ne [PDK-ja] nuk e kemi këtë problem. Është mirë që të

²¹² Intervistë me z. Agron Demi, politolog dhe Drejtor Ekzekutiv në institutin GAP, Prishtinë, 5 prill 2016.

²¹³ Intervistë me z. Ali Berisha, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Prishtinë, 7 prill 2016.

²¹⁴ Intervistë me z. Pal Lekaj, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Prishtinë, 7 prill 2016.

²¹⁵ Intervistë me z. Arben Gashi, Lidhja Demokratike e Kosovës, Prishtinë, 29 mars 2016.

²¹⁶ Intervistë me z. Shpejtim Bulliqi, Lidhja Demokratike e Kosovës, Prishtinë, 1 prill 2016.

ndërrohet ligji që Presidenti të zgjidhet drejtpërdrejt”.²¹⁷ Glauk Konjufca nga Lëvizja Vetëvendosje nuk ka dhënë një përgjigje definitive nëse në të ardhmen kjo lëvizje do të përkrahte zgjedhjen e Presidentit në mënyrë të drejtpërdrejtë. Sipas tij: “Lëvizja Vetëvendosje mendon që Presidenti mund të zgjidhet edhe në mënyrë të drejtpërdrejt, mirëpo ne aktualisht favorizojmë një President të zgjedhur nga Kuvendi, për arsye se besojmë në një Republikë parlamentare, ku Kuvendi është çelësi i vendimmarrjes dhe reprezentim i interesave të qytetarëve dhe të popullit. Jeta demokratike duhet të jetë e përqendruar në Kuvendin e Kosovës dhe Presidenti duhet të dalë prej Kuvendit”.²¹⁸

Siç hetohet nga argumentet e mësipërme, arsyetimi i zgjedhjes së Presidentit në mënyrë të drejtpërdrejtë bazohet në pragmatizëm, për shkak të problemeve të vazhdueshme që ka pasur Kosova në zgjedhjen e Presidentëve në Kuvendin e Kosovës. Megjithatë, çdo ndryshim eventual i zgjedhjes së Presidentit në mënyrë të drejtpërdrejtë nuk duhet ta ndryshojë karakterin parlamentar të Republikës së Kosovës, dhe Presidenti i zgjedhur në mënyrë të drejtpërdrejtë do të duhej t’i ushtronte të njëjtat kompetenca që parashihen me Kushtetutën e Kosovës.

Në lidhje me sistemin zgjedhor, po ashtu, partitë politike kanë qëndrime të ndryshme. Basri Musmurati nga PDK-ja ka preferuar një sistem zgjedhor me shumë zona ku deputetët e zgjedhur do të kishin bazën e tyre elektorale.²¹⁹ Glauk Konjufca ka theksuar se VV preferon një sistem me një zonë zgjedhore. Sipas Konjufcës, “Kuvendi i Kosovës trajton çështje shumë universale që kanë të bëjnë me shtetin e Kosovës në përgjithësi. Këto nuk janë çështje lokale dhe nuk ka pse, le të themi në njëfarë mënyrë, të lidhet

²¹⁷ Intervistë me z. Basri Musmurati, Partia Demokratike e Kosovës, Prishtinë, 31 mars 2016.

²¹⁸ Intervistë me z. Glauk Konjufca, Lëvizja Vetëvendosje, Prishtinë, 1 prill 2016.

²¹⁹ Intervistë me z. Basri Musmurati, Partia Demokratike e Kosovës, Prishtinë, 31 mars 2016.

votuesi vetëm me deputetin i cili vjen nga zona e tij”.²²⁰ Pal Lekaj nga AAK-ja ka deklaruar se “ne jemi për lista të hapura dhe që zgjedhjet të bëhen nëpër zona”.²²¹ Shpejtim Bulliqi nga LDK-ja ka theksuar se “për këtë temë nuk është diskutuar në strukturat partiake”, kurse për Arben Gashin nga LDK-ja, “sistemi zgjedhor është në rregull”.²²²

Meqenëse u prezantuan preferencat e partive politike dhe qëndrimet analistëve të pavaruar për mënyrën e zgjedhjes së Presidentit dhe sistemin zgjedhor, në pjesën e mëposhtme do të prezantohen 5 modele me tipare të ndryshme për sistemin zgjedhor, modele këto të prezantuara nga think-tanke të ndryshme në Kosovë.

5.4.1 Modeli 1: KIPRED

Instituti KIPRED në studimin e tij ‘Zgjedhjet për Qytetarin’ ka propozuar një sistem zgjedhor me 5 tipare, i cili, sipas tyre, do t’i përshtatej më së miri popullit të Kosovës. Sipas studimit në fjalë, së pari, Kosova duhet të kalojë nga një zonë në shtatë zona zgjedhore, në mënyrë që të rritet përfaqësimi i të gjitha rajoneve të Kosovës në Kuvendin e Kosovës dhe të krijohet një lidhje e re e llogaridhënies mes deputetëve dhe elektoratit. Së dyti, studimi nxjerr se opsioni më i mirë që qytetarët të zgjedhin deputetët e tyre rajonalë është jo votimi preferencial për 5 kandidatë, siç është tani, por votimi vetëm për një kandidat, i cili do të parandalonte manipulimet që janë bërë përmes votimit preferencial. Së treti, listat duhet të jenë të hapura, për shkak se kështu rritet legjitimiteti. Së katërti, pragu zgjedhor të

²²⁰ Intervistë me z. Glauk Konjufca, Lëvizja Vetëvendosje, Prishtinë, 1 prill 2016.

²²¹ Intervistë me z. Pal Lekaj, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Prishtinë 7 prill 2016.

²²² Intervistë me z. Shpejtim Bulliqi, Lidhja Demokratike e Kosovës, Prishtinë, 1 prill 2016; Intervistë me z. Arben Gashi, Lidhja Demokratike e Kosovës, Prishtinë, 29 mars 2016.

zbritet nga 5% në 1%, që t'u krijohen mundësi më të mëdha partive të vogla dhe kandidatëve të pavarur për të marrë pjesë në zgjedhje. Së pesti, studimi rekomandon se ndëshkimi i krimeve të kaluara zgjedhore është i domosdoshëm për një proces të ri zgjedhor.²²³

5.4.2 Modeli 2: D4D

Instituti D4D në studimin e tij 'Deforma Zgjedhore' jep rekomandime për reformimin e sistemit zgjedhor në Kosovë. Sipas këtij studimi, Kosova duhet të ndahet në zona zgjedhore, dhe këto zona duhet të kenë për bazë ndarjen e tanishme në Kosovë, dhe jo ndonjë marrëveshje politike për ndarjen e zonave të reja. Ndarja e zonave prodhon përfaqësim më të mirë të zonave në Kuvend, lidh elektoratin me deputetë, dobëson hierarkinë partiake dhe rrit demokratizimin e partive politike. Në mënyrë që të garantohet përfaqësimi gjinor dhe përfaqësimi i pakicave në Kuvendin e Kosovës, studimi rekomandon ndarjen e ulëseve 70/30/20 – 70 ulëse për shtatë zona, 30 ulëse për gra, dhe 20 ulëse për pakica. Më tej, studimi rekomandon që të ruhen listat e hapura, por në vend se për 5 kandidatë, votuesit të votojnë vetëm për një kandidat, duke e pamundësuar kështu manipulimin e votave. Pragu zgjedhor të jetë 3%, por ky prag të mos aplikohet për kandidatët e pavarur dhe partitë e pakicave.²²⁴

5.4.3. Modeli 3: IPOL

Lidhur me zonat zgjedhore, IPOL ofron dy opsione: një, ruajtja e një

²²³ KIPRED, 'Zgjedhjet për Qytetarin: Vlerësimi i Sistemit Zgjedhor të Kosovës dhe Rekomandimet për Zgjedhjet e Ardhshme', 2012, f. 6.

²²⁴ D4D, 'Deforma Zgjedhore: Dy vite pas, reforma në pikën zero'. Seria 5, Zgjedhjet. Prishtinë, shtator 2013, f. 42.

zone zgjedhore me përfaqësim proporcional për shkak të thjeshtësisë së sistemit; dy, një sistem të përzier zgjedhor ku 30 nga 100 deputetët do të zgjidheshin nga 7 zonat aktuale të Kosovës, dhe 70 deputetë të tjerë të zgjidhen përmes një zone të vetme në tërë Kosovën. Kjo do të garantonte përfaqësim më të madh të rajoneve, ku secili rajon do të mund t'i dërgonte 5 deri në 8 deputetë në Kuvend. IPOL kundërshton sistemin aktual zgjedhor, ku votuesit kanë mundësi të votojnë për 5 kandidatë në fletëvotim, për shkak se ky kishte qenë burimi i manipulimeve në zgjedhjet e vitit 2010. Përkitazi me këtë, IPOL propozon opsionin 'një votues – një votë për një kandidat', duke supozuar se kjo do të mund të parandalonte parregullsitë. Sipas IPOL, pragu zgjedhor duhet të jetë 7% për koalicionet, 4% për subjekte politike individuale dhe 1% për kandidat të pavarur. Përfaqësimi gjinor të ketë kuotën gjinore, ku 30% propozohet të mos ndryshohet. Lidhur me përfaqësimin e pakicave, IPOL argumenton se sistemi aktual zgjedhor e ushqen pasivitetin e pakicave përmes 20 ulëseve të rezervuara në Kuvend dhe kjo nuk i ndihmon integritet të pakicave, por përkundrazi e ngurtëson marginalizimin e tyre. Më tutje, IPOL preferon thjeshtim të procedurave zgjedhore në përputhje me Kodin e Komisionit të Venecias dhe po ashtu rekomandon ndryshimin e përbërjes së KQZ-së, ku nga totali i anëtarëve politikë në Komision, gjysma të jenë nga partitë qeveritare dhe gjysma tjetër nga partitë opozitare.²²⁵

5.4.4 Modeli 4: INDEP

Një studim tjetër mbi reformën zgjedhore, me titull 'Opsionet për Reformën Zgjedhore në Kosovë' ofrohet nga instituti INDEP. Fillimisht studimi argumenton se reforma e sistemit zgjedhor nuk ka

²²⁵ INPOL, 'Vlerësimi i Sistemit Zgjedhor të Kosovës dhe Rekomandimet për Reformën Zgjedhore', Prishtinë, 2012, ff. 24-29.

për qëllim demokratizimin e partive politike, por adresimin e keqpërdorimeve zgjedhore dhe të problemeve teknike të shfaqura në zgjedhjet e vitit 2010. Rreth ndarjes së Kosovës në zona zgjedhore, studimi analizon disa propozime të dhëna qoftë nga partitë politike, qoftë nga institutet e shoqërisë civile. Njëri nga propozimet e dhëna nga një parti politike (studimi aludon në propozimin e AAK-së) në Kosovë është që Kosova të ndahet në 100 zona zgjedhore, ku 100 deputetët e Kuvendit të Kosovës do të zgjidheshin nga 100 zona, dhe 20 deputetë të tjerë të komuniteteve pakicë do të kishin vende të garantuara. Edhe pse ky model mazhoritar forcon llogaridhënien, problemi i tij mbetet se me këtë sistem nuk mund të sigurohet kuota gjinore prej 30% për përfaqësimin e grave dhe se kjo do të shkaktonte problem në ndarjen e ulëseve të garantuara për pakicat, për shkak se në zonat ku komunitetet janë pakicë (qoftë shqiptarët në zonat serbe ose serbët në zonat shqiptare), ata nuk do të votonin duke qenë se kandidati i tyre nuk do të kishte shanse të mëdha të fitonte.

Një propozim tjetër që analizohet në këtë studim është ndarja e Kosovës në 37 zona zgjedhore, ku numri i zonave do të ndahej në bazë të komunave aktuale në Kosovë. Ky propozim nuk sqaron nëse 100 deputetët e Kuvendit të Kosovës do të duhej të zgjidheshin nga 37 zonat komunale, apo nëse kjo do të realizohej përmes një sistemi të përzier ku 70 deputetë do të zgjidheshin në 37 zona, 30 të zgjidheshin nga një zonë e përgjithshme në gjithë Kosovën, në mënyrë që të ruhej edhe kuota gjinore edhe përfaqësimi i komuniteteve pakicë. Në anën tjetër, kjo ndarje e zonave në komuna më pastaj rrezikon që liderët lokalë për kuvende komunale të kandidonin për Kuvendin e Kosovës dhe rrjedhimisht të humbte rëndësia e zgjedhjeve komunale. Një propozim tjetër i analizuar në këtë studim është ndarja e Kosovës në më shumë se 20 zona zgjedhore, ku 70 deputetët e Kuvendit të Kosovës do të zgjidheshin në mënyrë të drejtpërdrejtë nga zonat, kurse 30 deputetë të tjerë në

bazë të proporcionalitetit, përmes së cilit do të ruhej kuota gjinore. Një tjetër propozim është ndarja e Kosovës në 7 zona zgjedhore, duke u bazuar në sistemin aktual të rajoneve në Kosovë (Prishtinë, Ferizaj, Mitrovicë, Prizren, Gjiilan, Pejë, Gjakovë), ku numri total i votuesve në Kosovë do të përpjesëtohej me numrin e votueseve në zonë për të nxjerrë numrin e deputetëve të Kosovës në çdonjërin prej zonave. Pas analizës së të gjitha opsioneve, INDEP rekomandon që Kosova të vazhdojë ta ruajë sistemin aktual me një zonë zgjedhore, me lista të hapura (por, ku do të votohet vetëm për një kandidat) dhe pragu zgjedhor të zbresë nga 5% sa është tani, në 1%. Përparësitë e një sistemi zgjedhor njëzonal sigurojnë që votat e votuesve të jenë të barabarta në tërë Kosovën, pasi ndarja në zona do të privilegjonte disa komuna në nivelin e Kosovës, dhe një zonë do të garantonte përfaqësim të pakicave dhe të grave në Kuvendin e Kosovës. Pragu zgjedhor prej 1% në anën tjetër, do të siguronte mundësinë që partitë e vogla, iniciativat qytetare dhe kandidatët e pavarur të përfaqësonin interesat e grupeve të tyre sociale dhe politike në Kuvendin e Kosovës.²²⁶

5.4.5 Modeli 5: PIPS

Instituti PIPS, në analizën për reformimin e sistemit zgjedhor, konsideron se ndarja e Kosovës në shumë zona zgjedhore është një ndër rreziqet më të mëdha për Kosovën. Sipas PIPS ndarja e Kosovës – si një vend i vogël – në shumë zona zgjedhore do të rriste “krahinorizmin dhe hendekun mes rajoneve”. Duke e njohur nivelin e konsolidimit të partive politike në Kosovë, PIPS argumenton se ndarja e Kosovës në shumë zona do të përforconte partitë politike në zonat ku tradicionalisht janë dominante, dhe do të pamundësonte depërtimin e partive të tjera në këto zona. Siç thotë PIPS: “Mbase

²²⁶ INDEP, ‘Opsionet për Reformën Zgjedhore në Kosovë’, 2012/2, Prishtinë.

LDK-ja do t'i mbyllte zyrat në rajonin e Skenderajt e Drenasit. Do të përqendrohej në Llap. PDK-ja do ta zhvendoste nga radari zgjedhor Rrafshin e Dukagjinit, kurse ngjashëm do të vepronin edhe partitë e tjera politike".²²⁷ PIPS jep disa argumente kundër ndarjes së Kosovës në disa zona zgjedhore. Deputetët e zgjedhur nga ato zona do të merreshin më shumë me interesa të ngushta, duke e futur Kosovën në një formë të re të klientelizimit. Në lidhje me listat zgjedhore, PIPS rekomandon mbylljen e tyre. Mbyllja e listave do t'i parandalonte manipulimet si brendapartiake ashtu edhe mes subjekteve politike, si dhe do ta rriste demokracinë e brendshme partiake. Gjatë përpilimit të listave, partitë politike do të bënin përpjekje që të prezantonin ofertën më të mirë me kandidatët e tyre. Sa i përket pragut zgjedhor, ky institut rekomandon që pragu zgjedhor për partitë politike të mbetet 5%, kurse 3% për kandidatët e pavarur.

²²⁷ PIPS, 'Reforma Zgjedhore: Demokracia tek listat dhe zonat?'. Janar 2012, Prishtinë, f. 5.

VI

MES STABILITETIT
DHE DEMOKRATIZIMIT

KAPITULLI VI

KAPITULLI 6:

*SIMULACRA E ZGJEDHJEVE 2014 - PREMTIMET,
KRIZAT DHE KAUZAT*

KAPITULLI 6: SIMULACRA E ZGJEDHJEVE 2014 - PREMTIMET, KRIZAT DHE KAUZAT

Bashkësia ndërkombëtare, respektivisht Grupi i Kontaktit, ka pasur ndikim vendimtar në formësimin e të gjitha koalicioneve paszgjedhore nga viti 2000 e deri më 2007. Pas shpalljes së pavarësisë, ndonëse parapëlqimet për koalicione mes partive specifike ishin evidente, u hetua një tërheqje e intervenimeve direkte në proceset politike vendore. Forma e ndikimit tashmë është rimodeluar. Në vend të ndikimit të drejtpërdrejtë, ta zëmë, vendet që e kanë përkrahur pavarësinë e Kosovës ndikojnë nëpërmjet retorikës së tyre politike, duke i klasifikuar disa parti si më shumë ose më pak radikale dhe duke mbështetur ose jo kursin e politikave të qeverisë.

Ndonëse zakonisht politika e jashtme është reflektim i politikës së brendshme, rasti i Kosovës dëshmon të kundërtën. Politika e jashtme dhe agjenda e vendosur nga shtetet anëtare të Grupit të Kontaktit kanë ndikuar drejtpërdrejt në politikën e brendshme të Kosovës. Më 2014, Kosova kishte para vetes përsëri disa ‘tema të mëdha’ adresimi i të cilave kërkonte qeverisje stabile dhe lidrship të fuqishëm politik. Pas “standardet para statusit”, dialogut të Vjenës, shpalljes së pavarësisë së Kosovës, fillimit të normalizimit të marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë, tema e radhës doli të ishte themelimi i Gjykatës Speciale.

Zgjedhjet e përgjithshme të parakohshme u shpallën me 8 qershor 2014. Presidentja e Republikës së Kosovës, Atifete Jahjaga, në përputhje me kompetencat e saj kushtetuese, shpalli zgjedhjet e

përgjithshme të parakohshme si rezultat i shpërbërjes së Kuvendit të Kosovës. Kuvendi ishte bërë krejtësisht jofunksional për shkak se koalicionit qeverisës i mungonin votat e nevojshme për t'i kaluar vendimet kyçe të Qeverisë së Kosovës. Mungesa e konsensusit për vazhdimin e vendeve të rezervuara për komunitetet pakicë në Kuvendin e Kosovës ishte thelluar për shkak se LDK-ja, partia më e madhe opozitare, kishte refuzuar që pakicat të kishin edhe më tutje vende të rezervuara, me arsyetimin se ato i kishin konsumuar dy mandatet për vende të rezervuara në përputhje me Planin e Ahtisaarit. Në anën tjetër, PDK-ja, si hisedare kryesore e Qeverisë së Kosovës, kishte propozuar themelimin e Forcave të Armatosura të Kosovës, vendim ky që pakica serbe e kushtëzonte me vazhdimin e vendeve të rezervuara.

Meqenëse zgjedhjet e kaluara parlamentare ishin shoqëruar me probleme, Presidentja Jahjaga u kishte bërë ftesë monitoruesve evropianë që t'i vëzhgonin ato. Në një intervistë ajo kishte vënë theksin mbi një proces të rregullt votimi: “Zgjedhjet e parakohshme parlamentare duhet të dëshmojnë gatishmërinë tonë për të garantuar votën e lirë të qytetarit të Kosovës. Këto zgjedhje duhet të vëzhgohen nga afër për të garantuar një proces të rregullt. Në ditët në vijim do të kërkoj edhe nga Bashkimi Evropian që ta dërgojë një mision vëzhgues që t'i përcjellë nga afër zhvillimet në procesin e zgjedhjeve të parakohshme në vend”.²²⁸

Zgjedhjet lokale në Kosovë, të organizuara në nëntor 2013 ishin zhvilluar në frymë fer e demokratike, përkundër faktit se hisedarët politikë, partitë politike pra, ende nuk kishin arritur në një

²²⁸ ‘Më 8 qershor mbahen zgjedhjet parlamentare në Kosovë’, 8 maj 2014. Shih http://time.ikub.al/a3917afd30/5b3c73bf63abd9366493df2b358a9f6d/Lajm_Me-8-qershor-mbahen-zgjedhjet-parlamentare-ne-Kosove.aspx (qasur 22 qershor 2014); ‘Zgjedhjet mbahen më 8 qershor’. Gazeta Jeta në Kosovë, 8 maj 2014. Shih ‘<http://gazetajnk.com/?cid=1,1018,8174> (qasur 22 qershor 2014); ‘Zgjedhjet në Kosovë më 8 qershor’. Zëri i Amerikës, 8 qershor 2014. Shih <http://www.zeriamerikes.com/content/kosovo-president-elections/1910244.html> (22 qershor 2014).

‘emërues të përbashkët’ lidhur me reformën zgjedhore. Me gjithë faktin se zgjedhjet lokale të vitit 2013 edhe ato parlamentare të vitit 2014 u zhvilluan sipas ligjit aktual për zgjedhjet, në këto dy palë zgjedhje Kosova ka shënuar një progres në arritjen e standardeve demokratike për organizimin demokratik të zgjedhjeve. Në zgjedhjet e vitit 2014, propozimet e shoqërisë civile për reformimin e sistemit zgjedhor, për ndarjen e Kosovës në disa zona zgjedhore, për heqjen e votës preferenciale, për ta ulur prapun zgjedhor dhe ndryshuar kompozicionin e KQZ-së, nuk ishin marrë në konsideratë. Përkundër kësaj, zgjedhjet e përgjithshme të parakohshme të vitit 2014 u zhvilluan në një frymë fer e demokratike. Në anën tjetër, organizimi i zgjedhjeve të përgjithshme edhe në katër komunat e pjesës veriore të Kosovës shënon një ngjarje pozitive në integrimin e serbëve të pjesës veriore në Kosovën e paspavarësisë.

Zgjedhjet u monitoruan nga vëzhgues vendas dhe ndërkombëtarë. Demokracia në Veprim, një koalicion i OJQ-ve kosovare për monitorimin e zgjedhjeve, përpos problemeve që ishin gati të përsëritshme nëpër të gjitha zgjedhjet e organizuara në Kosovë, si votimi familjar, mosgjetja e emrave të votuesve në listën e votuesve dhe prania e personave të paaautorizuar afër qendrave të vendvotimit, nuk kishte raportuar për incidente ose manipulime të mëdha që do ta vinin në pikëpyetje kredibilitetin dhe legjitimitetin e organeve ligjvënëse të dala nga këto zgjedhje.²²⁹ Po ashtu, Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D) kishte vendosur 9 ekupe mobile në Kosovë për ta vëzhguar procesin zgjedhor.²³⁰ Pos organizatave vendore, BE-ja, me kërkesë të Presidentes së Kosovës, kishte dërguar një mision vëzhgues për monitorimin e zgjedhjeve në

²²⁹ ‘Komunikatë për Media’, 8 qershor 2014, Demokraci në Veprim. Shih http://www.demokracianeveprim.org/al/index.php?subaction=showfull&id=1402268182&archive=&start_from=&ucat=1& (24 qershor 2014).

²³⁰ ‘D4D vëzhgon zgjedhjet parlamentare 2014’, 8 qershor 2014, D4D. Shih <http://d4d-ks.org/aktivitetet/d4d-vezhgon-zgjedhjet-parlamentare-2014/> (qasur 26 qershor 2014).

Kosovë. Misioni i Bashkimit Evropian për Vëzhgimin e Zgjedhjeve, në raportin e publikuar me 9 qershor, një ditë pas zgjedhjeve në Kosovë, shkruante se zgjedhjet ishin transparente, pa incidente, të organizuara mirë, dhe gjithëpërfshirëse.

Edhe pse Kosova ende nuk e ka reformuar sistemin e saj zgjedhor, raporti i vëzhguesve evropianë vëren se legjislacioni aktual ofron një bazë të mjaftueshme për organizimin e zgjedhjeve demokratike në përputhje me standardet ndërkombëtare. Raporti i lartpërmendur vëren edhe se këto zgjedhje ishin të rëndësishë së lartë, meqenëse e rikthyen besimin e humbur nga zgjedhjet e vitit 2010 dhe, për herë të parë, ato po organizoheshin në mbarë territorin e Kosovës, duke përfshirë edhe veriun e vendit.²³¹

Zgjedhjet e përgjithshme të parakohshme ishin organizuar në 38 komuna të Kosovës. 1 milion e 782 mijë votues me të drejtë vote patën mundësinë që të zgjidhnin përfaqësuesit e tyre legjitimë për Kuvendin e Kosovës, në një garë elektorale ku merrnin pjesë 2000 kandidatë nga 19 parti politike, 7 nisma qytetare, 4 koalicionë dhe 1 kandidat i pavarur. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve kishte certifikuar 31 subjekte politike. Zgjedhjet u vëzhguan nga 100 monitorues të Bashkimit Evropian,²³² dhe nga shoqëria civile në Kosovë. Sipas të dhënave të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në zgjedhjet e përgjithshme të parakohshme të vitit 2014, numri i përgjithshëm i vendvotimeve ishte 2374, kurse përqindja e votuesve që kishin ushtruar të drejtën e tyre të votës ishte 43.16%.²³³

²³¹ 'Zgjedhjet Parlamentare në Kosovë: Deklaratë për Media. Misioni i Bashkimit Evropian për Vëzhgimin e Zgjedhjeve. Prishtinë, 9 qershor 2014. Shih http://www.eueom.eu/files/pressreleases/other/eueom-kosovo2014-preliminary-statement_sq.pdf (qasur 24 qershor 2014).

²³² 'Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare në Kosovë', DW, 8 qershor 2014. Shih <http://www.dw.de/zgjedhjet-e-parakohshme-parlamentare-në-kosovë/a-17691895> (qasur me 23 qershor 2014).

²³³ 'Dalja në zgjedhje. Komisioni Qendror Zgjedhor. Shih <http://rezultatet.kqz-ks.org/NightResults/Results.aspx?RaceID=1&UnitID=1&IsPS=0&Turnout=3&LangID=2> (më 24 qershor 2014).

6.1 Sloganet dhe premtimet si ‘simulacra’

Për herë të parë, që nga zgjedhjet e para të përgjithshme në Kosovë, subjektet politike adresuan në platformat e tyre partiake zhvillimin ekonomik dhe hapjen e vendeve të reja të punës. Raporti i Progresit i Komisionit Evropian për vitin 2013 shkruante se 73% e të rinjve të moshës 15 deri 24 vjeç janë të papunë, dhe kjo shkallë e papunësisë mbetet problem serioz për zhvillimin socio-ekonomik të Kosovës.²³⁴ Slogani i PDK-së ‘Misioni i Ri’, ai i LDK-së ‘Vetëm ne mundemi’, i AAK-së ‘Drejtimi i Ri’, i VV-së ‘A jeni lodhë’, i AKR-së ‘Ne kryejmë punë’, në qendër të platformës zgjedhore kishin zhvillimin ekonomik dhe krijimin e vendeve të reja të punës. Për dallim prej zgjedhjeve të kaluara, një karakteristikë e zgjedhjeve të vitit 2014 ishte se subjektet politike kanë provuar t’i konkretizojnë këto slogane në programe politike partiake në formë të shkruar.

Shumica e subjekteve politike ofronin një katalog të premtimeve për zgjedhjet e parakohshme parlamentare. PDK-ja premonte hapjen e 200.000 vendeve të reja të punës përmes ‘Fondit për Zhvillim’ (1.5 miliardë euro), kurse premtimet LDK-së u mjaftuan me 120.000 vende të punës. Për herë të parë premtimet e partive politike do të mund të shpjegoheshin përmes konceptit të ‘simulacra-s’ së Jean Baudrillard-it.²³⁵ Hiperrealiteti i premtimeve dhe fjalëve të mëdha zgjedhore nuk kishte asnjë bazë të përlllogaritjes reale. Njohës të ekonomisë kanë komentuar se në Kosovë duhet të ketë rritje ekonomike deri në 15%, në mënyrë që të realizohen këto premtime parazgjedhore. Ato ishin në kundërshtim

²³⁴ Raporti i Progresit 2013 për Kosovën’. Bruksel, 16. 10.2013. SWD (20130 416). Shih [http://www.mei-ks.net/repository/docs/1FINAL-ALB_MIE-Kosovo_Progress_Report_2013_\(alb\)_\(2\).pdf](http://www.mei-ks.net/repository/docs/1FINAL-ALB_MIE-Kosovo_Progress_Report_2013_(alb)_(2).pdf) (qasur 22 qershor 2014).

²³⁵ Jean Baudrillard, *Simulacra and Simulation* (University of Michigan Press, 1995).

me të gjithë parametrat parashikues për rritjen ekonomike në Kosovë.²³⁶

6.2 Bllokada institucionale dhe koalicionet joparimore

Zgjedhjet e vitit 2014, koalicionin parazgjedhor të drejtuar nga PDK-ja e nxorën fitues.²³⁷ PDK-ja arriti t'i kthente komunat dhe rajonet që i kishte humbur në zgjedhjet lokale të nëntorit 2013. Partitë politike opozitare, LDK-ja, Nisma dhe AAK-ja, në anën tjetër, nënshkruan një memorandum me të cilin zotoheshin se do ta formonin qeverinë, meqenëse PDK-ja nuk e kishte shumicën e nevojshme të deputetëve (61 deputetë) në Kuvendin e Kosovës. Sipas këtij plani, posti i Kryeministrit do t'i ndahej AAK-së, kurse ai i Kryetarit të Kuvendit LDK-së dhe, me përfundimin e mandatit të Presidentes Atifete Jahjaga, posti i Presidentit do t'i takonte LDK-së. Sidoqoftë, koalicionit paszgjedhor LDK-AAK-Nisma i mungonte shumica e nevojshme e votave në Kuvendin e Kosovës. Ky koalicion varej nga mbështetja potenciale e VV-së. Meqenëse qëndrimi i VV-së për ndërprerjen e bisedimeve me Serbinë ishte artikuluar qyshkur, ambasadat e akredituara në Kosovë, Zyra e Bashkimit Evropian dhe hisedarët e tjerë ndërkombëtarë e shihnin me skepticizëm këtë format të koalicionit.

²³⁶ 'Demi: Paqartësi në premtimet për zhvillim ekonomik', Lajmi.net. 7 qershor 2014. Shih http://lajmi.net/demi--paqartesi-ne-premtimet-per-zhvillim-ekonomik_100069106.html (qasur më 25 qershor 2014).

²³⁷ Sipas të dhënave të Komisionit Qendror Zgjedhor, PDK-ja ka fituar 214.533 vota, ose 30,71% të votave të vlefshme, LDK-ja ka fituar 179.848, ose 25,74% të votave të vlefshme, VV-ja ka fituar 94.483 vota, ose 13,52% të votave të vlefshme, AAK-ka ka fituar 36.570 vota, ose 5,23% të votave të vlefshme, kurse AKR-ja nuk e ka kaluar pragun (prej 5%) duke fituar 32.543, ose 4,66% të votave të vlefshme. Kurse nga partitë minoritare subjekti që doli më së miri me rezultate është Lista Serbe me 29.124 vota, ose 4,17% të votave të vlefshme.

Duke qenë se gara kryesore në zgjedhjet e vitit 2014 zhvillohej mes PDK-së dhe të gjitha partive të tjera së bashku (LDK, VV, AAK dhe Nisma) që e kishin ndërtuar një fushatë negative kundër PDK-së, problemi kryesor, pas certifikimit të rezultateve nga KQZ më 4 korrik 2014, ishte ndërtimi i koalicioneve dhe formimi i institucioneve. Partitë opozitare, LDK, VV, AAK dhe Nisma ndërtuan një koalicion opozitar paszgjedhor që u quajt VLAN. Ndonëse një koalicion i tillë i partive të mëdha opozitare kishte dallime të mëdha programore e ideologjike, megjithatë formula e bashkimit bazohej në një politikë opozitare ndaj PDK-së. Koalicioni VLAN pretendonte se e kishte shumicën, dhe se Qeveria e Kuvendi duhet të drejtoheshin prej tij. PDK-ja në anën tjetër insistonte të ndërtonte koalicion me njërën nga këto parti dhe t'i formonte institucionet, meqë në zgjedhje kishte dalë si partia e parë. PDK-ja në fakt kishte bërë një koalicion parazgjedhor me disa parti të vogla në Kosovë.

Ndonëse PDK-ja kishte marrë numrin më të madh të votave në nivel vendi, problemi ishte shfaqur qysh në fillim – në konstituimin e legjislaturës së pestë. Ish-Kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi, tashmë ishte ndarë nga PDK-ja dhe ishte bashkëthemelues i partisë Nisma, pjesë kjo e koalicionit VLAN. Krasniqi ishte ngarkuar që ta draftonte rendin e ditës për seancën konstitutive për legjislaturën e pestë. Pjesë e rendit të ditës të seancës së 17 korrikut 2014, para se të zgjidhej Kryetari dhe nënkryetarët e Kuvendit, ishte formimi i komisioneve për verifikimin e kuorumit dhe të mandateve, betimi i deputetëve dhe formimi i grupeve parlamentare. Ish-Kryetari i Kuvendit konsideronte se grupi LDK-AAK-Nisma ishte më i madhi grup parlamentar, ndonëse kjo kundërshtohet nga PDK-ja.

Çështja kryesore e diskutimit ishte se cili grup parlamentar kishte të drejtën ta propozonte i pari kandidatin për Kryetar të Kuvendit. PDK-ja insistoi se kjo e drejtë i takonte asaj si partia

fituese në zgjedhje me 37 deputetë, kurse LDK-AAK-Nisma insistonte se kjo e drejtë u takonte atyre meqë kishin shumicën e deputetëve në Kuvend (47), shto këtu edhe 16 deputetë të VV dhe 9 të Lista Srpska. VLAN e kishte informuar ish-Kryetarin e Kuvendit, Jakup Krasniqi, se LDK-AAK-Nisma kanë vendosur të themelojnë një grup të vetëm parlamentar. Seanca e 17 korrikut u zhvillua nën tension, dhe Kryesuesja e Kuvendit, respektivisht deputetja më e vjetër e Kuvendit, e cila vinte nga PDK-ja, e udhëhoqi seancën. Kryesuesja e Kuvendit, Flora Brovina, kishte kërkuar nga partitë politike t'i propozonin kandidatët për Kryetar. PDK-ja propozoi Agim Aliun, kurse LDK-ja Isa Mustafën. Pas fillimit të procesit të votimit, VLAN dhe Lista Srpska e lëshuan sallën, duke e pamundësuar kuorumin për marrjen e vendimeve. Kryesuesja e seancës ishte e obliguar ta mbyllte seancën në mungesë të kuorumit. Të njëjtën ditë, VLAN dhe Lista Srpska u kthyen në sallë, shkarkuan Kryesuesen e Kuvendit nga PDK-ja dhe zgjodhën një Kryesuese të re (Milka Vulić nga Lista Srpska). Në këtë mënyrë, ishte hapur rruga për zgjedhjen e Isa Mustafës në pozitën e Kryetarit të Kuvendit me 64 vota të deputetëve, nga 83 sa ishin të pranishëm.

Të kryesuar nga Xhavit Haliti, 30 deputetë të PDK-së, të nesërmen, më 18 korrik, kishin kontestuar zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit të Kosovës nga ana e VLAN-it. PDK-ja kontestoi si në formë, ashtu edhe në përmbajtje, mënyrën e zgjedhjes së Kryetarit të Kuvendit, Isa Mustafa. Më 21 gusht 2014, Gjykata Kushtetuese kishte sjellë dy argumente për zgjedhjen në mënyrë jokushtetuese të Isa Musfatës në pozitën e Kryetarit të Kuvendit. Gjykata Kushtetuese argumentoi se vazhdimi i seancës pas pezullimit të saj nga Kryesuesja e Kuvendit për shkak të mungesës së kuorumit është vendim jokushtetues dhe se vendimi i Kuvendit të Kosovës për zgjedhjen e Isa Musfatës ishte jokushtetues si për nga procedura, ashtu dhe për nga përmbajtja, pasi LDK-AAK-Nisma nuk ishte grupi më i madh parlamentar. Ndonëse ky vendim i Gjykatës

Kushtetuese u kontestua nga LDK, AAK dhe Nisma, duke u cilësuar si ‘vendim politik’, Gjykata Kushtetuese konstatonte se seanca e 17 korrikut nuk kishte përfunduar.²³⁸

Vonesa gjashtëmujore në formimin e institucioneve, që në zhargonin politik kosovar quhej ‘ngërç politik’, pritej të ndikonte edhe në ambientin e të bërit biznes në Kosovë. Kjo ishte reflektuar edhe në raportin e Bankës Botërore ‘Të bërit biznes’ për vitin 2014, ku Kosova renditej në vendin e 81-të. Si rezultat i thjeshtëzimit të procedurave në regjistrimin e bizneseve dhe shkurtimin e afateve kohore të pritjes, kjo renditje e Kosovës avancoi në raportin e vitit 2015.²³⁹

Pas aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, LDK-ja u shkëput nga koalicioni me AAK-në, Nismën dhe VV-në (VLAN), duke iu bashkuar koalicionit me PDK-në për formimin e institucioneve.²⁴⁰ Për gjashtë muaj rresht LDK-ja kishte qëndruar e bashkuar me AAK-në, VV-në dhe Nismën në bllokun opozitar, madje e gjithë fushata e LDK-së ishte ndërtuar si një fushatë anti-PDK. LDK-ja ishte zotuar publikisht disa herë se nuk do të futej asnjëherë në koalicion me PDK-në. Sidoqoftë, me 8 dhjetor formalisht u konstituua legjislatura e pestë, falë koalicionit të krijuar mes PDK-së (me 35 ulëse), LDK-së (me 33 ulëse), Listës Srpska (me 11 ulëse) dhe grupit minoritar joserb 6+ (me 6 ulëse). Hyrja e menjëhershme e LDK-së në koalicion me PDK-në u gjykua për joparimësi nga shoqëria civile, partitë opozitare dhe nga një pjesë e vetë anëtarësisë së LDK-së. S’do mend se ky ishte koalicion jo programatik, por

²³⁸ Gjykata Kushtetuese, ‘Aktgjykim në rastin Nr. Ko 119/14 Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit Nr. 05-V-001, të votuar nga 83 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të 17 korrikut 2014’, Prishtinë, 26 gusht 2014. Qasur në http://www.gjk-ks.org/repository/docs/gjk_ko_119_14_shq.pdf (13 Mars 2016).

²³⁹ World Bank, ‘Doing Business 2015: Going Beyond Efficiency’, (International Bank for Reconstruction and Development / The World Bank, 2014).

²⁴⁰ ‘Ja Marrëveshja e Plotë PDK-LDK’, Kallxo.com. 18 dhjetor 2014. Shih <http://kallxo.com/ja-marreveshja-e-plote-pdk-ldk-dokument/> (23 korrik 2016).

pragmatik. Sipas marrëveshjes së këtij koalicioni, përpos ndarjes së dikastereve qeveritare, LDK-ja mori pozitën e Kryeministrit dhe Isa Mustafa u zgjodh Kryeministër i Kosovës, kurse PDK-ja mori pozitën e Kryetarit të Kuvendit, të zëvendës-kryeministrit të parë, të udhëhequr nga Hashim Thaçi. Sipas marrëveshjes së koalicionit qeverisës mes LDK-së dhe PDK-së, pas përfundimit të mandatit të Atifete Jahjagës si presidente e vendit, posti i Presidentit të Kosovës do t'i kalonte Hashim Thaçit. Më 26 shkurt 2015, Hashim Thaçi u zgjodh në pozitën e Presidentit të vendit, në raundin e tretë të votimeve me 71 vota, përmes një kuorumi prej 2/3 të të gjithë deputetëve të pranishëm në sallën e Kuvendit.²⁴¹

Ndonëse koalicioni PDK-LDK kishte shumicën e votave (PDK – 37 ulëse, LDK – 30 ulëse) të nevojshme në Kuvendin e Kosovës për t'i kaluar shumicën e ligjeve duke mos u varur kështu në mënyrë të drejtpërdrejtë nga votat e Listës Srpska (e cila në zgjedhjet e vitit 2014 kishte fituar 9 ulëse), që nga dalja e LDK-së nga koalicioni VLAN, partitë e mbetura në opozitë – VV, AAK dhe Nisma – nuk kanë reshtur së kontestuari çdo veprim të këtij koalicioni. Fillimisht, vetë formimi i koalicionit PDK-LDK u cilësua si 'fund i një epoke politike', 'fatkeqësi për Kosovën', ose koalicion 'për heshtjen e dosjeve të ShIK-ut dhe Musfatës'. Ilir Deda nga VV, duke kritikuar koalicionin joparimor PDK-LDK si një koalicion për kapjen e shtetit, rikujtonte se vetë Isa Mustafa ishte bërë kryetar i LDK-së duke promovuar një frymë krejtësisht anti-PDK. Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, koalicionin PDK-LDK e shihte si fatkeqësi për Kosovën dhe si përzierje të dy shkollave të dështuara qeverisëse. Ish-Kryetari i VV-së, Albin Kurti, e shihte koalicionin

²⁴¹ Në rastin e zgjedhjes së Hashim Thaçit në pozitën e Presidentit të Kosovës, Kuvendi i Kosovës ishte i kujdesshëm që të mos përsëriste gabimet e bëra në procedurën e votimit të Behgjet Pacollit për President të Kosovës. Në rastin e zgjedhjes së Thaçit në sallën e Kuvendit ishin të pranishëm 81 deputetë, kurse në rastin e Pacollit ishin të pranishëm vetëm 65 deputetë në raundin e tretë. Pacolli nuk kishte ndonjë kundërkandidat, PDK i kishte vendosur një kundërkandidat formal Thaçit (Rafet Ramën).

PDK-LDK si koalicion të heshtjes së krimeve të ndërsjella të këtyre partive, ku LDK-ja amnistion PDK-në dhe ShIK-un për krime dhe korrupsion, kurse PDK-ja e amnistion LDK-në për krimet e bëra në nivel të Komunës së Prishtinës në kohën kur Isa Mustafa ishte Kryetar i saj, kundrejt të cilit VV-ja kishte dorëzuar 70 lëndë në prokurori. Metafora që kishte përdorur Albin Kurti për të përshkruar koalicionin PDK-LDK ishte kjo: “Këta ishin dy trupa, një karrige, pa asnjë tru”.²⁴²

6.3 Kauzat opozitare

Përkundër kritikave rationale të partive politike dhe të shoqërisë civile në Kosovë kundrejt koalicionit të sapoformuar PDK-LDK si koalicion joparimor, bashkësia ndërkombëtare, respektivisht ShBA-ja dhe vendet e BE-së që e kishin përkrahur pavarësinë e Kosovës, ndoqën një qasje pragmatike. Atyre u interesonte një stabilitet institucional, respektivisht një koalicion i madh që do t'i kishte votat e nevojshme për të kaluar vendime të vështira që e pritnin Kosovën më 2015. Vendimi i parë i vështirë me të cilin do të ballafaqohej ky koalicion ishte themelimi i Gjykatës Speciale, përmes të cilës do të vërtetoheshin pretendimet e raportit të senatorit të Këshillit të Evropës, Dick Marty, rreth përfshirjes së ish-pjesëtarëve të UÇK-së në krime lufte.²⁴³

²⁴² Kurti: Koalicioni PDK-LDK u bë për të heshtur dosjet e SHIK-ut e Mustafës', Kohanet, 20 nëntor 2014. Qasur në <http://koha.net/?id=27&l=33985> (13 korrik 2015); 'Ramush Haradinaj: Koalicioni PDK-LDK, fatkeqësi për vendin', Kohanet, 20 nëntor 2014. Qasur në <http://koha.net/?id=27&l=33954> (13 korrik 2015); 'Kurti: Koalicioni PDK-LDK u bë për të heshtur dosjet e SHIK-ut e Mustafës', Kohanet, 20 nëntor 2014. Qasur në <http://koha.net/?id=27&l=34003> (13 korrik 2015).

²⁴³ Parliamentary Assembly, 'Inhuman treatment of people and illicit trafficking in human organs', (Committee on legal Affairs and Human Rights, 12 dhjetor 2010)/ Qasur në

Thaçi, fjala vjen, në një rën anë, formimin e kësaj gjykate e shihte si një padrejtësi dhe imponim që po i bëhej Kosovës, kurse në anën tjetër si një domosdoshmëri për ta ruajtur partneritetin me ShBA-në dhe Bashkimin Evropian, që e kërkonin me ngulm themelimin e këtij mekanizmi.²⁴⁴ Përkundër shqetësimeve legjitime se Gjykata Speciale do ta përkeqësonte edhe më tutje imazhin tashmë jo aq pozitiv të Kosovës në arenën ndërkombëtare, Kosova nuk kishte shumë opsione para vetes. Partnerët ndërkombëtarë të Kosovës ishin të qartë në qëndrimin se në rast që Kosova do të dështonte në themelimin e kësaj gjykate, Gjykata Speciale do të themelohej nga Kombet e Bashkuara, respektivisht nga Këshilli i Sigurimit. Ky opsion do të ishte edhe më i keq për Kosovën, për shkak se kundërshtarët e pavarësisë së Kosovës, veçanërisht Rusia, do të provonin ta degradonin subjektivitetin ndërkombëtar të Kosovës.

Në prill 2014, deputetët e Kuvendit të Kosovës, me 89 vota dhe 22 kundër, ratifikuan marrëveshjen Kosovë-BE që t'i hapte rrugë themelimit e Gjykatës Speciale. Për të mundur themelimin e saj, do të duhej të amendohej Kushtetuta e Kosovës. Qeveria e Kosovës i kishte propozuar Kuvendit një amendament me 7 mars. Më 9 mars 2015, kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, e kishte dërguar të njëjtin amendament në Gjykatën Kushtetuese për ta vlerësuar kushtetutshmërinë e tij. Sipas këtij amendamenti, Kushtetutës së Kosovës do t'i shtohej neni 162. Neni 162 themelonte Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar. Përkundër faktit se Lëvizja Vetëvendosje në komentet e veta dërguar Gjykatës Kushtetuese argumentonte se ky amendament synonte të krijonte paralelizëm në sistemin gjyqësor të Kosovës, Gjykata

http://assembly.coe.int/CommitteeDocs/2010/20101218_ajdoc462010provamende.d.pdf (5 nëntor 2015).

²⁴⁴ Bekim Shehu, 'Kuvendi i Kosovës miraton themelimin e Gjykatës Speciale', DW, 23 prill 2014. Qasur në <http://www.dw.com/sq/kuvendi-i-kosoves-miraton-themelimin-e-gjykatës-speciale/a-17587510> (5 nëntor 2015).

Kushtetuese argumentoi se amendamenti i propozuar kishte 4 elemente strukturore, të cilat ndërlidhen me sistemin e drejtësisë në Kosovë: 1) themelimi i dhomave të specializuara në kuadër të sistemit të drejtësisë së Kosovës; 2) krijimi i Zyrës së Prokurorit të Specializuar; 3) themelimi i një dhome të specializuar në kuadër të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe 4) emërimi i një Ombudspersoni të veçantë të dhomave të specializuara.

Më 15 prill 2015, Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në aktgjykimin e saj 18 faqesh kishte konstatuar se ky amendament nuk pakësonte të drejtat dhe liritë e njeriut të përcaktuara me Kapitullin II dhe III të Kushtetutës së Kosovës.²⁴⁵ Në seancën e Kuvendit të Kosovës, të mbajtur më 26 qershor 2015, koalicioni PDK-LDK e kishte vendosur në rendin e ditës këtë amendament për miratimin e ndryshimeve kushtetuese, por nuk kishte arritur ta merrte miratimin e deputetëve në Kuvendin e Kosovës. Kundër ndryshimeve kushtetuese përmes këtij amendamenti dhe hapjes së rrugës për themelimin e Gjykatës Speciale ishin VV, AAK dhe Nisma. Në anën tjetër, gati dy muaj më vonë, më 3 gusht 2015, koalicioni PDK-LDK i siguroi 82 vota, të nevojshme këto për ndryshimet kushtetuese dhe, po të njëjtën ditë, Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin Nr/05/L-053 për Dhoma të Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar.²⁴⁶

Selia e jashtme e Gjykatës Speciale pritet të vendoset në Hagë, pas nënshkrimit të një marrëveshjeje mes Kosovës me

²⁴⁵ Gjykata Kushtetuese, 'Akgjykim në Rastin nr. Ko26/15 Vlerësim i amandamentit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, propozuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe referuar më 9 mars 2015 nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, me Shkresën nr.05-433/DO-318', Prishtinë, 15 prill 2015. Qasur në http://www.gjk-ks.org/repository/docs/KO26-15_SHQ.pdf (31 korrik 2016).

²⁴⁶ Ligji Nr. 05/L-053 Për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar. 31 gusht 2015. Qasur në <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=11036> (25 korrik 2016); Për funksionimit e kësaj gjykate, shih Marija Ristic, 'Gjykata Speciale e Kosovës: Si do të funksionojë ajo?', BIRN, 6 gusht 2015. Qasur në <http://www.balkaninsight.com/al/article/gjykata-speciale-e-kosoves-si-do-te-funksionoj-a-jo--08-05-2015> (25 korrik 2016).

Holandën. Njëra prej arsyeve kryesore për krijimin e një tipi të tillë të gjykatës dhe vendosjen e saj jashtë Kosovës ishte mungesa e kapaciteteve, si të EULEX-it ashtu edhe institucioneve të Kosovës, për mbrojtjen e dëshmitarëve. Në fakt, rreth mbrojtjes së dëshmitarëve edhe në proceset e mëhershme gjyqësore të zhvilluara në Kosovë, kanë dështuar si mekanizmat e drejtësisë vendore ashtu edhe EULEX-i – ndonëse ky i fundit ka pasur në dispozicion të gjitha kapacitetet e duhura për t'i mbrojtur dëshmitarët. Dilema që u shtrua nga qytetarët e Kosovës pas miratimit të Gjykatës Speciale ishte kjo: nëse misionet e mëhershme ndërkombëtare në Kosovë (UNMIK dhe EULEX) kanë dështuar që të sjellin drejtësinë për viktimat që nga viti 1999, pse duhet të besojmë tash se bashkësia ndërkombëtare e ka përnjëmend ndjekjen e autorëve të krimeve të pretenduara?

Pos Gjykatës Speciale, janë dy kauza përmes të cilave koalicioni i partive opozitare VV-AAK-Nisma kundërshton me të gjitha mjetet qeverinë dhe koalicionin qeverisës PDK-LDK. Këto kauza janë themelimi i Asociacionit të Komunave me shumicë serbe dhe demarkacioni me Malin e Zi. Më 25 gusht 2015, qeveria e Kosovës nënshkroi një dokument të quajtur 'Asociacioni/Bashkësia e komunave me shumicë serbe në Kosovë – Parime e përgjithshme/Elementet kryesore', sipas të cilit vendoseshin parimet për konkretizimin e mëtutjeshëm të marrëveshjes së parë politike të 19 prillit 2013 për themelimin e Asociacionit të komunave me shumicë serbe. Ndonëse dokumenti nuk kishte formën e një marrëveshjeje ndërkombëtare dhe ishte dizajnuar si një dokument paraprijës për draftimin e statutit të Asociacionit të komunave me shumicë serbe, partitë politike opozitare kontestuan formën dhe përmbajtjen e tij.

Me qëllim që ta parandalonte miratimin e këtyre marrëveshjeve, koalicioni opozitar VV-AAK-Nisma pamundësoi mbajtjen normale të seancave të Kuvendit duke hedhur gaz lotsjellës së sallën e Kuvendit. Me kërkesë të Presidentes së Kosovës,

dokumenti mbi parimet e Asociacionit u dërgua në Gjykatën Kushtetuese. Kjo e fundit, në aktgjykimin KO 130/15 dha një vlerësim abstrakt dhe konstatoi se dokumenti i quajtur ‘Asociacioni/Bashkësia e komunave me shumicë serbe në Kosovë – Parime të përgjithshme/Elementet kryesore’, nuk është tërësisht në përputhshmëri me frymën kushtetuese’. Gjykata Kushtetuese vlerësoi se ky dokument shkel barazinë para ligjit të qytetarëve të Kosovës, të drejtat dhe liritë themelore, dhe të drejtat e komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre.²⁴⁷

Përpos kësaj kauze, koalicioni opozitar VV-AAK-Nisma ka kritikuar edhe marrëveshjen e gushtit 2015 për vendosjen e demarkacionit mes Kosovës dhe Malit të Zi, të nënshkruar në Vjenë nga tashmë ish-Ministri për Punë të Jashtme i Kosovës, Hashim Thaçi. Ndërsa kauza primare e VV-së ishte Asociacioni i komunave me shumicë serbe, AAK-ja që nga fillimi e kishte ngritur çështjen e demarkacionit. Të dyja marrëveshjet, sipas opozitës, cenojnë rëndë integritetin territorial dhe sovranitetin e Kosovës: ajo e asociacionit duke e defunksionalizuar shtetin e Kosovës me një ‘Republika Srpska’ brenda tij, kurse demarkacioni duke i falur mijëra hektarë tokë Malit të Zi.²⁴⁸ Gjykata Kushtetuese vendosi pikat e kuqe dhe renditi nenet antikushtetuese të dokumentit për Asociacionin e komunave me shumicë serbe. Paralelisht me këtë dokument,

²⁴⁷ Gjykata Kushtetuese, ‘Aktgjykim në rastin nr. KO 130/15 lidhur me vlerësimin e përputhshmërisë së parimeve që përmban dokumenti i titulluar ‘Asociacioni/Bashkësia e komunave me shumicë serbe në Kosovë – Parimet e përgjithshme/Elementet kryesore’ me frymën e Kushtetutës, me nenin 3 [Barazia para Ligjit], paragrafi 1, me Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] dhe Kapitullin III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës’, Prishtinë, 23 dhjetor 2015. Qasur në http://www.gjks.org/repository/docs/gjk_ko_130_15_shq.pdf (5 prill 2016).

²⁴⁸ Për një perspektivë shkencore për marrëveshjen e demarkacionit Kosovë-Mali i Zi shih: Friedrich Ebert Stiftung, ‘Demarkacioni Kosovë – Mali i Zi (Aspektet Ndërkombëtare, Gjeografike, Politike dhe Historike), Prishtinë, 2015. Qasur në <http://www.fes-prishtina.org/wb/media/2015/Studimi%20per%20demarkacionin%20%20Kosove%20Mali%20i%20zi.pdf> (12 qershor 2016).

aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese është dokument referues kurdo që të draftohet Statuti i Asociacionit të komunave me shumicë serbe. Megjithatë, Gjykata Kushtetuese nuk konstatoi se Asociacioni i komunave me shumicë serbe nuk duhet të themelohet. Në anën tjetër, ndonëse marrëveshja e Kosovës për demarkacion me Malin e Zi nuk është ratifikuar ende në Kuvendin e Kosovës, dhe si e tillë nuk paraqet obligim ndërkombëtar për Kosovën, partitë opozitare theksojnë se me këtë marrëveshje Kosova po humb territor. Derisa për rastin e themelimit të Asociacionit të Komunave me shumicë serbe, Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar aspektet jokushtetuese të dokumentit të prezantuar, në rastin e demarkacionit metoda e ndjekur për përcaktimin e vijës kufitare, sipas praktikave ndërkombëtare të shënimit të kufijve, duket se ka qenë një gabim elementar i palës kosovare.

Përpos hedhjes së gazit lotsjellës në Kuvendin e Kosovës në mënyrë të vazhdueshme që nga tetori 2015²⁴⁹, opozita organizoi edhe një peticion, duke tubuar 200 mijë nënshkrime të qytetarëve kundër marrëveshjes për asociacionin dhe demarkacionin, si dhe disa protesta masive në Prishtinë.

6.4 Tentativat për rrugëdalje nga ‘kriza’

Hedhja e gazit lotsjellës në hapësirat e Kuvendit të Kosovës u kritikua nga Kryetari i Kuvendit dhe nga Presidentja e Kosovës. Kundër hedhjes së gazit lotsjellës reagoi edhe zyra e BE-së në

²⁴⁹ Për herë të parë gazi lotsjellës u hodh më 8 tetor. Më 12 tetor, gjatë një përplasjeje me policinë e Kosovës, u arrestua Albin Kurti, deputet i VV-së. Më 15 tetor gazi lotsjellës hidhet për të dytën herë në Kuvendin e Kosovës. Më 30 nëntor arrestohen disa deputetë nga opozita për hedhjen e gazit lotsjellës. Më 14 dhjetor hidhet përsëri gaz lotsjellës në kohën kur Kuvendi i Kosovës po aprovonte buxhetin. Për më shumë shih ‘Kosovo parliament hit by fresh tear-gas protest’, BBC News, 14 dhjetor 2015. Qasur në <http://www.bbc.com/news/world-europe-35096489> (15 qershor 2016).

Kosovë.²⁵⁰ Sipas matjeve të opinionit publik prej UNDP-së, vetëm 9.7% e qytetarëve i miratonin veprimet e dhunshme të protestuesve, si hedhja e gurëve, dëmtimi i pronës publike etj., kurse 72.9% e qytetarëve miratonin protestat paqësore kundër qeverisë. Sipas të njëjtit hulumtim mbi 70% e qytetarëve ishin të pakënaqur me drejtimin politik të Kosovës.²⁵¹

Ambasadori amerikan, Greg Delawie, dënoi po ashtu hedhjen e gazit nga opozita në Kuvendit e Kosovës. Në një deklaratë më 14 dhjetor 2015, Delawie theksonte se hedhja e gazit në Kuvendin e Kosovës nga disa anëtarë të tij ishte dëshpëruese. Ai rikujtonte porosinë e Sekretari të Shtetit Amerikan, John Kerry, që kishte qëndruar në Kosovë për t'i inkurajuar liderët të dialogonin dhe të mos përdornin dhunën në Kuvend. Dy muaj më herët, më 2 tetor 2015, Delawie kishte deklaruar se ambasada amerikane nuk e favorizonte asnjërën parti politike në Kosovë, dhe se punonte me përfaqësuesit e zgjedhur të Kosovës. Ai nënvizonte se ishin 23 ligje që prisnin leximin e parë ose të dytë në Kuvend, të cilat kishin për qëllim ta avanconin ekonominë e Kosovës. Opozita e Kosovës, sipas ambasadorit Delawie, duhet të kuptonte se partitë që formojnë koalicionin e shumicës i përcaktojnë politikën, dhe nëse këto politika nuk pëlqehen, partitë duhet ta bindin elektoratin e tyre në agjendën e tyre në zgjedhjet e ardhshme të 2018.

Në lidhje me dokumentin e gushtit 2015 për formimin e Asociacionit të Komunave me shumicë serbe, Delawie kishte deklaruar se “gjuha e marrëveshjes është e drejtpërdrejtë. Nuk duhet

²⁵⁰ “Zyra e BE-së në Kosovë, Përfaqësuesi Special i BE-së, i ka bërë thirrje opozitës që të tregojë respekt për institucionet e popullit të Kosovës, të përmbahet nga dhuna që kërcënon sigurinë e njerëzve dhe funksionimin normal të shkollave dhe shërbimeve publike”. Shih për më shumë në ‘Ambasadorja gjermane kërkon dialog në vend të dhunës në Kosovë’, Qasur në <http://www.telegrafi.com/ambasadorja-gjermane-kerkon-dialog-ne-vend-te-dhunes-ne-kosove/> (18 qershor 2016).

²⁵¹ United Nation Development Programme, ‘Pulsi Publik XI’, (Prishtinë, maj 2016), f. 10.

të jeni avokat që ta kuptoni. Është e qartë për ne se kjo marrëveshje është në përputhje me ligjet dhe Kushtetutën e Kosovës”.²⁵² Përkundër kësaj deklarate eksplicite të ambasadorit Delawie, Gjykata Kushtetuese gjeti se dokumenti ‘Asociacioni i komunave me shumicë serbe – parimet e përgjithshme’ nuk ishte në tërësi në përputhje me Kushtetutën e Kosovës. Në anën tjetër, përkundër paralajmërimit të ambasadorit Delawie se partitë opozitare duhet të bëheshin gati për zgjedhjet e vitit 2018, koalicioni i partive opozitare kishte insistuar vazhdimisht për organizimin e zgjedhjeve të jashtëzakonshme, pikërisht për shkak të nënshkrimit të këtij dokumenti.

Pos ambasadorit amerikan, edhe ambasadorja gjermane në Kosovë, Angelika Viets, hodhi dyshime nëse ekzistonte një bllok opozitar, apo një bllok interesash. Në këndvështrimin e ambasadores Viets, bllokimi i punës së Kuvendit të Kosovës nuk i ngjasonte një krize institucionale, pasi qeveria e zgjedhur ishte stabile dhe me 82 ulëse në Kuvend. Opozita, sipas qëndrimit të ambasadores Viets, duhet t’u përmbahej rregullave të demokracisë. Thirrjet e koalicionit opozitar për zgjedhje të reja, ajo i konsideroi të paarsyeshme. Sipas saj “kushdo që është një pakicë parlamentare mund të kundërshtojë të gjitha procedurat demokratike; kjo është plotësisht e papranueshme”.²⁵³ Ambasadorja Viets kishte hedhur dyshime se protestat e organizuara nga partitë opozitare ishin tentativë për ta bllokuar Gjykatën Speciale. Në deklaratën e saj thuhej: “Kjo mund të jetë një tentativë për ta çuar vendin në zgjedhje të reja, për të dëshmuar se qeveria është e pasuksesshme, tentativë për t’u përfshirë në pushtet ose tentativë për t’i shtyrë disa procese të tilla si

²⁵² Embassy of the United States Pristina – Kosovo, ‘Ambassador Delawie’s Interview with Koha Ditore’, 2 tetor 2015. Qasur në http://pristina.usembassy.gov/interview_kd_2015.html (5 qershor 2016).

²⁵³ Arbana Xhara, ‘S’ka bllok opozitar’, Zëri, 16 tetor 2015. Qasur në <http://zeri.info/aktuale/56582/s-ka-blllok-opozitar-ka-interesa/> (17 korrik 2016).

funksionalizimi i Gjykatës Speciale; hakmarrje ndaj Kryeministrit ose të gjitha këto së bashku”.²⁵⁴

Si rrugëdalje për krizën, ambasadorja gjermane kishte propozuar një ‘Komision Ndërmjetësues’ për tejkalimin e saj.²⁵⁵ Iniciativa për daljen nga kriza kishte edhe më herët. Në nëntor 2015, Ilir Deda dhe Vjosa Osmani, deputetë nga VV dhe LDK, kishin propozuar një marrëveshje politike pesëpikëshe për dalje nga kriza, ku parashihej formimi i një komisioni hetues të udhëhequr nga opozita për të shqyrtuar demarkacionin me Malin e Zi, vlerësimin e kushtetutshmërisë së Asociacionit të Komunave me shumicë serbe nga Gjykata Kushtetuese dhe, nëse kjo e fundit linte dilema të pazgjidhura, propozonin që Kuvendi i Kosovës t’i drejtohet Komisionit të Venecias, dhe kjo marrëveshje të mbikëqyrej nga Presidentja e Kosovës.²⁵⁶ Raportuesja për Kosovën në Parlamentin Evropian, Ulrike Lunacek, kishte përkrahur propozimin pesëpikësh të Dedës dhe Osmanit, duke e konsideruar atë si pikënisje për funksionalizimin e Kuvendit të Kosovës përmes dialogut politik mes liderëve partiakë. Ajo kishte deklaruar se “eskalimi i mëtejshëm i dhunës do ta bënte shumë të vështirë argumentimin e miqve të Republikës së Kosovës për integrim të mëtejshëm të shtetit më të ri evropian në BE, veçanërisht kur kemi të bëjmë me bindjen e Ministrave të Brendshëm vitin e ardhshëm – pasi Komisioni

²⁵⁴ ‘Ambasadorja e Gjermanisë: Protestat mund të jenë tentativë për bllokimin e Gjykatës Speciale’, Gazeta Zëri, 18 nëntor 2015. Qasur në <http://zeri.info/aktuale/62740/ambasadorja-e-gjermanise-protestat-mund-te-jene-tentative-per-blokimin-e-gjykates-speciale/> (5 mars 2016).

²⁵⁵ ‘Intervistë me ambasadorën gjermane: Të themelohet një Komision Ndërmjetësues për tejkalimin e krizës’, Gazeta Express, 9 mars 2016. Qasur në <http://www.gazetaexpress.com/intervista/interviste-me-ambasadoren-gjermane-te-themelohet-nje-komision-ndermjetesues-per-tejkalimin-e-krizes-video-174615/> (10 mars 2016).

²⁵⁶ ‘Marrëveshja që Osmani e Deda kanë propozuar për dalje nga kriza’, Gazeta Zëri, 20 nëntor 2015. Qasur në <http://zeri.info/aktuale/63101/kjo-eshte-propozim-marreveshja-e-propozuar-nga-deda-dhe-osmani-per-dalje-nga-kriza-dokument/>

[Evropian] me gjasë do t'ia japë dritën e gjelbër Këshillit [Evropian] në dhjetor – që ta japin dritën e gjelbër për liberalizim vizash”.²⁵⁷

Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën i vitit 2015 kishte theksuar rritjen e polarizimit mes Qeverisë dhe opozitës. Në këtë raport theksohet se “vonesa rreth konstituimit të Kuvendit pas zgjedhjeve të vitit 2014 e ka ngadalësuar procesin e reformimit në Kosovë. Pengimi i dhunshëm i sesioneve të fundit plenare nga deputetët e opozitës ka ndikuar negativisht në funksionimin e Kuvendit. Veprimet e tilla janë në kundërshtim me vlerat evropiane”.²⁵⁸

Propozimi pesëpikësh i deputetëve Deda dhe Osmani për tejkalimin e krizës politike dhe rivendosjen e dialogut nuk u mor për bazë as nga vetë kryetarët e partive të Dedës dhe të Osmanit, e as nga kryetarët e partive të tjera politike. Deri më tani (në momentin kur po shkruhet ky punim, tetor 2016), as propozimi i Ambasadores Gjermane, Angelika Viets, nuk është konsideruar seriozisht nga partitë politike. Megjithatë, elementet që përmend propozimi i deputetëve Deda dhe Osmani që kriza të zgjidhet përmes një dialogu në një tryezë me liderët e partive politike dhe elementet që përmenden tek propozimi i Ambasadores Viets, pra që pakica opozitare të mos përmbysë procedurat dhe rregullat e lojës të demokracisë, mund të gjenden në një raport studimor të Komisionit të Venecias (Komisionit Evropian për Demokraci Nëpërmjet Ligjit).

Në raportin ‘Roli i Opozitës në një Parlament Demokratik’ të Këshillit të Evropës, të aprovuar në tetor 2010, nënvizohej se parimi i qeverisjes së shumicës është njëra prej kërkesave formale dhe legale të demokracisë. Në këtë raport, termi ‘opozitë’ ka dy kuptime. Si funksion, opozita ofron të gjitha argumentet që kundërshtojnë politikat e shumicës dhe të qeverisë, kurse si subjekt opozita ka të

²⁵⁷ ‘Lunacek mirëpret propozimin e Osmanit e Dedës’, Shih <http://koha.net/?id=27&l=85365> (10 mars 2016).

²⁵⁸ Komisioni Evropian, ‘Dokument Pune i Personelit të Komisionit: Raporti për Kosovën 2015’, Bruksel, 10.11, 2015, SWD (2015) 215 final, f. 6.

bëjë me një ose disa parti që nuk e udhëheqin qeverinë. Edhe pse zakonisht në sistemet parlamentare partitë apo koalicionet që e formojnë qeverinë e kanë shumicën në parlament, duke siguruar mbështetje nga kjo shumicë, ka edhe raste të tjera në Evropë ku kanë udhëhequr ‘qeveritë e pakicave’, të cilat nuk e kanë pasur shumicën në parlament. Këto qeveri kanë qenë të detyruara të bashkëpunojnë me njërën prej partive opozitare, në mënyrë që të sigurojnë një shumicë stabile për vendimmarrje në parlament.

Opozita parlamentare konsiderohet pakicë dhe pakica, sipas këtij përkufizimi, nuk mund të qeverisë. Megjithatë, opozita ka tetë funksione të tjera vitale. Nëse pamundësohet ushtrimi i këtyre funksioneve nga opozita, atëherë një sistem i tillë nuk mund të konsiderohet demokraci. Këto funksione, sipas raportit të Këshillit të Evropës, ‘Roli i Opozitës në një Parlament Demokratik’, janë:

1. Të ofrojë alternativa politike;
2. Të artikulojë dhe të promovojë interesat e votuesve të tyre;
3. Të ofrojë alternativë për vendimet e propozuara nga qeveria dhe përfaqësuesit e shumicës;
4. Të përmirësojë procedurat e vendimmarrjes parlamentare duke siguruar debat, refleksion dhe kundërshtim;
5. Të monitorojë legjislativin dhe propozimet buxhetore të qeverisë;
6. Të mbikëqyrë qeverinë dhe administratën;
7. Të rrisë stabilitetin, legjitimitetin, llogaridhënien dhe transparencën në proceset politike.²⁵⁹

²⁵⁹ European Commission for Democracy Through Law, ‘Report on the role of the opposition in a democratic parliament’, Strasbourg, 15 November 2010, Study no.497/2008. Qasur në [http://www.venice.coe.int/eebforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2010\)025-e](http://www.venice.coe.int/eebforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2010)025-e) (16 maj 2016).

Sipas raportit të lartpërmendur, mungesa e një opozite të fortë mund t'i çojë vendet e ndryshme drejt një forme të opozitarizmit jashtëparlamentar. Kjo formë e opozitarizmit jashtëparlamentar mund të shprehet përmes protestave të dhunshme, duke e bërë kësaj jorelevant debatin parlamentar. Njëra prej mënyrave të parandalimit të kësaj tendence të opozitarizmit jashtëparlamentar është zvogëlimi i pragut zgjedhor për të hyrë në parlament. Edhe pse disa vende anëtare të Këshillit të Evropës e kanë pragun zgjedhur shumë të lartë, si Turqia (10%), Lihtenshtajni (8%), Federata Ruse (7%), Gjeorgjia (7%), Kosova ka një prag zgjedhor prej 5%. Për shkak se koalicioni qeverisës ka shumicën e votave në parlament, opozita në Kosovë ka zgjedhur edhe rrugën parlamentare edhe atë jashtëparlamentare për t'i kundërshtuar politikat qeveritare.

Raporti i Komisionit të Venecias thekson se opozita ka një obligim dhe përgjegjësi fundamentale. Veprimet e saj duhet të zhvillohen brenda kornizës ligjore, kushtetutës, kodeve civile dhe penale, dhe ajo është e obliguar t'i respektojë ato për aq kohë sa janë në fuqi. Në anën tjetër, opozita duhet të jetë e vetëdijshme se pa opozitë nuk mund të ushtrohet demokracia parlamentare.²⁶⁰ Rezoluta 1601 (2008), e aprovuar nga Këshilli i Evropës, rregullon në mënyrë konkrete të drejtat dhe përgjegjësitë e opozitës në parlamentet demokratike. Sipas kësaj rezolute, shumica parlamentare dhe qeveria duhet të jenë të pjekura dhe të gatshme për kompromise në të mirë që qeverisjes së vendit, duke kujtuar se partitë që janë në qeveri mund të humbin dhe të dalin në opozitë, si dhe anasjelltas.²⁶¹

Analistët dhe studiuesit e politikës kanë qëndrime të ndryshme sa u përket protestave opozitare. Politologu Agron Demi argumenton:

²⁶⁰ Po aty.

²⁶¹ Council of Europe, 'Parliamentary Assembly Doc.11465 Procedural guidelines on the rights and responsibilities of the opposition in a democratic parliament'. 3 January 2008. Qasur në <http://assembly.coe.int/nw/xml/XRef/X2H-Xref-VieëHTML.asp?FileID=11792&lang=en> (16 maj 2016).

Në një sistem me qeverisje demokratike, qeverisja nga shumica nuk nënkupton injorimin e pakicës parlamentare. Protestat e VV-AAK-Nisma, burimin e kanë tek pamundësia për të ndikuar përmes procesit parlamentar. Si të tilla, protestat janë legjitime, sidomos në rastet kur vendimet e Qeverisë rrezikojnë rendin kushtetues, ashtu siç është rasti me Asociacionin e komunave serbe. Por, qasja e opozitës se duhet ndaluar qeveria me çdo kusht dhe pa kompromis, është e njëjtë me qasjen e pushtetit se nuk ka nevojë për kompromis për shkak se ata e kanë shumicën.²⁶²

Politologu Artan Mustafa, në njërën anë, ka shtruar nevojën për maturimin e Lëvizjes Vetëvendosje për të marrë përgjegjësi udhëheqëse që punon në mënyrë sistematike për një shoqëri të barabartë e të lirë në Kosovë dhe, në anën tjetër, ka përmendur dhunën strukturore që kanë ushtruar partitë politike si PDK, LDK, AAK dhe themeluesit e partisë Nisma. Sipas tij:

Nuk duhet të harrohet që gazi lotsjellës në Kuvend dhe gjithë arrestimet e dënimet e ndërlidhura me të, janë edhe një thumbim i hollë. Sepse dhuna e establishmentit të PDK-së, LDK-së, AAK-së dhe Nismës, në mënyrë strukturore, ka qenë pakrahasimisht më e madhe dhe më e dëmshme ndaj Kosovës, imazhit të saj, vendeve të punës, lirisë së banorëve të saj. Të gjithë e dinë që derisa VV-ja “kërcënon” me forcë, establishmenti shkohet në qeshuri duke e ditur kush në të vërtetë posedon forcën.²⁶³

Të dyja palët – si opozita ashtu edhe qeveria – e kishin kushtëzuar dialogun politik të ndërsjellë me kërkesa maksimaliste. Meqenëse zgjedhjet e qershorit 2014 janë vlerësuar si zgjedhje të lira, fer dhe

²⁶² Intervistë me z. Agron Demi, politolog dhe Drejtor Ekzekutiv në institutin GAP, Prishtinë, 5 prill 2016.

²⁶³ Intervistë me z. Artan Mustafa, politolog dhe gazetar, Prishtinë, 5 prill 2016.

demokratike, partitë që e kanë formuar koalicionin qeverisës e konsiderojnë veten si koalicion legjitim për të qeverisur me Kosovën, kurse partitë opozitare duan zgjedhje të jashtëzakonshme, për shkak se, sipas tyre, qeveria ka shkelur Kushtetutën e Kosovës me marrëveshjet jokushtetuese për ‘demarkacion dhe asociacion’. Partitë opozitare argumentojnë se koalicioni qeverisës PDK-LDK nuk e ka marrë legjitimitetin për të nënshkruar marrëveshje të tilla. Ndonëse politikisht këto kërkesa janë legjitime, për shkak se çdoherë opozita synon t’i kundërshtojë politikat e qeverisë, të ofroj alternativa qeverisëse dhe t’i fitojë zgjedhjet e ardhshme, partitë opozitare deri më tani nuk kanë ofruar ndonjë alternativë qeverisëse. Ka dilemë nëse kauzat e opozitës kanë peshë domethënëse për qytetarët, në mënyrë që këta ta ridrejtojnë votën e tyre elektorale nga PDK-LDK drejt partive opozitare.

Përtej ‘kauzave të mëdha’ si asociacioni dhe demarkacioni, shkalla e lartë e papunësisë, spitalet me aparatura të vjetruara, mungesa e sigurimit shëndetësor, drejtësia sociale për grupe të marginalizuara, mungesa e sundimit të ligjit, korrupsioni dhe shkalla e lartë e informalitetit, janë ‘kauza të vogla’ që prekin të gjithë qytetarët e Kosovës. Ndonëse këto tema mund edhe të mos jenë të denja për partitë e mëdha politike – janë pikërisht ato që e përcaktojnë zhvillimin demokratik dhe mirëqenien e përgjithshme të shoqërisë kosovare.

Kriza e fundit, sido që ta emërtojmë, si krizë reale ose artificiale, është para së gjithash krizë e partive politike. E atyre që kërkojnë me çdo kusht ta mbajnë pushtetin dhe atyre që me çdo kusht e kërkojnë pushtetin. Mungesa e alternativave qeverisëse, marrja ‘peng’ e partive nga liderët partiakë, mungesa e qarkullimit të ideve dhe të lidërshiptit brendapartiak, ka prodhuar dhe po prodhon bllokim institucional dhe dëmtim të vazhdueshëm të publikes.



MES STABILITETIT
DHE DEMOKRATIZIMIT

KAPITULLI VII

KAPITULLI 7:

ZHVILLIMI EKONOMIK, KORRUPSIONI
DHE ZHGËNJIMI NGA EULEX-I

KAPITULLI 7: ZHVILLIMI EKONOMIK, KORRUPSIONI DHE ZHGËNJIMI NGA EULEX-i

Duke e marrë si bazë ndarjen që Max Weber u ka bërë shteteve në patrimoniale (shtete të qeverisura nga interesat personale) dhe moderne (shtete që distancojnë qeverisjen nga interesi personal), Fukuyama shtetet si Kosova do t'i klasifikonte si shtete neopatriomiale – ose shtete që formalisht i kanë institucionet e një shteti modern, por që në praktikë i përdorin ato për interesa personale.²⁶⁴

7.1 Zhvendosja paradigmatiche nga UNMIK-u tek EULEX-i në fushën e sundimit të ligjit

Gjatë dekadës së fundit UNMIK-u kishte vendosur stabilitetin si prioritet kryesor në Kosovë dhe jo zhvillimin ekonomik e sundimin e ligjit. Meqë statusi politik i Kosovës kishte mbetur pezull, konsideratat primare të UNMIK-ut në periudhën e administrimit mbi Kosovën (1999-2008) udhëhiqeshin nga premiset e stabilitetit. Duke u udhëhequr nga këto premisa, UNMIK-u nuk preokupohej me demokratizimin e vendit dhe transparencën e llogaridhënien e lidershipit politik të Kosovës kundrejt qytetarëve të saj. Kjo prodhoi një ‘paqe të korruptuar’, nëpërmjet të cilës mirëmbahej *status quo*-ja në Kosovë me çmimin e legjitimitetit të një klase politike kosovare, e cila po përfshihej gjithnjë e më shumë në afera korrupsioni dhe krim

²⁶⁴ Intervistë me z. Agron Demi, politolog dhe Drejtor Ekzekutiv në institutin GAP, Prishtinë, 5 prill 2016.

të organizuar. Mjafton këtu të themi se në procesin e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore në Kosovë, proces që fillimisht udhëhiqej nga UNMIK-u dhe, pas pavarësisë së Kosovës, nga institucionet vendore, lidhshipi politik vendor ishte përfshirë edhe vetë në procesin e privatizimit, duke marrë në pronësi dhe duke blerë toka bujqësore, ndërmarrje shoqërore, ose fabrika, me para të dyshimta. Ndonëse UNMIK-u ishte i vetëdijshëm për këto keqpërdorime, zyrtarët e tij e tregtonin stabilitetin e misionit të tyre dhe paqen negative në Kosovë. Siç ka vënë re Denisa Kostovicova, UNMIK-u është kritikuar vazhdimisht për qeverisje ekonomike joefektive në Kosovë. UNMIK-u nuk kishte arritur t'i luftonte strukturat klandestine dhe kriminale as në mesin e shqiptarëve dhe as të serbëve. Sipas Kostovicova-s: “UNMIK-u e bleu stabilitetin politik duke i toleruar strukturat lokale kriminale. Ekzistenca e papenguar e operacioneve të inteligjencës në hije, të kontrolluar nga partitë politike shqiptare, si dhe strukturat e sigurisë në hije, të vendosura nga Beogradi në komunitetin serb në Kosovë, e ilustronjë këtë”.²⁶⁵

Për Seymour Lipset ekziston një lidhje e pazgjidhshme mes legjitimitetit, demokracisë dhe stabilitetit të një sistemi politik.²⁶⁶ Një sistem politik që e bazon legjitimitetin në zgjedhje të lira dhe demokratike, por edhe në performancën e vet, duke qenë i suksesshëm në përmbushjen e nevojave të qytetarëve të tij, është një sistem stabil. Nëse e masin me këtë kriter administrimin e UNMIK-ut në Kosovë, atij i mungonte legjitimiteti i brendshëm, për shkak se nuk ishte mision i votuar nga qytetarët e Kosovës, dhe po tregohej i pasuksesshëm edhe me adresimin e nevojave të qytetarëve të Kosovës. Për ironi, as lidhshipi politik nuk e kishte shndërruar zhvillimin ekonomik në prioritet kryesor të vendit. Duke e pasur për

²⁶⁵ Denisa Kostovicova, ‘Legitimacy and International Administration: The Ahtisaari Settlement for Kosovo from a Human Security Perspective’, *International Peacekeeping* (2008), Vol. 15, No. 5, 631-647, f. 637.

²⁶⁶ Seymour Lipset, *Political Man: The Social Bases of Politics*, (Heinemann Educational Books, London, 1983), f. 64.

prioritet parësor dhe të fundit statusin e pazgjidhur politik të Kosovës, paradoksalisht, lidershpi politik ishte shndërruar në partner në mirëmbajtjen e stabilitetit dhe të *status quo*-së në vend. Ndërsa lidershpi politik *de jure* zgjidhej me zgjedhje të lira dhe të votave të qytetarëve, legjitimiteti i tyre varej nga pranueshmëria e këtij të fundit nga UNMIK-u, të cilët i mbanin ‘çelësat’ e pushtetit dhe negociacionin koalicionet paszgjedhore në Kosovë.

Ndonëse stabiliteti është shumë i rëndësishëm dhe veçanërisht kështu në shoqëritë e dala prej luftës, ajo që duhet të operacionalizohet tutje ishte ndarja mes stabilitetit negativ dhe atij pozitiv. Me stabilitet negativ nënkuptoj stabilitetin e mirëmbajtur nga bashkësia ndërkombëtare, ku stabiliteti nuk është rezultat i ballafaqimit real të interesave dhe nevojave të forcave të ndryshme shoqërore, por imponim i administratës ndërkombëtare, e cila nuk është llogaridhënëse karshi vendasve dhe lidershipit politik të vendit. Me stabilitet pozitiv po nënkuptoj një stabilitet të garantuar nga forcat politike vendore në bashkëpunim me shtetndërtuesit ndërkombëtarë, të ndërtuar mbi parimet e qeverisjes së mirë, të sundimit të ligjit dhe të demokracisë liberale. Meqenëse UNMIK-ut i mungonte një strategji dalëse nga Kosova, në mënyrë që ta mirëmbante *status quo*-në dhe stabilitetin, bashkëpunonte vetëm me lidershipin politik vendor, të cilin e ‘disiplinonte’ duke i dhënë ose jo pushtetin për të formuar dhe drejtuar institucione në Kosovë. Këta të fundit ndjeheshin llogaridhënës vetëm ndaj UNMIK-ut, por jo ndaj votuesve vendorë. Duke qenë se lidershpi politik kosovar mund të ndiqej dhe të persekutohej politikisht ose juridikisht vetëm nga UNMIK-u dhe jo nga qytetarët e Kosovës, në këmbim të ruajtjes së këtij stabiliteti, UNMIK-u kishte lejuar që lidershpi politik kosovar të keqpërdorte pushtetin politik për përfitime private. Paqartësia e statusit kontribuoi shumë për tolerimin e një elite politike në Kosovë që nuk e kishte as sensin e llogaridhënies

kundrejt qytetarëve e as atë të zhvillimit ekonomik dhe demokratik të vendit.

Kjo paradigmë e stabilitetit e ka vonuar vendosjen e një sistemit të sundimit të ligjit në Kosovë dhe adresimin e kauzave reale të qytetarëve të Kosovës – punësimin dhe zhvillimin e gjithëmbarshtëm. Në raportin e parë të nëntorit 2004, Kai Eide shkruante për nevojën e reduktimit të prezencës së UNMIK-ut, transferimin e pushtetit tek institucionet e Kosovës, dhe rritjen paralele të prezencës së Bashkimit Evropian.²⁶⁷ Sipas tij, *status quo*-ja ishte e paqëndrueshme dhe kishte ardhur koha për hapjen e negociatave për përcaktimin e statusit të ardhshëm të Kosovës. Kurse, në raportin e dytë të vitit 2005, ‘A Comprehensive Review of the Situation in Kosovo’, pos tjerash, Kai Eide shkruante se krimi i organizuar dhe korrupsioni janë faktorët kryesor që e rrezikojnë stabilitetin e Kosovës. Edhe UNMIK edhe institucionet e përkohshme vetëqeverisës kishin dështuar në luftimin e tyre. “Solidariteti brenda klanit, kodet e heshtjes, problemet me gjuhë dhe mungesa e përvojës së institucioneve lokale të zbatimit të ligjit të gjitha kanë kontribuar në këtë dështim”²⁶⁸, shkruante Eide. Thelbi i kritikës së Eide në lidhje me zhvillimin e institucioneve të reja të Kosovës ishte me sa vijon:

Zhvillimi i institucioneve të reja është rrënuar nga një tendencë e fortë mes politikanëve që e shohin vetveten si llogaridhënës ndaj partive të tyre politike më fort sesa ndaj publikut të cilit i shërbejnë. Partitë politike kanë tendencë t’i shohin institucionet e reja dhe shërbimin civil si ‘fushë’ të tyre. Kështu që emërimet bëhen në baza politike apo klanore e jo në bazë të kompetencës. Shumë shërbyes civilë janë të brengosur për këtë paaftësi për të

²⁶⁷ United Nations Security Council, ‘Letter dated 17 November 2004 from the Secretary-General addressed to the President of the Security Council’, United Nations S /2004/932, 30 November 2004. f. 4.

²⁶⁸ Po aty, f. 8.

dalluar autoritet politike nga shërbimi civil dhe efekti që prodhon kjo në zhvillimin e një administrate të qëndrueshme dhe stabile.²⁶⁹

Bashkësia ndërkombëtare, respektivisht Grupi i Kontaktit, duke qenë i vetëdijshëm se këto elemente mund të gërryenin legjitimitetin e institucioneve të Kosovës së pavarur, kishin pasur dilema se çfarë misioni ndërkombëtar do të duhej ta pasonte UNMIK-un. Duke qenë se UNMIK-u faktikisht kishte dështuar në luftimin e korrupsionit dhe të krimit në Kosovë, konsensusi i tyre minimalist ishte që misioni i cili do ta zëvendësonte UNMIK-un, të ishte një mision evropian për sundimin e ligjit.²⁷⁰

7.2 Papunësia, klientelizimi dhe administrata publike

Shtatëmbëdhjetë vjet pas luftës dhe vendosjes së administratës së UNMIK-ut në Kosovë dhe tetë vjet pas pavarësisë, varfëria, papunësia dhe korrupsioni mbeten tri prej problemeve kryesore që i brengosin qytetarët e Kosovës.²⁷¹ Të dhënat e fundit tregojnë se 145.776 persona ose 32,9% nga 37,6% të popullsisë kosovare që konsiderohet ekonomikisht aktive është e papunë. Papunësia tek gratë mbetet më e lartë në krahasim me meshkujt. Shkalla e punësimit të grave në Kosovë është 11,5%, kurse e meshkujve 37,5%. Pos dallimit gjinor, një indikator tjetër mbetet moshja në tregun e punës. Të rinjtë kosovarë janë më pak të punësuar në krahasim me të rriturit. 57,7% e të rinjve të moshës 15-24 vjeç janë

²⁶⁹ Po aty, f. 4.

²⁷⁰ Grupi Ndërkombëtar i Krizave, 'Kosova: Sfida e transicionit' (Raport për Evropë i Grupit të Krizave numër 170, 17 shkurt 2006), f. 14.

²⁷¹ Agjencia e Statistikave të Kosovës, 'Rezultatet e Anketës së Fuqisë Punëtore 2015 në Kosovë' (Prishtinë, qershor 2016), ff. 6-10.

të papunë. Në përgjithësi, shkalla totale e papunësisë në Kosovë për vitin 2015 ishte 32,9%.²⁷²

INDEP, një organizatë e tipit *think tank* në Kosovë, duke u bazuar në këto të dhëna, kishte propozuar 4 masa se si të zvogëlohet papunësia në Kosovë. Duke qenë se papunësia tek të rinjtë e grupmoshës deri 25 vjeç është më e lartë krahasuar me të rriturit, ky institut propozonte që të ulej mosha e pensionimit nga 65 në 60 vjeç në sektorin publik. Sipas këtij instituti, “bazuar në të dhënat e Trustit Pensional të Kosovës, 14.479 punonjës në institucionet publike ishin mbi moshën 60 vjeçare në vitin 2014. Fuqizimi i një mase të tillë do të krijonte hapësirë që këto vende të punës të plotësoheshin nga një fuqi e re punëtore, duke krijuar mundësi punësimi për përafërsisht 17.000 persona që janë aktivë dhe të papunë”.²⁷³ Masat e tjera që u propozuan ishin ndalimi i punësimit të shumëfishtë në sektorin publik, rritja e tatimit në të ardhura për punën e dytë nga 10 në 40%, nivelizimi i rrogave, etj.

Ndërsa INDEP propozon masa që ndikimin kryesor do ta kishin në rritjen e punësimit të të rinjve në sektorin publik (17.000 të rinj, duke e ulur kështu moshën e pensionimit), instituti GAP propozon uljen e të punësuarve në administratën publike. Kosova ka 21 ministri, 34 institucione dhe agjenci të pavarura, dhe mbi 91 mijë persona të punësuar në sektorin publik (47.555 punonjës në nivel qendror, 43,726 në nivelin lokal). Ky institut i rekomandoi Qeverisë së Kosovës “që të aplikojë një politikë të uljes së numrit të punonjësve publikë dhe civilë e cila do të zbatohet përmes pensionimit të rregullt të tyre pas moshës 65 vjeçare, bazuar në Ligjin për Shërbimin Civil dhe Ligjin e Punës”.

²⁷² United Nation Development Programme, ‘Pulsi Publik XI’, (Prishtinë, maj 2016), f. 10. Sipas anketës së UNDP-së, del se 57,1% e qytetarëve të Kosovës e konsiderojnë papunësinë si problemin kryesor në vend, 21,4% e konsiderojnë varfërinë, dhe 4,6% korrupsionin.

²⁷³ INDEP, ‘Papunësia në Kosovë: 3 masa për mbi 20.000 vende pune’ (Analizë Politikash, Prishtinë, 2013), f. 2.

Organizatat ndërkombëtare vazhdimisht kanë rekomanduar që të ristrukturohet qeveria e Kosovës, respektivisht të zvogëlohet numri i ministrive dhe i punonjësve civilë. Siç vëren GAP, vetëm Suedia (me 23 ministri) dhe Mbretëria e Bashkuar (me 24 departamente ministrore), kanë numër më të madh të ministrive në krahasim me Kosovën, përkundër numrit pakrahasueshëm më të madh të popullsisë të këtyre vendeve. Edhe në nivel rajonal, krahasimi është negativ. Bosnja e Hercegovina ka 16 ministri, Maqedonia 14, Mali i Zi 16, kurse Serbia 16. GAP propozoi zvogëlimin e numrit të ministrive nga 21 në 13, me çka do të zvogëlohej edhe madhësia e administratës publike.²⁷⁴ Në një studim tjetër për ristrukturimin e Qeverisë, i njëjti institut rekomandoi shuarjen e Ministrisë së Diasporës dhe shpërndarjen e fushëveprimtarisë së saj në Ministrinë e Punëve të Jashtme, Ministrinë e Arsimit, dhe Ministrinë e Kulturës, meqë fushëveprimtaria e Ministrisë së Diasporës bie në domenin e këtyre ministrive. Po ashtu, në vend të dy ministrive ekzistuese, siç është Ministria e Administratës Publike dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, GAP propozoi që kjo e fundit të shuhet, ndërkohë që duhet të fuqizohet Ministria e Administratës së Pushtetit Lokal. Po ashtu, në mënyrë që të rritet efikasiteti dhe të koordinohet zhvillimi ekonomik, propozohet që kompetencat e Ministrisë së Financave, Ministrisë së Tregtisë dhe të Industrisë dhe Ministrisë së Infrastrukturës të integrohen në një ministri të vetme, pra në një Ministri të Zhvillimit Ekonomik. Sipas këtij propozimi, nëse këto gjashtë ministri do të shuheshin dhe do të bëhej një ristrukturim më efikas i kompetencave dhe fushëveprimtarisë së ministrive, “vetëm nga postet ministrore dhe kabinetet do të kurseheshin mesatarisht 3.6

²⁷⁴ GAP, ‘Madhësia e Administratës Publike në Kosovë’, (Prishtinë, korrik 2015), f. 9.

milion euro për një mandat qeverisës”.²⁷⁵

Në raportet e progresit të Komisionit Evropian vazhdimisht është evidentuar se Kosova ka problem me efikasitetin e administratës publike. Në raportin e vitit 2015 për Kosovën, Komisioni Evropian evidenton si problem joefikasitetin e administratës publike, politizimin e vazhdueshëm të saj dhe mbivendosjen e kompetencave mes agjencive të ndryshme qeveritare. Komisioni Evropian në raportin e tij rekomandonte reformë në administratën publike, e cila do të duhej të fokusohet në rritjen e produktivitetit dhe uljen e kostove.²⁷⁶ Po ashtu, organizatat *think tank* në Kosovë vazhdimisht kanë evidentuar problemet që ka Kosova me politizimin e administratës, patronazhin, klientelizimin dhe patrimonializimin.

Sipas studimit të D4D për patronazhin në Kosovë, “shumica e të anketuarve kanë vlerësuar se ka pak gjasa që një individ mund të hyjë në shërbimin civil apo të ngrihet në detyrë duke u bazuar vetëm në meritë. Në të kundërtën, lidhjet politike dhe personale janë të pashmangshme”.²⁷⁷ Në këtë studim theksohet se klientelizimi, patronazhi dhe korrupsioni janë tri strategji të përdorura nga partitë politike për të fituar përkrahje politike. Në këtë studim, konceptet e mësipërme përkufizohen kështu: “Klientelizimi është devijim i përgjithshëm i burimeve publike për të ndërtuar mbështetje politike, patronazhi është përdorimi specifik i punësimit në sektorin publik për përfitime politike, dhe korrupsioni është përdorimi i pushtetit për të rrëmbyer fonde nga sektori privat”.²⁷⁸

²⁷⁵ GAP, ‘Ristrukturimi i Qeverisë: Propozim për zvoglimin e posteve ministrore për një Qeveri më pak të kushtueshme dhe më efikase’ (Prishtinë, korrik 2014), f. 28.

²⁷⁶ European Commission, ‘Commission Staff Working Document: Kosovo 2015 Report’ (Brussels, 10, 11. 2015) SWD (2015) 215 final), f. 4-33.

²⁷⁷ Demkracia për Zhvillim, ‘Klasë në vete: Patronazhi dhe ndikimi i tij në mobilitetin shoqëror në Kosovë’, (Seria: Interesi Publik, Nr. 2, Prishtinë, 2011), f. 9.

²⁷⁸ Po aty, f. 17.

Edhe Qendra Kosovare për Gazetari Hulumtuese kishte listuar një numër prej 250 zyrtarësh të lartë publikë që ishin punësuar në institucionet publike dhe që vinin në ato pozita nga partitë politike. Ky studim shpalos fizionominë e këtij patronazhi nga viti 1999 deri më 2014, duke bërë një lidhje direkte mes këtyre zyrtarëve me partitë politike në pushtet. Sipas këtij hulumtimi, PDK prin me punësimin e numrit më të madh të zyrtarëve që janë të lidhur me këtë parti, pasuar nga LDK-ja dhe AAK-ja.²⁷⁹

Po ashtu, një studim i David Jackson-it shpalos fenomenin e klientelizimit si dimension alternativ të qeverisjes në Kosovë. Sipas këtij studimi del se decentralizimi i pushtetit në Kosovë, një strategji kjo e propozuar nga Martti Ahtisaari për ta rritur stabilitetin politik në Kosovë dhe për t'i integruar pakicat, ka prodhuar edhe efektet anësore, respektivisht ka krijuar mundësi për nepotizëm dhe ka inkurajuar klientelizimin. Sipas këtij studimi, ekziston një perceptim dominant në Kosovë se raporti klient-patron, respektivisht klientelizimi, karakterizon marrëdhëniet dominuese mes qytetarëve dhe liderëve politikë. Partitë politike konsiderohen shkaktarët kryesorë të klientelizimit, për faktin se këto parti nuk kanë një ideologji të qartë që të mund t'i bindin masat dhe, në anën tjetër, kanë një strukturë hierarkike të organizimit. Studimi provon t'i gjejë arsyet e klientelizmit jo në kulturën tradicionale në Kosovë, por në pasigurinë ekonomike me të cilën ballafaqohen qytetarët e Kosovës, e cila i detyron të futen në marrëdhënie klienteliste me politikanë. Anketa shpalos se 43% e qytetarëve të Kosovës besojnë fuqishëm se ndërtimi i rrugëve bëhet me logjikën klienteliste, pra në ato rajone ku partitë që qeverisin kanë mbështetje politike. Po ashtu, 51% e qytetarëve besojnë fuqishëm se punësimi bëhet me logjikën

²⁷⁹ Besnik Boletini dhe Besa Kalaja, 'Partia e Punës: Fizionomia e patronazhit politik në Kosovë', (PrEPORT, Nr. 10, Qendra Kosovare për Gazetari Hulumtuese, dhjetor 2014).

klienteliste, dhe 60% e qytetarëve²⁸⁰, gjithnjë sipas kësaj ankete, besojnë fuqishëm se votimi bëhet me logjikën klienteliste, pra me logjikë këmbimi të tipit “unë të votoj, ti më punëson”.

7.3 Rritja e pamjaftueshme ekonomike në Kosovë

Në një raport të Bankës theksohet se Kosova ishte njëra prej katër ekonomive në Evropë që kishte shënuar rritje ekonomike pas krizës ekonomike të Evropës. Rritja ekonomike e Kosovës, gjatë viteve 2011-2014, ishte 3,5%.²⁸¹ Megjithatë, për shkak të bazës së ulët të zhvillimit ekonomik, kjo rritje nuk është domethënëse për zhvillimin e gjithëmbarshtëm shoqëror në Kosovë. Në janar 2016, qeveria e Kosovës përpiloi ‘Strategjinë Kombëtare për Zhvillim 2016-2021’. Siç mund të shihet nga tabela e mëposhtme, Kosova në të gjithë indikatorët ekonomikë qëndron më keq krahasuar me mesataren e vendeve të Evropës juglindore që nuk janë pjesë e BE-së. Ndërsa Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) për kokë banori në Kosovë është 2.935 euro, mesatarja e PBB në vendet e Evropës juglindore është 3.504 euro; derisa shkalla e varfërisë në Kosovë është 29,9%, mesatarja e varfërisë në vendet e Evropës juglindore është 19,7%. Më së dobëti Kosova qëndron kur ia krahasojmë me vendet e Evropës raportin mes eksporteve dhe importeve. Ndërkohë që këto vende eksportojnë 46,5% të produkteve të tyre jashtë, eksportet e Kosovës arrijnë vetëm 12%.²⁸²

²⁸⁰ David Jackson, ‘Clientelism: The alternative dimension to Kosovo’s governance’ (Kosovo Local Government Institute, Prishtinë, shkurt 2014), f. 11.

²⁸¹ The World Bank Group in Kosovo, ‘Country Snapshot’ (WB, tetor 2015), f. 2.

²⁸² Zyra e Kryeministrit të Kosovës, ‘Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021’ (Prishtinë, janar 2016), f. 4.

Treguesi	Kosova	Mesatarja e vendeve të Evropës Juglindore që nuk janë anëtare të BE-së
Produkti i brendshëm bruto për kokë banori	€2935	€3504
Përqindja e papunësisë	30,1%	20,8%
Pjesëmarrja në tregun e punës	40,5%	49,7%
Përqindja e popullsisë që jeton në varfëri	29%	19,7%
Raporti mes eksporteve dhe importeve	12%	46,5%

Indikatorët ekonomikë të Kosovës. Burimi: Strategjia Kombëtare për Zhvillim, 2016-2021

Në mënyrë që të adresohen problemet e mësipërme, Strategjia 2016-2021 ka evidentuar një mori problemesh që duhet të adresohen nga qeveria e Kosovës. Siç analizohet në këtë dokument, njëri prej problemeve se pse investitorët hezitojnë të investojnë në Kosovë ka të bëjë me kapitalin njerëzor, apo fuqinë e pakualifikuar punëtore. Ky problem ka të bëjë me cilësinë e ulët e arsimimit të fuqisë punëtore në Kosovë, që nuk i orienton njerëzit kah tregu i punës. Po ashtu, mungesa e sundimit të ligjit dhe mungesa e efikasitetit të gjykatave që garantojnë zbatim efektiv të kontratave, i kontribuon këtij ambienti joatraktiv për investitorët e jashtëm. Sektori i prokurimit publik mbetet njëri prej problemeve kryesore. Duke qenë se 40% e buxhetit të Kosovës shpenzohet përmes procedurave të prokurimit publik, mungesa e transparencës dhe korrupsioni që e shoqëron këtë sektor ndikon drejtpërdrejt si në moszhvillimin ekonomik ashtu edhe në keqpërdorimin e parasë publike. Problem tjetër i madh mbetet ekonomia informale. Si informalitet është vlerësuar rreth 26-34% e totalit të PBB-së së Kosovës. Pjesa e kryesore e informalitetit zhvillohet në kufijtë e Kosovës, kur merret parasysh se të hyrat kryesore të buxhetit të Kosovës mbledhen në kufij. Sipas studimit të RIINVEST-it për informalitetin në Kosovë, në mesin e 22 barrierave që kanë raportuar bizneset janë evazioni

fiskal, mosdeklarimi i punëtorëve, si dhe konkurrenca jo e drejtë, e cila listohet ndër problemet kryesore prej bizneseve.²⁸³ Po ashtu, furnizimi i qëndrueshëm me energji konsiderohet një prej problemeve që ndikon tek investitorët e jashtëm dhe të brendshëm dhe, rrjedhimisht, në zhvillimin ekonomik të Kosovës. Ndonëse vlerësohet se Kosova posedon 12 miliardë tonë linjit, ajo ende vazhdon të importojë energji elektrike. Infrastruktura rrugore dhe hekurudhore e Kosovës vazhdojnë të jenë të pamjaftueshme për të ofruar transport efikas dhe të shpejtë, në mënyrë që të mundësojnë qarkullim të shpejtë me kosto të ulët të mallrave dhe njerëzve në Kosovë dhe rajon. Gjatë viteve 2008-2010, qeveria e Kosovës ka ndarë gati një tretën e buxhetit për investimet në infrastrukturë. Derisa në vitin 2008, 28,9% e buxhetit të Kosovës, ose 99.812.595 euro janë ndarë për infrastrukturën rrugore, në vitin 2009, 31,3% ose 102.916.485 euro janë ndarë për infrastrukturë nga buxheti i Kosovës.²⁸⁴ Përkundër këtij investimi, vlerësohet se ende infrastruktura rrugore e Kosovës nuk është e asfaltuar në tërësi. Kosova ka të shtruar me asfalt vetëm 56% të infrastrukturës rrugore, kurse rrjeti hekurudhor i vjetruar shtrihet në 330 km. Pos shumë aspekteve të tjera, Strategjia 2016-2021 evidenton si sfidë reduktimin e procedurave administrative për t'ua lehtësuar punën bizneseve. Ndonëse shërbimet që institucionet qendrore dhe lokale të Kosovës u ofrojnë bizneseve janë të shumta (629 shërbime në nivel qendror, dhe 100 në nivel komunash), kostoja e këtyre shpenzimeve është vlerësuar e lartë. Siç vlerëson Strategjia 2016-

²⁸³ Riinvest, 'Të paguash apo të mos paguash: Informaliteti nga këndvështrimi i bizneseve në Kosovë', (Prishtinë, FES dhe KFOS, 2013), f. 8.

²⁸⁴ Lëvizja FOL, 'Transparenca e Investimeve Publike në Infrastrukturën Rrugore: Promovimi i Transparencës dhe Llogaridhënies Publike në Infrastrukturë', (Prishtinë, 2010), f. 6.

2021, “kostoja që i shkaktohet bizneseve kosovare prej gjithë proceseve është 130 milion euro në vit”.²⁸⁵

Megjithatë, raporti ‘Të bërit biznes’ i Bankës Botërore vlerëson se Kosova në vitet e fundit ka shënuar progres në lehtësimin e procedurave të të bërit biznes. Nga 189 vende, Kosova është renditur në vendin e 75-të. Po ashtu, Kosova është renditur në vendin e 67-të sa u përket lehtësive në pagimin e taksave, në vendin e 71-të sa u përket lehtësive për të tregtuar me jashtë (pakrahasimisht më keq se vendet e rajonit), në vendin e 48-të për zbatimin e kontratave, duke qëndruar shumë më mirë se Shqipëria, e cila zë vendin e 96-të, ndërkohë që Bosnja dhe Hercegovina renditet në vendin 66-të, kurse Sllovenia në vendin e 117-të.²⁸⁶ Edhe pse Kosova ka bërë përparime domethënëse në lehtësimin e të bërit biznes, anketat ndërkombëtare që matin perceptimin për korrupsionin në vend nuk kanë ndryshuar. Korrupsioni renditet shumë lart në indeksin e korrupsionit global.

7.4 Korrupsioni mes perceptimit dhe realitetit

Në raportin e Transparency International për Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit për vitin 2015, Kosova renditet në vendin e 103-të. Ky indeks i perceptimit të korrupsionit krahason Kosovën me Etiopinë, Republikën Dominikane dhe Moldovën, të cilat po ashtu renditen në vendin 103. Sipas këtij raporti, madje edhe në nivel krahasimi me rajonin, Kosova qëndron më së keqi. Mali i Zi renditet në vendin e 61-të, Maqedonia në vendin e 66-të, Serbia në vendin e

²⁸⁵ Zyra e Kryeministrit të Kosovës, ‘Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021’ (Prishtinë, janar 2016), f. 21.

²⁸⁶ World Bank Group, ‘Economic Profile 2016 Kosovo: Doing Business 2016 Measuring Regulatory Quality and Efficiency’, (The World Bank, 2016).

71-të dhe Bosnja-Hercegovina në vendin e 76-të.²⁸⁷ Duke qenë se Transparency International mat vetëm perceptimin subjektiv të qytetarëve karshi korrupsionit, së fundi, Qendra për Kurajë Politike ka botuar një analizë me anë të të cilës provon të matë nivelin e korrupsionit në Shqipëri dhe Kosovë në sektorin e industrisë dhe të licencave minerare. Në mënyrë që të matet korrupsioni empirikisht, numri i lëshimit të licencave dhe lejeve minerare gjatë periudhës kohore të mbajtjes së zgjedhjeve u përdor si tregues për matjen e korrupsionit. Matjet ekonometrike treguan se një vit para organizimit të zgjedhjeve, numri i licencave të lëshuara në Kosovë ishte 38% më i lartë në krahasim me numrin mesatar afatgjatë të lëshuar gjatë viteve të tjera. Supozohet se kjo rritje vjen si rezultat i marrëdhënieve klienteliste dhe korrupsionit mes kompanive dhe partive politike, të cilat në këmbim të financimit të fushatave zgjedhore favorizojnë kompani të afërta me këto parti me licenca dhe leje.²⁸⁸

Raporti i ‘Freedom House’ për Kosovën i vitit 2015 e klasifikon regjimin politik në Kosovë si një ‘regjim gjysmë të konsoliduar autoritar’, duke e vlerësuar shkallën e përgjithshme të demokratizimit me 5.14 pikë. Freedom House e vlerëson progresin demokratik nga 1 (si niveli më i lartë i progresit demokratik) deri në 7 (si progresi më i ulët demokratik). Sipas këtij raporti, në prokurimin publik të Kosovës korrupsioni është sistematik. Raporti vëren se ka pasur mungesë të vullnetit politik nga elita udhëheqëse politike për ta luftuar korrupsionin dhe se “ndikimi i politikanëve mbi gjyqësinë i pengon në mënyrë domethënëse hetimet dhe

²⁸⁷ Transparency International, ‘Corruption Perceptions Index 2015’ (TI, 2016), f. 7.

²⁸⁸ Qendra për Kurajo Politike, ‘Klientelizimi dhe Rritja: Si të kanalizohen më mirë përpjekjet antikorrupsion’, (Skicë politikash, Prishtinë, qershor 2016).

ndjekjet”. Vlerësimi i korrupsionit mbetet i pandryshuar me 6 pikë.²⁸⁹

Në Raportin e Progresit për Kosovën për vitin 2015 të Komisionit Evropian nënvizohet se në gjyqësorin e Kosovës ka ndërhyrje politike dhe se Kosova është ende në fazën fillestare në luftën e saj kundër korrupsionit. Komisioni Evropian vëren se janë ndërmarrë disa masa në luftën kundër korrupsionit në vitin 2015, duke përfshirë aprovimin e Kodit të Etikës për punonjësit civilë. Ky raport i rekomandon qeverisë së Kosovës që ta prioritetizojë luftën kundër korrupsionit te rastet e profilit të lartë, veçanërisht në prokurimin publik. Po ashtu, në këtë frymë të luftës kundër korrupsionit, rekomandohet të ketë bashkëpunim më të mirë mes policisë dhe prokurorisë gjatë hetimeve të rasteve të korrupsionit të profilit të lartë dhe të rishikohet ligji për konflikt të interesit. Po ashtu, hetohet një mungesë e bashkëpunimit mes Kryeprokurorit të Shtetit dhe Agjencisë Kundër Korrupsionit. Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit kishte hedhur poshtë mbi 70% të rasteve të korrupsionit të pretenduar nga Agjencia Kundër Korrupsionit, për faktin se, sipas kësaj zyre, nuk ishin gjetur prova të mjaftueshme për t’i vazhduar hetimet.

7.5 Strategjitë dhe lufta kundër korrupsionit

Në bashkëpunim me shtetndërtuesit e jashtëm, Kosova ka miratuar mekanizma të shumtë për ta luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar, por vullneti i politik i lidërshit kosovar për të mbështetur këta mekanizma vazhdimisht ka munguar. Në sektorin e drejtësisë ka pasur ndërhyrje të vazhdueshme politike për të mos e

²⁸⁹ Freedom House, ‘Kosovo | Nation in Transit, 2015’. Qasur në https://freedomhouse.org/sites/default/files/NIT2015_Kosovo.pdf (10 korrik 2016).

zbatuar në plotni ligjin, kur bëhej fjalë për rastet e profilit të lartë. Po ashtu, mekanizmat e vendosur dhe strategjitë e përpiluara qoftë për luftimin e korrupsionit (Strategjia kundër Korrupsionit 2013-2017), qoftë për luftimin e ekonomisë informale, pastrimit të parave dhe financimit të terrorizimit (Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Joformale, të Pastrimit të Parave, Financimit të Terrorizimit dhe Krimeve Financiare 2014-2018)²⁹⁰, kanë mbetur të pazbatuara plotësisht për shkak të mungesës së ndarjes së mjaftueshme të mjeteve financiare.²⁹¹ Studiues që janë marrë me Kosovën kanë provuar t'i shpjegojnë shkaqet dhe origjinën e korrupsionit dhe të krimit të organizuar në Kosovë “me një kulturë të konspiracionit, e cila u shërbente taktikave mbijetuese në një ambient të armiqësuar, të karakterizuar me marrëdhënie të dobëta me autoritetet. Këto autoritete, qofshin osmane, jugosllave apo serbe, perceptoheshin si shtypëse dhe si sundimtare të huaja e koloniale, kundrejt të cilëve familja e zgjeruar, klani dhe grupi i gjerë etnik shërbente si mbrojtje”.²⁹² Megjithatë, 8 vjet pasi Kosova është shpallur shtet sovran dhe i pavarur, korrupsioni ende vazhdon të jetë pengesë e zhvillimit dhe e demokratizimit të shoqërisë kosovare.

Në Kosovë janë katër institucione që merren me luftimin e korrupsionit: Agjencia Antikorrupsion; Koordinatori Kombëtar Antikorrupsion i emëruar nga Kryeprokurori i Shtetit; Këshilli Kombëtar Antikorrupsion, mekanizëm konsultativ i udhëhequr nga

²⁹⁰ Zyra e Kryeministrit, ‘Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimit të Parave, Financimit të Terrorizimit dhe Krimeve Financiare 2014-2018’ (Prishtinë, janar 2015). Qasur në http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia_Kombetare_e_Republikes_se_Kosoves_per_Parandalimin_dhe_Luftimin_e_Ekonomise_Joformale,_Pastrimin_e_Parave,_Financimin_e_Terrorizimit_dhe_Krimeve_Financiare_2014-2018.pdf (29 korrik 2016).

²⁹¹ European Commission, ‘Commission Staff Working Document: Kosovo 2015 Report’ (Brussels, 10, 11. 2015) SWD (2015) 215 final), f. 17.

²⁹² Wolfgang Koeth, ‘State Building Without a State: The EU's Dilemma in Defining Its Relations with Kosovo’ European Foreign Affairs 237 (2010), f. 244.

Presidenti i Kosovës; Drejtoria për Hetime të Krime Ekonomike dhe Korrupsion brenda Policisë së Kosovës. Megjithatë, korrupsioni mbetet ende endemik. Sipas studimit të KIPRED-it, njëri prej sektorëve që ka prirjen më të lartë për korrupsion mbetet sektori i prokurimit publik. Vetëm gjatë vitit 2014, 488 milion euro të buxhetit të Kosovës janë shpenzuar përmes procedurave të prokurimit publik. Përmes këtij sektori, partitë politike që janë në pushtet u kishin siguruar tenderë publikë kompanive dhe bizneseve të afërta me to gjatë fushatave zgjedhore, duke i kompensuar këto kompani për financimin e fushatave të tyre.²⁹³ Siç vërehet nga një analizë e organizatës FOL për ligjin e prokurimit, Ligji i Prokurimit Publik nuk është në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian.²⁹⁴ Njëra prej mangësive kryesore të Ligjit të Prokurimit ka të bëjë me transparencën e plotë. Neni 3 i këtij ligji përjashton disa aktivitete nga transparenca e plotë gjatë procesit të prokurimit. Sipas këtij neni: “pavarësisht nga dispozitat e tjera të këtij ligji, autoritetet kontraktuese nuk do të kërkohet që të veprojnë në përputhje me ndonjë procedurë të veçantë të prokurimit apo të respektojnë dispozitat e këtij ligji mbi transparencën gjer në shkallën kur përputhshmëria dhe respektimi do të komprometonin sekretin e ligjshëm ose interesat e sigurisë gjatë kryerjes së aktiviteteve të prokurimit, të rëndësishme për dhënien e një kontrate publike.”²⁹⁵ Pra, sipas ligjit, qeveria ka të drejtë të klasifikojë kontrata të

²⁹³ KIPRED, ‘Pandëshkueshmëria në Kosovë: Lufta kundër korrupsionit ndaj profilit të lartë’, (Analizë e Politikave, No.1/16, Janar 2016), f. 10.

²⁹⁴ Lëvizja FOL, ‘Analizë e Ligjit të Prokurimit Publik në kontekstin e parimit të transparencës’, (Prishtinë, 2012). Sipas analizës, Ligji i Prokurimit Publik në Kosovë bie ndesh me disa prej parimeve të legjislacionit evropian, si ‘Rregullorja e Këshillit (EC, Euroatom) Nr. 1605/2002 e datës 25 qershor 2002; Rregullorja e Komisionit (EC, EUROATOM), Nr. 2341/20002 e datës 23 dhjetor 2002; Direktiva 2004/17/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit Evropian e datës 31 mars 2004’, etj. Për një analizë të shpërdorimeve në prokurimin publik, shih edhe: Lëvizja FOL, ‘Shpërdorimet në Prokurimin Publik: Analizë për Shpërdorimin e Autoritetit Publik në fushën e prokurimit publik, (Prishtinë, 2012).

²⁹⁵ Po aty, f. 8.

caktuara si sekrete. Nën ‘banerin’ e sekretit, ka pasur dyshime të bazuara se një pjesë e kontratave janë nënshkruar ose në dëm të buxhetit të Kosovës dhe jashtë logjikës së çmimeve të tregut, ose se janë nënshkruar kontrata me kompanitë që kanë lidhje me partitë në pushtet.

As gjykatat dhe as prokuroritë vendore nuk janë treguar efikase në luftën kundër krimit dhe korrupsionit. Studimi i institutit kosovar KIPRED për luftën kundër korrupsionit ndaj profilit të lartë vëren se, përkundër faktit se Këshilli Prokurorial i Kosovës (PSRK) kishte aprovuar në Plan Veprimi për ta luftuar korrupsionin, rezultatet ende nuk janë optimiste. PSRK gjatë vitit 2014 kishte përfunduar vetë 18 raste kundër 121 personave, përkundër faktit se kishte para vetes 55 raste të korrupsionit kundër 322 personave.²⁹⁶ Për më tej, për dallim prej Policisë së Kosovës dhe Agjencisë Kundër Korrupsionit, që kanë iniciuar shumicën e rasteve, tek prokurorët kishte munguar vetiniciativa për t’i raportuar rastet e korrupsionit. Në vitin 2013, vetëm 4 raste të korrupsionit ishin raportuar me vetiniciativë të prokurorëve, kurse në vitin 2014 vetëm 11 raste. Problem tjetër mbetet hetimi i mirëfilltë i rasteve kundër korrupsionit dhe përfundimi i lëndëve. Përkundër faktit se gjatë vitit 2014 ishin ngritur 1011 kallëzime penale për korrupsion, 54% e lëndëve ishin hedhur poshtë. Po ashtu, përkundër faktit se gjykatat gjatë vitit 2014 kanë punuar në 655 raste kundër korrupsionit, vetëm 35% e këtyre ishin gjykuar.²⁹⁷

²⁹⁶ KIPRED, ‘Pandëshkueshmëria në Kosovë: Lufta kundër korrupsionit ndaj ndaj profilit të lartë’, (Analizë e Politikave, No.1/16, Janar 2016), f. 11.

²⁹⁷ KIPRED, ‘Pandëshkueshmëria në Kosovë: Lufta kundër korrupsionit ndaj ndaj profilit të lartë’, (Analizë e Politikave, No.1/16, Janar 2016, f. 13-14.

7.6 Pritshmëritë dhe zhgënjimet nga EULEX-i

Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës në shkurt të 2008, që u shoqërua me reduktimin e pranisë së UNMIK-ut dhe vendosjen e vonuar të EULEX-it në tërë territorin e Kosovës, ekzistonte një pritshmëri e përgjithshme se EULEX-i do të fillonte t'i fuqizonte kapacitetet vendore, ta zvogëlonte ndikimin e politikës në gjyqësor, ta luftonte korrupsionin dhe krimin e organizuar, t'i adresonte rastet e vjetra të krimeve të luftës, dhe ta shtrinte kontrollin në gjithë territorin e Kosovës, duke përfshirë pjesën veriore të vendit. Shtatë vjet pas vendosjes së EULEX-it në Kosovë, rezultatet e këtij misioni ende mbeten minimale.

Institucionet e Kosovës, duke qenë se e kanë ftuar dhe e legjitimuar vetë EULEX-in përmes Deklaratës së Pavarësisë, kanë ndjekur një qasje të dyfishtë ndaj tij – nga njëra anë duke e kritikuar për mosefikasitet të zbatimit të ligjit në gjithë territorin e Kosovës, sidomos në veri dhe njëkohësisht duke qenë mosbashkëpunuese kur EULEX-i ka vepruar për zbatimin e ligjit, sidomos me luftimin e krimit të organizuar dhe të korrupsionit në mesin e lidërshipt politik në Kosovë. Gjatë vitit 2013 EULEX-i kishte ngritur aktakuzë për korrupsion ndaj ish-Ministrit për Transport, Fatmir Limaj dhe ndaj ish-Ministrit të Shëndetësisë, Bujar Bukoshi.

Organizatrat *think tank* në Kosovë e kanë kritikuar EULEX-in për mosefikasitet në luftimin e krimit të organizuar dhe të korrupsionit. Kritika të tilla karshi EULEX-it janë adresuar edhe nga Gjykata Evropiane e Auditorëve. IPOL, në studimin e dhjetorit 2009 vëren se EULEX-i kishte arritur të shtrinte misionin e vet plotësisht më 9 dhjetor 2008, pikërisht në Ditën Ndërkombëtare Kundër Korrupsionit. Mbetej të shihej nëse kjo koincidençë ishte diçka ironike, ose e qëllimshme.²⁹⁸ Shtatë vjet pas vendosjes së këtij

²⁹⁸ Balkan Policy Institute, 'EULEX: In Search of and Identity' (Pristina, Kosovo, 27 dhjetor 2009), f. 5.

misioni, mund të konstatohet se data e vendosjes së EULEX-it në Ditën Ndërkombëtare Kundër Korrupsionit ka qenë më fort koincidence. Në janar 2013, instituti KIPRED botoi një analizë gjithëpërfshirëse të EULEX-it. Sipas studimit të këtij instituti, përkundër faktit se BE-ja deri më janar 2013 kishte investuar 613.8 milionë euro për EULEX-in, ky nuk e kishte përmbushur misionin e vet për luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar në Kosovë.

Krimi i organizuar dhe korrupsioni vazhdojnë të mbeten probleme shqetësuese në Kosovë. Duke qenë se UNMIK-u kishte dështuar të ndërtonte një sistem ligjor të mirëfilltë në Kosovë, pritshmëritë ishin të mëdha se BE-ja do ta ndihmonte Kosovën për ndërtimin e një shteti ligjor. Këto pritshmëri të kosovarëve ushqeheshin edhe nga deklaratat e zyrtarëve të EULEX për luftimin e korrupsionit edhe brenda lidërshit politik vendor, përmes diskursit të ndjekjes së ‘peshqve të mëdhenj’. Siç theksonte në studimin e vitit 2013 nga KIPRED-i:

EULEX-i ka trajtuar një numër të konsiderueshëm të rasteve penale; megjithatë, numri dhe cilësia e rasteve që kanë të bëjnë me krimin e organizuar dhe korrupsionin e ‘profilit të lartë’ mbeten në nivele zhgënjyese. Rreth 380 aktgjykime tashmë janë shqiptuar, prej të cilave janë rreth 306 aktgjykime për vepra penale, duke përfshirë edhe 51 gjykime në rastet e krimit të organizuar dhe korrupsionit në nivel të lartë. Kjo do të thotë se që nga vendosja në vitin 2008, gjyqtarët e EULEX-it mesatarisht kanë shqiptuar 78 aktgjykime në vit (ose rreth 2.1 aktgjykime në vit për gjyqtar), prej të cilave vetëm rreth 10 aktgjykime kanë qenë për rastet e krimit të organizuar dhe korrupsionit të profilin të lartë (me rreth 0.29 aktgjykime të tilla

vjetore për një gjyqtar). Prokurorët e EULEX-it kanë qenë të përfshirë në më shumë se 2078 raste.²⁹⁹

Nga viti 2009 deri më 2013, Kosova ka ndarë mesatarisht nga 151 milion euro çdo vit për të gjitha strukturat shtetërore në fushën e sundimit të ligjit. Në anën tjetër, EULEX-i, me një staf 5 herë më të vogël të gjyqtarëve që merren me vepra penale, ka buxhet vjetor prej 114 milion euro (1.3 herë më i ulët se ai i Kosovës) dhe ka shqiptuar 3 herë më pak aktgjykime sesa gjyqtarët e Kosovës. Ndërsa në mesatare secili prej 192 gjyqtarëve kosovarë që merren me raste penale ka shqiptuar 44 aktgjykime, secili prej 36 gjyqtarëve të EULEX-it në mesatare ka shqiptuar 2.1 vendime, pra 21 herë më pak. Sa u përket aktgjykimeve në rastet e profil të lartë, përkundër faktit se stafi i gjyqtarëve të EULEX-it është 5 herë më i vogël se stafi i gjyqtarëve kosovarë, gjyqtarët e EULEX-it kanë shqiptuar 3 herë më pak vendime (0.29 vendime për gjyqtar) në raport me gjyqtarët kosovarë (0.94 vendime për gjyqtar). Kjo tregon se gjyqtarët kosovarë ende ngurrojnë t'i trajtojnë rastet e 'profil të lartë' të korrupsionit dhe të krimit të organizuar. Ndonëse EULEX-i është kritikuar për mungesë të mjeteve të mjaftueshme financiare për luftimin e krimit dhe të korrupsionit në Kosovë, KIPRED-i në analizën e tij gjithëpërfshirëse për EULEX-in vlerëson se "buxheti i EULEX-it është mjaft i lartë për të përmbushur pritjet fillestare, gjë që nuk e ka arritur, derisa buxheti i Kosovës është mjaftueshëm i ulët për t'i plotësuar kushtet që kanë të bëjnë me sundimin e gjerë të ligjit, të cilin nuk e ka arritur. Është e qartë se ekziston një indiferencë e përgjithshme e të dyja palëve për t'i trajtuar me seriozitet të metat në gjyqësor".³⁰⁰

²⁹⁹ Kosovar Institute for Policy Research and Development, 'A Comprehensive Analysis of EULEX: What Next', (Policy Paper No.1/13 – January 2013, f. 16.

³⁰⁰ Kosovar Institute for Policy Research and Development, 'A Comprehensive Analysis of EULEX: What Next', (Policy Paper No.1/13 – January 2013, ff. 15-16.

Po ashtu, një raport i botuar së fundi nga lëvizja FOL shpalos përpjekjet e kufizuara të EULEX-it për ta luftuar korrupsionin. Që nga vendosja e tij në vitin 2008, EULEX-i ka nxjerrë 70 aktgjykime për korrupsionin dhe krimin e organizuar. Prej këtyre aktgjykimeve, 47 kanë pasur të bëjnë me rastet e korrupsionit dhe 23 me rastet e krimit të organizuar. Me gjithë këtë numër të vogël të aktgjykimeve, nuk dihet saktë numri i rasteve të dënimeve për korrupsion dhe krim të organizuar. Edhe në këtë raport vërehet se EULEX-i, ngjashëm me UNMIK-un, nuk i kishte ndjekur sa duhet rastet e profilin të lartë për korrupsion dhe krim të organizuar. Arsyeja e mosndjekjes së rasteve të profilin të lartë të korrupsionit dhe krimit të organizuar, u ndikua nga konteksti politik i Kosovës, respektivisht nga nevoja për të garantuar stabilitet, në një formë a tjetër, duke ruajtur kredibilitetin e politikanëve të korruptuar.³⁰¹

Duket se sikur UNMIK-u, edhe EULEX-i e ka prioritetizuar stabilitetin para zhvillimit demokratik të Kosovës. Qysh në preambulën e Veprimit të Përbashkët të Këshillit të BE-së, njëra prej bazave juridike me të cilën EULEX-i ishte vendosur në Kosovë, shkruhet se EULEX-i ka për qëllim që ta forcojë stabilitetin në Kosovë dhe në rajon³⁰². Kritikuesit e EULEX-it argumentojnë se njëra prej arsyeve për tërheqjen e EULEX-it nga luftimi efikas i korrupsionit dhe krimit të organizuar, sidomos tek rastet e profilin të lartë që lidhen me ministra, deputetë, kryetarë komunash e drejtorë departamentesh, është pikërisht frika që një veprim i tillë mund të shkaktojë destabilitet në Kosovën e paspavarësisë. Në një kolumnë për Kohën Ditore, komentatori Augustin Palokaj argumenton se “EULEX-i nuk mund t’i ikë përgjegjësisë për dështimet në Kosovë”. Palokaj theksonte se pothuajse në çdo raport progresi të Komisionit Evropian për Kosovën ishin evidentuar probleme me korrupsion,

³⁰¹ Lëvizja FOL, ‘EULEX: Anti-corruption and the limits of a quantitative assessment’ (Prishtinë, 2016), ff. 7-19.

³⁰² Council Joint Action 2008/124/CFSP of 4 February 2008 on the European Union Rule of Law Mission in Kosovo. Pika 1.3 dhe pika 7.

krim të organizuar dhe ndërhyrje në drejtësi. Duke i kritikuar njëkohësisht edhe strukturat kosovare të sigurisë, Palokaj shtronte pyetjen: “pse Kosova është e tillë çfarë është me gjithë ato qindra miliona euro që i ka shpenzuar Bashkimi Evropian në këtë mision”. Palokaj argumenton se:

BE-ja gjithmonë i ka dhënë prioritet stabilitetit politik më shumë sesa zhvillimit të demokracisë. E aty ku nuk ka zhvillim të demokracisë nuk ka as llogaridhënie, as përgjegjësi politike e si pasojë nuk mund të ketë as sundim të duhur të ligjit. Për të mos e prishur atë stabilitet politik, BE-ja nuk i ka dhënë sa duhet mbështetje politike EULEX-it që të godasë krimin e organizuar dhe korrupsionin në nivel të lartë. Pasojat e një politike të tillë do të ndihen me vite.³⁰³

Trajektorja e prioriteteve politike, si e partnerëve ndërkombëtarë ashtu edhe e partive politike në Kosovë, ka nevojë për një zhvendosje nga stabiliteti negativ aktual tek sundimi i ligjit, zhvillimi ekonomik dhe demokratizimi i vendit. Kjo zhvendosje prioritetesh nuk mund të ketë sukses nëse ‘martesa e lumtur’ mes mirëmbajtjes së stabilitetit afatshkurtër, të promovuar aktualisht nga EULEX-i, dhe tolerimit të politikanëve të korruptuar dhe jotransparentë në Kosovë zgjatet pafund. Në anën tjetër, vendosja e sundimit të ligjit si prioritet kryesor në Kosovë nuk prodhon detyrimisht destabilitet. Në fakt, kjo është mënyra më e mirë për garantimin e stabilitetit afatgjatë dhe demokratizimin e vendit. Në mënyrë që këto prioritete të rimendohen dhe të rirenditen, parakushti fillestar është që vetë partitë politike të demokratizohen. Nëse liderët partiakë i udhëheqin partitë politike në mënyrë autoritare dhe jontransparente dhe marrin vendime pa u konsultuar me anëtarësinë e tyre, nuk ka asnjë arsye të besohet se këto parti politike nuk do ta

³⁰³ Augustin Palokaj, ‘EULEX-i nuk mund t’i ikë përgjegjësisë për dështimet në Kosovë’. Kohanet. (28 shtator 2014).

udhëhiqnin me të njëjtën logjikë qeverinë, parlamentin dhe mekanizmat e tjerë shtetërorë kurdo që të jenë pjesë e tyre. Nëse në vizionin e partive politike është një shoqëri demokratike e anëtarëve të lirë e të barabartë në Kosovë, në mënyrë që ky vizion të jetë i besueshëm, ai duhet të provohet dhe të zbatohet fillimisht brenda vetë partive politike. Në këtë mënyrë edhe ‘predikimi’ i partive politike për demokratizimin dhe zhvillimin e shoqërisë kosovare bëhet më i besueshëm.



MES STABILITETIT
DHE DEMOKRATIZIMIT

KAPITULLI VIII

KAPITULLI 8:

DEMOKRACIA BRENDAPARTIAKE

KAPITULLI 8: DEMOKRACIA BRENDAPARTIAKE

Deri më tani, partitë politike nuk i kanë kushtuar kohë a vëmendje të duhur demokratizimit brendapartiak. Të preokupuar për shtatëmbëdhjetë vjet radhazi me agjendën e ‘çlirimit’, ‘pavarësisë’, marrjes së ‘njohjeve’ për Kosovën, themelimin e Gjykatës Speciale, miratimin e Asociacionit të komunave me shumicë serbe, demarkimin e kufijve me Malin e Zi etj., energjia e partive politike ishte drejtuar në politikën e jashtme. Kësisoj, demokratizimi i shoqërisë kosovare dhe zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik nuk përbënin prioritetë parësorë. Në mënyrë që demokratizimi i shoqërisë dhe zhvillimi i qëndrueshëm të shndërrohen në prioritetë të njëmendta të partive politike në Kosovë, këto të fundit, si organizata të agregimit, artikulimit dhe përfaqësimit publik të interesave të qytetarëve, duhet të jenë të afta, transparente dhe vizionare për t’i përmbushur këto prioritetë. Demokratizimi i shoqërisë kosovare lidhet ngushtë me demokratizimin e partive politike.

Para se të vihen në shqyrtim dhe të krahasohen ndërsjellazi statutet e partive politike në Kosovë, duhet të vërejmë se Kushtetuta e Kosovës në asnjë formë nuk e rregullon karakterin e brendshëm demokratik të partive politike. Thënë ndryshe, Kushtetuta e Kosovës nuk ndalon në mënyrë eksplicite themelimin, organizimin dhe pjesëmarrjen në jetën publike të partive politike që potencialisht kanë për qëllim shkatërrimin e rendit kushtetues dhe demokratik në Kosovë. Ligji për zgjedhje të përgjithshme në Republikën e Kosovës nuk e rregullon organizimin e brendshëm partiak. Ligji i definon

partitë politike në aspektin funksionalist si: “një organizim i individëve të cilët janë bashkuar vullnetarisht mbi bazën e ideve, interesit dhe të pikëpamjeve të përbashkëta, me qëllim të ushtrimit të ndikimit dhe pasjes së përfaqësuesve të tyre të zgjedhur në zyrë publike, ose siç përcaktohet ndryshe me legjislacionin në fuqi”.³⁰⁴ Në anën tjetër, kemi shembullin me ligjin bazik gjerman të vitit 1949, i cili shprehimisht rregullon demokracinë e brendshme partiake të partive politike në Gjermani. Neni 21.1 dhe ai 21.2 rregullojnë sa vijon: “Partitë politike [...] mund të themelohen lirshëm. Organizimi i tyre i brendshëm duhet të bëhet konform parimeve demokratike. Partitë [...] të cilat kërkojnë shkatërrimin e rendit bazik demokratik ose kërcënojnë ekzistencën e Republikës Federale të Gjermanisë janë jokushtetuese”.³⁰⁵

Shkollarët Ingrid va Biezen dhe Daniela Rome Piccio shpjegojnë se në Kushtetutat e Kroacisë, Gjermanisë, Spanjës dhe Portugalisë, në mënyrë eksplicite rregullohet demokracia e brendshme partiake, kurse në vendet e tjera si Greqia, Italia dhe Franca, ndonëse në mënyrë implicite, kërkohet nga partitë politike që të respektojnë parimet demokratike.³⁰⁶

Në Kosovë nuk ka një ligj për funksionimin e partive politike dhe organizimin e brendshëm të tyre. Partitë politike, koalicionet dhe iniciativat qytetare regjistrohen në bazë të Rregullores 01/2013 për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike. Rregullorja precizon se partitë politike duhet të kenë simbolin, statutin, lidershipin, nënshkrimet e 500 anëtarëve të partisë, të paguajnë 500 euro për regjistrim dhe të nënshkruajnë Kodin e Mirësjelljes për Partitë Politike. Rregullorja kërkon (neni 15) që partitë politike të

³⁰⁴ ‘Ligji Nr. 03/L-073 Për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, 15 qershor 2008. Neni 3: Përkufizimet.

³⁰⁵ Ingrid van Biezen, Daniela Romeo Riccio, ‘Shaping Intra-Party Democracy: On the Legal Regulation of Internal Party Organizations’, në William R. Cross & Richard S. Katz (ed.) *The Challenges of Intra-Party Democracy* (Oxford University Press (2013), f. 32.

³⁰⁶ Po aty, f. 33.

mbajnë kuvendin (konventën zgjedhore) gjashtë muaj nga data e regjistrimit dhe më pas çdo 48 muaj. Po ashtu, në nenin 5 Rregullorja përcakton që KQZ-ja ka të drejtë të refuzojë kërkesën e një partie politike për t'u regjistruar, nëse statuti dhe dokumentet e tjera të kërkuara janë në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës dhe ligjet në fuqi dhe nëse partia e cila kërkon regjistrim, përmes akronimit ose simboleve të saj, sipas vlerësimit të KQZ-së, mund të nxisë urrejtje ose dhunë ndëretnike a religjioze. Një tjetër aspekt i rregulluar përmes kësaj rregulloreje është edhe pezullimi i partive të regjistruara politike, të cilat nuk e kanë mbajtur Kuvendin e partisë, ose nuk e kanë dërguar raportin vjetor financiar, nëse statutin dhe programin nuk i kanë në përputhje me rregullat e KQZ-së, nëse partia nuk i ka shlyer borxhet ndaj KQZ-së, etj. Porsa partitë politike t'i përmbushin këto obligime karshi KQZ-së, sipas rregullores, KQZ-ja mund ta vazhdojë regjistrimin e tyre.

Rregullorja për Regjistrimin e Partive Politike, në nenin 14 kërkon nga partitë politike që statudet e tyre të përmbajnë edhe norma që rregullojnë:

1. procedurat përmes të cilave qytetarët mund të bëhen anëtarë dhe të pushojnë të jenë anëtarë të partisë, si dhe të drejtat dhe përgjegjësitë e anëtarëve;
2. procedurat që duhen zbatuar për ndryshimin e statudit ose të programit politik të partisë;
3. procedurat që duhen zbatuar nga partia për hyrjen në koalicion elektorale;
4. procedurat që duhen zbatuar për zgjedhjen e kryetarit, të anëtarëve të organizimit më të lartë ekzekutiv ose të zyrtarëve të tjerë të zgjedhur të partisë;
5. procedurat që duhen zbatuar për zgjedhjen e kandidatëve të partisë në zgjedhjet për

- Kuvendin e Kosovës dhe të kuvendeve komunale;
6. mundësia e ushtrimit të kontrollit të brendshëm financiar;
 7. të drejtat e anëtarëve për t'u informuar për të gjitha të hyrat dhe shpenzimet e subjektit politik si dhe për përgjegjësinë e organit gjegjë për transaksione financiare;
 8. krijimin e një organi për zgjedhjen e kontesteve brenda partisë lidhur me interpretimin e statutit.³⁰⁷

Megjithatë, asnjëra nga 8 prerogativat e kësaj rregulloreje nuk përmend në mënyrë eksplicite demokracinë e brendshme partiake. I vetmi nen ku kjo gjë përmendet në mënyrë implicite është neni 16, sipas së cilit partitë politike duhet të sigurojnë “pjesëmarrje demokratike të anëtarëve të partisë në zgjedhjen e kandidatëve elektorale të partisë”. Ligji për Zgjedhje të Përgjithshme në Kosovë rregullon të drejtën dhe fshehtësinë e votës për të gjithë qytetarët pa diskriminim dhe obligon subjektet politike që ta zhvillojnë garën brenda një kulture të tolerancës demokratike. Po ashtu, rregullon edhe përshtatshmërinë e kandidatëve që mund të certifikohen për të garuar në zgjedhje, meqë partitë politike nuk e kanë rregulluar përmes statuteve të tyre në mënyrë eksplicite se kush mund të garojë dhe kush jo brenda listave zgjedhore të prezantuara nga subjektet politike. Ligji për Zgjedhje të Përgjithshme precizon se

[C]ilido person, emri i të cilit paraqitet në Listën e Votuesve, është i aftë për certifikim si kandidatit përveç nëse ai apo ajo është: a) gjykatës a prokuror në Kosovë ose gjetkë; b)

³⁰⁷ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ‘Rregullore Nr.01/2013 për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike. 0 korrik 2013. Qasur në www.kqz-ks.org/Uploads/Documents/Rregulla%20_123072013_agalzvuxxn.pdf (4 gusht 2016).

pjesëtar i Forcës së Sigurisë së Kosovës; c) pjesëtar i Policisë së Kosovës; d) pjesëtar i Shërbimit Doganor të Kosovës; e) pjesëtar i Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë; f) kryesues i një agjencie të pavarur; g) përfaqësues diplomatik; h) kryesues apo anëtar i KQZ-së; i) pjesëtar i KZAP-it; j) anëtar i Komisionit Komunal të Zgjedhjeve; k) pjesëtar i forcave të armatosura të ndonjë shteti; l) pjesëtar i ndonjë force policore apo të një trupi të ngjashëm; m) duke vuajtur dënimin e shqiptuar nga Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë; n) nën akuzë nga Tribunali dhe ka dështuar të veprojë në përputhje me urdhrin për t'u paraqitur para Tribunalit; o) me anë të vendimit të gjykatës, duke përfshirë edhe vendimin e KZAP-it, i është hequr e drejta për të qenë kandidat; p) me anë të vendimit të gjykatës, i është hequr e drejta për të qenë kandidat; q) i shpallur fajtor për veprë penale me një vendim përfundimtar të gjykatës në tri (3) vitet e fundit; r) ka dështuar ta paguajë gjobën e vënë nga KZAP-i apo KQZ-ja; ose s) ka dështuar t'i përmbahet ndonjë urdhri të KZAP-it".³⁰⁸

Pikat *p*, *q* dhe *r* të këtij ligji, në mënyrë të tërthortë kontribuojnë në demokratizimin brendapartiak, duke ua pamundësuar kandidimin për zgjedhje anëtarëve të partive politike që në një formë a tjetër kanë shkelur ligjin. Këto nene kanë një relevancë të shtuar në Kosovë, për faktin se një numër kandidatësh të partive politike i kanë shfrytëzuar partitë politike si 'çadra mbrojtëse' për t'u ikur përgjegjësiive penale.

Ligji i obligon partitë politike që në listat e kandidatëve të kenë së paku 30% gra, me çka garantohen kuotat e përfaqësimit gjinor në institucione. Siç do të hetojmë nga analiza e statuteve të partive politike në Kosovë, këto nuk rregullojnë kuota gjinore në organet drejtuese brendapartiake, me çka dëshmohet edhe më tutje domosdoshmëria e kuotave për përfaqësim gjinor në institucionet

³⁰⁸ 'Ligji Nr. 03/L-073 Për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, 15 qershor 2008. Neni 29.

qendrore, të garantuara përmes këtij ligji. Po ashtu, nënshkrimi i Kodit të Mirësjelljes nga subjektet politike, i rregulluar edhe me këtë ligj, ka për qëllim që t'i parandalojë praktikat jodemokratike të ushtrimit të ndikimit në procesin e votimit. Sipas këtij kodi, partitë politike duhet t'i informojnë anëtarët dhe simpatizantët e vet se ushtrimi i dhunës, frikësimi dhe kërcënimet ndaj kundërshtarëve politikë ndalohen me ligj. Meqë organizatat që merren me monitorimin e zgjedhjeve kanë evidentuar raste kur anëtarë dhe simpatizantë të partive politike frikësojnë dhe japin udhëzime para qendrave të votimit se për kë dhe për cilën parti duhet të votojnë qytetarët, kjo prerogativë ligjore duhet të zbatohet në plotni nga të gjitha partitë politike në Kosovë.

Një aspekt tjetër që rregullohet nga ky ligj është raportimi financiar për fushatat zgjedhore të organizuara nga partitë politike. Neni 40 i këtij ligj kërkon që partitë politike t'i dorëzojnë raportet financiare të fushatave të tyre zgjedhore, më së largu 45 ditë pas ditës së zgjedhjes, dhe nëse këto nuk dorëzohen ose dorëzohen të paplota, ato duhet të ridorëzohen, në të kundërtën partitë politike detyrohen të paguajnë gjobë.³⁰⁹ Kjo prerogativë ligjore ka për qëllim ta rrisë transparencën dhe llogaridhënien e partive politike kundrejt qytetarëve të Kosovës për shpenzimet e partive politike gjatë fushatave të tyre zgjedhore, megjithatë partitë politike deri më vonë kanë vazhduar që të mos e respektojnë në plotni këtë aspekt ligjor.

Edhe Ligji për Financimin e Subjekteve Politike rregullon transparencën financiare të subjekteve politike. Sipas tij, subjektet politike financohen përmes Buxhetit të Republikës së Kosovës nga Fondi për mbështetjen e subjekteve politike. Shuma totale e mjeteve buxhetore që mbledh ky Fond nuk mund të kalojë 0.17% të Buxhetit të Kosovës. Ky Fond e rregullon ndarjen e mjeteve financiare për

³⁰⁹ Ligji Nr. 03/L-174 Për Financimin e Subjekteve Politike. 16 shtator 2010. http://www.gazetazyrtare.com/e-gov/index.php?option=com_content&task=view&id=157&Itemid=56&lang=sq (2 prill 2015).

subjektet politike të përfaqësuar në Kuvend, varësisht prej numrit të ulëseve në këtë të fundit. Po ashtu, ky 0.5% i këtij Fondi (që nuk mund ta tejkalojë 0.17% e Buxhetit të Kosovës) ndahet për financimin e fushatave zgjedhore në nivel qendror dhe lokal për subjektet politike, ku 90% e mjeteve ndahen në bazë të numrit të ulëseve të fituara në zgjedhjet e fundit nga subjektet politike, kurse 10% ndahen për subjektet politike të saporegjistruara dhe të certifikuar në KQZ.

Ligji parasheh edhe kufizime në marrjen e kontributeve nga personat fizikë ose juridikë. Ndërsa subjekteve politike u lejohet të marrin një vlerë prej 2000 eurosh prej personave fizikë dhe 10.000 eurosh prej personave juridikë për një vit kalendarik, në momentin kur subjektet politike marrin një kontribut financiar, qoftë nga persona fizikë ose juridikë, prejardhjen e të cilit kontribut nuk mund ta dëshmojnë, ato detyrohen që brenda 2 javësh t'i njoftojnë organet kompetente. Sipas këtij ligji “Subjektet Politike duhet ta definojnë qartë, me Statut, të drejtën e anëtarëve për t’u informuar për të gjitha të hyrat dhe shpenzimet e subjekteve politike si dhe për përgjegjësinë e organit gjegjës për transaksione financiare”.³¹⁰ Megjithatë, ky aspekt i ligjit nuk është i integruar në statutet e partive politike në Kosovë.

Neni 21 i këtij ligji rregullon politikat ndëshkimore me sa vijon:

1. Subjekti politik do të gjobitet prej tremijë (3.000) deri në dhjetëmijë (10.000) euro, ndërsa kandidatët për deputetë dhe këshilltarë si dhe kandidatët e pavarur do të gjobiten prej pesëqind (500) deri në tremijë (3.000) euro për cenim të dispozitave të këtij ligji, në qoftë se:

³¹⁰ Po aty, shih nenin 7, 10, 17.

- 1.1. pranon mjete financiare në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji dhe të legjislacionit tjetër në fuqi;
- 1.2. mban shënimet në regjistrat e veta në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji dhe të legjislacionit tjetër në fuqi;
- 1.3. nuk i përmbahet dispozitave të këtij ligji dhe dispozitave të tjera të ligjeve të tjera në fuqi, për zgjedhjet e përgjithshme dhe zgjedhjet lokale.
2. Një subjekt politik, i cili nuk ia paraqet raportin vjetor financiar KQZ-së brenda afatit të përcaktuar me këtë ligj, humb të drejtën për të përfituar nga fondi në vitin e ardhshëm.
3. Personi përgjegjës brenda subjektit politik dënohet në shumë prej treqind (300) deri në njëmijë (1.000) euro për cenim e dispozitave të këtij ligji.³¹¹

Megjithatë, këto dispozita ndëshkimore janë të pamjaftueshme për rregullimin e transparencës financiare. Politikat ndëshkimore dhe gjobat e ulëta nuk kontribuojnë për rritjen e transparencës brendapartiake. Kësisoj, partitë politike në Kosovë vazhdojnë të sillen si organizata hermetikisht të mbyllura dhe aspak llogaridhënëse kundrejt votueseve. Siç vëren raporti i KDI-së ‘Çmontimi i financimit politik’:

Dënimet aktuale janë simbolike dhe nuk i nxisin partitë politike që ta zbatojnë ligjin. Shuma totale e dënimeve të shqiptuara gjatë vitit 2011 ka qenë 2.700 euro, që në mesatare i bie nga 451 euro për partitë [politike]. Edhe pse shkeljet e ligjit janë të shumta, siç edhe është cekur në raportin e auditorit për vitin 2010, KQZ-ja nuk ka lëshuar asnjë dënim për mospërputhje me

³¹¹ Ligji Nr. 03/L-256 për Financimin e Subjekteve Politike, 29 tetor 2010. Neni 21.

rregullat e kontabilitetit (përveç për raportet e dërguara me vonesë). KQZ-ja rrallë merr vendime për dënime për shkelje të vogla, duke u lejuar partive politike që të mos e ndiejnë presionin për ta përmirësuar kapacitetin dhe burimet e stafit të tyre administrativ që i përgatit raportet e tyre financiare.³¹²

Në të njëjtën vijë me zërat kritikë vendorë, edhe në Raportin e Progresit të vitit 2014 të Komisionit Evropian për Kosovën nënvizohet se “partitë politike në përgjithësi nuk i përmbushin detyrimet e tyre në bazë të Ligjit për Financimin e Partive Politike. Zbatimi dhe ekzekutimi i ligjit është i dobët. Zyra e Komisionit Qendror Zgjedhor, e cila është e ngarkuar me monitorimin e zbatimit, ka mungesë të kapaciteteve dhe të burimeve”.³¹³

Në qershor 2014, Kosova është anëtarësuar në Komisionin e Venecias. Me Kosovën, Komisioni i Venecias numëron 60 anëtarë. I njohur ndryshe edhe Komisioni Evropian për Demokraci Përmes Ligjit, komisioni punon në tri fusha: institucionet demokratike dhe të drejtat fundamentale, drejtësia konstitucionale dhe drejtësia e zakonshme, si dhe zgjedhjet, referendumet dhe partitë politike. Fushëveprimtaria e tretë e këtij Komisioni është me rëndësi të veçantë për Kosovën. Në dhjetor 2008, ky komision ka aprovuar Kodin për Praktikë të Mirë në Fushën e Partive Politike. Qëllimi eksplicit i këtij Kodi është: “Fuqizimi i demokracisë së brendshme brenda partive politike dhe rritja e kredibilitetit të tyre në sytë e qytetarëve, duke kontribuar kështu në legjitimimin e procesit demokratik dhe të institucioneve si tërësi dhe duke përkrahur pjesëmarrjen në jetën politike, si dhe promovimin e primeve

³¹² Instituti Demokratik i Kosovës, ‘Çmontimi i Financimit Politik’ (Prishtinë, qershor 2013), f. 8.

³¹³ Po aty, f. 16.

demokratike si barazia, dialogu, bashkëpunimi, transparenca dhe lufta kundër korrupsionit ”.³¹⁴

Kodi për Praktikë të Mirë në Fushën e Partive politike parasheh katër parime udhëheqëse për partitë politike. Këto parime janë: sundimi i ligjit, demokracia, mosdiskriminimi dhe transparenca. Këto parime konsiderohen si shtylla të trashëgimisë konstitucionale evropiane. Kodi thekson se partitë politike duhet të udhëhiqen nga parimi i përfaqësueshmërisë, përgjegjshmërisë dhe transparencës. Parimi i parë nënkupton se struktura dhe procedurat brenda partisë duhet të përfaqësojnë opinionin e anëtarëve. Parimi i dytë nënkupton se politikat dhe veprimet e organeve partiake duhet të mbahen përgjegjëse para anëtarësisë, dhe parimi i fundit, ai i transparencës, nënkupton se partitë politike duhet t'i bëjnë publike statutin, programin dhe raportet e tyre financiare. Meqenëse tashmë Kosova është anëtare e Komisionit të Venecias, parimet e mësipërme do të duhej të përbrendësoheshin plotësisht në dokumentet dhe veprimet e organeve të partive politike në Kosovë.

8.1 Matja e demokracisë brendapartiake

Studiues të partive politike, si Benjamin von dem Berge, Thomas Poguntke, Peter Obert dhe Diana Tipei në librin e tyre *Measuring Intra-Party Democracy: A Guide for the Content Analysis of Party Statutes With Examples from Hungary, Slovakia and Romania* [Matja e demokracisë brendapartiake: Udhëzues për analizën përmbajtësore së statuteve partiake me shembuj nga Hungaria, Sllovakia e Rumania] kanë përpiluar një listë të pyetjeve standarde

³¹⁴ European Commission for Democracy (Venice Commission), ‘Code of Good Practice in the Field of Political Parties’, adopted by the Venice Commission at its 77th Plenary Session’, (Strasbourg, 20 janar 2009), f. 2 Qasur në [http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2009\)002-e](http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2009)002-e) (5 korrik 2016).

për ta matur demokracinë e brendshme partiake. Përmes kësaj liste pyetjesh, ne i kemi analizuar statutet partiake. Disa pyetje janë shkurtuar për qëllime praktike, kurse pjesa krahasuese dhe kodimi, siç e kemi dizajnuar në këtë tabelë, është pjesë e shtuar për nevojat praktike të këtij studimi. Meqenëse statutet e partive të analizuara dallojnë nga njëri-tjetri si në aspektin e terminologjisë, ashtu edhe në atë të hierarkisë organizative, për t'i vlerësuar pyetjet e shtruar kemi shfrytëzuar udhëzuesin e këtyre autorëve për analizimin e këtyre pyetjeve. Nëse në statut nuk ka pasur përgjigje eksplicite për ndonjërin nga pyetjet e parashtruara, këto përgjigje janë koduar si Jo-1, pra si përgjigje negative, që kanë ndikim negativ në demokracinë brendapartiake. Kriteri vlerësues i pyetjeve të këtij pyetësori është gjithëpërfshirja dhe decentralizimi. Përgjigjet me ndikim pozitiv në gjithëpërfshirje dhe decentralizim të partisë politike, janë vlerësuar me + (plus), kurse përgjigjet me ndikim negativ në këto dy aspekte të demokracisë partiake janë vlerësuar me – (minus). Po + (plus) nënkupton se ekziston një formë e organizimit partiak ashtu siç kërkohet në pyetje, dhe ka ndikim pozitiv në demokracinë e brendshme partiake. Jo + (plus) nënkupton se nuk ekziston një formë e organizimit partiak, ashtu siç kërkohet në pyetje, por që mosprania e këtij mekanizmi ndikon pozitivisht në demokracinë brendapartiake. E njëjta formulë vlen edhe për Po – (minus) dhe Jo– (minus). Po – (minus) nënkupton se ekziston një formë e organizimit partiak, ashtu siç kërkohet në pyetje, dhe se ka ndikim negativ në demokracinë e brendshme partiake. Jo – (minus) nënkupton se nuk ekziston një formë e organizimit partiak ashtu siç kërkohet në pyetje, çka ka ndikim negativ në demokracinë e brendshme partiake.

STATUTET – SKEMA KODUESE	PDK	LDK	VV	AAK
Të drejtat/përgjegjësitë <i>Të drejtat e përgjithshme të anëtarëve</i>				
1. A përmendet demokracia brendapartiake në mënyrë eksplicite në statut?	Po +	Jo –	Jo –	Jo –
2. A janë të përmendura të drejtat e anëtarëve në mënyrë eksplicite në statut?	Po +	Po +	Po +	Po +
3. A kanë të drejtë anëtarët të formojnë fraksione brenda partisë?	Jo –	Jo –	Jo –	Jo –
<i>Të drejtat e pakicave dhe grave?</i>				
4. A ka kuota që përmenden në mënyrë eksplicite për pakica në organet partiake?	Jo –	Jo –	Jo –	Jo –
5. A ka kuota që përmenden në mënyrë eksplicite për gratë në organet partiake?	Po –	Jo –	Jo –	Jo –
Struktura organizative <i>Kongresi/Kuvendi partiak</i>				
6. A përmendet ekzistenca e një kongresi/kuvendi partiak apo ekuivalenti me të në statut?	Po +	Po +	Po +	Po +
7. A përmendet se kongresi është organi më i lartë në parti?	Po +	Po +	Jo +	Po +
8. A përmendet në statut se kongresi/kuvendi i partisë duhet të mbledhet të paktën njëherë në tre vjet?	Po +	Po +	Po +	Po +
<i>Agjencitë për zgjidhjen e konfliktit</i>				
9. A ka ndonjë agjenci/mekanizëm për zgjidhjen e konfliktit të përmendur në mënyrë eksplicite në statut?	Po –	Po –	Po –	Jo –
10. A përmendet ekzistenca e ndonjë organi të pavarur partiak (p.sh. Gjykata partiake), që vendos për masa disiplinore?	Po –	Po –	Po –	Jo –
11. A përmendet në mënyrë eksplicite se juridiksioni i gjykatës përfshin edhe ekzekutivin e partisë dhe Kryetarin e partisë?	Jo –	Jo –	Jo –	Jo –

<i>Komiteti/kryesia ekzekutive</i>				
12. A i përmend statuti përgjegjësit e komitetit ekzekutiv?	Po +	Po +	Po +	Po +
13. A ka ndonjë trup/mekanizëm që përmendet në mënyrë eksplicite, e që është specifikisht i ngarkuar për të kontrolluar komitetin ekzekutiv?	Po +	Po +	Jo -	Po +
<i>Kryetari i partisë</i>				
14. A e përmend statuti që kryetari i partisë mund të sfidohet në pozitën e tij?	Jo -	Po +	Jo -	Po +
15. A i përmend statuti të drejtat (obligimet) e Kryetarit, me sa vijon:				
16. Të bllokojë ekzekutimin e vendimeve dhe të akteve të tjera të ekzekutivit?	Jo +	Po -	Jo +	Jo +
17. Të përjashtojë një anëtar nga partia?	Jo +	Jo +	Jo +	Jo +
18. Të shkarkojë një anëtar nga ekzekutivi i partisë?	Jo +	Jo +	Jo +	Jo +
19. Të veprojë kundër provizioneve të përgjithshme të statutit në raste të veçanta?	Jo +	Jo +	Jo +	Jo +
20. Të formojë apo mbyllë degët dhe nëndegët e partisë?	Po -	Jo +	Jo +	Jo +
<i>Marrëdhëniet mes nivelit nacional dhe komunal?</i>				
21. A i përmend statuti degët dhe nëndegët, apo ekuivalentët me to?	Po +	Po +	Po +	Po +
22. A i përmend statuti të drejtat e degëve dhe nëndegëve?	Po +	Po +	Po +	Po -
22. A përmend statuti që degët dhe nëndegët ndikojnë në organe më të larta të partisë?	Jo -	Jo -	Po +	Jo -
23. A përmendet në mënyrë eksplicite në statut se degët dhe nëndegët gëzojnë autonomi?	Jo -	Jo -	Jo -	Jo -
Vendimmarrja – Rekrutimi Nominimi i kandidatëve				
24. A e përmend statuti të drejtën për të sugjeruar/nominuar kandidatët për poste publike?	Po -	Po -	Po +	Po -

25. A vjen nominimi për kandidatë nga ekzekutivi qendror?	Po –	Po –	Jo +	Po –
26. A vjen nominimi i kandidatëve nga Kongresi partiak?	Jo –	Jo –	Jo +	Jo –
27. A vjen nominimi për kandidatë nga nëndegët (pikat)?	Jo –	Jo –	Jo –	Jo –
<i>Përzgjedhja e kandidatëve – Kuvend</i>				
28. A e përmend statuti kush ka të drejtë të zgjedhë kandidatët për Kuvend?	Jo –	Po –	Jo –	Po +
29. A i përzgjedhin anëtarët e regjistruar partiakë kandidatët për zgjedhje?	Jo –	Jo –	Jo –	Jo –
30. A i përzgjedhin delegatët kandidatët për zgjedhje?	Jo –	Po +	Po +	Jo –
31. A i përzgjedh kandidatët Ekzekutivi nacional apo ndonjë komitet i zgjedhur nga ai?	Po –	Po –	Po –	Po –
32. A i përzgjedh kandidatët ndonjë komitet ekzekutiv, kryetari apo një komitet i zgjedhur nga ai?	Po –	Po –	Jo +	Po –
<i>Përzgjedhja e kandidatëve – Kryetari</i>				
33. A e përmend statuti në mënyrë eksplicite se kush ka të drejtë t'i zgjedhë kandidatët për kryetar të partisë?	Po +	Po +	Jo –	Po +
34. A mundet kryetari i partisë të përzgjedhë veten për kandidat për kryetar?	Jo +	Jo +	Jo +	Jo +
35. A e përzgjedhin anëtarët e regjistruar të partisë (votuesit) kandidatin me zgjedhje?	Jo –	Jo –	Jo –	Jo –
1.3 A i zgjedhin delegatët kandidatët me zgjedhje?	Jo –	Po –	Jo +	Jo –
<i>Marrëdhëniet mes nivelit qendror dhe niveleve lokale</i>				
36. A e kontrollon në plotni qendra e partisë përzgjedhjen e kandidatëve?	Jo +	Jo +	Jo +	Jo +
37. A propozojnë njësitë e partisë (degët dhe nëndegët) kandidatët, por organet qendrore të partisë vendosin përfundimisht?	Po –	Po –	Po +	Po –
38. A sigurojnë njësitë e partisë një listë të emrave prej të cilëve organet qendrore të	Po –	Po +	Po +	Po –

partisë bëjnë përzgjedhjen e listës finale?				
39. A kanë të drejtë vetoje njësitë e partisë lidhur me përzgjedhjen e kandidatëve për poste publike?	Jo -	Jo -	Jo +	Jo -
40. A e kontrollojnë në plotni njësitë (degët, nëndegët) partiake procesin dhe marrin vendim përfundimtar për kandidatët për poste publike?	Jo -	Jo -	Jo +	Jo -
<i>Poste brendapartiake – Niveli qendror</i> <i>Zgjedhjet për ekzekutivin qendror</i>				
41. A ka rregulla që përmenden në mënyrë eksplicite në statut në lidhje me zgjedhjen e kryesisë/ekzekutivit qendror?	Po -	Po +	Po +	Po +
42. A janë të përfshirë drejtpërdrejt anëtarët e partisë në zgjedhjen e ekzekutivit qendror?	Jo -	Jo -	Jo -	Jo -
43. A janë të përfshirë drejtpërdrejt delegatët e zgjedhur në kongresin e partisë apo në kryesi/komitete qendrore për zgjedhjen e ekzekutivit qendror?	Po +	Po +	Po +	Po +
44. A është kongresi qendror drejtpërdrejt i përfshirë në zgjedhjen e ekzekutivit qendror?	Po -	Po +	Jo +	Po +
45. A është kryetari i partisë drejtpërdrejt i përfshirë në zgjedhjen e ekzekutivit partiak?	Po -	Po -	Jo +	Po -
2. Zgjedhja e kryetari të partisë				
46. A ka ndonjë rregull për zgjedhjen e kryetarit të partisë të përmendur në statut?	Po +	Po +	Jo -	Po +
47. A janë të përfshirë drejtpërdrejt të gjithë anëtarët në zgjedhjen e kryetarit të partisë?	Jo -	Jo -	Jo -	Jo -
48. A janë të përfshirë drejtpërdrejt delegatët në kongresin partiak në zgjedhjen e kryetarit të partisë?	Po +	Po +	Po +	Po +
49. A është i përfshirë drejtpërdrejt ekzekutivi qendror në zgjedhjen e kryetarit të partisë?	Jo +	Jo +	Jo +	Jo +

50. A është i përfshirë drejtpërdrejt komiteti ekzekutiv në zgjedhjen e kryetarit të partisë?	Jo +	Jo +	Jo +	Jo +
<i>4. Procedurat - Procedurat e votimit</i>				
51. A përmban statuti ndonjë informatë për mënyrën e votimit brendapartiak?	Po +	Po +	Po +	Po +
52. A është përdorur metoda e zgjedhjes së fshehtë kur zgjidhen kandidatët për pozita brendapartiake ose për poste publike?	Po +	Po +	Jo -	Po +
52. A përmendet në mënyrë eksplicite se rezultatet e votimit do të prezantohen tek të gjithë anëtarët brenda partisë për të justifikuar dhe legjitimuar kandidatët?	Po +	Jo -	Jo -	Jo -
<i>4. Marrëdhëniet mes njësive qendrore dhe lokale të partisë</i>				
53. A është e specifikuar në mënyrë eksplicite se njësitë (degët, nëndegët, etj.) zgjedhin kandidatët për poste publike?	Jo -	Po +	Po +	Jo -
54. A gëzojnë njësitë partiake autonomi kur i zgjedhin kandidatët për poste publike?	Jo -	Jo -	Po +	Jo -
55. A përmendet në mënyrë eksplicite se njësitë partiake bashkëpunojnë me degët qendrore kur i zgjedhin kandidatët për poste publike?	Jo -	Jo -	Jo -	Jo -
56. A e kontrollojnë në plotni organet qendrore të partisë zgjedhjen e kandidatëve të njësive partiake?	Po -	Jo +	Jo +	Jo +
<i>5. Marrëdhëniet mes njësive qendrore dhe lokale - postet brendapartiake nëpër njësi</i>				
57. A përmendet në mënyrë eksplicite se njësitë partiake e zgjedhin lidërshtipin e tyre?	Po +	Po +	Po +	Po +
58. A bashkëpunojnë njësitë partiake me qendrën e partisë kur zgjedhin lidërshtipin e tyre?	Jo -	Po -	Jo +	Jo +
59. A e kontrollojnë në mënyrë të plotë njësitë e partisë zgjedhjen e lidërshtipit të njësive të tyre?	Po +	Po +	Po +	Po +

Çështjet programore				
60. A e përmend statuti në mënyrë specifike se kush është i ngarkuar për zhvillimin e programit?	Jo -	Jo -	Po +	Jo -
61. A kanë të drejtë anëtarët e partisë të votojnë programin?	Jo -	Jo -	Po +	Jo -
62. A ka të drejtë kongresi partiak të votojë për programin?	Po +	Po +	Po +	Po +
63. A mund të votojë ekzekutivi partiak për programin?	Po +	Jo -	Jo +	Po -
64. A mund të votojë kryetari i partisë për programin?	Jo +	Jo +	Jo +	Jo +
65. A mund të kenë njësitë lokale të partisë një votë të ndarë mbi programin?	Jo -	Jo -	Jo -	Jo -
TOTALI	- 37	- 33	- 22	- 33

Nga katër partitë e koduara këtu, VV prin në mënyrë relative për nga demokratizimi brendapartiak për shkak të gjithëpërfshirjes më të lartë të anëtarëve të saj në proceset e brendshme të lëvizjes dhe autonomisë statutores që gëzojnë pikat dhe qendrat. LDK dhe AAK kanë një demokratizim brendapartiak mesatar, për faktin se strukturat e brendshme partiake të dy partive janë ende të centralizuara, kurse degët dhe nëndegët nuk gëzojnë një decentralizëm të plotë brendapartiak. PDK vlerësohet partia me shkallën më të lartë të centralizimit, të mospërfshirjes së anëtarëve në procese vendimmarrëse dhe të mungesës së autonomisë së njërive të saj partiake.

8.2 Demokracia brendapartiake: gjithëpërfshirja dhe decentralizimi tek PDK, LDK, VV dhe AAK

Demokracia brendapartiake ka të bëjë me shpërndarjen e pushtetit brendapartiak, autonominë e njësive dhe të organeve brendapartiake dhe shkallën e gjithëpërfshirjes së anëtarësisë së partive politike në proceset vendimmarrëse. Një grup studiuesish të partive politike si p.sh. Benjamin vo dem Berge, Thomas Poguntke, Peter Obert dhe Diana Pipei, theksojnë se “në mënyrë ideale, në një parti demokratike, vullneti duhet të formohet nga ‘poshtë-lart’ dhe (...) shpërndarja e brendshme e pushtetit duhet të ndahet ndërmjet niveleve, trupave dhe individëve të ndryshëm dhe jo të përqendrohet në një organ”.³¹⁵ Sipas këtyre studiuesve, demokracia brendapartiake ka të bëjë me përfshirjen e anëtarësisë në vendimmarrjen e brendshme partiake. Ky aspekt është i njohur si gjithëpërfshirshmëri. Aspekt tjetër i demokracisë së brendshme partiake është decentralizimi, që nënkupton se vendimmarrja partiake nuk është e centralizuar në një organ të vetëm dhe se njësitë (degët, nëndegët, seksionet) partiake gëzojnë një nivel të caktuar autonomie vendimmarrëse. Me fjalë të tjera, gjithëpërfshirshmëria ka të bëjë me të drejtat e anëtarëve, të simpatizantëve, të përkrahësve të partive politike, kurse decentralizimi ka të bëjë me të drejtat e pikave, degëve dhe nëndegëve në procesin vendimmarrës. Sidoqoftë, studiues të partive politike tërheqin vëmendjen tek dallimi mes të drejtave të anëtarëve dhe mekanizmave vendimmarrës të përcaktuar në statutet partiake si dhe shpërndarjes reale të pushtetit brenda partive politike.³¹⁶

³¹⁵ Benjamin vo dem Berge, Thomas Poguntke, Peter Obert dhe Diana Pipei, *Measuring Intra-Party Democracy: A Guide for the Content Analysis of Party Statutes with Examples from Hungary, Slovakia and Romania* (Springer, 2013), f. 2.

³¹⁶ William P. Cross dhe Richard S. Katz (ed.), *The Callenges of Intra-Party Democracy* (Oxford University Press, 2013).

Në përgjithësi, këto janë disa prej problemeve kyçe që e shoqërojnë mungesën e demokracisë brendapartiake tek katër partitë e analizuara në këtë studim.

Statutet dhe rregulloret e brendshme partiake. Statutet partiake dhe rregulloret e brendshme të organizmit brendapartiak nuk janë të shkruara në frymën demokratike. Statutet e partive politike nuk janë produkte politike të një debati të gjerë brendapartiak. Ndonëse një pjesë e neneve të statuteve partiake ka anomali serioze për funksionimin demokratik të partive politike, ajo që mbetet edhe më shqetësuese për nivelin e demokracisë brendapartiake është mungesa e zbatimit të këtyre statuteve.

Liderizmi. Fuqia e pakontestuar e liderit për të ekzekutuar vendime pa konsultuar as anëtarësinë e gjerë dhe as strukturat vendimmarrëse, siç përcaktohet me statut, ka dobësuar skajshmërisht ndikimin e organeve partiake në vendimmarrje.

Mungesa e autonomisë së veprimit të njërive partiake. Njësitë partiake, qofshin këto pikat, nëndegët, seksionet ose degët, nuk gëzojnë autonomi të plotë në zgjedhjen e kandidatëve të tyre. Ka pasur ndërhyrje të vazhdueshme të strukturave qendrore për t'i zgjedhur të preferuarit e tyre në njësitë lokale partiake.

Mungesa e lirisë së shprehjes dhe e lirisë së mendimit të anëtarëve partiakë. Sanksionimi dhe disiplinimi i mendimit të lirë brenda partive politike është rregulluar me shumicën e statuteve të partive politike në Kosovë, me përjashtim të AAK-së. Në organizimet brendapartiake të partive perëndimore (në formën e Gjykatës së Arbitrazhit siç është rasti me partitë politike në Gjermani ose Austri) mekanizmat të tillë quhen 'mekanizma të zgjidhjes së konfliktit. Në organizimet partiake në Kosovë mekanizmat e tillë quhen 'mekanizma disiplinues'.

Mungesa e transparencës financiare. Në Kosovë është vendosur një lidhje klienteliste mes partive politike dhe bizneseve private. Meqenëse partitë që udhëheqin me qeverinë kontrollojnë

shumicën e bordeve të të ashtuquajturave autoritete të pavarura rregullative, këto të fundit favorizojnë dhe shpërblejnë biznese private të cilat i kanë financuar partitë politike në organizimin e zgjedhjeve. Fizionomia e klientelizimit dhe patronazhit ka disa forma në Kosovë. Njëra prej tyre është kjo: kompanitë financojnë partitë politike, kurse këto të fundit i shpërblejnë kompanitë me licenca dhe leje për shfrytëzimin e aseteve publike të Kosovës ose import të mallrave të caktuara. Së këndejmi, mungesa e transparencës rreth raportimeve financiare për fushatat zgjedhore të partive politike kontribuon drejtpërdrejt në kulturën e papërgjegjshmërisë dhe mungesës së llogaridhënies kundrejt votueseve të tyre rreth burimeve financiare të tyre, shpenzimeve të tyre dhe auditivit të atyre shpenzimeve.

Megjithatë, me qëllimin që t'i ikim sa më shumë vlerësimeve subjektive, do të provojmë të hedhim pak dritë mbi vlerësimin që analistët dhe studiuesit i bëjnë demokracisë brendapartiake, pastaj mbi vlerësimin që partitë politike i bëjnë njëra-tjetrës dhe më pas, të bëjmë një krahasim të statuteve të këtyre partive. Kjo qasje mundëson një vlerësim më gjithëpërfshirës për demokracinë brendapartiake. Qasja do të fitonte peshë të shtuar sikur partitë politike të ishin krejtësisht transparente dhe të mundësohej një 'observim me pjesëmarrje', ku hulumtuesi do të kishte mundësi të vrojtonte praktikisht procesin vendimmarrës brendapartiak dhe raportet e pushtetit mes organeve partiake, liderëve dhe anëtarësisë, etj. Meqenëse procesi i vendimmarrjes brenda partisë politike konsiderohet '*black box*', ky aspekt nuk është mbuluar në këtë studim.

Analisti Halil Matoshi ka theksuar mungesën e demokracisë së brendshme tek të gjitha partitë politike në Kosovë. Sipas tij: "Asnjëra nga partitë politike kosovare nuk i përmbush kriteret demokratike, sepse vuajnë krizën e lidershit, ku anëtarësia është në shërbim të kultit të liderit, e jo lideri të jetë në shërbim të

anëtarësisë. Po ashtu, partitë politike kosovare vuajnë sindromën e partive rajonale dhe klanore”.³¹⁷ Politologu Bekim Baliqi ka vlerësuar se zgjedhja e të gjithë liderëve partiakë është bërë në mënyrë jodemokratike. Sipas tij: “Derisa LDK-ja ka pasur vetëm një kandidat për Kryetar, njëjtë kanë vepruar edhe në PDK, VV, dhe AAK. Megjithatë, unë mendoj se Vetëvendosja deri diku e ka një nivel më të lartë të demokracisë, ndoshta për faktin që nuk ka qenë ende në pushtet [qendror].”³¹⁸ Në anën tjetër, politologu Artan Mustafa ndonëse ka kritikuar zgjedhjet e fundit me vetëm një kandidat për Kryetar të Lëvizjes Vetëvendosje, ka renditur një numër arsyes se pse e konsideron Lëvizjen Vetëvendosje si më demokratike, krahasuar me partitë e tjera. Sipas tij, “VV [ka demokraci më të madhe brendapartiake] për shkak se ka rreshtim ideologjik të qartë, strukturë që aktualisht rreket për aktivizëm në terren, shumë personalitete që flasin në publik, zgjedhje direkte ku voton e gjithë anëtarësia. Gjithashtu duhet t’i njihet merita që është partia e parë që arrin të mobilizojë një masë të re të popullatës pa u ndërlidhur me ngjarje të jashtëzakonshme si koha e luftës”.³¹⁹ Të njëjtin qëndrim ka prezantuar edhe politologu Agron Demi, i cili argumenton se: “Nëse merret për bazë mënyra e përzgjedhjes së strukturave qeverisëse partiake dhe mënyra e përpilimit të listave zgjedhore, duket se VV ka një demokraci më të madhe brendapartiake”.³²⁰

Partitë politike kanë perceptime të ndryshme për njëra-tjetrën. Duke qenë se secila prej katër partive politike të analizuara këtu mburret për nivelin e demokracisë brendapartiake dhe kritikon partitë e tjera për mungesë të saj, këtë çështje kam provuar ta adresoj

³¹⁷ Intervistë me z. Halil Matoshin, analist, Prishtinë, 28 mars 2016.

³¹⁸ Intervistë me z. Bekim Baliqi, politolog dhe profesor në Departamentin e Shkencës, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 31 mars 2016.

³¹⁹ Intervistë me z. Artan Mustafa, politolog dhe gazetar, Prishtinë, 5 prill 2016.

³²⁰ Intervistë me z. Agron Demi, politolog dhe Drejtor Ekzekutiv në institutin GAP, Prishtinë, 5 prill 2016.

përmes një pyetjeje. Për t'i parë perceptimet e partive politike për njëra-tjetrën, në mesin e pyetjeve tek intervistat e thella, është shtruar pyetja: Cila prej tri partive politike më të mëdha ka demokraci brendapartiake më të madhe, me përjashtim të partisë suaj? Në pyetjen se cila prej partive politike (LDK, VV dhe AAK) ka demokraci më të madhe, me përjashtim të PDK-së, Basri Musmurati i PDK-së ka theksuar se: “Në bazë të asaj që shihet, Lidhja Demokratike e Kosovës e ka një demokraci më të madhe se këto dy të tjerat. Kurse në Vetëvendosje ka një centralizim total, i cili nuk ka perspektivë”.³²¹ Në të njëjtën pyetje, Arben Gashi nga Lidhja Demokratike e Kosovës, ka kritikuar PDK-në, VV-në dhe AAK-në për mungesë të demokracisë brendapartiake: Sipas tij “PDK-ja është një parti e cila nuk ka kaluar në proces të brendshëm të mirëfilltë demokratik, sepse që nga themelimi i saj ka pasur një lider, dhe tash mbetet të shihet si do të veprojë. Kurse, Lëvizja Vetëvendosje ka një diktaturë të brendshme të deklaruar nga njerëzit, të cilët janë larguar prej saj. Ndërsa AAK-ja ka karakteristikat e një partie familjare”.³²² Glauk Konjufca nga Lëvizja Vetëvendosje ka vlerësuar demokracinë formale që ekziston në LDK, por ka kritikuar aspektin përmbajtësor të kësaj demokracie. Sipas tij:

Në kuptimin formal të fjalës, Lidhja Demokratike e Kosovës duket se ka një demokraci. Pra, në aspektin formal, Lidhja Demokratike e Kosovës duket se e përmbush më së miri aspektin e demokracisë dhe kjo për disa arsye: për shembull, arsyeja e parë është që në LDK kemi pasur më së shumti ndryshim të kryetarit, domethënë prej kohës së Presidentit Rugova, janë tre kryetarë të partisë që janë ndërruar. Ky është

³²¹ Intervistë me z. Basri Musmurati, Partia Demokratike e Kosovës, Prishtinë, 31 mars 2016.

³²² Intervistë me z. Arben Gashi, Lidhja Demokratike e Kosovës, Prishtinë, 29 mars 2016.

një kusht formal, por në aspektin përmbajtësor, Lidhja Demokratike e Kosovës nuk duket që dallon prej Partisë Demokratike të Kosovës. Kurse sa i përket Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës duket që në aspektin përmbajtësor ka forume në të cilat ka diskutime për mënyrën se kah t'ia mbajë partia, mirëpo kemi pasur një Kryetar i cili ka dashur jo vetëm që ta mbajë postin e tij, por bile me ndryshimet statutores ka kërkuar ta zgjasë postin e tij, ta bëjë një post presidencial, një post të përhershëm e kështu me radhë, gjë që nuk i kontribuon demokracisë në vend.³²³

Pal Lekaj nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës ka dhënë këtë vlerësim për demokracinë brendapartiake të partive rivale.


Unë mendoj se nuk dallojnë njëra prej tjetrës. Vetëvendosje duket që ka brendapërbrenda, mirëpo edhe aty është një strukturë zinxhirore. Urdhrrat jepen nga lart-poshtë me një vijë vertikale komanduese, dhe prapë mendoj se jemi larg demokratizimit. LDK-ja mundet me qenë më demokratike se ka pasë ndryshime edhe më vonë. Por jo aq demokratike, sepse sa herë është zgjedhur Kryetari, ka pasur ndarje të LDK-së, dhe kjo e ka dobësuar shumë LDK-në. Prandaj, mendoj se partitë politike në Kosovë nuk janë demokratike, sepse ende ekziston një lider i pakontestueshëm. Derisa nuk ka konkurrencë të brendshme nuk mund të flasim për demokratizim.³²⁴

Duke u bazuar në statutet e partive politike, praktikat vendimmarrëse dhe intervistat me disa prej zyrtarëve të partive politike, në këtë studim kam bërë një vlerësim të shkallëshmërisë së gjithëpërfshirjes dhe decentralizimit të katër partive politike në Kosovë. Bazuar në modelin e Reuven Y. Hazan dhe Gideon

³²³ Intervistë me z. Glauk Konjufca, Lëvizja Vetëvendosje, Prishtinë, 1 prill 2016.

³²⁴ Intervistë me z. Pal Lekaj, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Prishtinë, 7 prill 2016.

Rahat³²⁵, shtrirja e partive politike në Kosovë sa i përket vektorit të gjithëpërfshirjes dhe të decentralizimit, është vlerësuar si në tabelën e mëposhtme. Në aspektin formal, me përjashtim të PDK-së, e cila në statutin e saj e thekson shprehimisht demokracinë e brendshme partiake (Neni 10), në statutet e tri partive të tjera, demokracia brendapartiake nuk përmendet askund shprehimisht. Kjo nuk do të thotë se PDK-ja është më e avancuar në procesin e demokratizimit brendapartiak në krahasim me LDK-në, VV-në dhe AAK-në. Në fakt, përmes krahasimit të statuteve të katër partive, vërehet qartë se PDK-ja ka më së shumti probleme me demokracinë brendapartiake në krahasim me VV-në, LDK-në dhe AAK-në. Duke u shërbyer me modelin e zhvilluar nga Hazan dhe Rahat, në mënyrë grafike, çfarë u pohua më lartë për shtrirjen e partive politike në vektorin e demokratizimit, merr formën e mëposhtme.



³²⁵ Reuven Y. Hazan dhe Gideon Rahat, *Democracy within Parties: Candidate Selection Methods and Their Political Consequences* (Oxford University Press, 2010), f. 35.

8.2.1 Të drejtat e anëtarëve

PDK, LDK, VV dhe AAK kanë vendosur kritere të ndryshme për mënyrën dhe kërkesat që duhet t'i plotësojnë qytetarët e Kosovës për t'u anëtarësuar në këto parti politike. Ndërsa në PDK, VV dhe AAK kërkesa për anëtarësim dërgohet në formë të shkruar dhe duhet të dorëzohet individualisht nga vetë kandidati për anëtar, në LDK, ndonëse kërkesa për anëtarësim dërgohet individualisht, statuti i saj nuk kërkon që kandidati të jetë i pranishëm në momentin e dorëzimit të kërkesës. Sa i përket moshës, të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës që në momentin e anëtarësimit kanë të mbushur 16 vjet, mund të anëtarësohen në PDK; pragu minimal i moshës për t'u anëtarësuar në LDK nuk përcaktohet me statut, kurse për anëtarësim në VV qytetarët duhet t'i plotësojnë këto pesë kritere: mosha mbi 16 vjeç, pagesa e anëtarësimit, pranimi vullnetar i dokumenteve të VV, informimi me nenet e statutit të VV-së që kanë të bëjnë me të drejtat dhe detyrimet e anëtarëve dhe kandidati të mos jetë anëtar i ndonjë subjekti tjetër politik. Në AAK mund të anëtarësohet çdo qytetar i Kosovës që në momentin e anëtarësimit ka të mbushur 18 vjet. Në vijim analizohen të drejtat dhe obligimet e anëtarëve si dhe kriteret formale të kërkuara për anëtarësim në PDK, LDK, VV dhe AAK.

	PDK	LDK	VV	AAK
Mënyra e anëtarësimit në parti	Kërkesa për anëtarësi duhet të dërgohet individualisht.	Kërkesa për anëtarësi duhet të dërgohet në formë të shkruar (nuk është e nevojshme që kandidati të jetë i pranishëm në momentin e dorëzimit të kërkesës).	Kërkesa për anëtarësi duhet të dërgohet në formë të shkruar. Kërkesa nënshkruhet dhe dorëzohet nga kandidati.	Kërkesa për anëtarësi duhet të bëhet në formë të shkruar. Kërkesa dorëzohet nga kandidati.
Mosha dhe kriteret e tjera	Të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës që në momentin e anëtarësimit kanë të mbushur 16 vjet.	Nuk përmendet në statut.	Për të qenë anëtar në VV (neni 16), duhet të plotësohen këto 5 kriteret: mosha mbi 16 vjeç, pagesa e anëtarësimit, pranimi vullnetar i dokumenteve të VV, informimi me nenet e statutit të VV-së që kanë të bëjnë me të drejtat dhe detyrimet e anëtarëve dhe kandidati të mos jetë anëtar i ndonjë subjekti tjetër politik.	Çdo qytetar i Kosovës që në momentin e anëtarësimit ka të mbushur 18 vjet.

Forma e anëtarësimit në partitë politike në Kosovë.

PDK

Demokracia brendapartiake përmendet në mënyrë eksplicite në statutin e PDK-së. Sipas këtij statuti, anëtarët kanë të drejtë të shprehin qëndrimet e tyre, por vendimet e partisë merren me shumicë dhe janë të detyrueshme për të gjithë anëtarët.³²⁶ Parimi i përgjithshëm i anëtarësimit në këtë parti kushtëzohet me prapësinë e mosës, që vlen për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës që në momentin e anëtarësimit kanë të mbushur 16 vjet. Anëtarësimi është individual. Procedurat e anëtarësimit fillojnë pas dorëzimit të formularit në njërën prej strukturave të PDK-së, qoftë ai seksion, nëndegë, degë apo seli qendror. Vendimin për pranimin e anëtarit e merr Kryesia e Seksionit apo të Nëndegës brenda dy javësh.³²⁷ Po ashtu, me statutin e PDK-së janë të precizuara të drejtat dhe detyrimet e anëtarëve dhe kushtet nën të cilat anëtarët e PDK-së potencialisht e humbin statusin e anëtarit.

Anëtarët e PDK-së kanë të drejtë të ndërmarrin nisma politike dhe t'i prezantojnë këto organeve vendimmarrëse; kanë të drejtë të propozohen si kandidatë në listat zgjedhore dhe të informohen për punën e organeve të PDK-së. Megjithatë, statuti nuk precizon natyrën e iniciativave politike që anëtarët mund t'i ndërmarrin e as mënyrat se si do të informohen për punën e organeve qendrore të PDK-së. Anëtarët e PDK-së e humbin statusin e anëtarit në rastin e dorëheqjes nga partia, të përjashtimit nga partia apo në rast të vdekjes. Pra, gjithmonë sipas statutit, anëtarit të rëndomtë nuk i pushon statusi i anëtarit brenda partisë në rast se ndaj tij/saj zhvillohet një proces hetimor, ose në rast se akuzohet për korrupsion a krim të organizuar. Statuti i PDK-së e rregullon vetëm humbjen e statusit të anëtarit të Këshillit Drejtues në rast të shkeljes serioze të statutit të PDK-së, apo në rast se ka një aktgjykim të formës së prerë

³²⁶ Statuti i Partisë Demokratike të Kosovës (pa datë), neni 10.2.

³²⁷ Statuti i Partisë Demokratike të Kosovës (pa datë), neni 15.

dhe anëtari dënohet me mbi një vit burg.³²⁸ Sidoqoftë, figura eminente të PDK-së, respektivisht kryetarë të komunave si Ramadan Muja (Prizren), Xhabir Zharku (Kaçanik), ose Sokol Bashota (Klinë), ndonëse janë akuzuar për korrupsion, armëmbajtje pa leje etj., kanë vazhduar të mbrohen nga PDK-ja, meqë statusi i tyre si anëtarë të PDK-së nuk u është pezulluar.³²⁹ Pos anëtarëve, statuti i PDK-së³³⁰ rregullon se në veprimtarinë e PDK-së mund të marrin pjesë edhe përkrahësit, mbështetësit dhe simpatizuesit, por pa të drejtë vote.

LDK

Statuti i LDK-së nuk e përmend në mënyrë eksplicite demokracinë brendapartiake. Të drejtat dhe detyrimet e anëtarëve të LDK-së rregullohen me nenin 8 të statutit të saj. Anëtarët e LDK-së kanë të drejtë të zgjedhin dhe të jenë të zgjedhur në organet e LDK-së; kanë të drejtë t'i shprehin mendimet lirshëm dhe të ofrojnë nisma dhe propozime në përputhje me statutin, programin dhe qëndrimet e LDK-së dhe të jenë të informuar për aktivitetet e LDK-së. Në përputhje me statutin, anëtarët e LDK-së kanë për obligim t'i përmbahen programit, statutit dhe vendimeve të LDK-së, ta paguajnë anëtarësinë dhe “të ruaj[n]ë nderin, autoritetin dhe interesat e LDK-së [...] dhe të përpiq[n] për suksesin e LDK-së në fushata zgjedhore”.³³¹ Të dy këto obligime të fundit janë tejet të përgjithshme për të qenë obligime konkrete për anëtarësinë e LDK-

³²⁸ Statuti i Partisë Demokratike të Kosovës (pa datë), neni 41.

³²⁹ Genc Nimoni, ‘Konfrimohet Dënimi ndaj Zharkut, Kaçaniku në zgjedhje’, *Gazeta Jeta në Kosovë*, 08.05.2012. Qasur në <http://gazetajnk.com/?cid=1,1018,2105> (23 mars 2015); ‘VV-ja: Muja, kreu i katërt komunal (nga PDK) i akuzuar për korrupsion’, *Kohantet*, 27.02.2013. Qasur në <http://koha.net/?id=8&arkiva=1&l=136749> (20 mars 2015); Jeton Musliu ‘Raporti Mjekësor që e mban Xhemajlin jashtë burgut’, *Gazeta Jeta në Kosovë*, 24.10.2012. Qasur në <http://gazetajnk.com/?cid=1,3,3344> (20 mars 2015).

³³⁰ Statuti i Partisë Demokratike të Kosovës (pa datë), neni 19.

³³¹ Statuti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (2012), neni 8.2.

së. Një problematikë tjetër e rregulluar me statutin e LDK-së janë vlerat e LDK-së. Në statutin e LDK-së, në mënyrë eksplicite thuhet se “kriter i vlerave në LDK është kontributi dhe përkushtimi i çdo anëtari të saj për rritjen e anëtarësisë dhe të votave në të gjitha nivelet”.³³² Matja e vlerave në LDK përmes kriterit numerik të rritjes së anëtarësisë dhe rritjes së votës është kriter deficitar dhe problematik. I lexuar në mënyrë të drejtpërdrejtë, ky kriter përcakton që anëtarët e përkushtuar për ofrimin e ideve, të strategjive dhe të politikave programatike e sektoriale brenda LDK-së, nuk kanë ‘vlerë’ sipas kriterit matës numerik të vlerave në LDK. Pos anëtarëve, në statutin e LDK-së (neni 15) theksohet se në veprimtarinë e LDK-së mund të marrin pjesë edhe përkrahësit dhe simpatizantët e partisë, por në statut nuk rregullohet e drejta e tyre e votës. Pra, gjithmonë sipas statutit, anëtarëve të rëndomtë nuk u pushon statusi i anëtarit apo funksioni brenda partisë në rast se ndaj anëtarit respektiv zhvillohet ndonjë proces hetimor, ose në rast se anëtari akuzohet për korrupsion a krim të organizuar.

VV

Për të qenë anëtar në VV (neni 16), duhet të plotësohen 5 kritere: mosha mbi 16 vjeç, pagesa e anëtarësimi, pranimi vullnetar i dokumenteve të VV, informimi me nenet e statutit të VV-së që kanë të bëjnë me të drejtat dhe detyrimet e anëtarëve dhe kandidati të mos jetë anëtar i ndonjë subjekti tjetër politik. Në statutin e Lëvizjes Vetëvendosje (VV) nuk përmendet në mënyrë eksplicite demokracia brendapartiake (brenda Lëvizjes), por vetëm demokracia e drejtpërdrejtë. Sipas këtij parimi, një anëtar ka një votë. Rregullimi i anëtarësisë në VV bëhet në përputhje me kreun 3 të statutit. Neni 17 i statutit precizon në mënyrë negative se kush nuk mund të jetë anëtar i VV-së, dhe këtu përfshihet bashkëpunimi me shërbime

³³² Statuti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (2012), neni 9.

inteligjente të huaja, përfshirja në keqpërdorim fondesh dhe korrupsion, si dhe përfshirja në aktivitete që mbrojnë ideologji fashiste dhe naziste. Ky rregullim eksplicit nuk gjendet në statutet e PDK-së, LDK-së a të AAK-së. Statusi i mbështetësve të VV ndahet në dy nënkategori – anëtarë dhe simpatizantë. Këta të fundit mund të marrin pjesë në aksionet dhe mbledhjet e VV-së, por nuk gëzojnë të drejtë vote. Nëse anëtarët e VV-së, fjala vjen, në mënyrë të pajustificueshme nuk marrin pjesë tri herë radhazi në mbledhjet e pikës, ose nëse i shkelin detyrimet statutore, statusi i tyre mund t'u ndryshohet nga anëtarë në simpatizantë (neni 21), por ky ndryshim mund të bëhet edhe në mënyrë vullnetare, me dëshirën e anëtarit për të qenë simpatizant. Anëtarët e VV-së kanë për obligim edhe që të marrin pjesë në mbledhjet, aksionet dhe aktivitetet e VV-së, t'i respektojnë dokumentet themeltare, ta paguajnë kuotën e anëtarësisë dhe t'i pranojnë vendimet e shumicës. Të drejtat e anëtarëve rregullohen me nenin 22, ku thuhet se anëtarët kontribuojnë në hartimin e qëndrimeve dhe të politikave të VV-së, votojnë për organet vendimmarrëse të VV-së, si dhe kandidojnë, propozohen e zgjidhen në pozicione drejtuese të VV-së. Po ashtu, ata mund të ankohen për vendimet e ndryshme të VV-së.

AAK

Anëtar i AAK-së mund të jetë çdo qytetar i Kosovës që në momentin e anëtarësimit ka të mbushur 18 vjet.³³³ Anëtarët e AAK-së kanë të drejtë të zgjedhin dhe të zgjidhen në organet udhëheqëse të AAK-së, të kandidohen për institucionet e pushtetit komunal dhe qendror, të marrin detyrime për realizmin e programit, t'i përmbahen programit, statutit dhe vendimeve të AAK-së dhe ta ruajnë 'nderin, autoritetin dhe interesat' e kësaj partie. Statuti i AAK-së rregullon se anëtar i të AAK-së mund t'i pushojë statusi i anëtarit me kërkesën e

³³³ Statuti i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (2008), neni 5.

vetë anëtarit, ose me përjashtim, për shkak të veprimeve që janë në kundërshtim me programin, statutin, qëndrimet dhe vendimet e AAK-së, ose edhe nëse i njëjti është anëtarësuar në një subjekt tjetër politik.³³⁴ Për dallim nga dorëheqja që bëhet me kërkesë të anëtarëve, përjashtimi bëhet me vendim të Kuvendit të Degës ose të Nëndegës së AAK-së, kurse propozimi për përjashtim vjen me kërkesë të Kryesisë së Degës apo të Nëndegës. Kundrejt vendimit të përjashtimit, anëtarët kanë të drejtë ankese pranë Komisionit Statutar në afat prej 15 ditësh. Vendimin përfundimtar për përjashtim e shqyrton Këshilli Drejtues i AAK-së. Për dallim prej statuteve të tjera, në AAK rregullohet edhe statusi i anëtarit të nderit³³⁵ që u ndahet qytetarëve me merita të veçanta. Anëtari i nderit propozohet nga Kryesia, kurse vendimi miratohet nga Këshilli Drejtues i AAK-së. Në statutin e AAK-së nuk përmendet në mënyrë eksplicite kontributi i anëtarësisë për hartimin e politikave, të programit apo të statutit të AAK-së. Nuk përmendet as se anëtarëve të AAK-së që potencialisht mund të përfshihen në afera korrupsioni apo krimi, mund t'u pushohet statusi i anëtarit.

8.2.2 Kuotat për përfaqësimin e grave, të rinjve dhe pakicave

Një element tjetër jo më pak i rëndësishëm në demokracinë brendapartiake është përcaktimi i kuotave të përfaqësimit të grave, të rinjve dhe pakicave. Rinia dhe gratë e PDK-së përfaqësohen në dy organe: Rinia Demokratike (RD) dhe Gruaja Demokratike (GD).³³⁶ Statuti i LDK-së po ashtu siguron përfaqësimin e të rinjve dhe të grave në organet e LDK-së në nivel të organeve lokale dhe qendrore, por nuk përcakton kuota përfaqësimi. Sipas statutit të LDK-së, “me

³³⁴ Statuti i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (2008), neni 7.

³³⁵ Statuti i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (2008), neni 8.

³³⁶ Statuti i Partisë Demokratike të Kosovës (pa datë), neni 57.

rastin e zgjedhjes së delegatëve për Kuvend, secila degë siguron përfaqësimin e femrave dhe të rinjve”³³⁷. Po ashtu, në listën e forumeve të LDK-së përfshihen Forumi i Gruas së LDK-së dhe Forumi Rinor i LDK-së (ku përfshihen të rinjtë nga mosha 16 deri në 26 vjeç).³³⁸ Lëvizja Vetëvendosje nuk ofron kuota për pjesëmarrje në parti, as për gra dhe as për të rinj. Të rinjtë dhe gratë në AAK përfaqësohen në organet Aleanca e Gruas së Kosovës (AGK), dhe Aleanca e të Rinjve të Kosovës.³³⁹

Kuotat për gratë, të rinjtë dhe pakicat	PKD	LDK	VV	AAK
	Nuk përmenden në statut	Nuk përmenden në statut	Nuk përmenden në statut	Nuk përmenden në statut

Kuotat për gratë, të rinjtë dhe pakicat brenda partive politike në Kosovë.

Fakti se partitë politike në Kosovë nuk e rregullojnë me statut përfaqësimin e grave në mënyrë precize në strukturat partiake, tregon shumë për mungesën e ndjeshmërisë së tyre për të ndërtuar një shoqëri të lirë e të barabartë të qytetarëve të Kosovës. Demokracia nuk është regjim politik i sundimit të burrave, qysh kuptohet shpeshherë në Kosovë. Madje të dhënat e fundit tregojnë se, në kumulativ, përpjesa e daljes së grave në votime në zgjedhjet lokale të vitit 2013 ishte 51%, kurse e ajo e burrave 44%, duke treguar kështu një interesim të shtuar politik për pjesëmarrje dhe përfaqësim.³⁴⁰ Në fakt, për herë të parë në zgjedhjet lokale të 2013, kosovarët e kishin votuar një grua për kryetare komune, kur Mimoza Kusari-Lila nga AKR kishte fituar garën kundrejt Palë Lekajt të AAK-së në komunën e Gjakovës. Duke qenë shoqëri e udhëhequr

³³⁷ Statuti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (pa datë), neni 18.

³³⁸ Statuti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (2012), neni 38.

³³⁹ Statuti i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (2008), neni 35 dhe neni 37.

³⁴⁰ NDI, ‘Kosovë: Tejkallimi i Pengesave për Pjesëmarrjen e Grave në Politikë’. NDI. Shkurt, 2015, f. 10.

politikisht nga figurat ‘atërore’, me çka patriarkalizmi zgjatohet edhe në sferën politike, dizajnuesit e sistemit politik në Kosovë kishin vendosur mekanizma proaktivë, respektivisht kuotën 30%, përmes të cilës do të përfaqësoheshin gratë. Ligjet për zgjedhjet lokale dhe të përgjithshme i obligojnë partitë të garantojnë që çdo i treti kandidat në listat e tyre për zgjedhje të jetë grua.

Shtatëmbëdhjetë vjet pas vendosjes së administratës ndërkombëtare, falë garantimit të përfaqësimit të gruas në institucione, Kosova ka bërë hapa domethënës në rritjen e numrit të grave në institucionet politike, në nivelin qendror dhe atë lokal. Numri i grave deputete në zgjedhjet e përgjithshme ka shënuar rritje nga 34 në vitin 2001, në 36 në vitin 2004, pastaj 37 në vitin 2007, duke e arritur përfaqësimin më të lartë në zgjedhjet e vitit 2010, kur numri i grave deputete në Kuvendin e Kosovës ishte 40, duke rënë pastaj lehtësisht në zgjedhjet e vitit 2014, kur 39 gra u zgjodhën deputete në Kuvendin të Kosovës.

Ndonëse zbatimi i kuotës për përfaqësimin e grave në institucione ka kontribuar në thyerjen e paragjykimeve për gratë, të dhënat tregojnë se krahas kuotave është rritur edhe numri i votave preferenciale për gratë. Në tri zgjedhjet e fundit të përgjithshme në Kosovë (2007, 2010 dhe 2014), numri i votave preferenciale për gratë është rritur në mënyrë të konsiderueshme. Në zgjedhjet 2007, numri i grave që kanë fituar mandatin e deputetes pa kuota është 16, në zgjedhjet e vitit 2010 ky numër bie në 15, për të shënuar tavanin më të lartë në zgjedhjet e vitit 2014, kur 20 deputete të Kuvendit të Kosovës u mandatuan për ta kryer funksionin e deputetes pa kuota.

Në nivel të partive politike, sipas të dhënave të KQZ-së, del se numri i grave deputete të LDK-së që votohen me meritë (pra jashtë kuotës) është më i lartë në krahasim me partitë e tjera politike. Në zgjedhjet e vitit 2010, numri i grave deputete të zgjedhura pa kuotë ishte 7 (në raport me 2 gra që kishin fituar me kuotë), kurse në zgjedhjet e 2014 ky numër ra në 5 (në raport me 4 gra që fituan me

kuotë). Vlen të përmendet këtu se në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2014, Vjosa Osmani ishte renditur e dyta në listën e më të votuarve nga LDK, duke marrë gjithsej 39.911 vota, Teuta Rugova kishte marrë 37.178 vota, kurse Hykmete Bajrami kishte marrë 10.196 vota.³⁴¹ Votimi preferencial për gratë deputete të PDK-së ka shënuar rënie nga zgjedhjet e vitit 2007 në ato të vitit 2010 dhe 2014, kur 7 gra deputete ishin zgjedhur pa kuotë, kurse në dy palë zgjedhjet e fundit të përgjithshme vetëm 2 gra deputete të PDK-së janë zgjedhur pa kuotë, në raport me 9 (në vitin 2010) dhe 10 (në vitin 2014) gra deputete të zgjedhura përmes kuotës. Sala Berisha-Shala nga PDK ishte renditur e 33-ta në listë duke marrë 14,179 vota, kurse Labinota Demi-Murtezi, nga Partia e Drejtësisë, e cila ishte futur në listën e kandidatëve të PDK-së si rezultat i një marrëveshjeje parazgjedhore, kishte marrë numrin më të madh të votave në listën e PDK-së, respektivisht 14.232 vota. Në VV ka një rritje të votës preferenciale prej 40% për gratë deputete nga viti 2010 në 2014. Ndërsa në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2010, 4 gra kishin fituar ulëse në Kuvendin e Kosovës duke u bazuar në kuotë dhe 1 deputete grua kishte fituar me meritë, në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2014 vetëm 2 gra deputete të VV-së kishin fituar mandatin e deputetes në bazë të kuotës, kurse 3 të tjera me meritë.³⁴² Në zgjedhjet e përgjithshme të 2014, Puhie Demaku nga VV ishte renditur e katërta me 15.765 vota, kurse Aida Dërguti ishte renditur e nënta me 9.805 vota. Në AAK ka një rritje relative të votës preferenciale për gratë nga 2010 në 2014. Në zgjedhjet e vitit 2010, 3 gra nga lista e AAK-së ishin bërë deputete falë kuotës, kurse 1 me meritë, për dallim nga zgjedhjet e vitit 2014 kur 2 gra nga AAK kishin fituar mandatin e

³⁴¹ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, 'Rezultatet përfundimtare të kandidatëve', zgjedhjet 2014. Qasur në http://www.kqz-ks.org/Uploads/Documents/20140701%20Candidates%20Seats%20Allocation_bs.pfuqcvtz.pdf (23 prill 2015).

³⁴² Shih për më shumë, D4D, 'Trendet zgjedhore 2000-2014; Analizë numerike e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit', (Seria: Zgjedhjet dhe partitë politike, Nr. 9, Prishtinë, 2015).

deputetes me kuotë dhe 2 të tjera me meritë. Dy gratë më të votuara të AAK-së në zgjedhjet e vitit 2014 ishin Donika Kadaj Bujupi me 6.143 vota, që renditej e katërta me numrin më të madh të votave në AAK, dhe Time Kadrija, që renditej e shtata me 5.749 vota.

Ndonëse përqindja e kosovarëve që gjithnjë e më shumë votojnë për gra ka shënuar rritje, hulumtimet tregojnë se gratë ndihen më pak të favorizuara nga partitë e tyre si për nga pjesëmarrja nëpër debate mediatike ashtu edhe për nga përkrahja financiare që ua ofron partia. Sipas anketës së NDI-së, 77% e grave janë të pakënaqura me promovimin mediatik që u bëhet nga partitë e veta, dhe 49% e grave mendojnë se ato janë më pak të mbështetura financiarisht nga partitë e veta.³⁴³

Në lidhje me përfaqësimin e pakicave brenda strukturës organizative partiake, asnjëra nga të katër partitë politike të përfshira në këtë studim nuk ofron kuotë përfaqësimi brendapartiak për pakicat. Në Kosovë asnjëra prej partive politike nuk është multietnike në strukturë apo me vizionin politik. Ndonëse ky studim nuk ka objekt analize partië e grupeve etnike minoritare në Kosovë, duhet thënë se këto partitë janë të regjistruara si parti etnike dhe në përputhje me parimet e përfaqësimit të demokracisë konsensuale të Arendt Lijppart, përfaqësimi i tyre rregullohet me kushtetutë dhe ligje. Megjithatë, në vizionet e partive politike shqiptare në Kosovë, formulimet dhe gjuha e përdorur për t'i përshkruar pakicat ose komunitet dallon. Statuti i PDK-së, fjala vjen, thekson se PDK-ja angazhohet për “respektimin e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të drejtave të pakicave të garantuara me Kushtetutë, me ligje dhe me konventa ndërkombëtare”. Statuti i LDK-së nuk përmend fare termin *pakicë, etni, bashkësi etnike, ose komunitet*. As në statutin e VV-së nuk përmenden asnjëri prej termave që përshkruan pakicat ose komunitet në Kosovë. Në dispozitat e përgjithshme, në statutin e

³⁴³ NDI, ‘Kosovë: Tejkallimi i Pengesave për Pjesëmarrjen e Grave në Politikë’. NDI. Shkurt, 2015, f. 17.

VV-së përmenden si më poshtë termet *popull* dhe *qytetar*: “Faktorizimi i popullit në vendimmarrje politike nëpërmjet organizimit dhe mobilizimit”, dhe më tej theksohet se VV mbështetet “në parimin e barazisë, të demokracisë, të lirisë politike dhe të drejtësisë sociale të çdo qytetari”. Pra, termi *qytetar* dhe jo *grup etnik* ose *bashkësi etnike* është ai që përdoret në statutin e VV-së. Termi *popull* në statutin e VV-së përdoret 4 herë. Tri herë në kuptimin e përgjithshëm: ‘faktorizim i popullit’, ‘vullnet i popullit’, ‘populli të jetë i lirë’, kurse të katërtën me kuptimin konkret: ‘sovrانيتet i popullit shqiptar’. Në statutin e AAK-së, sikurse në atë të LDK-së, nuk përmenden pakicat as termat e ndërlidhur me pakicat.

8.2.3 Organet qendrore partiake

Organi qendror më i lartë brenda PDK-së është Konventa e Përgjithshme, kurse në LDK ky është Kuvendi. Organi më i lartë vendimmarrës brenda VV-së është Kryesia, kurse në AAK Kuvendi Qendror. Shpeshtësia e mbledhjeve dhe kompetencat e këtyre organeve nëpër këto parti politike dallojnë nga njëra-tjetra. Në PDK, Konventa Zgjedhore mbahet çdo dy vjet, në LDK Kuvendi zgjedhor duhet të thirret çdo tre deri në katër vjet. Në AAK Kuvendi Qendror Zgjedhor mbledhet të paktën një herë në tre vjet, kurse zgjedhjet e përgjithshme në VV mbahen të paktën dy herë në vjet. Shpeshtësia e mbajtjes së Konventave/Kuvendeve zgjedhore brendapartiake supozohet se ndikon drejtpërdrejt në debatin brendapartiak dhe reformimin e strukturave partiake. Në këtë aspekt prin VV, pastaj PDK, AAK dhe në fund LDK.

Konventa/Kuvendi Zgjedhor	PDK	LDK	VV	AAK
	Çdo dy vjet	Çdo tre deri në katër vjet	Të paktën dy herë në vit	Të paktën një herë në tre vjet

Shpeshhtësia e Konventave Zgjedhore në partitë politike në Kosovë

PDK

Struktura organizative e PDK-së bazohet në dy nivele, atë qendror dhe lokal. PDK-ja po ashtu ushtron veprimtarinë e vet edhe jashtë territorit të Kosovës, në mërgatë. Mandati i organeve qendrore të PDK-së është katërvjeçar. Organet qendrore janë: Konventa e Përgjithshme, Kryetari, Këshilli Drejtues, Kryesia, Asambleja Kombëtare, Organizata e Gruas Demokratike, Organizata e Rinisë Demokratike dhe Grupet e Vullnetarëve. Në nivelin lokal, PDK organizohet në nivel të seksioneve, nëndegëve dhe degëve. Sipas statutit të PDK-së, Konventa e Përgjithshme është organi më i lartë i PDK-së. Konventa mban sesione pune dhe sesione zgjedhore. Sesionet e punës së Konventës mbahet çdo dy vjet, kurse zgjedhoret çdo katër vjet. Përbërja e Konventës së Përgjithshme bazohet në gjashtë kategori: delegatët e zgjedhur përpjesëtimisht me numrin e votave të fituara në zgjedhjet e fundit; anëtarët e Kryesisë së PDK-së; Ministrat nga radhët e PDK-së; Deputetët e Kuvendit të Kosovës që vijnë nga PDK; Kryesia e Rinisë Demokratike në nivel qendror dhe Kryesia e Gruas Demokratike në nivel qendror. Konventa e Përgjithshme e PDK-së mund të thirret edhe në sesione të jashtëzakonshme nga 1/3 e delegatëve të kësaj Konvente, 1/3 e degëve, Këshilli Drejtues ose Kryetari. Kompetencat e Konventës, përfshijnë mes të tjerash edhe miratimin e programit të PDK-së, zgjedhjen e kryetarit të PDK-së, zgjedhjen e Këshillit Drejtues,

Zgjedhjen e Komisionit Statutor.³⁴⁴ Organi më i lartë ndërmjet dy konventave është Këshilli Drejtues, i përbërë nga 155 anëtarë plus 10 anëtarë nga mërgata, të gjithë këta me mandat 4-vjeçar. Gjysmën e kandidatëve të zgjedhur në Këshillin Drejtues, në konsultim me Kryesinë, e propozon Kryetari.³⁴⁵ Këshilli Drejtues ka 14 kompetenca të përcaktuara me statut,³⁴⁶ ku mes të tjerash përfshihet: iniciativa për të dhënë propozime për program dhe statut të PDK-së, miratimi i rregullores së punës, zgjedhja e anëtarëve të kryesisë, miratimi i buxhetit, zgjedhja e shtabit zgjedhor, miratimi i listës e kandidatëve për zgjedhje dhe vendosja për lidhjen e koalicioneve para dhe pas zgjedhjeve.

LDK

Struktura organizative e LDK-së bazohet në dy nivele, qendror dhe lokal. LDK-ja e ushtron veprimtarinë politike edhe jashtë territorit të Republikës së Kosovës dhe bashkëpunon me organizata të tjera politike e jopolitike si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Organet qendrore të LDK-së janë: Kuvendi; Këshilli i Përgjithshëm; Kryetari dhe Kryesia. Kuvendi është organi më i lartë brenda LDK-së. Në statutin e LDK-së rregullohen dy lloje të Kuvendeve – Kuvendi Zgjedhor dhe Kuvendi i Punës. Kuvendi Zgjedhor thirret çdo katër vjet, kurse Kuvendi i Punës së paku njëherë ndërmjet dy kuvendeve zgjedhore. Mbledhjen e Kuvendit e thërret Kryetari i LDK-së, ose me kërkesë të një të tretës së delegatëve të Kuvendit. Kuvendin e LDK-së e përbëjnë 355 delegatë të zgjedhur në Kuvendet e degëve. Kriteret dhe numrin e përzgjedhjes së delegatëve nëpër degë dhe nëndegë e vendos Këshilli i Përgjithshëm. Gjatë përzgjedhjes, secila degë dhe nëndegë sigurohet për përfaqësimin e grave dhe të rinjve. Anëtarët e Kryesisë dhe të Këshillit të Përgjithshëm, të cilët

³⁴⁴ Statuti i Partisë Demokratike të Kosovës (pa datë), neni 34.

³⁴⁵ Statuti i Partisë Demokratike të Kosovës (pa datë), neni 38, neni 39.

³⁴⁶ Statuti i Partisë Demokratike të Kosovës (pa datë), neni 42.

nuk janë zgjedhur delegatë, kanë të drejtë të marrin pjesë në Kuvend, por pa të drejtën e votës. Kuvendi është organi më i lartë i LDK-së dhe ushtron 8 kompetenca. Mes të tjerash, Kuvendi është organi ku miratohet programi dhe statuti, zgjidhet Kryetari, Këshilli i Përgjithshëm dhe anëtarët e Komisionit Statutar. Në statutin e LDK-së thuhet shprehimisht se “zgjedhja e organeve të LDK-së bëhet me votim të fshehtë”.³⁴⁷ Mes dy Kuvendeve Zgjedhore, Këshilli i Përgjithshëm i LDK-së, i përbërë nga 99 anëtarë, është organi më i lartë i kësaj partie. Kuvendi i LDK-së zgjedh 98 anëtarë të Këshillit, kurse Kryetari i Kuvendit të LDK-së është edhe Kryetar i Këshillit të Përgjithshëm. Propozimi i anëtarëve në Këshillin e Përgjithshëm bëhet nga Komisioni Kandidues në konsultim me Kryetarin. Këshilli i LDK-së ka 17 kompetenca: ia propozon Kuvendit programin dhe statutin për aprovim; vendos për koalicionet para- dhe paszgjedhore në nivel qendror; zgjedh dhe shkarkon anëtarët e Kryesisë; me propozimin e Kryetarit, miraton anëtarët e kabinetit qeveritar të propozuar nga kandidati për kryeministër.

VV

Lëvizja Vetëvendosje është e organizuar në tri nivele. VV-ja organizohet në nivel të pikave, të qendrave dhe të organeve më të larta vendimmarrëse. Organi më i lartë vendimmarrës është Këshilli i Përgjithshëm i VV-së, i cili i ka 16 kompetenca. Pos të tjerash, Këshilli plotëson, ndryshon dhe miraton statutin me 2/3 e votave të anëtarëve të Këshillit të Përgjithshëm; vendos për shpërbërjen e VV-së me 3/4 e votave të të gjithë anëtarëve të Këshillit; vendos me shumicë të thjeshtë që çështjet e parregulluara me statut të votohen përmes demokracisë së drejtpërdrejtë; zgjedh Kryesuesin dhe zv. Kryesuesin e Këshillit të Përgjithshëm; mbikëqyr Grupin

³⁴⁷ Statuti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (2012), neni 21.

Parlamentar të VV-së; cakton datën e zgjedhjeve të brendshme; miraton buxhetin, miraton listën finale të kandidatëve të VV-së për zgjedhjet e Kuvendit të Kosovës; thërret në interpelancë Kryetarin e VV-së, me kërkesë të 1/5 të anëtarëve të Këshillit. Këshilli i Përgjithshëm i mban mbledhjet një herë në tre muaj, kurse mbledhjet e jashtëzakonshme mund të thirren me kërkesë të 1/5 së anëtarëve të Këshillit. Këshilli i Përgjithshëm i VV-së përbëhet nga delegatët e qendrave, kryetarët e qendrave, deputetët e VV-së, kryetarët e komunave të VV-së, ministrat e VV-së, kryetari, kryesia dhe anëtarët e nderit.³⁴⁸ Organi më i lartë mes dy mbledhjeve të Këshillit të Përgjithshëm është Kryesia e VV-së.

AAK

Për dallim nga statutet e partive të tjera, ai i AAK-së nuk bën ndarje të qartë të përgjegjësiave mes organeve lokale dhe atyre qendrore. Fjala vjen, kur përmendet Kuvendi, Këshilli ose Kryetari, si dhe kur listohen përgjegjësitë e këtyre organeve, nuk ka qartësi të plotë të kompetencave të organeve partiake dhe thuhet vetëm “varësisht nga niveli i organizimit”. Struktura organizative e AAK-së është e ndarë në nivel të nëndegëve, degëve, degëve të AAK-së në mërgatën shqiptare, si dhe të organeve qendrore. Organi më i lartë vendimmarrës në AAK është Kuvendi Qendror, i cili ka 8 kompetenca. Pos të tjerash, ky Kuvend miraton, ndryshon dhe plotëson statutin dhe programin politik të AAK-së; vlerëson punën e organeve qendrore të AAK-së; zgjedh dhe shkarkon Kryetarin e AAK-së (zgjedhja bëhet mbi bazën e konkurrencës së lirë); zgjedh Këshillin Drejtues; mund të kërkojë votëbesimin për Kryetarin e AAK-së; miraton raportin financiar dhe shqyrton dhe miraton raportin e Kryesisë për aktivitetet e ndërmarra mes dy Kuvendeve. Statuti i AAK-së njeh këto tri lloje të Kuvendeve: Kuvendin

³⁴⁸ Statuti i Lëvizjes Vetëvendosje (2012), neni 66.

zgjedhor, Kuvendin e punës dhe Kuvendin e jashtëzakonshëm. Kuvendi i Rregullt Zgjedhor mbahet një herë në tre vjet dhe atë mund ta thërrasë vetëm Kryetari. Statuti i AAK-së përcakton 8 kritere se si të delegohen anëtarët në Kuvend.

Sipas formulës së përcaktuar me Statut, çdo degë delegon 2 delegatë në Kuvendin e Kosovës, me përjashtim të degëve në territorin e të cilave ka më shumë se 100.000 banorë, të cilat i delegojnë 3 delegatë në Kuvend. Deputetët, ministrat, zv/ministrat, anëtarët e kryesisë aktuale dhe 9 ekspertë të Këshillit Kombëtar të AAK-së delegohen në mënyrë automatike. Po ashtu, Aleanca e Gruas dhe ajo e të Rinjve delegojnë secila nga 20 delegatë në Kuvendin Qendror Zgjedhor, kurse degët e AAK-së nga diaspora përfaqësohen me 20 delegatë. Kuvendi i jashtëzakonshëm në AAK mund të thirret: në rast të shkeljeve të rënda statutore nga udhëheqja e kësaj partie; në rast të shpalljes së zgjedhjeve të jashtëzakonshme, të krizave politike apo kushtetutare në vend; si dhe në rast në dorëheqjes apo të vdekjes së Kryetarit të AAK-së. Ky tip i Kuvendit mund të thirret me 2/3 e anëtarëve apo 1/3 e delegatëve të Kuvendit. Këshilli Drejtues i AAK-së është organi më i lartë vendimmarrës mes dy Kuvendeve Zgjedhore.

Për dallim nga PDK, LDK, dhe VV, Këshilli Drejtues i AAK-së është më gjithëpërfshirës dhe më përfaqësues. Këshillin Drejtues të AAK-së e përbëjnë 6 kategori. Këshilli përbëhet nga: Kryetari; Nënkryetarët; Sekretari i Përgjithshëm; 60 anëtarë të zgjedhur nga Kuvendi; 5 përfaqësues nga Aleanca e Gruas; dhe 5 përfaqësues nga Aleanca e të Rinjve.

Këshilli Drejtues i AAK-së ka 15 kompetenca. Pos të tjerash ky Këshill aprovon propozimin për programin dhe draft-statutin e partisë; me propozim të Kryetarit të AAK-së zgjedh Nënkryetarët, Sekretarin e Përgjithshëm dhe anëtarët e tjerë të Kryesisë me 2/3 e votave të anëtarëve të Këshillit Drejtues; me propozimin e Kryetarit miraton “vijën strategjike, politike dhe detyrat e partisë” (ndonëse

nuk precizohet se çfarë është “vija strategjike”); me propozim të Kryetarit, miraton listën e kandidatëve për deputetë në Kuvendin e Kosovës dhe shqyrton koalicionet në çdo nivel të organizimit. Sipas statutit të AAK-së, partia mund të shpërbëhet me votën e 2/3 të të gjithë përfaqësuesve në mbledhjen e Kuvendit, qoftë ai rregullt ose i jashtëzakonshëm.³⁴⁹

³⁴⁹ Statuti i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (2008), neni 47.

8.2.4 Komisionet disiplinore

	PDK	LDK	VV	AAK
Komisionet disiplinore	Komisionet disiplinore mund të formohen në degë dhe qendër.	Komisionet disiplinore formohen vetëm në qendër.	Komisionet disiplinore formohen në nivel të qendrave dhe në nivel të përgjithshëm të VV.	Statuti nuk rregullon ndonjë komision disiplinor.
	Komisionet formohen nga kryesitë (e degëve ose ajo qendrore)	Komisioni përbëhet nga 3 anëtarë. 2 anëtarë zgjidhen nga Kryesia Qendrore e LDK-së, kurse 1 zgjidhet nga Kryesia e degës nga ku vjen rasti disiplinor.	Komisioni përbëhet nga pesë anëtarë.	
	“Ndaj të gjithë anëtarëve të PDK, duke përfshirë edhe ata që janë në pozita të larta udhëheqëse brenda PDK, e që e shkelin Statutin, vendimet e organeve të PDK, programin, devijojnë nga politika e PDK ose në ndonjë formë tjetër shkelin parimet dhe vlerat e PDK, do të shqiptohen masa	Largimi i anëtarit nga LDK-ja mund të bëhet në rast se ‘abuzon me vlerat themelore dhe objektivat e LDK-së, kryen veprime të cilat e sjellin LDK-në në situatë të palakmueshm e ose	Statuti parasheh 8 masa disiplinore, si në vijim: 1) vërejtja; 2) vërejtja me shkrim; 3) heqja nga cilido pozicion brenda organeve të VV; 4) pezullimi i përkohshëm ose i përhershëm i të drejtës për të kandiduar nëpër pozicione organizative të VV; 5) parapërgjashtimi; 6) pezullimi i përkohshëm i statusit të anëtarit; 7) kërkesa për dëshmipërblim për dëmin e	

	disiplinore”. 5 Masa disiplinore: vërejtja verbale, qortimi, marrja e përkohshme e funksionit, marrja e funksionit, dhe përjashtimi i përkohshëm	diskredituese, vepron kundër kandidatëve të LDK-së në zgjedhjet parlamentare, lokale apo nivele të tjera, dhe i përkrah subjektet e tjera politike dhe kandidatët e tyre në zgjedhje’. Nuk përmenden masat disiplinore.	shkaktuar ndaj VV; dhe 8) përjashtimi i plotë.	
--	---	--	--	--

Roli i Komisioneve Disiplinore në partitë politike në Kosovë.

Me përjashtim të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovë, të gjitha partitë politike të analizuara këtu kanë Komisione Disiplinore në statutet e tyre. Është me rëndësi të theksohet se në praktikat e organizimit brendapartiak në Evropë, këta mekanizma quhen mekanizma për zgjidhje të konflikteve dhe jo mekanizma disiplinorë.

PDK

Organ tjetër që rregullohet me statut të PDK-së janë të ashtuquajturat komisione disiplinore. Këto komisione, sipas statutit

të PDK-së³⁵⁰, formohen në dy nivele. Në nivel të qendrës, komisionet disiplinore formohen nga Kryesia e PDK-së, kurse nëpër degë nga Kryesia e Degës. Përbërja e këtyre komisioneve është gjashtanëtarëshe, duke përfshirë këtu një kryetar të komisionit, zëvendëskryetarin dhe katër anëtarë. Sipas statutit të PDK-së³⁵¹, disiplina partiake dhe mënyra e votimit rregullohen si në vijim: “Ndaj të gjithë anëtarëve të PDK-së, duke përfshirë edhe ata që janë në pozita të larta udhëheqëse brenda PDK-së, e që e shkelin Statutin, vendimet e organeve të PDK, programin, devijojnë nga politika e PDK ose në ndonjë formë tjetër shkelin parimet dhe vlerat e PDK, do të shqiptohen masa disiplinore”. Statuti i PDK-së, parasheh 5 masa disiplinore: vërejtja verbale, qortimi, marrja e përkohshme e funksionit, marrja e funksionit, dhe përjashtimi i përkohshëm. Megjithatë, në statut nuk përmendet askund shprehimisht se Komisioni disiplinor mund të ndërmarrë masa disiplinore edhe për kryetarin e partisë.

LDK

Në mesin e 3 komisioneve të rregulluara me statutin e LDK-së³⁵² është edhe Komisioni Disiplinor. Ky komision përbëhet nga 3 anëtarë. 2 anëtarë zgjidhen nga Kryesia Qendrore e LDK-së, kurse 1 anëtar zgjidhet nga Kryesia e degës nga ku vjen rasti disiplinor për t’u shqyrtuar. Sipas statutit, masa disiplinore mund të shqiptohen ndaj të gjithë anëtarëve që veprojnë në kundërshtim me programin dhe statutin e LDK-së.³⁵³ Sipas statutit të LDK-së, janë gjashtë raste kur një anëtar pushon së qeni anëtar i LDK-së: vdekja e anëtarit, dorëheqja nga anëtarësia, anëtarësimi në një subjekt tjetër, kandidimi në një listë të një subjekti tjetër politik dhe përjashtimi

³⁵⁰ Statuti i Partisë Demokratike të Kosovës (pa datë), neni 58.

³⁵¹ Statuti i Partisë Demokratike të Kosovës (pa datë), neni 65.

³⁵² Statuti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (pa datë), neni 16.

³⁵³ Statuti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (2012), neni 13.

nga LDK-ja.³⁵⁴ Ndaj anëtarëve të LDK-së që veprojnë në kundërshtim me programin dhe statutin e LDK-së dhe që janë kundër vendimeve dhe qëndrimeve të organeve qendrore të LDK-së, mund të shqiptohen masa disiplinore nga Komisioni Disiplinor. Largimi i anëtarit nga LDK-ja mund të bëhet në rast se “abuzon me vlerat themelore dhe objektivat e LDK-së, kryen veprime të cilat e sjellin LDK-në në situatë të palakmueshme ose diskredituese, vepron kundër kandidatëve të LDK-së në zgjedhjet parlamentare, lokale ose nivele të tjera, dhe i përkrah subjektet e tjera politike dhe kandidatët e tyre në zgjedhje”. Siç shihet, neni 14 i statutit që rregullon shkaqet e përjashtimit të anëtarëve nga partia dhe marrjen e masave disiplinore, është shumë i përgjithësuar. Përdorimi i termave si ‘abuzimi me vlera themelore’, ‘sjellja e LDK-së në situatë të palakmueshme’ mbetet tepër problematik, për faktin se janë terma abstraktë, joempirikë dhe lejojnë hapësirë që ‘situatat e palakmueshme’ të definohen dhe të vlerësohen në mënyrë arbitrare dhe krejt subjektivisht. Një element tjetër problematik për demokracinë brendapartiake mbetet trajtimi i anëtarëve të LDK-së që kanë mendime të ndryshme, ose nuk pajtohen me vendimet e organeve të LDK-së. Sipas statutit të LDK-së, anëtarët që publikisht i refuzojnë vendimet e organeve të LDK-së, nuk mund të marrin pozita udhëheqëse në organet dhe forumet e LDK-së. Megjithatë, për dallim nga statuti i PDK-së, në statutin e LDK-së nuk janë të parapara masa disiplinore si qortimi, vërejtja verbale, përjashtimi i përkohshëm ose marrja e funksionit të anëtarëve.

VV

Statuti i VV-së rregullon masat disiplinore që ndërmerren ndaj anëtarëve të VV në rast të shkeljes së statutit ose të programit. Komisionet disiplinore formohen në nivel të qendrave dhe në nivel

³⁵⁴ Statuti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (2012), neni 11.

të përgjithshëm të VV-së. Në nivel qendre, Këshilli i Qendrës krijon Komision Disiplinor të Qendrës që përbëhet nga pesë anëtarë të qendrës. Nga ana tjetër, Komisioni Disiplinor i Përgjithshëm përbëhet po ashtu nga pesë anëtarë, të cilët propozohen edhe zgjidhen nga Këshilli i Përgjithshëm i VV-së. Statuti po ashtu rregullon konfliktin potencial të interesit mes anëtarit ndaj të cilit mund të shqiptohet masa disiplinore dhe anëtarëve të Komisioneve Disiplinore; në rast të tillë këta të fundit duhet të zëvendësohen. Të drejtë ankese kundrejt këtyre komisioneve kanë të gjithë anëtarët e VV-së. Për anëtarët që vërtetohet se kanë shkelur parimet, vendimet dhe dokumentet themeltare të VV-së, statuti parasheh 8 masa disiplinore, si në vijim: 1) vërejtje; 2) vërejtje me shkrim; 3) heqje nga cilido pozicion brenda organeve të VV-së; 4) pezullim i përkohshëm ose i përhershëm i të drejtës për të kandiduar nëpër pozicione organizative të VV-së; 5) parapërgjashtim; 6) pezullim i përkohshëm i statusit të anëtarit; 7) kërkesë për dëmshpërblim për dëmin e shkaktuar ndaj VV-së; dhe 8) përjashtim i plotë.³⁵⁵ Po ashtu, në statut parashihet edhe Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave, tek i cili anëtarët ndaj të cilëve janë shqiptuar masa disiplinore kanë të drejtë të deponojnë ankesa. Ky i fundit duhet të shqyrtojë ankesën dhe të marrë vendim përfundimtar në një afat prej 14 ditëve. Për dallim prej partive të tjera, VV-ja ka praktikuar këtë prerogativë të statutit. Kështu për shembull, bazuar në nenin 24 dhe nenin 88, Ajnishahe Halimi dhe Arben Gecaj, me vendim të Komisionit Disiplinor, janë përjashtuar nga VV, me arsyetimin se kanë abuzuar me fondet dhe detyrat e besuara nga VV kur e kanë vendosur zyrën e VV-së në pronën e saj dhe kanë shkelur parimet dhe dokumentet themeltare të VV-së.³⁵⁶ Më pas, një pjesë e Qendrës së VV-së në Skenderaj kishte lëshuar një komunikatë ku thuhej se arsyet e

³⁵⁵ Statuti i Lëvizjes Vetëvendosje (2012), neni 88.

³⁵⁶ Vetëvendosje i përjashton nga partia Ajnishahe Halimin dhe Arben Gecajn', Telegrafi. Qasur në <http://www.telegrafi.com/vetevendosje-i-perjashton-nga-partia-ajnishahe-halimin-dhe-arben-gecajn/> (2 qershor 2016).

shkarkimit të znj. Halimi nuk qëndrojnë dhe se zyrat e VV-së në Skenderaj janë shfrytëzuar ekskluzivisht për qëllimet e VV-së. Në këtë deklaratë akuzohet kreu i VV-së me sa vijon: “ata janë diktatorë për nga formimi, ekstremistë të majtë, deri enveristë dhe përdorin metoda staliniste për të eliminuar çdokënd që nuk mendon njëqind për qind si ata. Ai taraf është mbyllur në gëzhjojën e vet – minishtetin e vet, të cilin e ruan me fanatizëm që brenda tij të mos depërtojë asnjë ide, asnjë njeri, qoftë ai edhe intelektual, sepse ua prish terezinë”.³⁵⁷ Megjithatë, një pjesë tjetër e anëtarëve të Qendrës së VV-së në Skenderaj kishin reaguar duke mos u pajtuar me këtë deklaratë.

8.2.5 Kryesitë e partive politike

Kryesitë e partive politike janë organe qendrore të partive politike. Në PDK dhe LDK, Kryesia e partisë është organi kryesor ekzekutiv i saj, kurse në VV dhe AAK, Kryesia është organi më i lartë vendimmarrës. Kryesia e VV-së ka më së paku anëtarë krahasuar me partitë e tjera. Kryesia e LDK-së ka më shumti kompetenca në krahasim me kryesitë e partive të tjera. Kryesia e PDK-së ka 25 anëtarë, ajo e LDK-së 23 anëtarë, AAK ka 17 anëtarë, kurse VV 15 anëtarë. Nëse përfshirja në Kryesi merret si njëri prej kriterëve matëse të demokracisë brendapartiake, atëherë PDK-ja prin për nga përfshirja në Kryesi, e pasuar nga LDK-ja, AAK-ja dhe në fund VV-ja. Megjithatë, nëse analizohet gjerësia e kompetencave që formalisht me statut ka të drejtë t’i ushtrojë Kryesia – sipas logjikës: sa më pak koncentrim të kompetencave në një organ partiak dhe sa më shumë bashkushtrim dhe ndarje kompetencash brenda organeve

³⁵⁷ ‘Sa Vetëvendosje ka në Skenderaj?’, Telegrafi. Qasur në <http://www.telegrafi.com/sa-vetevendosje-ka-ne-skenderaj/> (2 qershor 2016).

partiake – atëherë Kryesia e AAK-së dhe e VV-së prijnë për nga demokratizimi, të pasuara nga LDK-ja dhe në fund PDK-ja.

	PDK	LDK	VV	AAK
Kryesia e partisë	Organi kryesor ekzekutiv i partisë.	Organi kryesor ekzekutiv i partisë.	Organi më i lartë vendimmarrës.	Organi më i lartë vendimmarrës.
	Kryesia përbëhet nga 25 anëtarë.	Kryesia përbëhet nga 23 anëtarë.	Kryesia përbëhet nga 15 anëtarë.	Kryesia përbëhet nga 17 anëtarë.
	Ka 14 kompetenca	Ka 20 kompetenca	Ka 11 kompetenca.	Ka 11 kompetenca.

Kompetencat dhe përbërja e kryesive partiake

PDK

Përveç Këshillit Drejtues, Kryesia e PDK-së, e përbërë nga 25 anëtarë me mandat 4 vjeçar, është organi kryesor që i ekzekuton politikat e PDK-s.³⁵⁸ Kryesia përbëhet nga kryetari, zëvendëskryetari, nënkryetarët, sekretari i përgjithshëm dhe anëtarët e tjerë. Mbledhjet e rregullta javore të kryesisë thirren nga Kryetari ose 1/3 e anëtarëve të Kryesisë dhe vendimet merren me shumicë të votave. Vota e Kryetarit është vendimtare nëse numri i votave *për* dhe *kundër* është i barabartë.³⁵⁹ Kryesia ka 14 kompetenca³⁶⁰ dhe ndër të tjerat: 1) propozon listën e kandidatëve për zgjedhje nacionale dhe lokale, e cila miratohet nga Këshilli Drejtues; 2) menaxhon mjetet financiare dhe pasurinë në nivel qendror; 3) përzgjedh kandidaturat për poste publike; 4) zgjedh anëtarët e Komisionit të Kontrollit Financiar dhe

³⁵⁸ Statuti i Partisë Demokratike të Kosovës (pa datë), neni 43.

³⁵⁹ Statuti i Partisë Demokratike të Kosovës (pa datë), neni 47.

³⁶⁰ Statuti i Partisë Demokratike të Kosovës (pa datë), neni 46.

të Komisionit Disiplinor; 5) jep pëlqimin përfundimtar për listën e kandidatëve për ministra; 6) jep pëlqimin përfundimtar për kandidatët e PDK-së për kryetarë komunash; 7) themelon Komisionin Qendror Disiplinor.

LDK

Kryesia e LDK-së, e përbërë nga 23 anëtarë, është organi që i ekzekuton politikat e Këshillit të Përgjithshëm. Kryetari propozon 20 anëtarë të Kryesisë për aprovim të Këshillit të Përgjithshëm, kurse 3 anëtarë të tjerë, Kryetari i LDK-së, Kryetarja e Forumit të Gruas dhe Kryetari i Forumit të Rinisë janë anëtarë të Kryesisë së LDK-së. Për dallim nga statuti i PDK-së, ku vota e kryetarit është vendimtare nëse numri i votave *për* dhe *kundër* është i barabartë, në statutin e LDK-së theksohet se ‘kryetari i LDK-së, përkatësisht Kryesia, kanë të drejtë të pezullojnë ekzekutimin e vendimeve të organeve të LDK-së, të cilat janë në kundërshtim me Ligjin, Programin dhe Statutin e LDK-së’ (neni 32). Kryesia e LDK-së ka 20 kompetenca. Ndër të tjera Kryesia 1) kujdeset për zbatimin e vendimeve të Kuvendit, si dhe të Këshillit dhe Kryetarit, 2) zgjedh anëtarët e Komisionit Disiplinor, 3) emëron Kryetarin e Grupit Parlamentar të LDK-së, 4) pezullon punën e Kryesisë së Degëve ose të Nëndegëve në raste të veçanta, dhe 5) paraqet raport vjetor për punën e Këshillit të Përgjithshëm.

VV

Sipas statutit të VV-së, midis dy mbledhjeve të Këshillit të Përgjithshëm, Kryesia është organi më i lartë vendimmarrës. Në përbërje prej 15 anëtarësh, Kryesia nuk mund të kenë për anëtarë kryetarët e komunave, këshilltarët komunalë, deputetët dhe anëtarët e kabinetit qeveritar. Nga kjo rregull përjashtohen Kryetari i VV-së, Kryetari i Grupit Parlamentar të VV-së dhe Kryeministri i zgjedhur

nga ana e VV-së, që janë pjesë përbërëse e Kryesisë. Kryesia e VV-së mban mbledhje njëherë në dy javë dhe drejtohet nga Kryetari ose ndonjë anëtar tjetër i Kryesisë, i autorizuar nga Kryetari. Janë dy procedura për t'i thirrur mbledhjet e Kryesisë: 1) me kërkesë të Kryetarit të VV, 2) me kërkesë të 1/3 së anëtarëve të Kryesisë. Sipas statutit të VV-së³⁶¹, Kryesia përbëhet nga: Kryetari, dy nënkryetarët, Kryesuesi i Këshillit të Përgjithshëm, Sekretari Organizativ, Kryetari i Grupit Parlamentar dhe Sekretari për Marrëdhënie me Jashtë, Koordinator i Komiteteve, dhe 7 anëtarë të propozuar nga Këshilli i Përgjithshëm i Lëvizjes Vetëvendosje. Kryesia e VV-së ka 11 kompetenca. Ndër të tjera, Kryesia 1) zbaton vendimet e Këshillit të Përgjithshëm; 2) mbikëqyr punën e organeve ekzekutive dhe këshilluese të VV-së; 3) në raste të veçanta pezullon punën e një qendre, e cila vepron në kundërshtim me Statutin; 4) negocion marrëveshje me palët e treta; 4) merr vendime për të gjitha aksionet politike të VV-së; 5) merr vendime për organizimin e protestave dhe të demonstratave, 6) thirr mbledhje të jashtëzakonshme të Këshillit të Përgjithshëm.

AAK

Kryesia e AAK-së është organ ekzekutiv i zbatimit të politikave në çdo nivel të organizimit të kësaj partie. Në Statutin e AAK-së neni 20 rregullon Kryesinë e Zgjeruar, kurse neni 21 rregullon funksiononin dhe organizimin e Kryesisë.³⁶² Kryesia e Zgjeruar e AAK-së nxjerr rekomandime, formon trupa pune dhe nxjerr rregulloren e punës. Kryesia e AAK-së është përgjegjëse për organizimin e fushatës zgjedhore, zgjerimin e anëtarësisë dhe grumbullimin e fondeve. Ndarjen e përgjegjësive në mesin e anëtarëve të Kryesisë e bën Kryetari, një praktikë kjo jo e

³⁶¹ Statuti i Lëvizjes Vetëvendosje (2012), neni 70.

³⁶² Statuti i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (2008), neni 20 dhe 21.

zakonshme për statutet e PDK-së, LDK-së ose të VV-së. Kryesia e Përgjithshme e AAK-së ka më së paku 17 anëtarë, dhe është përgjegjëse për zbatimin e programit dhe të statutit të AAK-së. Ajo i nënshtrohet politikave të Kuvendit dhe Këshillit Drejtues të AAK-së. Kryesia ka 11 kompetenca. Ndër të tjera, nxjerr vendime për aktivitetin partiak, miraton me shumicë të thjeshtë votash listën e Këshillit Drejtues për kandidatët për kryetarë të komunave, për këshilltarë në Kuvendin Komunal, si dhe listën e kandidatëve për Deputetë të Kuvendit të Kosovës. Pasi të aprovohet kjo listë e kandidatëve nga Kryesia e partisë, Kryetari i AAK-së ia dërgon atë për aprovim Këshillit Drejtues.

8.2.6 Kryetari i partisë

Pjesë e organeve qendrore partiake janë edhe kryetarët e partive politike. Me përjashtim të VV-së, asnjëri prej statuteve nuk e kufizon mandatin e Kryetarit të Partisë. Fuqia politike e kryetarëve të partive politike në Kosovë shkon përtej kompetencave që parashihen me statutet e tyre, por, për qëllime empirike këtu krahasohen aspektet statutorë rreth mënyrës e zgjedhjes së tyre, gjerësia e kompetencave që ushtrojnë dhe mekanizmat llogaridhënës. Kryetari i LDK-së ka më shumti kompetenca statutorë në krahasim me kryetarët e PDK-së, të VV-së dhe të AAK-së. Statuti i LDK-së i jep Kryetarit të LDK-së 20 kompetenca. Kryetari i AAK-së ka 15 kompetenca. Kryetari i PDK-së ka 14 kompetenca, kurse Kryetari i VV-së formalisht i ka 10 kompetenca. Për dallim prej sekretarëve të partive të tjera që kanë pushtet simbolik, Sekretari i VV-së praktikisht dhe formalisht, në bazë të statutit, është njëri prej figurave kyçe në VV. Sekretari i VV-së i raporton çdo dy javë Kryetarit të VV-së, duke bashkushtruar kompetenca ekzekutive. Ndërsa statuti i PDK-së nuk kërkon votim të fshehtë dhe as më

shumë se një kandidat në procesin e zgjedhjes së Kryetarit, statuti i LDK-së kërkon që votimi për zgjedhjen e Kryetarit të bëhet me votë të fshehtë, me më shumë kandidatë. Përkundër kësaj, në Kuvendin e fundit zgjedhor në LDK-së, fjala bie, Kryetari u zgjodh me aklamacion dhe pa votë të fshehtë, në kundërshtim me këtë dispozitë statutore. As statuti i AAK-së nuk e përcakton votën e fshehtë dhe më shumë se një kandidat në procedurën e zgjedhjes së Kryetarit. Kryetari i VV-së zgjidhet drejtpërdrejt nga anëtarët e VV-së, dhe në aspektin e gjithëpërfshirjes së anëtarëve në procesin e zgjedhjeve së këtij organi partiak është më demokratik në krahasim me partitë e tjera. Megjithatë, edhe në zgjedhjet e brendshme të fundit në VV-së, Kryetari i saj ishte zgjedhur pa asnjë kundërkandidat. Sa u përket mekanizmave llogaridhënës, statuti i PDK-së dhe ai i VV-së nuk parashohin procedurë eksplicite për shkarkimin e Kryetarit, për dallim nga statutet e LDK-së dhe të AAK-së ku parashihet votëbesimi i Kryetarit.

	PDK	LDK	VV	AAK
Kryetari i partisë	Zgjidhet nga Konventa e Përgjithshme.	Zgjidhet nga Kuvendi i LDK-së me votim të fshehtë me shumë kandidat.	Kryetari i VV zgjidhet drejtpërdrejt nga anëtarët e VV me të drejtë vote.	Kryetari i AAK zgjidhet dhe mund të shkarkohet nga Kuvendi i AAK-së.
	Nuk kërkohet votimi i fshehtë ose një kundërkandidat për zgjedhjen e Kryetarit.	Kryetari i LDK-së zgjidhet në Kuvendin e LDK-së, me votim të fshehtë, me më shumë kandidatë.	Kryetari ka mandat trevjeçar.	Ka 15 kompetenca.
	Ka 14 kompetenca.	Kandidaturat për kryetar të LDK-së shpallen në Kuvendin e LDK-së dhe 'kandidatura miratohet me	Për dallim nga statutet e LDK, PDK, dhe AAK, në statutin e VV rregullohet se në momentin që kryetari i VV zgjidhet kryeministër,	Në rast të zgjedhjes së tij në postin e Kryetarit të shtetit, lirohet nga posti i Kryetarit të AAK-së.
	Ndër të tjera, ka të drejtë ta shpërbëjë degën dhe të caktojë			Kryetari ka të

	udhëheqje të re të përkohshme.	50% plus 1 të delegatëve të pranishëm' (neni 25).	ai/ajo jep dorëheqje nga posti i Kryetarit të VV.	drejtë në çdo kohë dhe sipas nevojës që të kooptojë anëtarë në Kryesi, dhe 'propozimet e tilla duhet të aprovohen nga Këshilli Drejtues'.
	Statuti i PDK-së nuk parasheh ndonjë procedurë për shkarkimin e kryetari të PDK-së, apo kufizim të mandateve për t'u rikandiduar për kryetar.	Ka 20 kompetenca. Me propozimin e 1/3 së anëtarëve të Kuvendit, mund të ngrihet çështja e votëbesimit të Kryetarit. Parashihet votëbesimi i Kryetarit.	Kryetari ka 10 kompetenca. Megjithatë, Sekretari i VV, i cili ka kompetenca ekzekutive, raporton çdo dy javë te Kryetari. Nuk parashihet shkarkimi me statut.	Parashihet votëbesimi i Kryetarit.

PDK

Dy prej 10 kompetencave të Konventës së Përgjithshme (neni 34), janë zgjedhja e Këshillit Drejtues dhe zgjedhja e Kryetarit të PDK-së. Megjithatë, statuti nuk e rregullon në mënyrë eksplicite procedurën e zgjedhjes së Kryetarit, nëse ky duhet zgjidhet me votë të fshehtë ose me aklamacion, nuk precizohet numri i kandidatëve dhe as metoda e zgjedhjes së tij. Kryetari ka mandat katërvjeçar dhe për punën e vet i përgjigjet Konventës së Përgjithshme. Kryetari i PDK-së i ka 14 kompetenca. Neni 37 i statutit të PDK-së i jep kryetarit kompetenca për: 1) përfaqësimin e PDK-së në organe vendore dhe organizma ndërkombëtare; 2) thirrjen dhe udhëheqjen e mbledhjeve të Kryesisë dhe Këshillit Drejtues; 3) jep propozimin përfundimtar, në bashkëpunim me Kryesinë, për listën e kandidatëve të PDK-së për Kuvendin e Kosovës; 4) Me akt të veçantë, pas konsultimit me Kryesinë, propozon përjashtimin nga PDK-ja të "të gjithë atyre që veprojnë në kundërshtim me politikat e PDK-së dhe nuk i përmbahen disiplinës partiake"; 5) propozon anëtarët e

Kryesisë; 6) në konsultim me kryesinë, vendos për koalicionet paraose paszgjedhore.³⁶³ Statuti i PDK-së i jep kompetencë Kryetarit të PDK-së që të shpërbëjë degë dhe të caktojë udhëheqje të re të përkohshme, në rast të, siç thuhet, “paraqitjes së rrethanave të jashtëzakonshme dhe të mosmarrëveshjeve të cilat pamundësojnë funksionimin e degës përkatëse”.³⁶⁴ Statuti i PDK-së nuk parasheh ndonjë procedurë për shkarkimin e kryetari të PDK-së, apo kufizim të mandateve për t’u rikandiduar për kryetar.

LDK

Dy prej 8 kompetencave të Kuvendit të LDK-së³⁶⁵ janë zgjedhja e anëtarëve të Këshillit të Përgjithshëm dhe zgjedhja e Kryetarit. Sipas Statutit të LDK-së “Kryetari i LDK-së zgjidhet në Kuvendin e LDK-së, me votim të fshehtë, me më shumë kandidatë”. Kandidaturat për kryetar të LDK-së shpallen në Kuvendin e LDK-së, dhe “kandidatura miratohet me 50% plus 1 të delegatëve të pranishëm”.³⁶⁶ Kryetari i LDK-së udhëheq tri pozita brenda LDK-së – është kryetar i Kuvendit, kryetar i Këshillit të Përgjithshëm dhe kryetar i Kryesisë së LDK-së. Për punën e vet kryetari i jep llogari Kuvendit të LDK-së. Mandati i organeve të zgjedhura të LDK-së, duke përfshirë këtu Kryetarin e LDK-së, është 4 vjet.³⁶⁷ Statuti nuk i kufizon mandatet e kryetarit. Kryetari i LDK-së ka 10 kompetenca. Neni 26 i statutit të LDK-së i jep kryetarit kompetenca për: 1) zbatimin e vendimeve të Kuvendit 2) përfaqësimin e LDK-së brenda dhe jashtë vendit; 3) marrjen e vendimeve politike në pajtim me programin dhe statutin; 4) thirrjen dhe udhëheqjen e mbledhjeve të Kuvendit, Këshillit dhe Kryesisë së LDK-së; 5) emërimin e

³⁶³ Statuti i Partisë Demokratike të Kosovës (pa datë), neni 37.

³⁶⁴ Statuti i Partisë Demokratike të Kosovës (pa datë), neni 43.

³⁶⁵ Statuti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (pa datë), neni 19.

³⁶⁶ Statuti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (2012), neni 25.

³⁶⁷ Statuti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (2012), neni 51.

udhëheqësit në administratën e LDK-së, etj. Për dallim prej statutit të PDK-së, ku nuk parashihet ndonjë procedurë eksplicite për shkarkimin e kryetarit, në nenin 27 të statutit të LDK-së rregullohet se “me propozimin e 1/3 së anëtarëve të Kuvendit, mund të ngrihet çështja e votëbesimit të Kryetarit. Votimin për besim mund ta ngrejë edhe vetë Kryetari”. Mandati i Kryetarit mund të pushojë me shkarkim ose kryetari mund të japë dorëheqje edhe para përfundimit të mandatit.

VV

VV aplikon demokracinë e drejtpërdrejtë në zgjedhjen e Kryetarit. Për dallim nga PDK, LDK dhe AAK, kryetari i VV-së zgjidhet drejtpërdrejt nga anëtarët e saj me të drejtë vote. Kryetari i VV-së është përfaqësuesi më i lartë politik, drejton Kryesinë dhe i përgjigjet Këshillit të Përgjithshëm. Kryetari ka mandat trevjeçar. Për dallim nga statutet e LDK-së, PDK-së dhe të AAK-së, në statutin e VV-së rregullohet se në momentin që kryetari i VV-së zgjidhet kryeministër, ai/a jo jep dorëheqje nga posti i Kryetarit të VV-së. Megjithatë, në statutin e VV-së nuk janë paraparë procedura eksplicite për iniciimin e shkarkimit të kryetarit, siç përmendet, fjala vjen, në statutin e LDK-së. Statuti precizon se anëtarëve të VV-së në pozita drejtuese mund t’u ndërpritet mandati në rast të: 1) dorëheqjes; 2) mospërmbylljes së detyrave; dhe 3) shkeljeve të dokumenteve themeltare të VV-së.³⁶⁸ Kryetari ka dhjetë kompetenca. Mes të tjerash 1) bashkërendon veprimtaritë e VV; 2) thërret dhe drejton mbledhjet e zakonshme dhe të jashtëzakonshme të VV-së; 3) cakton detyrat e Kryesisë; 4) propozon postet e nënkryetarit të parë, të sekretarit organizativ, të koordinatorit të Komiteteve, dhe Sekretarin për Marrëdhënie me Jashtë. Anëtarët e VV-së që zgjidhen në postet e mësipërme nuk mund të mbajnë asnjë

³⁶⁸ Statuti i Lëvizjes Vetëvendosje (2012), neni 44.

pozicion tjetër drejtues brenda VV-së. Sekretari i VV-së i raporton çdo javë Kryetarit të VV-së, dhe në konsultim me të i propozon drejtuesit e sekretariateve të qendrave. Koordinatori i Komiteteve propozon komitetet e strukturave të tjera të VV-së së bashku me Kryetarin e VV-së, kurse Sekretari për Marrëdhënie me Jashtë përfaqëson VV-së në nivel ndërkombëtar me autorizim të Kryetarit. Pos këtyre kompetencave, Kryetari i VV-së propozon 1/4 e listës për deputetë të Lëvizjes VV (3/4 e tjera të listës i propozojnë qendrat). Përkundër faktit se struktura organizative e VV-së mbetet më e decentralizuar në krahasim me partitë e tjera, pozita, kompetencat dhe autorizimet e Kryetarit të VV-së mbeten mjaft të fuqishme.

AAK

Funksioni dhe përgjegjësitë e Kryetarit të AAK-së rregullohen me nenin 23 të statutit të AAK-së. Kryetari i AAK zgjidhet dhe mund të shkarkohet nga Kuvendi i AAK-së. Kryetari i AAK-së ka 15 kompetenca, mes të cilave 1) propozon përbërjen e Kryesisë së AAK-së; 2) zbaton programin dhe statutin; 3) udhëheq dhe përfaqëson partinë; 4) emëron këshilltarët e vet dhe anëtarët e kabinetit të tij (këtu nuk përdoret ‘të saj’); 5) thërret Kuvendin e Rregullt; 6) propozon dhe nënshkruan marrëveshje politike për koalicion, të cilat miratohen nga Këshilli Drejtues; 6) i propozon Kryesisë Shefin e Shtabit Zgjedhor. Në statut përmendet shprehimisht se “në rast të zgjedhjes së tij në postin e Kryetarit të shtetit, lirohet nga posti i Kryetarit të AAK-së”. Rreth mandatit të zyrtarëve të zgjedhur në organet e AAK-së, duke përfshirë këtu edhe Kryetarin, përdoret një formulim i paqartë “mandati i anëtarëve i të gjitha organeve të AAK-së zgjat në periudhën e caktuar kohore të përcaktuar me legjislacionin e aplikueshëm në Kosovë”. Sipas statutit të AAK-së, Kryetari ka të drejtë në çdo kohë dhe sipas nevojës të kooptojë anëtarë në Kryesi, dhe “propozimet e tilla duhet

të aprovohen nga Këshilli Drejtues”, pra nuk thuhet p.sh se “mund të bëhen kooptime pas aprovimit të Këshillit Drejtues”, por përdoret termi “duhet të aprovohen”.³⁶⁹

8.2.7 Financat partiake

Partitë politike vazhdojnë të mbeten organizatat më jotransparente si në aspektin e paraqitjes dhe të publikimit të aktiviteteve të tyre politike ashtu edhe në atë të financimit të tyre. Mjafton të themi se në momentin kur po draftohet ky studim, me përjashtim të VV-së, PDK, LDK dhe AAK nuk kanë një faqe në internet ku qytetarët mund të informohen për veprimtarinë, dokumentet, programet dhe politikat e këtyre partive. Edhe në aspektin financiar, për dallim nga VV-ja që ka dorëzuar raport financiar për zgjedhjet e vitit 2014, partitë e tjera nuk e kanë bërë një gjë të tillë. Sipas statutit, PDK-ja financohet përmes tri mënyrave, LDK-ja përmes katër mënyrave, VV-ja përmes gjashtë mënyrave, kurse statuti i AAK-së nuk e rregullon në trajtë eksplicite mënyrën e financimit të kësaj partie.

Financat	PDK	LDK	VV	AAK
	Financohet përmes tri mënyrave – nga mjetet e anëtarësisë, buxheti i Kosovës dhe nga donacionet.	Financohet përmes gjashtë mënyrave – nga buxheti i Kosovës, anëtarësia, donacionet e personave fizikë apo të bizneseve, të hyrat nga aktivitetet	Financohet përmes gjashtë burimeve: nga të ardhurat nga kuota e anëtarësisë; buxheti i shtetit; ndihmat dhe dhuratat nga simpatizantët dhe anëtarët;	Në statutin e AAK-së nuk janë precizuar mënyrat e financimit të kësaj partie.

³⁶⁹ Statuti i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (2008), neni 42.

		promovuese të LDK-së, botimet dhe pronat e LDK-së.	ndihmat dhe dhuratat e organizatave partnere; dhe zhvillimi i aktiviteteve ekonomike të VV.	
--	--	--	---	--

PDK

Sipas statutit, PDK-ja financohet përmes tri mënyrave³⁷⁰ – nga mjetet e anëtarësisë, buxheti i Kosovës dhe nga donacionet. Raportet financiare bëhen publike vetëm për anëtarët e Këshillit Drejtues dhe të Kryesisë, por jo për anëtarët apo simpatizantët e PDK-së. Buxheti i brendshëm partiak menaxhohet nga Sekretari i Përgjithshëm i PDK-së, dhe ky është i detyruar ta njoftojë Kryesinë e PDK-së për gjendjen financiare të partisë çdo 3 muaj. Sidoqoftë, për zgjedhjet e fundit të përgjithshme të 2014, PDK-ja ende nuk i publikuar raportet financiare dhe nuk ka treguar transparencë të plotë për donacionet dhe shpenzimet e saj elektorale.

LDK

Sipas statutit, LDK-ja financohet përmes gjashtë mënyrave – nga buxheti i Kosovës, anëtarësia, donacionet e personave fizikë apo të bizneseve, të hyrat nga aktivitetet promovuese të LDK-së, botimet dhe pronat e LDK-së.³⁷¹ Sipas statutit, “për mjetet financiare të LDK-së dhe shfrytëzimin e tyre, Kryesia i raporton Këshillit të Përgjithshëm një herë në vit”. Sidoqoftë, për zgjedhjet e fundit vendore të 2014, LDK-ja ende nuk i publikuar raportet financiare dhe nuk ka treguar transparencë të plotë për donacionet dhe shpenzimet e saj elektorale.

³⁷⁰ Statuti i Partisë Demokratike të Kosovës (pa datë), neni 68.

³⁷¹ Statuti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (2012), neni 50 dhe 50.6.

VV

Statuti rregullon pesë mënyra të financimit të Lëvizjes Vetëvendosje. Burimet financiare të VV-së janë: 1) të ardhurat nga kuota e anëtarësisë; 2) të ardhurat nga buxheti i shtetit; 3) ndihmat dhe dhuratat nga simpatizantët dhe anëtarët; 4) ndihmat dhe dhuratat e organizatave partnere; dhe 5) zhvillimi i aktiviteteve ekonomike të VV.³⁷² Financat e VV menaxhohet nga Sekretari Organizativ dhe Sekretari për Financa, dhe këta mekanizma mbikëqyren nga Kryesia dhe Këshilli i Përgjithshëm i VV-së. Ndryshe prej statuteve të PDK, LDK dhe AAK, statuti i VV-së është eksplisit në lidhje me kufizimet dhe kontrollohet rreth burimeve të financimit. Sipas statutit, VV-ja nuk pranon fonde nga persona juridikë dhe fizikë që kanë zhvilluar aktivitete ekonomike të jashtëligjshme dhe krim të organizuar, dhe nuk pranon fonde nga persona juridikë dhe fizikë që “importojnë mallra tregtare nga ato shtete që nuk e njohin sovranitetin e popullit shqiptar dhe që kanë pretendime territoriale ndaj Kosovës dhe Shqipërisë”. Lëvizja Vetëvendosje në lidhje me raportet e veta financiare ka treguar transparencë të plotë, duke i publikuar të gjitha raportet financiare që nga viti 2011 deri në vitin 2014.

AAK

Për dallim prej statuteve të PDK-së, LDK-së, VV-së, në statutin e AAK-së nuk janë precizuar mënyrat e financimit të kësaj partie. Sipas statutit të AAK-së,³⁷³ drejtuesi i financave i propozon kryesisht një rregullore për menaxhimin e financave dhe të buxhetit të AAK-së dhe krijon sistem unik financiar për të gjitha degët. Po ashtu,

³⁷² Statuti i Lëvizjes Vetëvendosje (2012), neni 88.

³⁷³ Statuti i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (2008), neni 26.

drejtuesi i financave, i cili zgjidhet nga Kryesia,³⁷⁴ paraqet raporte mujore dhe tremujore financiare. Auditimi i financave në AAK bëhet nga një Komision që përbëhet nga pesë ekspertë dhe kontrollon veprimtarinë financiare të AAK-së edhe në Kosovë edhe në diasporë. Kuvendi i AAK-së e shqyrton dhe e miraton raportin financiar.³⁷⁵

8.2.8 Mënyra e votimit brenda partive politike

Vendimmarrja brendapartiake është një prej treguesve kryesorë të demokracisë brendapartiake. Praktikisht në shumicën e partive politike vendimet kryesore merren nga Kryetari në bashkëpunim me një grup të ngushtë dhe të shumtën e herëve pa e përfshirë fare Kryesinë, Këshillin, Kuvendin ose organet e tjera në procesin vendimmarrës. Megjithatë, në aspektin statutor, procesi i marrjes së vendimeve është i rregulluar në katër partitë politike të analizuara në këtë punim. Statuti i PDK-së parasheh se zgjedhja e anëtarëve të Kryesisë bëhet me votim të fshehtë, por nuk e precizon as kuorumin dhe as për çfarë shumice bëhet fjalë. Statuti i PDK-së rregullon pjesërisht procedurat e votimit për zgjedhjen e strukturave partiake, por nuk rregullon si merren vendimet politike dhe programore brendapartiake. Për dallim nga PDK-ja, statuti i LDK-së precizon se vendimet merren me votim të hapur në Kuvend (ndonëse kjo procedurë nuk konsiderohet shumë demokratike), kurse zgjedhja e strukturave partiake bëhet me votim të fshehtë. Në LDK, plotësimet e organeve partiake me anëtarë të rinj mund të bëhen me votim të hapur, por paraprakisht duhet të ketë një vendim për votim të hapur të së paku 50% të anëtarëve të organit përkatës. VV-ja praktikon

³⁷⁴ Statuti i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (2008), neni 22.

³⁷⁵ Statuti i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (2008), neni 13.

demokracinë direkte dhe indirekte në vendimmarrjen e saj brendapartiake. Sipas statutit, vendimet në VV merren me konsensus, por në rast të mungesës së konsensusit, merren “me vullnetin e shumicës në bazë të procedurave të votimit të strukturave përkatëse”. Vendimet që nuk merren me demokraci të drejtpërdrejtë, i mbeten Këshillit të Përgjithshëm. Në AAK, statuti rregullon se vendimet për çështjet politike dhe programore votohen haptazi dhe jo me votë të fshehtë, kurse votimi nëpër të gjitha organet e AAK-së konsiderohet i ligjshëm nëse në to marrin pjesë shumica e thjeshtë (50 + 1% të votave).

Mënyra e votimit	PDK	LDK	VV	AAK
	Statuti i PDK-së parasheh se zgjedhja e anëtarëve të Kryesisë bëhet me votim të fshehtë. Në statut nuk precizohet se për çfarë lloj shumice të votave bëhet fjalë. Mënyra dhe procedura e votimit, sipas statutit të PDK-së, është e rregulluar vetëm për zgjedhjen e	Statuti i LDK-së parasheh se vendimet në Kuvend merren me votim të hapur, kurse zgjedhja e organeve me votim të fshehtë. Vendimet e Kuvendit konsiderohen valide nëse votojnë më tepër se gjysma e anëtarëve të zgjedhur të Kuvendit.	VV aplikon demokracinë direkte dhe jo atë indirekte. Votimi për të gjitha pozicionet drejtuese në VV është votim i fshehtë. Vendimet merren me konsensus. Në rast të mungesës së konsensusit, vendimet merren “me vullnetin e	Sipas Statutit të AAK-së, votimi nëpër të gjitha organet e AAK-së konsiderohet i ligjshëm nëse në këto organe marrin pjesë shumica e thjeshtë (50 + 1%). Çështjet politike dhe programore votohen haptazi, pra jo përmes votës së

	strukturave partiake nga niveli qendror deri tek ai i degëve dhe nëndegëve, por nuk rregullohet mënyra se si merren vendimet politike dhe programore brendapartiake.	Kryetari i LDK-së dhe kryetarët e degëve zgjidhen me votim të fshehtë. ‘Ndryshimet dhe plotësimet në organet e LDK-së ndërmjet dy kuvendeve zgjedhore, të bazuar në Programin Politik të LDK-së, mund të bëhen edhe me votim të hapur. Vendimi për votim të hapur merret me më së paku 50% plus 1 votë të anëtarëve të organit përkatës’	shumicës në bazë të procedurave të votimit të strukturave përkatëse”. Vendimet që nuk merren me demokraci të drejtpërdrejtë, i takojnë Këshillit të Përgjithshëm. Megjithëse në statutin e VV-së nuk precizohen shprehimisht se cilat janë ato vendime ku nuk aplikohet demokracia e drejtpërdrejtë. Vendimet merren me shumicë të thjeshtë të votave (50 % +1), nëse përmbushet kuorumi (50 % +1) në të gjitha organet vendimmarrëse.	fshehtë, kurse për çështje të kuadrove votimi është i fshehtë.
--	---	---	---	---

PDK

Statuti i PDK-së parasheh që zgjedhja e anëtarëve të Kryesisë të bëhet *me votim të fshehtë*, me ç'rast kandidatët potencialë që kanë fituar shumicën e votave zgjidhen në pozitën e anëtarëve në Kryesi.³⁷⁶ Në statut nuk precizohet se për çfarë lloj shumice të votave bëhet fjalë (shumicë e kualifikuar, e thjeshtë, etj). Mënyra e votimit dhe saktësimi i shumicës së votave bëhen më të qartë kur zgjidhen anëtarët e Komisionit të Kontrollit Financiar të PDK-së. Anëtarët e komisionit, në këtë rast, zgjidhen me '*votime të fshehta të shumicës së të pranishmëve*'.³⁷⁷ Megjithatë, në statut nuk përmendet një kuorum specifik. Po ashtu, edhe shtatë anëtarët e Komisionit Statutar zgjidhen me votim të fshehtë, pas propozimit nga Këshilli Drejtues. Këshilli i Degës së PDK-së (që mund t'i ketë nga 31 deri në 91 anëtarë), në nivel lokal, zgjidhet nga Kuvendi i Degës me vota të fshehta, dhe Këshilli më pas zgjedh me vota të fshehta Kryesinë e Degës (që mund të ketë 15 deri në 31 anëtarë). Mënyra dhe procedura e votimit, sipas statutit të PDK-së, është e rregulluar vetëm për zgjedhjen e strukturave partiake nga niveli qendror deri tek ai i degëve dhe i nëndegëve, por nuk rregullohet mënyra se si merren vendimet politike dhe programore brendapartiake. Neni 34 i statutit të PDK-së nënvizon se Konventa e Përgjithshme miraton programin e PDK-së, apo ndryshim-plotësimet e Statutit, por nuk precizohen procedurat e votimit nëse programi miratohet me shumicën e votave të të pranishmëve, ose formën e ndonjë kuorumi të domosdoshëm.

Edhe pse Kryetari i Partisë ka të drejtë, pas konsultimit me Kryesinë, që ta propozojë listën zgjedhore, në statut nuk precizohet nëse kjo listë miratohet me vota të fshehta të shumicës ose jo. Neni 69 i statutit të PDK-së rregullon mënyrën e informimit të anëtarëve

³⁷⁶ Statuti i Partisë Demokratike të Kosovës (2012), neni 45.

³⁷⁷ Statuti i Partisë Demokratike të Kosovës (pa datë), neni 56.

të PDK-së për vendimet e marra në të gjitha nivelet e partisë. Sipas këtij neni, seksionet dhe nëndegët, brenda afatit prej tre ditësh duhet ta informojnë Zyrën Qendrore të Informimit të PDK-së për vendimet e marra, por nuk parashihet asnjë afat kohor a mënyrë konkrete se si informohen degët, nëndegët dhe seksionet për vendimet e organeve qendrore të partisë.³⁷⁸

LDK

Sipas Statutit të LDK-së, vendimet e organeve të LDK-së (qoftë Kuvendi, Këshilli, Kryesia, ose Kuvendi a Kryesia e degëve) konsiderohen valide atëherë kur gjatë marrjes së këtyre vendimeve marrin pjesë dhe votojnë shumica e anëtarëve të pranishëm në këto organe.³⁷⁹ Megjithatë, në statut nuk precizohet se për ç’lloj shumice të votave bëhet fjalë (shumicë e thjeshtë, e kualifikuar, etj). Statuti i LDK-së parasheh se vendimet në Kuvend merren me *votim të hapur*, kurse zgjedhja e organeve bëhet me *votim të fshehtë*. Vendimet e Kuvendit konsiderohen të vlefshme nëse votojnë më *shumë se gjysma e anëtarëve të zgjedhur të Kuvendit*. Kryetari i LDK-së dhe kryetarët e degëve zgjidhen me votim të fshehtë. Deputetët, ministrat ose kryetarët e komunave të LDK-së që nuk janë anëtarë të Këshillit të Përgjithshëm, kanë të drejtë të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit, po pa të drejtë vote.³⁸⁰ Statuti po ashtu rregullon se ‘ndryshimet dhe plotësimet në organet e LDK-së ndërmjet dy kuvendeve zgjedhore, të bazuar në Programin Politik të LDK-së, mund të bëhen *edhe me votim të hapur*. Vendimi për votim të hapur merret me më së paku *50% plus 1 votë* të anëtarëve të organit përkatës’.³⁸¹ Statuti i LDK-së i jep kompetencë Kuvendit të LDK-së që të miraton, ndryshon ose plotëson programin dhe statutin e LDK-

³⁷⁸ Statuti i Partisë Demokratike të Kosovës (pa datë), neni 69.

³⁷⁹ Statuti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (2012), neni 21.

³⁸⁰ Statuti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (2012), neni 23.6.

³⁸¹ Statuti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (2012), neni 54.3.

së, por, në të nuk precizohet procedura e votimit nëse programi miratohet me shumicën e votave të të pranishmëve, ose nuk jep informatën për formën e ndonjë kuorumi të domosdoshëm.³⁸² Në statutin e LDK-së nuk jepet ndonjë informatë specifike për mënyrën e informimit të anëtarëve të PDK-së për vendimet e marra në të gjitha nivelet dhe organet partisë.

VV

Në krahasim me partitë e tjera, VV-ja aplikon demokracinë e drejtpërdrejtë dhe atë përfaqësuese. Vendimet merren me konsensus. Në rast të mungesës së konsensusit, vendimet merren “me vullnetin e shumicës në bazë të procedurave të votimit të strukturave përkatëse”. Vendimet janë të detyrueshme³⁸³ dhe çdo anëtar ose simpatizant i VV-së e ka për detyrë që t’i pranojë vendimet e shumicës dhe ta respektojë mendimin ndryshe”. Në statutin e VV-së, tri herë përdoret togfjalëshi ‘vullnet i shumicës’ kur bëhet fjalë për legjitimitimin e vendimeve që merren nga VV. Me fjalë të tjera, pakica e pakënaqur e anëtarëve duhet të respektojë mendimin ndryshe të shumicës. Sidoqoftë, një mënyrë më demokratike e rregullimit të respektimit të vendimeve do të ishte që shumica të respektonte mendimin ndryshe të pakicës, dhe jo anasjelltas. Statuti precizon se votimi për të gjitha pozicionet drejtuese në VV është votim i fshehtë. Statuti ashtu parasheh edhe pjesëmarrjen e anëtarëve të VV-së në vendimmarrje, përmes demokracisë së drejtpërdrejtë, që nga këshillat e pikave.³⁸⁴ Për vendimet që nuk merren me demokraci të drejtpërdrejtë, këto vendime merren nga Këshilli i Përgjithshëm. Megjithatë, në statutin e VV-së nuk precizohet shprehimisht se cilat janë ato vendime në të cilat nuk aplikohet demokracia e drejtpërdrejtë dhe që rrjedhimisht merren nga Këshilli i

³⁸² Statuti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (2012), neni 19.

³⁸³ Statuti i Lëvizjes Vetëvendosje (2012), neni 24.

³⁸⁴ Statuti i Lëvizjes Vetëvendosje (2012), neni 7.

Përgjithshëm. Vendimet merren me shumicë të thjeshtë të votave (50% +1), nëse përmbushet kuorumi (50% +1) në të gjitha organet vendimmarrëse. Neni 12 parasheh se procedurat për zgjedhjet e brendshme në VV, votimi i çështjeve për të cilat aplikohet demokracia e drejtpërdrejtë, rregullohen në bazë të Rregullores së Zgjedhjeve të Brendshme.

AAK

Sipas Statutit të AAK-së, votimi nëpër të gjitha organet e AAK-së (Kuvend, Këshill, Kryesi e Zgjeruar, Kryesi), konsiderohen të ligjshme nëse në këto organe marrin pjesë shumica e thjeshtë (50 + 1%). Çështjet politike dhe programore votohen haptazi,³⁸⁵ pra jo përmes votës së fshehtë, kurse për çështje të kuadrove votimi është i fshehtë. Për ligjshmërinë e procesit të votimit në të gjitha nivelet e organizimit të AAK-së vendos Komisioni Verifikues. Ky komision vendos me shumicë të thjeshtë (50+1 %) nëse ka pasur shkelje ose manipulime gjatë procesit të votimit. Pos Komisionit të Verifikimit, me statut të AAK-së rregullohet dhe Komisioni i Votimit³⁸⁶, i cili mbikëqyr ligjshmërinë e votimit dhe numëron fletëvotimet. Këshilli Drejtues i AAK-së i merr vendimet me shumicë të thjeshtë, kurse ‘vendimet e rëndësishme’ të Këshillit merren me 2/3 e votave të anëtarëve të Këshillit Drejtues.³⁸⁷ Megjithatë, statuti nuk e precizon se cila është lista e këtyre ‘vendimeve të rëndësishme’.

³⁸⁵ Statuti i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (2008), neni 41.2.

³⁸⁶ Statuti i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (2008), neni 9.

³⁸⁷ Statuti i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (2008), neni 18.

8.2.9 Organizimi lokal partiak

Organizimi lokal partiak dhe autonomia vendimmarrëse e organeve partiake në nivel lokal tregon shkallën e decentralizimit brendapartiak. Sa më shumë që strukturat lokale partiake gëzojnë autonomi vendimmarrëse në nivel lokal, aq më demokratike është një parti politike. PDK, LDK, VV dhe AAK kanë forma të ndryshme të organizimit lokal partiak. Ndërsa PDK-ja është e organizuar në nivel të seksioneve, nëndegëve dhe degëve, LDK-ja është e organizuar vetëm në nivel të degëve dhe nëndegëve. VV është e organizuar në nivel të pikave dhe të qendrave, kurse AAK-ja është e organizuar në nivel të aktiveve, degëve dhe nëndegëve. Nëse krahasohen qendrat e VV-së me degët e PDK-së dhe të LDK-së, atëherë të parat gëzojnë më shumë autonomi dhe kanë më shumë kompetenca në krahasim f.v. me LDK-në, e cila renditet e dyta, dhe PDK-në, e cila renditet e treta.

	PDK	LDK	VV	AAK
Organizimi lokal partiak	PDK është e organizuar në nivel të seksioneve, nëndegëve dhe degëve. Kryesia e Degës ka 4 kompetenca Kryetari i degës ka 6 kompetenca	LDK është e organizuar në nivel të degëve dhe nëndegëve. Kryesia e degës ka 10 kompetenca. Kryetari i degës ka 9 kompetenca.	VV është e organizuar në nivel të pikave dhe qendrave. Këshilli i Qendrës ka 14 kompetenca. Kryesia e Qendrës është organi më i lartë vendimmarrës në nivel të Qendrës dhe ka 7 kompetenca.	Organizimi lokal i AAK-së është i rregulluar në nivel të nëndegëve dhe degëve dhe aktiveve. Në statutin e AAK-së nuk ndahen në mënyrë të prerë kompetencat e organeve qendrore dhe lokale.

PDK

Në terren, PDK është e organizuar në nivel të seksioneve, nëndegëve dhe degëve. Organet e seksionit janë: Kuvendi, Kryesia dhe Kryetari. Kryetarin e seksionit e zgjedh Kryesia, kurse kjo e fundit duhet të ketë së paku 5 anëtarë. Nëndegët e PDK-së, sipas statutit, cilësohen si njësi e mesme e organizimit të PDK-së, që kanë për qëllim lidhjen e seksioneve (njësi e vogël) me degët (njësi më e madhe). Organet e nëndegës janë Kuvendi, Kryesia dhe Kryetari. Delegatët e Kuvendit të Nëndegës së PDK-së delegohen nga seksionet. Kryetarin e nëndegës e zgjedh Kryesia e nëndegës e cila duhet të ketë shtatë anëtarë. Dega është forma më e lartë e organizimit të PDK-së në nivel lokal. Organet e Degës janë Kuvendi, Këshilli Drejtues, Kryesia dhe Kryetari. Kryetari i Degës nuk zgjidhet nga Kryesia e Degës, por nga Këshilli Drejtues i Degës me votim të fshehtë.³⁸⁸ Në statutin e PDK-së nuk janë të saktësuara kompetencat e organeve të seksioneve dhe nëndegëve, kurse për nivelin më të lartë të organizimit lokal, atë të degës, statuti liston kompetencat e organeve të degës. Kryetari i degës ka 6 kompetenca, duke përfshirë këtu përfaqësimin e PDK-së në territorin e degës, thirrjen e mbledhjeve, krijimin e grupeve punuese për çështje profesionale në bashkëpunim me Kryesinë e Degës, që “në bashkërendim me Kryesinë e Degës mbajnë aktive degën”.³⁸⁹ Kryesia e Degës ka 4 kompetenca: organizimin e aktiviteteve partiake nga dega; menaxhimin e procesit zgjedhor në degë; dhe raportimin njëherë në vit për mbarëvajtjen e punës tek Këshilli Drejtues i Degës. Kryesitë e Degëve, sipas statutit, janë të obliguara që me shkrim të raportojnë tek Kryesia Qendrore e PDK-së njëherë në çdo tre muaj. Në rast të mosfunksionim të degës, Kryesia Qendrore e PDK-së, pas konsultimit me Kryetarin e partisë, mund ta

³⁸⁸ Statuti i Partisë Demokratike të Kosovës (pa datë), neni 24.

³⁸⁹ Statuti i Partisë Demokratike të Kosovës (pa datë), neni 25.

shpërbëjë degën dhe të caktojë një udhëheqje të përkohshme deri në zgjedhjen e organeve të degës.

LDK

Në terrenin lokal, LDK është e organizuar në nivel të degëve dhe të nëndegëve. Degët e LDK-së, si njësi të organizimit dhe të veprimit territorial, organizohen në nivel të komunës, sipas ndarjes territoriale administrative në Kosovë. Përpos në nivel të komunave, degët, me vendim të veçantë të Këshillit të Përgjithshëm, mund të themelohen edhe nëpër vendbanime të tjera, ose jashtë territorit të Kosovës. Numri më i madh i degëve në nivel të komunave është i koncentruar në Prishtinë, ku LDK-ja ka pesë degë. Bashkërendimin e punëve të degëve e bën Kolegjiumi i Degëve, por ky mekanizëm nuk ka të drejtë vendimmarrjeje. Degët kanë tri organe: Kuvendin; Kryetarin; dhe Kryesinë e degës. Kuvendi i degës përbëhet nga 110 delegatë. Në mesin e 5 kompetencave, pos të tjerash, zgjedh Kryetarin dhe Kryesinë e degës.³⁹⁰ Zgjedhjet për Kuvendin e Degës mbahen çdo 4 vjet, kurse mbledhjet për Kuvendin e Degëve mund të thirren nga 1/3 e delegatëve që e përbëjnë Kuvendin. Kandidaturat për Kryetarë të Degëve shpallen në Kuvendet e Degëve dhe një kandidaturë miratohet atëherë ku 50% plus 1 delegatë të pranishëm votojnë për kryetarin e degës. Kryetari i degës ka 9 kompetenca, në mesin e të cilave: thërret mbledhjet e degës; propozon kandidatët për anëtarë të Kryesisë (kësaj liste të anëtarëve, Kuvendi i Degës ka të drejtë t'i shtojë 1/3 e kandidatëve për Kryesi. Organizimi i brendshëm i nëndegëve të LDK-së është i ngjashëm me atë të degës – nëndega ka kryetarin dhe Kryesinë e Nëndegës, dhe në nëndegë marrin pjesë të gjithë anëtarët, në rast se nëndega ka më pak se 100 anëtarë. Në rast se Nëndega ka më shumë se 100 anëtarë, atëherë Kuvendi zgjedh përbërjen e vet.

³⁹⁰ Statuti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (2012), neni 42.

VV

Në nivel lokal, VV është e strukturuar në dy nivele - në nivel të pikave dhe të qendrave. Në nivelin e pikës ndodhet Këshilli i Pikës, ku pozicionet drejtuese janë Kryetari, Nënkryetari dhe Sekretari. Kryetari i Pikës zgjidhet nga anëtarët e Këshillit të Pikës. Kryetari i pikës ka 5 kompetenca. Edhe nënkryetari zgjidhet nga anëtarët e Këshillit të Pikës dhe ka 4 kompetenca. 1/5 e anëtarëve të Këshillit të Pikës kanë të drejtë të thërrasin në interpelancë secilin prej delegatëve ose personave në pozitë drejtuese në Pikë dhe mund ta zëvendësojnë para përfundimit të mandatit të tij ose saj trevjeçar, duke kërkuar zgjedhje të parakohshme për atë pozitë. Këshilli i Pikave ka 16 kompetenca, ndër të cilat: identifikon problemet në territorin ku operon; harton politika për zhvillimin e pikës në atë territor; ndjek dhe zbaton udhëzimet dhe vendimet politike të Këshillit të Qendrës dhe të Sekretariatit të Qendrës, organizon aksione politike. Këshilli i pikave zgjedh anëtarë dhe delegon në Këshillin e Qendrës së VV-së. Në statutin e VV-së formula e përlllogaritjes së delegatëve për secilën pikë³⁹¹ është me sa vijon: 1 delegat = 7 deri në 15 anëtarë; 2 delegatë = 16 deri në 30 anëtarë; 3 delegatë = 31 deri në 60 anëtarë; 4 delegatë = më shumë se 61 anëtarë. Qëndrimet e pikave përmes delegatëve të tyre prezantohen në Këshillin e Qendrës dhe më pas delegatët e pikave raportojnë për vendimet e marra nga Këshilli i Qendrës.

Niveli i dytë organizativ i VV-së përbëhet nga Qendrat e VV-së. Qendrat bashkojnë së paku tri pika në nivel komune, përveç nëse Këshilli i Përgjithshëm vendos ndryshe. Organet e Qendrës janë: Këshilli i Qendrës, Kryesia e Qendrës, Sekretariati i Qendrës, Nënkomitetet e Qendrës dhe Komisioni Disiplinor. 1/5 e anëtarëve të Këshillit të Qendrës kanë të drejtë të thërrasin interpelancë për personat që ushtrojnë funksione drejtuese në nivel të Qendrës dhe,

³⁹¹ Statuti i Lëvizjes Vetëvendosje (2012), neni 39.

me shumicë të thjeshtë të votave në Këshill, mund të kërkojnë zgjedhje të parakohshme për pozicionet drejtuese. Këshilli i Qendrës ka 14 kompetenca. Mes tjerash: 1) zgjedh Komisionin Disiplinor të Qendrës; 2) harton politikat e zhvillimit lokal; 3) voton për personat e deleguar; 4) i raporton Sekretariatit të Përgjithshëm; 5) miraton dhe mbikëqyr buxhetin vjetor të Qendrës. Të paktën një herë në tre muaj, Këshilli i Qendrës mban mbledhje të zakonshme.³⁹² Votimi në nivel të Këshillit të Qendrës në lidhje me zgjedhjet e brendshme bëhet në mënyrë të hapur, përveç nëse 1/5 e anëtarëve kërkon që votimi të jetë i fshehtë. Sipas statutit, Kryesia e Qendrës është organi më i lartë vendimmarrës në nivel të Qendrës.³⁹³ Mbledhjet e jashtëzakonshme të Kryesisë së Qendrës mund të thirren me kërkesë të 1/3 të anëtarëve të Kryesisë, ose me kërkesë të Kryetarit të Qendrës. Anëtarët e Kryesisë së Qendrës nuk mund të jenë Këshilltarët Komunalë dhe Drejtorët e Drejtorive Komunale të VV-së. Nëse Kryetari i Qendrës së VV-së zgjidhet Kryetar Komune, atij/asaj i kërkohet me statut të që të japë dorëheqje nga pozita e Kryetarit të Qendrës.

AAK

Organizimi lokal i AAK-së është i rregulluar në nivel të nëndegëve, degëve e aktiveve. Degët formohen në nivel të komunave dhe çdo degë duhet të ketë së paku 5 nëndegë. Për formimin e më shumë se një dege në nivel të një komune vendos Kryesia Qendrore e AAK-së. Organet e degëve janë: Kuvendi; Këshilli Drejtues; Kryesia e Zgjeruar; dhe Kryesia e Degës. Të gjitha degët përbëjnë të ashtuquajturën ‘Bashkësinë e Degëve’. Nëndegët si njësi themelore territoriale formohen në nivel të lagjeve, qyteteve ose të fshatrave. Me vendim të Kryesisë së Degës, degët kanë të drejtë të formojnë

³⁹² Statuti i Lëvizjes Vetëvendosje (2008), neni 48.

³⁹³ Statuti i Lëvizjes Vetëvendosje (2008), neni 54.

aktive në fshatra ose lagje. Nëndegët udhëhiqen nga Kryesia e nëndegës. Për dallim prej organizimeve lokale të partive të tjera, në statutin e AAK-së nuk përmendet nëse degët dhe nëndegët kanë Kryetar. AAK i organizon degët e veta edhe në diasporë.

1.2.1 Selektorati dhe selektokracia

Decentralizimi i pushtetit për t'i përzgjedhur kandidatët partiakë që do të garojnë në zgjedhjet parlamentare është i rëndësishë thelbësore për demokracinë brendapartiake. Derisa në PDK, listën e kandidatëve që garojnë në zgjedhje e propozon Këshilli në konsultim me Kryetarin e partisë, në LDK degët dhe Kryetari propozojnë një listë, e cila merr miratimin para Këshillit të Përgjithshëm. Në aspektin e përzgjedhjes së listës, VV prin për nga demokratizimi për faktin se 3/4 e kandidatëve potencialë propozohen nga njësitë lokale partiake, kurse vetëm 1/4 e kësaj liste propozohet nga Kryetari i VV-së. Statuti i AAK-së po ashtu u jep mundësi njërive lokale partiake që të propozojnë një listë, ngjashëm sikurse tek LDK-ja, por nuk e përcakton saktësisht se sa kandidatë kanë të drejtë t'i propozojnë degët, nëndegët dhe aktivet.

Ndërsa statuti i PDK-së i jep të drejtë anëtarëve që të nominojnë apo të nominohen si kandidatë për zgjedhje parlamentare,

	PDK	LDK	VV	AAK
Selektokracia – Vendosja e listës së kandidatëve për zgjedhjet parlamentare	Këshilli Drejtues në konsultim me Kryetarin	Degët propozojnë një listë, Kryetari i Partisë propozon kandidatët potencialë para Këshillit të Përgjithshëm.	¾ e të nominuarve nga njësitë partiake joqendrore, ¼ nga Kryetari i Partisë.	Njësitë brendapartiake e propozojnë një listë, Kryetari propozon listën finale tek Këshilli Drejtues.

statuti i LDK-së nuk përmend askund në mënyrë eksplicite se

anëtarët e LDK-së kanë të drejtë të nominojnë apo të nominohen. Në PDK, statuti nuk e përcakton të drejtën e anëtarëve që të votojnë për listën e propozuar të kandidatëve të nominuar për zgjedhje, por kjo e drejtë u është rezervuar dy organeve qendrore partiake, respektivisht Kryesisë dhe Kryetarit, ku ky i fundit jep propozimin përfundimtar, në bashkëpunim me Kryesinë, për listën e kandidatëve të PDK-së për zgjedhje parlamentare. Këshilli Drejtues i PDK-së e jep miratimin final për listën përfundimtare zgjedhore. Në LDK, degët dhe nëndegët kanë të drejtë të nominojnë kandidatë potencialë, kryetari e bën përzgjedhjen e kandidatëve nga kjo listë, kurse aprovimi final bëhet nga Këshilli i Përgjithshëm i LDK-së. Në VV, në anën tjetër, nominimi i anëtarëve për zgjedhje parlamentare dhe përpilimi i listës zgjedhore organizohen në dy nivele – qendror dhe lokal. Tri të katërtat e totalit të listës zgjedhore nominohen nga niveli lokal, kurse vetëm një e katërta nga niveli qendror. Për dallim prej PDK, LDK, dhe AAK, në VV anëtarët kanë të drejtën e përzgjedhjes së 3/4 të kandidatëve të nominuar për zgjedhje nga lista e hapur. Statuti i AAK-së e përcakton në mënyrë eksplicite të drejtën e anëtarëve që të nominohen për zgjedhje parlamentare, por nuk e përmend të drejtën e anëtarëve që të nominojnë. Këshillat Drejtues të degëve të AAK-së propozojnë një listë tek Kryetari i partisë, i cili e dërgon listën e përzgjedhur të kandidatëve për aprovimin final tek Këshilli Qendror Drejtues i AAK-së. Në aspektin e selektokracisë, VV prin në aspektin e decentralizimit, ku degët, nëndegët, seksionet dhe pikat kanë të drejtë të përzgjedhin 3/4 e kandidatëve të dominuar për zgjedhje nga lista e hapur. Më pastaj, AAK renditet e dyta në aspektin e decentralizimit të përzgjedhjes së kandidatëve, për faktin se Këshilli Drejtues i degëve (si një trup më gjithëpërfshirës), dhe jo kryetari i degës, ka të drejtë të propozojë një listë të kandidatëve. LDK-ja renditet e treta, për faktin se kryetarët e degëve (më pak gjithëpërfshirës) kanë të drejtë të propozojnë një listë të kandidatëve. PDK renditet e katërta, për faktin se përzgjedhja e

kandidatëve bëhet nga Kryetari, në ‘bashkëpunim me degët’, duke mos e precizuar në mënyrë eksplicite me statut rolin e degëve apo të nëndegëve në përzgjedhjen e kandidatëve.

8.2.11 Programet partiake

Me përjashtim të VV-së, ku programi votohet drejtpërdrejt nga anëtarët dhe këta të fundit kanë të drejtë të kontribuojnë në hartimin e politikave dhe të qëndrimeve të VV-së, në të gjitha partitë, dizajnimi i programit dhe listimi i prioriteteve bëhet nga ‘lart-poshtë’.

PDK

Në statutin e PDK-së, fjala *program* përmendet pesë herë, por asnjëherë në kontekstin e pjesëmarrjes dhe të kontributit të anëtarëve në dizajnimin e politikave programore. Herën e parë termi ‘program i PDK-së’ përmendet në kontekstin e të detyrimeve të anëtarëve të PDK-së që të ndërmarrin iniciativa në përputhje me programin e PDK-së (neni 16); herën e dytë përdoret në kontekstin se simpatizues i PDK-së konsiderohet ai/a jo që pajtohet me programin e PDK-së; herën e tretë përdoret në kontekstin e miratimit të programit nga Konventa e Përgjithshme;³⁹⁴ herën e katërt në kontekstin e kompetencave të Këshillit Drejtues, ku pos të tjerash miraton programin dhe Platformën Zgjedhore, dhe herën e pestë në kontekstin e disiplinës partiake, kur anëtarët e PDK-së shkelin programin e PDK-së dhe ndaj tyre shqiptohen masa disiplinore. Pra, siç shihet këtu, roli i seksioneve, nëndegëve dhe degëve nuk përmendet fare në kontekstin e dizajnit të programit, dhe programi si dokument qendror i PDK-së dizajnohet në organet

³⁹⁴ Statuti i Partisë Demokratike të Kosovës (pa datë), neni 34.

qendrore dhe dorëzohet që të zbatohet poshtë tek strukturat lokale të partisë – një qasje programatike kjo ‘nga lart-poshtë’.

LDK

Në statutin e LDK-së, fjala *program* përmendet tetëmbëdhjetë herë, por asnjëherë në kontekstin e pjesëmarrjes dhe kontributit të anëtarëve në dizajnimin e politikave programore. Së pari, fjala *program* përmendet në sqarimin se LDK-ja është parti e qendrës së djathtë, që vepron në pajtueshmëri me objektivat e programit të saj politik.³⁹⁵ Së dyti, përmendet në kontekstin e detyrimeve të anëtarëve që duhet t’u përmbahen vendimeve dhe synimeve programore të LDK-së.³⁹⁶ Së treti, përmendet në kontekstin e përgjegjësive të anëtarëve në rast se veprojnë në kundërshtim me programin dhe të marrjes së masave disiplinore ndaj tyre.³⁹⁷ Së katërti, statuti e përmend fjalën *program* në sqarimin se Kuvendi i LDK-së e miraton, ndryshon dhe plotëson Programin. Së pesti, se Kryesia e përgatit draftin dhe ia propozon Këshillit të Përgjithshëm statutin.

VV

Sipas statutit të VV, anëtarët kanë të drejtë që të marrin pjesë dhe të kontribuojnë në hartimin e qëndrimeve dhe të politikave të VV-së. Për dallim prej PDK-së, LDK-së dhe AAK-së, ku anëtarët nuk e votojnë drejtpërdrejt programin dhe nuk marrin pjesë aktivisht në hartimin e politikave, anëtarët e VV-së votojnë nëpërmjet demokracisë së drejtpërdrejtë për programin politik të VV-së (neni 29).³⁹⁸ Hartimi i Programit Politik të VV-së bëhet në Komitetet e

³⁹⁵ Statuti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (2012), neni 2.

³⁹⁶ Statuti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (2012), neni 8.

³⁹⁷ Statuti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (2012), neni 13.

³⁹⁸ Statuti i Lëvizjes Vetëvendosje (2012), neni 29.

VV-së si organe këshilluese dhe hulumtuese dhe ky proces orientohet nga Këshilli i Përgjithshëm dhe Kryesia e VV-së. Megjithëse statuti i VV-së rregullon në mënyrë eksplicite procedurën e votimin të programit politik nga anëtarësia, ai mbetet i heshtur lidhur me pjesëmarrjen e pikave dhe të qendrave e organeve të këtyre dy niveleve organizative të VV-së në diskutimin, komentimin, dhe draftimin e opsioneve dhe të politikave programore para se programi politik i VV-së të votohet nga anëtarësia.

AAK

Në statutin e AAK-së, fjala *program* përmendet nëntëmbëdhjetë herë, por asnjëherë në kontekstin e pjesëmarrjes dhe të kontributit të anëtarëve në dizajnimin e politikave programore. Së pari, fjala program përmendet në kontekstin se AAK mbron lirinë e shprehjes së mendimeve të anëtarëve të saj në zbatimin dhe përmirësimin e programit. Së dyti, në kontekstin e dokumenteve themeltare të AAK-së. Së treti, në kontekstin e kompetencave të Kuvendit për ta miratuar, ndryshuar apo plotësuar programin.

PËRFUNDIME

Shtatëmbëdhjetë vjet pas luftës, lidhshipi dhe partitë politike në Kosovë janë marrë me ‘tema të mëdha’ të politikës së jashtme, që nga Marrëveshja e Rambujesë e deri te Marrëveshjet e Brukselit. Duke u qeverisur mbi bazën e premisave të stabilitetit, zhvillimi demokratik dhe ai ekonomik i Kosovës nuk ishin prioritetet kryesore të partive politike. Duke u udhëhequr nga këto premisa, UNMIK-u nuk ishte i interesuar që të kërkonte nga lidhshipi partiak dhe institucional i Kosovës as transparencë dhe as llogaridhënie kundrejt qytetarëve të Kosovës. Kjo prodhoi një ‘paqe të korruptuar’, përmes të cilës mirëmbahej *status quo*-ja në Kosovë. Në mënyrë që të mirëmbahej *status quo*-ja dhe stabiliteti i një territori pa status të definuar politik në periudhën 1999-2008, UNMIK-u kishte mirëmbajtur paqen në Kosovë, duke e toleruar dhe duke mos e luftuar krimin dhe korrupsionin.

Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovë dhe vendosjes së EULEX-it, krimi i organizuar dhe korrupsioni vazhdojnë të jenë probleme shqetësuese në Kosovë. Duke qenë se UNMIK-u kishte dështuar që ndërtonte një sistem ligjor të mirëfilltë në Kosovë, pritjet ishin shumë të mëdha se BE-ja do të ndihmonte Kosovën për ndërtimin e një shteti ligjor. Deri më tani, EULEX-i nuk ia ka dalë ta ndërtojë një shoqëri të qytetarëve ku ligji sundon në mënyrë të barabartë për të gjithë. EULEX-i, sikurse UNMIK-u, i ka dhënë përparësi stabilitetit para zhvillimit demokratik të Kosovës, duke vazhduar të njëjtën mendësi të UNMIK-ut për tolerimin e krimit dhe të korrupsionit në Kosovë. Kosova ka dy opsione përpara vetes: a) ‘të demokratizohet me detyrim’ përmes Gjykatës Speciale, ku figura të përfshira në krim dhe korrupsion dhe vrasje politike do të mund të

gjykoheshin para kësaj gjykate, duke mundësuar kështu heqjen faktike nga skena politike në Kosovë të një klase politike të korruptuar që nuk e ka sensin minimal llogaridhënës demokratik kundrejt qytetarëve; b) ‘të demokratizohet paqësisht’, përmes reformimit të partive politike. Meqenëse opsioni i parë nuk ka funksionuar në Kosovë, për faktin se figura politike eminente që janë arrestuar më herët nga UNMIK ose EULEX-i, në vend që të ndëshkoheshin nga qytetarët e Kosovës, janë shpërblyer duke u konsideruar heronj të Kosovës, rruga më normale do të ishte që partitë politike të demokratizoheshin, të ndërtonin profil të ri politik përmes të cilit do të bëhej i mundshëm qarkullimi i elitave, respektivisht rekrutimi i njerëzve të rinj, të shkolluar mirë, me vizion politik dhe ekonomik për vendin.

Të gjitha zgjedhjet e organizuara pas luftës në Kosovë deri më 2008 janë parë si instrument i stabilitetit dhe i blerjes së kohës karshi adresimit të statusit politik përfundimtar të Kosovës. Brenda kësaj paradigme të mirëmbajtjes së stabilitetit ishte ndërtuar edhe sistemi zgjedhor i Kosovës. Në debatin mes partive politike dhe UNMIK-ut për sistemin zgjedhor, LDK-ja kishte propozuar një sistem zgjedhor të përzier. PDK-ja në anën tjetër, e bindur për fitore absolute, kishte dalë me propozimin për vendosjen e një sistemi zgjedhor mazhoritar në Kosovë. Të dyja këto propozime ishin hedhur poshtë nga UNMIK-u, i cili kishte imponuar sistemin zgjedhor proporcional. Përmes sistemit zgjedhor proporcional UNMIK-u synonte të përmbushte katër objektiva: a) të garantonte mbrojtjen dhe përfaqësimin e pakicave në institucionet e Kosovës; b) të pamundësonte që një parti e vetme të formonte në mënyrë ekskluzive institucionet; c) të impononte kuota përfaqësimi institucional për gratë; d) ky sistem zgjedhor ishte më i lehtë për t’u menaxhuar dhe politikisht më gjithëpërfshirës. Sistemi zgjedhor i vendosur në Kosovë ishte ndërtuar duke u bazuar relativisht në idetë për demokracinë konsensuale të Arendt Lijphartit. Partitë politike,

sipas këtij sistemi, detyroheshin të ndërtonin koalicione paszgjedhore për ta formuar qeverinë e vendit. Me fjalë të tjera, sistemi zgjedhor proporcional ishte njëra prej metodave (çelësave) që përdori UNMIK-u për ta inxhinieruar përfaqësimin politik, kulturën politike dhe ndërtimin e institucioneve.

Ndonëse studiuesit rekomandojnë që zgjedhjet e përgjithshme duhet t'u paraprijnë atyre lokale në shoqëritë e dala nga lufta, mbajtja e zgjedhjeve të përgjithshme në Kosovë u zëvendësua fillimisht me ato lokale për arsye politike. Zgjedhjet e para lokale u mbajtën pikërisht duke e pasur në konsideratë paqartësinë politike të statusit të Kosovës. Për ta zbritur nivelin e kërkesave politike në Kosovë, UNMIK-u kishte organizuar zgjedhjet lokale. Megjithatë, oferta zgjedhore numër një – edhe pse këto ishin zgjedhje lokale – nuk do të ishte zhvillimi ekonomik, arsimi, shëndetësia apo shërbimet publike – por pavarësia e Kosovës. Këto zgjedhje ishin bojkotuar nga serbët. Meqenëse zgjedhjet e para lokale ishin fituar nga LDK-ja – dhe me këtë ishte arritur njëri prej objektivave të UNMIK-ut që një parti e moderuar në sytë e tij të merrte timonin kryesor për drejtimin e institucioneve – tani mbetej të arrihej edhe një objektiv tjetër: përfshirja e serbëve në zgjedhjet e përgjithshme që do të organizoheshin më 2001. Me rënien e regjimit të Milošević-it në Serbi, ishte hapur mundësia që forcat e moderuara në Serbi ta përkrahnin pjesëmarrjen e serbëve në zgjedhjet e Kosovës.

Në zgjedhjet e para të përgjithshme të nëntorit 2001, serbët kishin marrë pjesë në zgjedhje përmes një koalicioni të madh të disa partive politike, të quajtur Koalicioni 'Povratok'. Ky koalicion kishte arritur të fitonte 11,3% të votave të përgjithshme. Duke qenë se me Kornizën Kushtetuese 10 vende ishin të garantuara paraprakisht për pakicën serbe, këtyre iu shtua edhe rezultati zgjedhor prej 12 ulëseve, duke e rritur numrin e ulëseve për serbët e Kosovës në Kuvendin e Kosovës në 22. LDK-ja kishte dalë përsëri parti fituese, por, si e vetme nuk mund t'i formonte institucionet në

mënyrë ekskluzive. PDK-ja kishte dalë e dyta, kurse AAK-ja e treta. Duke qenë se përfaqësuesit dhe ambasadorët e Quint-it dhe të UNMIK-ut mbanin 'çelësat e pushtetit' dhe ishin të interesuar për një lidhshmëri të moderuar politik, ata do të ndërhyjnë dhe të jepnin udhëzime të qarta se kush mund të merrte pushtet drejtues në institucionet e Kosovës. Lideri i PDK-së, si Drejtor Politik i UÇK-së dhe Kryeministër i 'Qeverisë së Përkohshme', sipas perceptimit të UNMIK-ut, nuk kishte mundësi që të kontribuonte në ndërtimin e një shoqërie demokratike, tolerante dhe multietnike, prej vetë faktit se shihej si 'njeri i UÇK-së' nga serbët. Po ashtu, LDK-ja, partia më e madhe fituese e zgjedhjeve, rezistonte ta pranonte Thaçin për Kryeministër në një qeveri të përbashkët, duke qenë se Hashim Thaçi kishte hedhur akuza mbi vetë kryetarin e LDK-së pas takimit të këtij të fundit me Milošević-in gjatë kohës së bombardimeve të NATO-s.

Pas negociatave të drejtpërdrejta mes UNMIK-ut, zyrës diplomatike të ShBA-së në Kosovë dhe lidhshmërisë të LDK-së, PDK-së dhe AAK-së, ishte arritur një kompromis. Sipas këtij kompromisi, Bajram Rexhepi ishte zgjedhur Kryeministër i Kosovës. Në shkurt 2002, LDK, PDK dhe AAK ndërtuan një koalicion të madh qeverisës. Përmes këtij koalicioni synohej të ulej bipolaritetin politik mes LDK-së dhe PDK-së dhe të ndërtohej një konsensus i gjerë për të qeverisur me Kosovën e pasluftës. Në anën tjetër, duke qenë se shumica e këtyre partive kishin baza etnike dhe lojaliteti i tyre fitohej e mbahej nga aleancat familjare dhe klanore në rajonet ku këto parti shtriheshin dhe organizoheshin, UNMIK-u dëshironte që duke i përfshirë të gjitha partitë politike në pushtet, ta rriste kontrollin mbi territorin e Kosovës, ta zgjeronte bazën e vet të legjitimitetit dhe ta mirëmbante *status quo*-në. Megjithatë, këtij koalicioni të madh qeverisës i mungonte një lidhshmëri i fuqishëm që do t'i bashkërendonte veprimet brendaqeveritare dhe të kishte një politikë kohezive në raport me jashtë. Kryeministri Bajram Rexhepi

nuk ishte kryetar i PDK-së dhe për çdo veprim duhet të konsultohet me Hashim Thaçin.

Përplasjet mes UNMIK-ut dhe Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse të Kosovës filluan menjëherë pas zgjedhjeve të para të përgjithshme. Ishin tri ngjarje që e përshpejtuan këtë përplasje. Ngjarja e parë kishte të bënte me nënshkrimin e një Marrëveshjeje Kufitare mes Jugosllavisë, Maqedonisë dhe UNMIK-ut, në prill 2002. Kjo marrëveshje u kontestua nga lidërshipi politik kosovar, për faktin se sipas saj mendohej që Republika e Serbisë i kishte dhënë Maqedonisë një pjesë të territorit të Kosovës. Ngjarja e dytë konfrontuese mes UNMIK-ut dhe institucioneve të Kosovës ndodhi në fund të vitit 2002. Pas nënshkrimit të marrëveshjes për themelimin e Unionit Serbi-Mali i Zi, në nëntor 2002, Serbia kishte marrë përsipër të gjitha të drejtat dhe obligimet për Kosovën në bazë të Rezolutës 1244. Sipas kësaj marrëveshjeje, Kosova konsiderohej pjesë e Serbisë. Kuvendi i Kosovës, si në rastin e parë (më 23 maj kishte aprovuar rezolutën ‘Integriteti Territorial i Kosovës’) edhe në të dytin (me 7 nëntor kishte aprovuar rezolutën kundër Marrëveshjes së Unionit Serbi-Mali i Zi) kishte aprovuar një rezolutë dhe kishte kundërshtuar këto veprime. Ngjarja e tretë që shënoi përplasjen mes UNMIK-ut dhe IPVQ-ve kishte të bënte me ndjekjet penale që bënte UNMIK-u kundrejt ish-luftëtarëve të UÇK-së. Meqë UNMIK-u në fillim të vitit 2003 kishte filluar të ndiqte dhe të burgoste disa prej figurave të UÇK-së, Kuvendi i Kosovës, më 15 maj 2003 kishte nxjerrë rezolutën e tretë për ‘Luftën Çlirimtare të Popullit të Kosovës për Liri dhe Pavarësi’. Kjo rezolutë, sikurse dy të parat, u shpall e pavlefshme dhe u konsiderua përçarëse në raportin me serbët. Rezoluta e tretë për ‘Luftën Çlirimtare të Popullit të Kosovës për Liri dhe Pavarësi’ kishte ndikuar që të ulej tonaliteti i konfliktit të mëparshëm mes LDK-së dhe PDK-së, për faktin se rezoluta njohu luftën e armatosur të UÇK-së dhe rezistencën paqësore të LDK-së. Të trija këto ngjarje ndikuan në rritjen e unitetit dhe zvogëlimin e

përplasjeve dhe të 'armiqësive politike' mes LDK-së dhe PDK-së.

Rritja e këtij uniteti prodhoi një dinamikë të re politike. Kërkesa për qartësimin e statusit politik të Kosovës ishte intensifikuar nga forcat politike në Kosovë. UNMIK-u nuk i jepte përgjigje kësaj kërkesë për faktin se nuk kishte një strategji dalëse nga Kosova. Vonesa në adresimin e statusit të pazgjidhur politik të Kosovës kishte rrezikuar që t'i përmbyste të gjitha investimet ndërkombëtare për ta ndërtuar një shoqëri multietnike dhe paqësore. Në këtë kontekst politik, frustrimi i qytetarëve të Kosovës kishte arritur pikën e zenitit. Papunësia e madhe, mungesa e zhvillimit ekonomik, presioni retorik nga Serbia se do ta kthente Kosovën nën sundimin e vet, instrumentalizimi i strukturave paralele serbe nga Beogradi, kishin ndikuar që në Kosovë në vend se të zbutej perceptimi negativ për marrëdhëniet ndëretnike, të rriteshin politikat etnike përjashtuese. Ngjarjet e marsit 2004, kur turma shqiptare e Kosovës kishte sulmuar UNMIK-un dhe serbët lokalë dhe objektet e tyre të kultit, ishin rezultat i këtij frustrimi të përgjithshëm.

Pas këtyre ngjarjeve, Kai Eide, i Ngarkuari Special i Sekretarit të Përgjithshëm, ishte emëruar për të vlerësuar situatën e përgjithshme në Kosovë. Në raportin e tij Eide nënvizoi se *status quo*-ja në Kosovë ishte e paqëndrueshme dhe rekomandoi nisjen e negociatave për përcaktimin e statusit të Kosovës. Ndonëse këto ngjarje e kishin përshpejtuar hapjen e negociatave për përcaktimin e statusit të Kosovës, mesazhi ndërkombëtar ishte i qartë: një dhunë tjetër e përmasave të marsit 2004 do ta pengonte hapjen e negociatave. Megjithatë, hapja dhe dinamika e këtyre negociatave do të varej nga rrethanat politike në Kosovë dhe Serbi, respektivisht nga konfiguracionet e pushtetit në këto dy vende. Në tetor 2004 Kosova organizoi zgjedhjet e dyta të përgjithshme. LDK përsëri printe në nivel të garës politike dhe kishte dalë partia e parë fituese në to. PDK doli partia e dytë dhe AAK e treta. Pas shpalljes së rezultateve të këtyre zgjedhjeve, LDK-ja kishte ndërtuar një

koalicion me AAK-në. Rugova përsëri kishte marrë pozitën e Kryetarit të Kosovës, kurse Haradinaj atë të Kryeministrit të Kosovës. Për shkak të ngjarjeve të marsit, serbët i kishin bojkotuar zgjedhjet e vitit 2004.

Janë disa elemente të rëndësishme që i karakterizuan zgjedhjet e vitit 2004. Për herë të parë në Kosovë, skena politike do të ballafaqohej me një opozitarizëm të fortë, meqenëse PDK-ja, ndonëse parti e dytë, do të mbetej në opozitë. Së dyti, në këto zgjedhje do të regjistroheshin dhe të garonin edhe Lista Qytetare ORA, e drejtuar nga Veton Surroi, si dhe Alternativa Demokratike, e drejtuar nga Edita Tahiri. ORA kishte arritur të fitonte 7 ulëse në Kuvendin e Kosovës. Së treti, gjatë këtyre zgjedhjeve, shoqëria civile kishte artikuluar kërkesën për reformimin e sistemit zgjedhor dhe hapjen e listave zgjedhore, duke argumentuar se një sistem zgjedhor me lista të mbyllura vetëm çka e favorizonte forcimin e pushtetit të liderëve në strukturën hierarkike dhe hermetike të partive politike.

Pas formimit të koalicionit LDK-AAK, në mars 2005, Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavi, kishte ngritur aktakuzë për krime lufte ndaj Kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj. Duke qenë se Serbia, si agresori kryesor në luftërat e ish-Jugosllavisë, ende po strehonte dy prej njerëzve më të kërkuar për krime lufte, liderët serbë të Bosnjës Radovan Karadžić dhe Ratko Mladić, ngritja e aktakuzës ndaj kryeministrit Haradinaj, një vit pas ngjarjeve të marsit, rrezikonte ta fuste Kosovën në një trazirë tjetër. Megjithatë, përkundër kësaj frike, Haradinaj, në momentin e dorëheqjes nga pozita e Kryeministrit dhe të vetëdorëzimit, u tregua lider i matur dhe i përgjegjshëm. Kjo ishte rrethanë pozitive në favor të Kosovës, kurdo që diskutohej statusi i saj përfundimtar.

Negociatat për statusin përfundimtar të Kosovës nuk do të mund të fillonin pa marrë parasysh faktorët e brendshëm dhe ata rajonalë. Forcat politike që ishin në pushtet në Kosovë dhe në Serbi

në kohën e vendosjes së këtij statusi, ishin ndër indikatorët kryesorë për suksesin e këtij procesi. Gjatë vitit, në Serbi dhe në Kosovë do të organizoheshin zgjedhjet e përgjithshme. Në Kosovë, për herë të parë, PDK-ja doli e para, kurse LDK-ja e dyta. Duke qenë të detyruara të udhëhiqnin procesin negociues për statusin e Kosovës, premisat e të cilit ishin vënë në dy raportet e Kai Eides, në vitin 2004 dhe 2005, PDK-ja dhe LDK-ja do të ndërtonin një koalicion të madh qeverisës. Sipas marrëveshjes së këtij koalicioni, LDK-ja përsëri do të marrë pozitën e Presidentit të Kosovës, kurse PDK-ja do ta marrë pozitën e Kryeministrit. Një koalicion i tillë ishte përkrahur edhe nga përfaqësitë diplomatike në Kosovë, për faktin se PDK-ja dhe LDK-ja, si dy partitë më të mëdha politike në Kosovë, do të mund të gjeneronin më shumë stabilitet politik brenda Kosovës, dhe do të mund të merrnin më shumë përgjegjësi në raport me negociatat që po zhvilloheshin. Kosova dhe Serbia kishin zhvilluar që nga viti 2006 negociata në Vjenë për formën dhe përmbatjen e statusit të ardhshëm të Kosovës. Në fakt, shumica e këtyre negociatave ishin zhvilluar për statusin e serbëve brenda shtetit të Kosovës, i cili do ndërtohej mbi Planin e Ahtisaarit. Pas shumë raunde bisedimesh, tashmë ishte shpalosur Plani i Ahtisaarit, i cili ndonëse nuk e përmendte askund fjalën *pavarësi*, të gjitha prerogativat e tij çonin drejt saj.

Lëvizja Vetëvendosje, nën sloganin ‘jo negociata, vetëvendosje!’, kishte organizuar protesta në Kosovë kundër këtij plani, i cili sipas tyre nuk e lejonte vetëvendosjen për popullin e Kosovës. Ekzistonte një frikë në mesin e Grupit të Kontaktit nëse Hashim Thaçi, ish-Kryeministër i Kosovës dhe ish-Kryetar i PDK-së, në një moment të caktuar do ta përdorte strategjinë e Vetëvendosjes dhe do të bënte presion për shpalljen e pavarësisë menjëherë pas shpalosjes së Planit të Ahtisaarit, pa marrë parasysh dinamikat politike ndërkombëtare, veçanërisht në rajon dhe Serbi. Shpallja e koordinuar e pavarësisë së Kosovës do të varej, sipas të

gjitha gjasave, prej dinamikave politike dhe rezultateve zgjedhore që priteshin të organizoheshin në Serbi më 2007. Megjithatë çdo shtyrje eventuale e rrezikonte procesin.

Zgjedhjet presidenciale në Serbi ishin organizuar në janar 2008. Gara për president të vendit ishte zhvilluar mes Vojislav Koštunica-s dhe Boris Tadić-it. Pas një rezultati shumë të afërt, në raundin e dytë të zgjedhjeve, Tadić-i kishte fituar me 51% të votave kundrejt Koštunica-s, i cili kishte marrë 49% të votave. ‘Përfaqësuesit e popullit të Kosovës’ shpallën në mënyrë të koordinuar pavarësinë e Kosovës, me 17 shkurt 2008, vetëm një ditë pasi Tadić-i ishte inauguruar në pozitën e Presidentit të Serbisë. Pavarësia e Kosovës ishte kontestuar nga Serbia, duke përforcuar edhe më shumë pranimin e saj në pjesën veriore të Kosovës, duke penguar vendosjen e EULEX-it në Kosovë, por edhe duke penguar si njohjet e Kosovës ashtu edhe anëtarësimin e saj në organizatat ndërkombëtare. Pjesë e kësaj strategjie ishte paraqitja e Kosovës si një shtet i pakryer, për statusin e të cilit duhet të negociohej sërish. Për këtë, Serbia ia kishte kërkuar një opinion Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë rreth deklaratës së shpalljes së pavarësisë së Kosovë dhe GjND-ja kishte lëshuar opinionin duke konstatuar se deklarata e pavarësisë nuk ishte në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare.

Zgjedhjet e para pas pavarësisë së Kosovë ishin mbajtur më 2010. Koalicioni qeverisës mes PDK-së dhe LDK-së, që e kishte dërguar dhe menaxhuar vendin deri tek pavarësia, ishte futur në rrugë qorre, kur një grup prej 31 deputetësh kishin kërkuar nga Gjykata Kushtetuese ta jepte mendimin për Presidentin e Kosovës, Fatmir Sejdiu, i cili ushtronte njëkohësisht edhe pozitën e Kryetarit të LDK-së. Gjykata Kushtetuese e Kosovës konstatoi se Kryetari i LDK-së, njëherësh President i Republikës së Kosovës, kishte bërë shkelje të rëndë kushtetuese duke mbajtur njëkohësisht dy pozicione. Si rezultat i kësaj, Presidenti Sejdiu kishte dhënë dorëheqje nga

pozita e Presidentit të Kosovës. Nëntë muaj më vonë, duke gjetur si shkas mos-privatizimin e PTK-së nga partneri i saj i koalicionit, LDK-ja kishte dalë nga koalicioni me PDK.

Për dallim nga zgjedhjet tjera të organizuara para pavarësisë, Kosova bëri një prapakthim në aspektin e demokratizimit, kur në këto zgjedhje, partitë politike u përfshinë drejtpërdrejt në manipulimin e rezultateve zgjedhore. PDK kishte ndërtuar qeverinë në koalicion me partitë të vogla të drejtuara nga AKR-ja. Sipas marrëveshjes, pozita e Kryeministrit i takoi PDK-së, kurse ajo e Presidentit, AKR-së. Më 22 shkurt 2011, Kuvendi i Kosovës zgjodhi Behgjet Pacollin në postin e Presidentit të Kosovës, por kjo zgjedhje u kontestua në formë dhe përmbajtje në Gjykatën Kushtetuese. Gjykata Kushtetuese konstatoi se zgjedhja e Pacollit ishte bërë proceduralisht në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës.

Pas kontestimit përmbajtësor të legjitimitetit të zgjedhjeve të vitit 2010, liderët e partive politike arritën një marrëveshje për reformimin e sistemit zgjedhor. Pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese rreth rastit Pacolli, tre liderët e partive politike, Hashim Thaçi, Isa Mustafa dhe Behgjet Pacolli nënshkruan një marrëveshje për reformimin e sistemit zgjedhor, ku pajtoheshin për emërimin e Atifete Jahjagës në postin e Presidentes, formimin e një Komisioni për Reformën e Ligjit për Zgjedhje të Përgjithshme dhe të një Komisioni tjetër për Reformën e Zgjedhjeve Presidenciale. Në fakt, që nga viti 2010, kjo marrëveshje nuk ishte zbatuar asnjëherë në plotësinë e saj, me përjashtim të emërimit të Atifete Jahjagës në postin e Presidentes së vendit.

Shoqëria civile dhe komentatorët e politikës në Kosovë kishin ofruar propozime të ndryshme se si të reformohet sistemi zgjedhor në Kosovë. Ndarja e Kosovës në disa zona zgjedhore, ulja e pragut zgjedhor, votimi vetëm për një kandidat, zgjedhja e Presidentit të Kosovës në mënyrë të drejtpërdrejtë ishin disa prej opsioneve që mendohej se mund të ndikonin në rritjen e nivelit të

përfaqësueshmërisë së qytetarëve në Kuvendin e Kosovës, rritjen e llogaridhënies politike, menaxhimin më të mirë të krizave politike dhe rritjen e demokracisë brendapartiake. Ndonëse Kosova ka bërë hapa të suksesshëm në procesin e demokratizimit, demokracia në Kosovë ende nuk është e konsoliduar. Janë disa faktorë që e penguan dhe vazhdojnë ta pengojnë konsolidimin e demokracisë, duke i përfshirë këtu ndërhyrjet e vazhdueshme ndërkombëtare në proceset politike në Kosovë, mungesën e barazisë mes klasave dhe gjinive, klientelizimin si dimension të marrëdhënieve pushtetare politikanë-qytetarë/biznes etj. Demokracia në Kosovë vazhdon të mbetet demokraci minimaliste. Ky tip i demokracisë e redukton demokracinë në procedura zgjedhore dhe e barazon legjitimitetin e institucioneve me zgjedhje fer dhe demokratike, e jo në rezultatet konkrete të këtyre institucioneve për ta ndërtuar një shoqëri të drejtë, të barabartë dhe të mirëqenë.

Zgjedhjet e vitit 2014 nxorën koalicionin parazgjedhor të formuar nga PDK-ja si parti fituese. Sidoqoftë, partitë politike opozitare, LDK-ja, Nisma dhe AAK-ja, kishin nënshkruar një memo ku zotoheshin se do ta formonin qeverinë, meqë PDK-ja nuk e kishte shumicën e nevojshme të deputetëve (61 deputetë) në Kuvendin e Kosovës. Sipas këtij plani, posti i Kryeministrit do t'i ndahej AAK-së, kurse ai i Kryetarit të Kuvendit LDK-së. Pas përfundimit të mandatit të presidentes Atifete Jahjaga, posti i Presidentit pritej t'i ndahej LDK-së. Sidoqoftë, koalicionit pas-zgjedhor LDK-AAK-Nisma i mungonte shumica e nevojshme e votave në Kuvendin e Kosovës. Mbijetesa e këtij koalicioni varej drejtpërdrejt nga mbështetja potenciale që mund t'ua ofronte VV-ja. Koalicioni VLAN pretendonte se e kishte shumicën dhe se Qeveria e Kuvendi i Kosovës duhet të drejtoheshin prej tij. PDK në anën tjetër insistonte të ndërtonte koalicion me njërën nga këto parti dhe t'i formonte institucionet, meqenëse në zgjedhje kishte dalë si parti e parë. PDK-ja në fakt kishte bërë një koalicion parazgjedhor me disa parti të

vogla të Kosovës. Pas një vendimi të Gjykatës Kushtetuese, të drejtën për ta formuar Qeverinë e Kosovës e kishte fituar PDK-ja, dhe pas një vonese gjashtëmujore, PDK-ja dhe LDK-ja përsëri kishin ndërtuar një koalicion qeverisës, i përkratur ky nga shtetet anëtare të Grupit të Kontaktit, për shkak se temat e radhës që e prisnin Kosovën si: themelimi i Gjykatës Speciale, formimi i Asociacionit të Komunave me shumicë serbe dhe demarkimi i vijës kufitare me Malin e Zi, do të kërkonin një qeverisje stabile që do ta kishte shumicën e votave në Kuvendin e Kosovës. Partitë opozitare si VV, AAK dhe NISMA i kundërshtuan të trija këto procese politike, hodhën gaz në Kuvendin e Kosovës, organizuan peticion qytetar dhe pamundësuan zhvillimin normal të seancave të Kuvendit, duke argumentuar se këto procese e gërryejnë dhe e kërcënojnë sovranitetin e shtetit të Kosovës.

Gjatë shtatëmbëdhjetë vjetëve të pasluftës, Kosovës i ka munguar qeverisja kualitative, llogaridhënese dhe demokratike. Instalimi i logjikës klienteliste dhe neopatrimoniale nga partitë politike në administratë, biznes, votim, angazhim publik dhe komunitar, ka ndikuar negativisht në konsolidimin e shtetit të Kosovës. Mungesa e transparencës dhe e llogaridhënës e ka dëmtuar kredibilitetin e partive politike kundrejt publikut. Rekrutimi, trajnimi dhe gradimi i elitave të reja në partitë politike në Kosovë deri më tani i është nënshtruar logjikës klienteliste dhe jodemokratike. Është e vështirë të imagjinohen sot shtetet demokratike pa parti politike, megjithëse nuk është fare e vështirë të imagjinohen parti politike që veten e quajnë parti demokratike, por që u mungon demokracia brendapartiake. Me përjashtime të vogla, pothuajse shumicës së partive politike në Kosovë u mungon demokracia brendapartiake.

Nga matjet empirike që janë bërë në këtë studim përmes krahasimit të statuteve partiake, VV prin në mënyrë relative për nga demokratizimi brendapartiak për shkak të shkallës më të lartë të gjithëpërfshirjes së anëtarëve të saj në proceset e brendshme të

lëvizjes dhe autonomisë statutore që gëzojnë pikat dhe qendrat. Për nga shkallëshmëria, LDK dhe AAK kanë një demokratizim brendapartiak mesatar, për faktin se strukturat e brendshme partiake të të dy partive janë më të centralizuara dhe degët e nëndegët nuk gëzojnë një decentralizim të plotë brendapartiak. PDK vlerësohet si një parti me shkallën më të lartë të centralizimit, të mospërfshirjes së anëtarëve në procese vendimmarrëse dhe të mungesës së autonomisë së njësive të saj partiake, respektivisht të degëve dhe nëndegëve.

Demokracia brendapartiake në Kosovë pengohet nga shumë faktorë. Më poshtë po i listojmë pesë sosh adresimi i së cilëve do të ndikonte drejtpërdrejt në reformimin e partive politike. Së pari, liderizmi. Fuqia e pakontestuar e liderit për të ekzekutuar vendime pa e konsultuar as anëtarësinë e gjerë dhe as strukturat vendimmarrëse pamundëson vendimmarrjen demokratike brenda partive politike. Së dyti, mungesa e autonomisë së veprimit të njësive partiake. Njësitë partiake, qofshin pika, nëndegë, seksione apo degë, nuk gëzojnë autonomi të plotë për zgjedhjen e kandidatëve të tyre. Preferencat e organeve qendrore partiake kanë ndikim të drejtpërdrejt në nominimet e kandidatëve që potencialisht garojnë për poste publike dhe, sidomos atë të kryetarit, në nivel komune. Së treti, arbitrariteti i lidërshpit partiak. Sanksionimi dhe disiplinimi i mendimit të lirë brenda partive politike është rregulluar me shumicën e statuteve të partive politike në Kosovë. Mungesa e procedurave dhe normave të qarta se kur dhe si mund të përjashtohet një anëtar nga partia politike ndikon drejtpërdrejt në rritjen e arbitraritetit të organeve qendrore partiake, me theks të veçantë të organit të Kryetarit. Kjo pamundëson deliberimin demokratik brendapartiak. Së katërti, mostransparenca financiare. Mungesa e transparencës rreth raportimeve financiare për fushatat zgjedhore të partive politike kontribuon drejtpërdrejt në kulturën e papërgjegjshmërisë dhe mosllogaridhënies kundrejt votueseve se cilat janë burimet financiare të partive, ku shpenzohen ato dhe si

auditohen shpenzimet. Së fundi, por jo për nga rëndësia, statutet dhe rregulloret e brendshme partiake nuk janë të shkruara në frymë dhe gjuhë demokratike.

BIBLIOGRAFIA

- Baldini, Gianfranco dhe Adriano Pappalardo, *Elections, Electoral Systems and Volatile Voters* (Palgrave Macmillan, 2009).
- Baudrillard, Jean, *Simulacra and Simulation* (University of Michigan Press, 1995).
- Beha, Adem, 'Minority Rights: An Opportunity for Adjustment of Ethnic Relations in Kosovo?', *Journal on Ethnopolitics and Minority Issues in Europe*; Vol 13, No 4, 2014, 85-110.
- Berge, Benjamin vo dem, Thomas Poguntke, Peter Obert dhe Diana Pipei, *Measuring Intra-Party Democracy: A Guide for the Content Analysis of Party Statutes with Examples from Hungary, Slovakia and Romania* (Springer, 2013).
- Biezen, Ingrid van dhe Daniela Romee Riccio, 'Shaping Intra-Party Democracy: On the Legal Regulation of Internal Party Organizations', në William R. Cross & Richard S. Katz (ed.) *The Challenges of Intra-Party Democracy* (Oxford University Press (2013).
- Binmore, Ken, *Game Theory: A Very Short Introduction* (Oxford University Press, 2007).
- Birch, Sarah, *Electoral Systems and Political Transformation in Post-Communist Europe* (Palgrave Macmillan, 2003).
- Buxhovi, Jusuf, *Kthesa Historike: Vitet e Gjermanisë dhe epoka e LKD-s* (Faik Konica, Prishtinë, 2008).
- Canaj, Zekeria, *Apeli 215 intelektualëve shqiptarë*, (Rilindja, Prishtinë, 2001).
- Capocchia, Giovanni, 'Anty-system parties', *Journal of Theoretical Politics* (2002); 14, 9.

- Capusella, Andrea Lorenzo, *Shtetndërtimi në Kosovë: demokracia, korrupsioni dhe BE-ja në Ballkan* (KOHA, Prishtinë, 2015).
- Chesterman, Simon, 'Elections Are What We Do', *The World Today*, Vol. 57, No. 11 (Nov., 2001).
- Chesterman, Simon, 'Imposed Constitutions, Imposed Constitutionalism, and Ownership', *Connecticut Law Review* (2004), Vol 37.
- Chesterman, Simon, 'Just war or Just Peace After September 11: Axes of Evil and War Against Terror in Iraq and Beyond,' *International Law* (2004-2005) Vo.37.
- Chesterman, Simon, 'Kosovo in Limbo: State-building and "Substantial Autonomy"', (International Peace Academy, Gusht 2001).
- Chesterman, Simon, *You, The People: The United Nations, Transitional Administration, and State-building* (Oxford University Press, 2004).
- Choedon, Yeshi, 'The United Nations Peacebuilding in Kosovo: The Issue of Coordination', *International Studies* 47 (1), 2010.
- Cocozelli, Fred, 'Critical junctures and local agency: how Kosovo became independent', *Southeast European and Black Sea Studies*, (2009) 9:1-1.
- Cocozzelli, Fred, 'Between Democratisation and Democratic Consolidation: The Long Path to Democracy in Kosovo', *Perspectives on European Politics and Society* (2013), 14:1.
- Cross, William P. & Richard S. Katz, 'The Challenges of Intra-Party Democracy', në William P. Cross & Richard S. Katz (ed.), *The Challenges of Intra-Party Democracy* (Oxford University Press, 2013).
- Cross, William P. dhe Richard S. Katz (ed.), *The Callenges of Intra-Party Democracy* (Oxford University Press, 2013).
- Deutsch, Karl, *The Analysis of International Relations* (Prentice Hall College, 1988).
- Doudriette, Richard W. Doudriette dhe Andrew Ellis, 'A Global Snapshot', në Larry Diamond dhe Marc F. Plattner (ed.), *Electoral*

- Sysmtes and Democracy* (The Johns Hopkins University Press: Baltimore, 2006).
- Doyle, Michael W., *Ways of War and Peace: Realism, Liberalism and Socialism* (New York: W. W. Norton, 1997).
- Duverger, Maurice, *Political Parties: A Behavioural Analysis* (Rand McNally, 1964).
- Duverger, Maurice, *Political Parties: Their Organization and Activity in the Modern State* (London: Methuen, 1954).
- Eric Schattschneider, Elmer, *Party Government* (New York: Rinehart and Company, 1942).
- Florian Bieber (ed.), *Montenegro in Transition: Problems of Identity and Statehood* (Nomos Verlagsgesellschaft, Baden-Baden, 2003).
- Gallagher, Micheal dhe Paul Mitchel, 'Introduction to Electoral Systems', në Micheal Gallagher dhe Paul Mitchel, *The Politics of Electoral Systems* (Oxford University Press, 2005).
- Gashi, Shkëlzen, *Statusi pa Pardon* (PrintingPress, Prishtinë, 2006).
- Gheciu, Alexandra, 'International Norms, Power and the Politics of International Administration: The Kosovo Case', *Geopolitics* (2005), 10:1.
- Golosov V., Grigorri, 'Party system classification: A methodological inquiry', *Party Politics* 2011, 17:539.
- Grilli di Cortona, Pietro, Cecila Manazi, Aline Pennisi, Federica Ricca, Bruno Simeone, *Evaluation and Optimization of Electoral Systems* (SIAM Monographs, 1998).
- Gunther, Richard & Larry Diamond, 'Species of Political Parties: A New Typology', *Party Politics*, Vol.9, No.2.
- Hamzaj, Bardh, *Paqja e Gjeneralit: Dialog me Ramush Haradinaj* (Zëri, Prishtinë, 2001).
- Hasani, Enver, 'Constitutional Protection of the Head of State: The Case of Kosovo' *ICL Journal* (2013), Vol.7.
- Hazan, Reuven Y. dhe Gideon Rahat, *Democracy within Parties: Candidate Selection Methods and Their Political Consequences* (Oxford University Press, 2010).
- Hill, Christopher, 'Renationalizing or Regrouping? EU Foreign Policy

- Since 11 September 2001', *Journal of Common Market Studies*, Vol.41, Issue 1, 143-163.
- Hooper, James dhe Paul R. Williams, 'Earned Sovereignty: The Political Dimension', *Denv. J. Int'L. & Pol'y*, Vol 31.
- Horowitz, Donald, 'Democracy in divided societies'. *Journal of Democracy* (1993) 4 (4).
- Judah, Tim, 'Kosovo's Moment of Truth', *Survival*, Vol. 47, No. 4 Winter 2005–06, ff. 73–84
- Kataz, Richard S., 'Why are there so many (or so few) electoral reforms?', në Micheal Gallagher dhe Paul Mitchel (ed.), *The Politics of Electoral Systems* (Cambridge University Press, 2005).
- Ker-Lindsay, James, 'From autonomy to independence: the evolution of international thinking on Kosovo, 1998-2005', *Journal of Balkans and Near Eastern Studies*, 2009, 11:2.
- Ker-Lindsay, James, 'The Emergence of 'Mediation' in International Peacemaking', *Ethnopolitics: Formerly Global Review of Ethnopolitics* (2009), 8:2, 223-233.
- King, Iain dhe Whit Mason, *Paqe me çdo kusht: Si dështoi bota në Kosovë* (KOHA: Prishtinë).
- Knoll, Bernhard, 'Fuzzy Statehood: An International Legal Perspective on Kosovo's Declaration of Independence', *Review of Central and East European Law* 34 (2009) 361-402.
- Knudsen, Tonny Brems dhe Carsten Bagge Lausten (ed.) *Kosovo between War and Peace: Nationalism, Peacebuilding and International Trusteeship* (London and New York, Routledge, 2006).
- Koeth, Wolfgang, 'State Building Without a State: The EU's Dilemma in Defining Its Relations with Kosovo' *European Foreign Affairs* 237 (2010).
- Kostovicova, Denisa, 'Legitimacy and International Administration: The Ahtisaari Settlement for Kosovo from a Human Security Perspective', *International Peacekeeping* (2008), Vol. 15, No. 5, 631-647.

- Kraja, Mehmet, *Vitet të humbura*, (Shoqata Botuese e Lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipërisë, Tiranë, 1995).
- Kurti, Albin, 'JISB Interview: Kosova in Dependence: From Stability of Crisis to the Crisis of Stability', *Journal of Intervention and Statebuilding*, 5: 1, 2011, 89 — 97.
- Lemay-Hébert, Nicolas, 'Coerced transitions in Timor- Leste and Kosovo: managing competing objectives of institution-building and local empoWerment', *Democratization* (2012), 19:3.
- Leys, Colin, 'Models, theories, and the theory of political parties', *Political Studies*, Vol. 7, Issue 2, 1959.
- Lijphart, Arend, 'Consociational Democracy', *World Politics*, Volume 21, Issue 2, January 1969.
- Lijphart, Arend, 'Constitutional design for divided societies', *Journal of Democracy* (2004), Volume 15, Number 2, April 2004.
- Lijphart, Arend, 'Multiethnic Democracy' në Seymour Martin Lipset, *The Encyclopedia of Democracy* (Washington, 1985).
- Linz, Juan J. dhe Alfred Stepan, 'Political Identities and Electoral Sequences: Spain, the Soviet Union and Yugoslavia', *Daedalus*, 121, Spring 1992.
- Linz, Juan J. dhe Alfred Stepan, *Problems of Democratic Transition and Consolidation: Southern Europe, South America and Post-Communist Europe* (Baltimore, MD: The Johns Hopkins University Press, 1996).
- Lipset, Seymour, *Political Man: The Social Bases of Politics*, (Heinemann Educational Books, London, 1983).
- Lorenz, Roger F. M., 'The Rule of Law in Kosovo: Problems and Prospects', *Criminal Law Forum* (2000) 11: 127–142.
- M. Farrell, David, *Comparing Electoral Systems* (Macmillan Press Ltd, 1998).
- Machover, Mosh'e, 'The Underlying Assumptions of Electoral Systems', në Dan S. Felsenthal dhe Mosh'e Machover (ed.), *Electoral Systems: Paradoxes, Assumptions, and Procedures* (Springer, 2012).

- Maliqi, Shkelzen, *Kosovo: Separate Worlds* (Dugagjini PH, MM, Prishtina 1998).
- Marko, Joseph, 'Independence without standards? Kosovo's Interethnic Relations Since 1999', *European Yearbook of Minority Issues Online* (2007), Vol. 5, Issue 1.
- McCormick, James M., *The Domestic Sources of American Foreign Policy: Insights and Evidence* (Rowman & Littlefield Publishers, Inc. 2012).
- Michels, Robert, *Political Parties: A Sociological Study of the Oligarchical Tendencies of Modern Democracy* (Kitchener, Ontario: Batoche Books, 2001).
- Mitchell, Ian R., 'The ambiguities of elections in Kosovo: Democratisation versus human rights?', *The International Journal of Human Rights* (2000), 4:3-4.
- Morrow, Jame, *Game theory for political scientists*, (Princeton University Press, 1994).
- Motyl, Alexander J. dhe Amanda Schnetzer, *Nations in Transit 2004: Democratization in East Central Europe and Eurasia* (New York, Washington D.C, 2004).
- Mouffe, Chantal, *Agonistics: Thinking the World Politically* (Verso, 2013).
- Mouffe, Chantal, *On the Political* (Routledge; New Ed edition, 2005).
- Mouffe, Chantal, *The Return of the Political* (Verso Books; Revised edition, 2005).
- Nabers, Dirk, 'Filling the Void of Meaning: Identity Construction in U.S. Foreign Policy After September 11, 2001', *Foreign Policy Analysis*, Vol. 5, Issue 2, 91-214.
- Narten, Jens, 'Post-Conflict Peacebuilding and Local Ownership: Dynamics of External-Local Interaction in Kosovo under United Nations Administration', *Journal of Intervention and Statebuilding* (2008), 2:3, 369-390.
- Newmann, Sigmund, "Towards a Comparative Study of Political Parties", në Sigmund Neumann (ed.) *Modern Political Parties* (Chicago: University of Chicago Press, 1956).

- Norris, Pippa, 'Choosing electoral systems: proportional, majoritarian and mixed systems'. *International Political Science Review*, 1997, 18 (3), 297–312.
- Nye, Joseph S., 'U.S. Power and Strategy After Iraq', *Foreign Affairs* (2003).
- Paris, Roland, *At War's End: Building Peace after Civil Conflict* (Cambridge University Press, 2004).
- Pateman, Carole, *Participation and Democratic Theory* (Cambridge: Cambridge University Press, 1970).
- Perrit, Henry, *Ushtria Çlirimtare e Kosovës: Rrëfimi prej brenda për një kryengritje*, (KOHA, Prishtinë, shtator 2008),
- Pettifer, James, 'The Ahtisaari Report – Totem & Taboo', (Conflict Studies Research Centre, Balkan Series 07/08, Feb. 2007).
- Poguntke, Thomas dhe Paul Webb (ed.) *The Presidentialization of Politics: A Study in Comparative Politics* (Oxford University Press, Oxford, 2005)
- Pond, Elizabeth, 'Kosovo and Serbia after the French non', *The Washington Quarterly*, 28:4, 19-36.
- Przeworski, Adam, 'Democracy as the contingent outcome of conflicts', në J. Elster & R. Slagstad (eds.), *Constitutionalism and Democracy*, (Cambridge, UK: Cambridge University Press, 1988).
- Putman, Robert D., 'Diplomacy and domestic politics: the logic of tëo-level games', *International Organization* / Volume 42 / Issue 03 / Summer 1988.
- Putman, Robert D., *Making Democracy Work: Civic Tradition in Modern Italy* (Princeton Universtiy Press, 1993).
- Rahat, Gideon dhe Tamir Sheafer, 'The personalization(s) of politics: Israel, 1949– 2003. *Political Communication* 24 (1), 2007, 65–80.
- Really, Benjamin, *Democracy in Divided Societies. Electoral Engineering for Conflict Management*. (Cambridge University Press, Cambridge, 2001).
- Reeve, Andrew dhe Alan Ware, *Electoral Systems: A comparative and theoretical introduction* (Routledge, 2011).

- Rokkan, Stein, *Citizens, Elections, and Parties: Approaches to the Comparative Study of the Process of Development* (Oslo: Universitetsforlaget, 1970)
- Rugova, Ibrahim, *Çështja e Kosovës: Biseda me Marie-Francoise Allain dhe Xavier Galmiche* (Dugagjini, Pejë, 1995).
- S. Mack, Charles, *When Political Parties Die: A Cross-National Analysis of Disalignment and Realignment* (Praeger, 2010).
- Sartori, Giovanni, 'European Political Parties: The Case of Polarize Pluralism', në Joseph La Palombara dhe Myron Weiner (ed.) *Political Parties and Political Development* (Princeton University Press).
- Sartori, Giovanni, 'Political development and political engineering', në J. D. Montgomery & A.O. Hirschman (eds.), *Public Policy*, Vol. 17. (Cambridge, MA: Harvard University Press, 1968).
- Sartori, Giovanni, *Parties and Party Systems: A Framework for Analysis* (Colchester, ECPR 2005).
- Scarrow, Susan, 'Political Parties and Democracy in Theoretical and Practical Perspective: Implementing Intra-Party Democracy', (National Democratic Institute for International Affairs, 2005).
- Schmitt, Carl, *The Concept of the Political* (University of Chicago Press, Expanded edition, 2007).
- Schmitt, Oliver Jens, *Kosova: Histori e Shkurtër e Një Treve Qendrore Ballkanike* (KOHA, Prishtinë, nëntor 2012).
- Schumpeter, Joseph, *Capitalism, Socialism and Democracy* (New York: Harper & Brothers, 1947).
- Schwandner-Sievers, Stephanie, 'Democratisation through Defiance? The Albanian Civil Organisation 'Self-Determination' and International Supervision in Kosovo', në V. Bojicic-Dzelilovic et al. (eds.), *Civil Society and Transitions in the Western Balkans* (Palgrave Macmillan, 2013).
- Schwandner-Sievers, Stephanie, 'The bequest of Ilegalja: contested memories and moralities in contemporary Kosovo', *Nationality Papers: The Journal of Nationalism and Ethnicity* (2013), Vol.41, Issue 6, 953-970.

- Simon Chesterman, 'Ownership in Theory and in Practice: Transfer of Authority in UN Statebuilding Operations, *Journal of Intervention and Statebuilding* (2007), 1:1.
- Sisk, Timonhy, 'Choosing an electoral system: South Africa seeks new ground rules', *Journal of Democracy*, 1993, 4 (1), 79–91.
- Stahn, Carsten, *The Law and Practice of International Territorial Administration: Versailles to Iraq and Beyond*, (Cambridge: Cambridge University Press, 2008).
- Stilhoff Sörensen, Jens, 'International Statebuilding in Kosovo', në David Chandler dhe Timothy D. Sisks (ed.) *Routledge Handbook of International Statebuilding* (Routledge, 2013).
- Tansey, Oisín, 'Democratization Without a State: Democratic Regime-building in Kosovo, Democratization'. 14:1 (2007).
- Tansey, Oisín, *Regime-building: Democratization and International Administration*. (Oxford University Press, 2009).
- Taylor, Andrew, 'Electoral systems and the promotion of 'consociationalism' in a multi-ethnic society. The Kosovo Assembly elections of November 2001', *Electoral Studies* 24 (2005) 435-463.
- Taylor, Andrew, 'This election was never going to be perfect: The Kosovo Municipal election of October 2000 as post-conflict election', *Civil Wars* (2002), Vol. 5 Issue 3.
- Teorell, Jan, 'A Deliberative Defence of Intra-Party Democracy', *Party Politics* (1999) 5, 363-382.
- Vickers, Miranda, *Between Serbs and Albanians: A History of Kosovo*, (Columbia University Press, 2001).
- Visoka, Gëzim dhe Adem Beha, 'Minority Consultative Bodies in Kosovo: A Quest for Effective Emancipation or Elusive Participation?', *Journal on Ethnopolitics and Minority Issues in Europe*, Vol 10, No 1, 2011, 1-30.
- Visoka, Gezim, 'International Governance and Local Resistance in Kosovo: the Thin Line between Ethical, Emancipatory and Exclusionary Politics', *Irish Studies in International Affairs*, Vol. 22 (2011), 99.

- W. Cox, Gary, *Making Votes Count: Strategic Coordination in the World's Electoral Systems* (Cambridge University Press, 1997).
- Walt, Stephen M., 'Beyond bin Laden: Reshaping U.S. Foreign Policy', *International Security* (2001/2), Vol.26, No. 3, 56-78.
- Weller, Marc, 'The Vienna negotiations on the final status for Kosovo', *International Affairs* 84: 4 (2008) 659–681.
- Weller, Marc, *Peace Lost: The Failure of Conflict Prevention in Kosovo* (Martinus Nijhoff, 2008).
- Weller, Marc, *The crisis in Kosovo, 1989–1999* (Cambridge: Documents and Analysis Publishing, 1999).
- Weller, Marc, *The Kosovo conflict* (Cambridge: Documents and Analysis Publishing, 2001).
- Zakaria, Fareed, 'The rise of illiberal democracy', *Foreign Affairs*; Nov/Dec 1997; 76, 6.
- Zakaria, Fareed, *The Future of Freedom, Illiberal Democracy at Home and Abroad* (W. W. Norton & Company, 2007).
- Zaum, Dominik, *Sovereignty Paradox: Norms and the Politics of International Statebuilding* (Oxford, New York: Oxford University Press, 2007).

Intervista

1. Intervistë me z. Artan Mustafa, politolog dhe gazetar, 5 prill 2016.
2. Intervistë me z. Gëzim Selaci, sociolog dhe ligjërues në Departamentin e Sociologjinë (Universiteti i Prishtinës), 6 prill 2016.
3. Intervistë me z. Bekim Baliqi, politolog dhe profesor në Departamentin e Shkencës Politike (Universiteti i Prishtinës), 31 mars 2016.
4. Intervistë me z. Halil Matoshi, analist, 28 mars 2016.
5. Intervistë me z. Agron Demi, politolog dhe Drejtor Ekzekutiv në institutin GAP, 5 prill 2016.
6. Intervistë me z. Dukagjin Gorani, sociolog dhe analist, 5 prill 2016.

7. Intervistë me z. Glauk Konjufca, Lëvizja Vetëvendosje, 1 prill 2016.
8. Intervistë me z. Basri Musmurati, Partia Demokratike e Kosovës, 31 mars 2016.
9. Intervistë me znj. Ajnishale Halimi, ish anëtare e Lëvizjes Vetëvendosje, tash anëtare e PDK-së, 22 maj 2016.
10. Intervistë me z. Arben Gashi, Lidhja Demokratike e Kosovës, 29 mars 2016.
11. Intervistë me z. Shpejtim Bulliqi, Lidhja Demokratike Kosovës, 1 prill 2016.
12. Intervistë me z. Pal Lekaj, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, 7 prill 2016.
13. Intervistë me z. Ali Berisha, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, 7 prill 2016.

Statutet partiake

Statuti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (Mars, 2012).

Statuti i Partisë Demokratike të Kosovës (pa datë).

Statuti i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (2008) .

Statuti i Lëvizjes Vetëvendosje (Mars 2012).

Ligje/rregullore dhe strategji të institucioneve të Kosovës

Zyra e Kryeministrit të Kosovës, ‘Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021’ (Prishtinë, janar 2016).

Zyra e Kryeministrit, ‘Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimit të prave, Fiancimin e Terrorizimit dhe Krimeve Financiare 2014-2018’ (Prishtinë, janar 2015). Qasur në http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia_Kombetare_e_Republikes_se_Ko

soves_per_Pandalimin_dhe_Luftimin_e_Ekonomise_Joformale,_
Pastrimin_e_Parave,_Financimin_e_Terrorizmit_dhe_Krimeve_Fi
nanciare_2014-2018.pdf (29 korrik 2016).

Ligji Nr. 05/L-053 Për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit
të Specializuar. 31 gusht 2015. Qasur në [https://gzk.rks-
gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=11036](https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=11036) (25 korrik 2016).

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, 'Rregullore Nr.01/2013 për
Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike. 0 korrik 2013. Qasur
në [www.kqz-
ks.org/Uploads/Documents/Rregulla%20_123072013_agalzvuxxn.
pdf](http://www.kqz-ks.org/Uploads/Documents/Rregulla%20_123072013_agalzvuxxn.pdf) (4 gusht 2016)

Kuvendi i Kosovës, 'Rezolutë në mbështetje të Memorandumit të
marrëveshjes ndërmjet Behgjet Pacolli, Isa Mustafa dhe Hashim
Thaçi. Nr. 04-R-01, Prishtinë, 7 prill 2011. Qasur në
<http://elibraria.org/assets/Rezoluta-Marreveshja.pdf> (10 janar
2014).

Ligji Nr. 03/L-174 Për Financimin e Subjekteve Politike. 16 shtator
2010. [http://www.gazetazyrtare.com/e-
gov/index.php?option=com_content&task=view&id=157&Itemid=
56&lang=sq](http://www.gazetazyrtare.com/e-gov/index.php?option=com_content&task=view&id=157&Itemid=56&lang=sq) (2 prill 2015).

'Ligji Nr. 03/L-073 Për zgjedhjet e përgjithshme në Republinë e
Kosovës, 15 qershor 2008.

Dokumente/raporte të UNMIK-ut

UNMIK, 'Standards for Kosovo', Pristina, 10 dhjetor 2003. Qasur në
[http://www.securitycouncilreport.org/atf/cf/%7B65BFCF9B-6D27-
4E9C-8CD3-CF6E4FF96FF9%7D/Kos%20Standards.pdf](http://www.securitycouncilreport.org/atf/cf/%7B65BFCF9B-6D27-4E9C-8CD3-CF6E4FF96FF9%7D/Kos%20Standards.pdf) (26
korrik 2016).

United Nations Security Council, 'Letter dated 17 November 2004 from
the Secretary-General addressed to the President of the Security
Council', United Nations S /2004/932, 30 November 2004.

Report of the Secretary-General on the United Nations Interim Administration Mission in Kosovo [S/1999/1250] of 23 December 1999.

United Nations Security Council, 'No exit without strategy: Security Council decision-making and the closure or transition of United Nations peacekeeping operations', S /2001/394, 20 prill 2001.

UNMIK Rreg/2001/9, 'Constitutional Framework for Provisional Self-Government in Kosovo', 15 maj 2001.

UNMIK/Reg/2000/16 'Për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike në Kosovë', 21 mars 2000.

UNMIK/Reg/2000/39 'Mbi Zgjedhjet Komunale në Kosovë', 8 korrik 2000.

UNMIK/Rreg/2000/01 'Mbi Strukturën e Përbashkët të Përkohshme Administrative të Kosovës', 14 janar 2000.

Aktgjykime të Gjykatës Kushtetuese

Gjykata Kushtetuese, 'Aktgjykim në rastin Nr. Ko 119/14 Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit Nr. 05-V-001, të votuar nga 83 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të 17 korrikut 2014', Prishtinë, 26 gusht 2014. Qasur në http://www.gjks.org/repository/docs/gjk_ko_119_14_shq.pdf (13 Mars 2016).

Gjykata Kushtetuese, 'Aktgjykim në rastin nr. KO 130/15 lidhur me vlerësimin e përputhshmërisë së parimeve që përmban dokumenti i titulluar 'Asociacioni/Bashkësia e komunave me shumicë serbe në Kosovë – Parimet e përgjithshme/Elementet kryesore' me frymën e Kushtetutës, me nenin 3 [Barazia para Ligjit], paragrafi 1, me Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] dhe Kapitullin III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës', Prishtinë, 23 dhjetor 2015. Qasur në

http://www.gjk-ks.org/repository/docs/gjk_ko_130_15_shq.pdf (5 prill 2016).

Gjykata Kushtetuese ‘Aktgjykim në Rastet K.O.29/12 dhe K.O. 488/12 Amandametet e propozuara kushtetuese, të dorëzuara nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës më 23 mars 2012 dhe 4 maj 2012’. Shih http://www.gjk-ks.org/repository/docs/Aktgjykim%20KO29_48_12_Anex%20A%20&%20B_SHQ.pdf (9 qershor 2015).

Raporte/studime/rregullore të institucioneve evropiane

Council of Europe, ‘Code of Good Practice in the Field of Political Parties’, European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), Study No. 414/2006.

Council of Europe, ‘Parliamentary Assembly Doc.11465 Procedural guidelines on the rights and responsibilities of the opposition in a democratic parliament’. 3 January 2008. Qasur në <http://assembly.coe.int/nw/xml/XRef/X2H-Xref-VieHTML.asp?FileID=11792&lang=en> (16 maj 2016).

European Commission for Democracy Through Law, ‘Report on the role of the opposition in a democratic parliament’, Strasbourg, 15 November 2010, Study no.497/2008. Qasur në [http://www.venice.coe.int/ëebforms/documents/default.aspx?pdfid=CDL-AD\(2010\)025-e](http://www.venice.coe.int/ëebforms/documents/default.aspx?pdfid=CDL-AD(2010)025-e) (16 maj 2016).

European Commission for Democracy (Venice Commission), ‘Code of Good Practice in the Field of Political Parties’, adopted by the Venice Commission at its 77th Plenary Session’, (Strasbourg, 20 janar 2009).

European Union Election Expert Mission to Kosovo, ‘Final Report’, 25 January 2011.

Komisioni Evropian, ‘Dokument Pune i Personelit të Komisionit: Raporti për Kosovën 2015’, Bruksel, 10.11, 2015, SËD (2015) 215 final.

- Memorandumi i Zyrës së BE-së në Kosovë dërguar liderëve politikë në Kosovë, ‘Memo to Party Leaders on Kosovo’s Electoral Reform Process from the EUSR/Head of European Union Office and EU Member States represented in Pristina’. Shih <http://elibraria.org/assets/General-Principles-for-Electoral-Reform.pdf> (12 janar 2014).
- Parliamentary Assembly, ‘Inhuman treatment of people and illicit trafficking in human organs’, (Committee on legal Affairs and Human Rights, 12 dhjetor 2010)/ Qasur në http://assembly.coe.int/CommitteeDocs/2010/20101218_adjdoc462010provamended.pdf (5 nëntor 2015).
- Raporti i Progresit 2013 për Kosovën’. Bruksel, 16. 10.2013. SËD (20130 416).
- Council Joint Action 2008/124/CFSP of 4 February 2008 on the European Union Rule of Law Mission in Kosovo.

Studime tematike

- Agjencia e Statistikave të Kosovës, ‘Rezultatet e Anketës së Fuqisë Punëtore 2015 në Kosovë’ (Prishtinë, qershor 2016).
- Balkan Policy Institute, ‘EULEX: In Search of and Identity’ (Pristina, Kosovo, 27 dhjetor 2009).
- Besnik Boletini dhe Besa Kalaja, ‘Partia e Punës: Fizionomia e patronazhit politik në Kosovë’, (Preport, Nr. 10, Qendra Kosovare për Gazetari Hulumtuese, dhjetor 2014).
- D4D, ‘Busolla ideologjike në Kosovë: Hartë e orientimit të partive politike’, Seria: Partitë Politike, Nr 8, Prishtinë, 2014.
- D4D, ‘Deforma Zgjedhore: Dy vite pas, reforma në pikën zero’. Seria 5, Zgjedhjet. Prishtinë, shtator 2013.
- D4D, ‘Trendet zgjedhore 2000- 2014: Analizë numerike e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit’, (Seria: Zgjedhjet dhe partitë politike, Nr. 9, Prishtinë, 2015).

- Demkracia për Zhvillim, 'Klasë në vete: Patronazhi dhe ndikimi i tij në mobilitetin shoqëror në Kosovë', (Seria: Interesi Publik, Nr. 2, Prishtinë, 2011).
- Dan Everts, 'Review of the OSCE Mission in Kosovo's Activities 1999–2001'. Pristine/Prishtine, 2001, OMiK.
- David Jackson, 'Clientelism: The alternative dimension to Kosovo's governance' (Kosovo Local Government Institute, Pristine, shkurt 2014)
- Derick W.Brinkerhoff dhe Arthyr A. Goldsmith, 'Cleintelism, Patrimonialism and Democrtatic Governance: An Overwied and Framework for Assessment and Programming', (U.S. Agency for International Development, dhjetor 2002).
- Friedrich Ebert Stiftung, 'Demarkacioni Kosovë – Mali i Zi (Aspektet Ndërkombëtare, Gjeografike, Politike dhe Historike), Prishtinë, 2015. Qasur në <http://www.fes-prishtina.org/ëb/media/2015/Studimi%20per%20demarkacionin%20%20Kosove%20Mali%20i%20zi.pdf> (12 qershor 2016).
- GAP, 'Madhësia e Administratës Publike në Kosovë', (Prishtinë, korrik 2015).
- GAP, 'Ristrukturimi i Qeverisë: Propozim për zvogëlimin e posteve ministrore për një Qeveri më pak të kushtueshme dhe më efikase' (Prishtinë, korrik 2014).
- Freedom House, 'Kosovo | Nation in Transit, 2015'. Qasur në https://freedomhouse.org/sites/default/files/NIT2015_Kosovo.pdf (10 korrik 2016).
- GLPS dhe DPC, 'EULEX (i) – Drejt Një Strategjie Përfundimtare: Fuqizimi i shtetit të së drejtës përmes integritimit në BE (Raport Politikash, Nr.05, prill 2014).
- Grupi Ndërkombëtar i Krizave, 'Dy në Tango: Agjendë për PSSP në Kosovë' (ICG Raporti i Raporti i Evropës N°148, 3 shtator 2003).
- Grupi Ndërkombëtar i Krizave, 'Kosova pas Haradinajt', (Raport për Evropë i Grupit të Krizave, numër 163, 26 maj 2005.
- Grupi Ndërkombëtar i Krizave, 'Kosova: Drejt Statusit Final' (Raporti i Grupit të Krizave për Evropë N°161, 24 janar 2005),

- Grupi Ndërkombëtar i Krizave, 'Kosova: Sfida e transicionit' (Raport për Evropë i Grupit të Krizave numër 170, 17 shkurt 2006).
- Grupi Ndërkombëtar i Krizave, 'Kosova: Zgjedhje Historike (Prishtinë, 21 nëntor 2001).
- Grupi Ndërkombëtar i Krizave, 'Udhëzime Për Kosovën (I) Shqyrtimi I Statusit Përfundimtar' (Raporti 125 i ICG-së për Ballkanin, 1 mars, 2002),
- ICG Balkans Report, 'Elections in Kosovo: Moving Toward Democracy?', 7 July 2000, Pristina, Washington/Brussels.
- International Crisis Group, 'Starting from Scratch in Kosovo', (Balkans Report No 83, 13 December 1999).
- International Crisis Group, 'Unifying the Kosovar Factions: The Way Forward' (ICG Balkan Report no 58, Brussels – Tirana, 12 March 1999)
- INDEP, 'Opsionet për Reformën Zgjedhore në Kosovë', 2012/2, Prishtinë.
- INDEP, 'Papunësia në Kosovë: 3 masa për mbi 20, 000 vende pune' (Analizë Politikash, Prishtinë, 2013).
- INPOL, 'Vlerësimi i Sistemit Zgjedhor të Kosovës dhe Rekomandimet për Reformën Zgjedhore', Prishtinë, 2012.
- Instituti Demokratik i Kosovës, 'Cmontimi i Financimit Politik' (Prishtinë, qershor 2013).
- Jeton Zulfaj et al., 'Political Parties in Kosovo: Profile and Ideology', Çelnaja, Prishtinë, 2008.
- KIPRED, 'Pandëshkueshmëria në Kosovë: Lufta kundër korrupsionit ndaj ndaj profilit të lartë', (Analizë e Politikave, No.1/16, Janar 2016),
- KIPRED, 'Shkaqet dhe shkasat e krizës institucionale në Kosovë', Analizë Politike 2010/6, Prishnë, nëntor 2010;
- KIPRED, 'Zgjedhjet Parlamentare në Kosovë 2010: Vështrim i përgjithshëm dhe trendet', Prishtinë, prill 2011.
- KIPRED, 'Zgjedhjet për Qytetarin: Vlerësimi i Sistemit Zgjedhor të Kosovës dhe Rekomandimet për Zgjedhjet e Ardhshme', 2012.

- KIRPED, 'Krimet e Zgjedhjeve: Analizë e ndjekjes penale dhe gjykimit të rasteve të krimeve të zgjedhjeve në Kosovë'. Prishtinë, tetor 2011.
- Kosovar Institute for Policy Research and Development, 'A Comprehensive Analysis of EULEX: What Next', (Policy Paper No.1/13 – January 2013).
- Kosovo Stability Initiative, 'A Power Prime: A Handbook to Politics, People, and Parties in Kosovo', dhjetor 2011.
- Kosova Centre for Security Studies, 'Kosovo Security Barometer: Public Perceptions on Kosovo's Foreign Policy and Dialogue with Serbia', (Prishtinë, shkurt 2016). Qasur http://www.qkss.org/repository/docs/Public_perceptions_on_Kosovo's_Foreign_Policy_and_Dialogue_with_Serbia.jpg_531411.pdf (24 maj 2016).
- Kushtrim Shaipi dhe Agon Maliqi, 'Party Attitudes Towards the Society: Values, Religion, State and Individuality', FES, Prishtinë, 2009.
- Lëvizja FOL, 'EULEX: Anti-corruption and the limits of a quantitative assessment' (Prishtinë, 2016), ff.7-19.
- Lëvizja FOL, 'Shpërdorimet në Prokurimin Publik: Analizë për Shpërdorimin e Autoritetit Publik në fushën e prokurimit publik, (Prishtinë, 2012).
- Lëvizja FOL, 'Transparenca e Investimeve Publike në Infrastrukturën Rrugore: Promovimi i Transparencës dhe Llogaridhënies Publike në Infrastrukturë', (Prishtinë, 2010).
- Lëvizja FOL, 'Analizë e Ligjit të Prokurimit Publik në kontekstin e parimit të transparencës', (Prishtinë, 2012).
- NDI, 'Kosovo 2004 Central Assembly Elections'. Qasur në https://www.ndi.org/files/1761_ksv_assembly_102604.pdf (27 qershor 2016).
- NDI, 'Kosovë: Tejkalimi i Pengesave për Pjesëmarrjen e Grave në Politikë'. NDI. Shkurt, 2015.
- NDI, 'Kosovë: Tejkalimi i Pengesave për Pjesëmarrjen e Grave në Politikë'. NDI. Shkurt, 2015.

- OSCE, 'Kosovo Assembly Elections 2004 – CRS Results', Pristina, 3 nëntor 2004. Qasur në <http://www.osce.org/kosovo/25332?download=true> (27 qershor 2016).
- PIPS, 'Reforma Zgjedhore: Demokracia tek listat dhe zonat?'. Janar 2012, Prishtinë.
- Qendra Për Kurajo Politike, 'Klientelizimi dhe Rritja: Si të kanalizohen më mirë përprojekjet antikorrupsion', (Skicë politikash, Prishtinë, qershor 2016).
- Riinvest, 'Të paguash apo të mos paguash: Informaliteti nga këndvështrimi i bizneseve në Kosovë', (Prishtinë, FES dhe KFOS, 2013).
- The World Bank Group in Kosovo, 'Country Snapshot' (WB, tetor 2015).
- World Bank Group, 'Economic Profile 2016 Kosovo: Doing Business 2016 Measuring Regulatory Quality and Efficiency', (The World Bank, 2016).
- World Bank, 'Doing Business 2015: Going Beyond Efficiency', (International Bank for Reconstruction and Development / The World Bank, 2014).
- Transparency International, 'Corruption Perceptions Index 2015' (TI, 2016).
- Transparency International, 'Shining a light on Political Parties Financing. Albania, Croatia, Kosovo, FYR Macedonia, Serbia', 2011.
- UNDP dhe USAID, 'Pulsi Publik', Raporti 1. Mars 2011, Prishtinë.
- UNDP, Early Warning Reports, Kosovo, October – December 2005.
- United Nation Development Programme, 'Pulsi Publik XI', (Prishtinë, maj 2016),

Artikuj/Lajme në medie

- Ambasadorja e Gjermanisë: Protestat mund të jenë tentativë për bllokimin e Gjykatës Speciale', Gazeta Zëri, 18 nëntor 2015. Qasur në <http://zeri.info/aktuale/62740/ambasadorja-e-gjermanise-protestat-mund-te-jene-tentative-per-blokimin-e-gjykates-speciale/> (5 mars 2016).
- Arbana Xhara, 'S'ka bllok opozitar', Zëri, 16 tetor 2015. Qasur në <http://zeri.info/aktuale/56582/s-ka-bloko-opozitar-ka-interesa/> (17 korrik 2016).
- Augustin Palokaj, 'EULEX-i nuk mund t'i ikë përgjegjësisë për dështimet në Kosovë'. Kohanet. (28 shtator 2014).
- Bekim Shehu, 'Kuvendi i Kosovës miraton themelimin e Gjykatës Speciale', DW, 23 prill 2014. Qasur në <http://www.dë.com/sq/kuvendi-i-kosovës-miraton-themelimin-e-gjykatës-speciale/a-17587510> (5 nëntor 2015).
- Björg Hope Galtung, 'Kosovo: Assembly Elections October 2004', Nordem Report 02/2005. Qasur në <http://www.jus.uio.no/smr/english/about/programmes/nordem/publications/2005/0205.pdf> (27 qershor 2016).
- D4D vëzhgon zgjedhjet parlamentare 2014', 8 qershor 2014, D4D. Shih <http://d4d-ks.org/aktivitetet/d4d-vezhgon-zgjedhjet-parlamentare-2014/> (qasur 26 qershor 2014).
- 'Dalja ne zgjedhje. Komisioni Qendror Zgjedhor. Shih <http://rezultatet.kqz-ks.org/NightResults/Results.aspx?RaceID=1&UnitID=1&IsPS=0&Turnout=3&LangID=2> (me 24 qershor 2014).
- 'Ambasadorja gjermane kërkon dialog në vend të dhunës në Kosovë', Qasur në <http://www.telegrafi.com/ambasadorja-gjermane-kerkon-dialog-ne-vend-te-dhunes-ne-kosove/> (18 qershor 2016).
- 'Demi: Paqartësi në premtimet për zhvillim ekonomik', Lajmi.net. 7 qershor 2014. Shih <http://lajmi.net/demi--paqartesi-ne-premtimet->

per-zhvillim-ekonomik_100069106.html (qasur me 25 qershor 2014).

Embassy of the United States Pristina – Kosovo, ‘Ambassador Delaëie’s Interview with Koha Ditore’, 2 tetor 2015. Qasur në http://pristina.usembassy.gov/interview_kd_2015.html (5 qershor 2016).

Genc Nimoni, ‘Konfrimohet Dënimi ndaj Zharkut, Kacaniku në zgjedhje’, *Gazeta Jeta në Kosovë*, 08.05.2012. Qasur në <http://gazetajnk.com/?cid=1,1018,2105> (23 mars 2015); ‘VV-ja: Muja, kreu i katër komunal (nga PDK) i akuzuar për korrupsion’, *Kohanet*, 27.02.2013. Qasur në <http://koha.net/?id=8&arkiva=1&l=136749> (20 mars 2015); Jeton Musliu ‘Raporti Mjekësor që e mban Xhemajlin jashtë burgut’, *Gazeta Jeta në Kosovë*, 24.10.2012. Qasur në <http://gazetajnk.com/?cid=1,3,3344> (20 mars 2015).

Intervistë me Ambasadoren Gjermane: Të themelohet një Komision Ndërmjetësues për tejkalimin e krizës’, *Gazeta Express*, 9 mars 2016. Qasur në <http://www.gazetaexpress.com/intervista/interviste-me-ambasadoren-gjermane-te-themelohet-nje-komision-ndermjetesues-per-tejkalimin-e-krizes-video-174615/> (10 mars 2016).

Komisioni Qendër Zgjedhor, ‘Rezultatet përfundimtare të kandidatëve’, zgjedhjet 2014. Qasur në http://www.kqz-ks.org/Uploads/Documents/20140701%20Candidates%20Seats%20Allocation_bspfuqvtz.pdf (23 prill 2015).

Kurti: Koalicioni PDK-LDK u bë për të heshtur dosjet e SHIK-ut e Mustafës’, *Kohanet*, 20 nëntor 2014. Qasur në <http://koha.net/?id=27&l=33985> (13 korrik 2015); ‘Ramush Haradinaj: Koalicioni PDK-LDK, fatkeqësi për vendin’, *Kohanet*, 20 nëntor 2014. Qasur në <http://koha.net/?id=27&l=33954> (13 korrik 2015); ‘Kurti: Koalicioni PDK-LDK u bë për të heshtur dosjet e SHIK-ut e Mustafës’, *Kohanet*, 20 nëntor 2014. Qasur në <http://koha.net/?id=27&l=34003> (13 korrik 2015).

- Lëvizja Vetëvendosje, 'Historiku i Lëvizjes Vetëvendosje!'. Qasur në http://www.vetevendosje.org/wp-content/uploads/2013/09/Historik_i_Levizjes_VETEVENDOSJE.pdf (15 shkurt 2015);
- Lëvizja Vetëvendosje, 'Jo negociata, sepse'. Qasur në http://www.vetevendosje.org/ep-content/uploads/2013/09/jo_negociata_sepse.pdf (12 shkurt 2015).
- Marija Ristic, 'Gjykata Speciale e Kosovës: Si do të funksionoj ajo?', BIRN, 6 gusht 2015. Qasur në <http://www.balkaninsight.com/al/article/gjykata-speciale-e-kosoves-si-do-te-funksionoj-a-08-05-2015> (25 korrik 2016).
- Nën hetime: 256 zyrtarë të lartë, 17 kryetarë komunash, ministra, zëvendësministra'. Telegrafi, qershor 2016. Qasur në <http://www.telegrafi.com/nen-hetime-256-zyrtare-te-larte-17-kryetare-komunash-ministra-zevendesministra/> (29 korrik 2016).
- Petrit Collaku, 'Kosovo Elects Neë President', Balkan Insight, 7 prill 2011. Qasur në <http://www.balkaninsight.com/en/article/kosovo-elects-new-president> (12 qershor 2016).
- Reforma zgjedhore në dorën e partive politike, jo të Komisionit të Venecias', Telegrafi, 6 janar 2014. Shih <http://www.telegrafi.com/lajme/reforma-zgjedhore-ne-doren-e-partive-politike-jo-te-komisionit-te-Venecias-2-39857.html> (15 janar 2014).
- State Union of Serbia and Montenegro, 'Constitutional Charter of the State Union Serbia and Montenegro', 2002. Qasur në http://www.worldstatesmen.org/SerbMont_Const_2003.pdf (5 korrik 2015).
- Tanjug, 'EU dissatisfied with electoral reform in Kosovo', 20 April 2012. Qasur në http://www.b92.net/eng/news/politics.php?yyyy=2012&mm=04&dd=20&nav_id=79861 (10 janar 2014)
- Vehbi Kajtazi, 'Transaksionet e dyshimta nga fondi i 3 %-shit – tërheqje parash deri në vitin 2012', Insajderi, 19 shkurt 2016. Qasur në <http://www.insajderi.com/hulumtime/transaksionet-e-dyshimta->

nga-fondi-i-3-shit-terheqje-parash-deri-ne-vitin-2012/ (2 qershor 2016).

Zgjedhjet Parlamentare në Kosovë: Deklaratë për Media. Misioni i Bashkimi Evropian për Vëzhgimin e Zgjedhjeve. Prishtinë, 9 qershor 2014. Shih

http://www.eueom.eu/files/pressreleases/other/eueom-kosovo2014-preliminary-statement_sq.pdf (qasur 24 qershor 2014).

‘Lunacek mirëpret propozimin e Osmanit e Dedës’, Shih <http://koha.net/?id=27&l=85365> (10 mars 2016).

‘Marrëveshja që Osmani e Deda kanë propozuar për dalje nga kriza’, Gazeta Zëri, 20 nëntor 2015. Qasur në

<http://zeri.info/aktuale/63101/kjo-eshte-propozim-marreveshja-e-propozuar-nga-deda-dhe-osmani-per-dalje-nga-kriza-dokument/>

‘Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare në Kosovë’, DW, 8 qershor 2014. Shih <http://www.dw.de/zgjedhjet-e-parakohshme-parlamentare-ne-kosove/a-17691895> (qasur me 23 qershor 2014).

‘Ja Marrëveshja e Plotë PDK – LDK’, Kallxo.com. 18 dhjetor 2014. Shih <http://kallxo.com/ja-marreveshja-e-plote-pdk-ldk-dokument/> (23 korrik 2016).

‘Komunikatë për Media’, 8 qershor 2014, Demokraci në Veprim. Shih http://www.demokracianeveprim.org/al/index.php?subaction=show_full&id=1402268182&archive=&start_from=&ucat=1& (24 qershor 2014).

‘Kosovo parliament hit by fresh tear-gas protest’, BBC News, 14 dhjetor 2015. Qasur në <http://www.bbc.com/news/world-europe-35096489> (15 qershor

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

329(496.51)
342.8(496.51)

Beha, Adem

Mes stabilitetit dhe demokratizimit : zgjedhjet, partitë
politike dhe demokracia brendapartiake në Kosovë / Adem
Beha. – Prishtinë : CPC & FES, 2017. – 311 f. ; 21 cm.

Bibliografia : f. 285-305

Ky studim plotëson një boshllëk të madh në literaturën e mangët për sistemin politik dhe demokracinë e Kosovës, duke ndihmuar njëkohësisht në të kuptuarit më të hollësishëm të procesit të demokratizmit dhe të rolit të aktorëve politikë kryesorë në këtë proces. Meqenëse sistemi zgjedhor dhe ai partiak ndikojnë konsiderueshëm në funksionimin e shteteve dhe demokratizimin e tyre, studimi shtjellon ndërlidhjen e tyre, duke analizuar këto raporte si në lidhjet e tyre shkakore ashtu edhe në ndryshimet që pësuajnë këto ndër vite. Veçanërisht kreu mbi demokracinë brendapartiake arrin të zbërthejë suksesshëm disa prej faktorëve kyç që ndikojnë në reformimin e partive politike dhe në konsolidimin e demokracisë në vend.

Prof. Asoc. Dr. Bekim Baliqi, Universiteti i Prishtinës

Me këtë studim origjinal, Adem Beha i jep një kuadër të plotë kërkimit mbi partitë politike në Kosovë. Ky është ndër studimet e para shkencore mbi këtë temë nga një politolog kosovar. Studimi kryqëzon një qasje konfiguracioniste dhe një analizë të aspekteve të organizimit të partive politike. Ai analizon dinamikat specifike të partive politike duke filluar nga gjeneza e formimit të tyre, konjunktura politike kosovare dhe konkurrenca politike ndërmjet tyre, për t'i kuptuar interesat praktikë dhe simbolikë të partive dhe të liderëve politikë. Ky studim analizon transicionin e ngecur të Kosovës drejt demokracisë. Me një objektivitet të përpiktë, i pasuruar me analiza të detajuara dhe me informacione të rralla, studimi është i mirëseardhur për shkencën politike kosovare dhe shkencën politike në përgjithësi.

Prof. Ass. Dr. Anton Vukpalaj, Universiteti i Prishtinës

Studimi i Adem Behës për demokracinë partiake në Kosovë paraqet studimin e parë serioz shkencor mbi këtë fushë nga një akademik kosovar. Beha konsideron dinamikat brenda dhe mes partive politikë si thelbësore për suksesin e shtetndërtimit në Kosovë. Ai argumenton fuqishëm se partitë politike si agentët dominues vendorë në proceset transicionale para dhe pas pavarësisë kanë dështuar në demokratizimin brendapartiak, si dhe në demokratizimin e institucioneve dhe të shoqërisë kosovare. Prandaj, studimi ofron një kontribut të vlefshëm në debatet aktuale akademike mbi rolin dhe ndikimin e agentëve vendorë për formësimin e paqes dhe ndërtimin e shteteve pas konflikteve të dhunshme. Ky punim shkencor duhet të lexohet me kujdes nga përfaqësuesit e partive politike, shoqëria civile dhe komuniteti akademik në Kosovë e më gjerë.

Dr. Gëzim Visoka, Dublin City University

ISBN 978-9951-8857-3-7



9 789951 885737